



ISBN 978-9928-210-06-7

ISSN 2413-1334

Konferenca e II-të Shkencore Ndërkombëtare

VËLLIMI I DYTË



# Policimi dhe **SIGURIA**

Shkencat ligjore dhe sfidat  
bashkëkohore të sigurisë

NËNTOR  
2017

PROCEEDINGS  
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2017



**POLICIMI DHE SIGURIA**  
**AKADEMIA E SIGURISË**

POLICIMI DHE SIGURIA

Shkencat ligjore dhe sfidat  
bashkëkohore të sigurisë

---

PROCEEDINGS

---

*Vëllimi II*

**© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.**

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të këtij botimi, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

**Akademia e Sigurisë**

Shkenca ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë :  
konferenca 2-të ndërkombëtare : Tiranë, nëntor 2017 :  
proceedings / Akademia e Sigurisë. - Tiranë : Akademia  
e Sigurisë, 2017

Vol. 2 ; 253 f. ; 16.5 X 24cm.

ISBN 978-9928-210-06-7

1.Policia 2.Siguria kombëtare 3.Kriminologjia  
4.Bashkimi ndërkombëtar 5.Konferenca

351.74 (062)

343.9 (062)

NR **9**  
NËNTOR  
2017

## BORDI EDITORIAL

### Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

### Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Sebastiano TAFARO

Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

### Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

### Përkthyes

Vangjel LILI

Lavdim KAZAZI

### Punimet grafike

Andi OSMANI

### Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,  
Akademia e Sigurisë

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë”

## Bordi Shkencor/ Scientific Committee

### Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Giovanni **ARCUDI**, Universiteti i Romës “Tor Vergata”

### Anëtarët/Members

Prof. Dr. Ismet **ELEZI**, *Kriminolog*  
Prof. Ali **CHADLY**, *Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Monastir (Tunizi)*  
Prof. Dr. Irakli **KOCOLLARI**, *Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit"*  
Prof. Dr. Sebastiano **TAFARO**, *Universiteti i Barit*  
Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO**, *Akademia e Sigurisë, Tiranë*  
Prof. Asc. Rauf **DIMNAJ**, *Zv. Minister i Arsimit dhe Sporteve*  
Prof. Asc. Ferdinand **ELEZI**, *Prokuroria e Apelit Durrës*  
Prof. Asc. Nikola **DUJOVSKI**, *Fakulteti i Sigurisë, Shkup*  
Prof. Asc. Luan **VELICOTI**, *Kolegji Universitar "Luarasi" Tiranë*  
Dr. Blerim **OLLURI**, *Kryeshef Ekzektiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë*  
Dr. Frenk **HARIS**, *MSc, D.Crim.J., University of Portsmouth*  
Dr. Sandër **LLESHI**, *Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave*  
Dr. Bilbil **MEMAJ**, *Rektor/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë*  
Dr. Xhavit **SHALA**, *Akademia e Sigurisë, Tiranë*  
Dr. Artur **BEU**, *Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*  
Dr. Admir **SINAMATI**, *Instituti i Mjekësisë Ligjore, Tiranë*  
z. Ismail **SMAKIQI**, *Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Kosovë*

## Komiteti organizator/Organizational committee

Drejtuues i Lartë Dr. Bilbil **MEMAJ**, *Drejtori i Akademisë së Sigurisë, Tiranë*  
Drejtuues Dr. Xhavit **SHALA**, *Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë*  
Drejtuues Msc. Xhevahir **ÇELOALIAJ**, *Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore*  
Kryekomisar Msc. Bilbil **DERVISHI**, *QKSH, Akademia e Sigurisë*  
Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, *Redaktor shkencor, Akademia e Sigurisë Tiranë.*

## Sekretariati dhe koordinimi/secretariat and coordination

Dr. Irvin FANIKO, *Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë Tiranë, (përgjegjës)*  
Msc. Anisa AGASTRA, *Spektori i Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (koordinatore e konferencës)*  
Andi OSMANI, *Spektori i Botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (anëtar)*

## Redaktor Shkencor

Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, *Akademia e Sigurisë, Tiranë*

### Punimet grafike

Andi Osmani

### Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2017

# Përmbajtja


## SESIONI II/Second Section

Këndvështrime profesionale të shkencave forenzike në hetimin e skenës së krimit, në aspektin ligjor e më gjerë

<b>Prof. Asoc. Luan VELIQOTI</b> Kriminalistika dhe kontributi në këqyrjen e vendit të ngjarjes . . . . .	14
<b>Prof. Dr. Ilirjan MANDRO</b> Rëndësia e eksperimentit hetimor gjatë procesit të hetimit . . . . .	32
<b>Msc. Arjan MUÇAJ</b> Ekspertimet kompjuterike, një sfidë e rëndësishme për luftën kundër krimit . . . . .	48
<b>Msc. Blerim KRASNIQI</b> Forenzika digjitale në shërbim të ligjit. . . . .	58
<b>Dr. Sc. Xhemajl ADEMAJ, Dr. Sc. Blerim OLLURI</b> Parandalimi i akteve terroriste - strategjia ligjore në Kosovë, Shqipëri, EU dhe SHBA . . . . .	68
<b>Msc. Dritan ZOTO</b> Pajisjet eksplozive të improvizuara (PEI). . . . .	78
<b>Msc. Xhevaïr ÇELOALIAJ</b> Akreditimi – e ardhmja e Institutit të Policisë Shkencore Shqiptare . . . . .	92
<b>Cand. PhD Milazim TAHIRUKAJ, Dr. Sc. Blerim OLLURI, Dr. Sc. Xhemajl ADEMAJ</b> Optimizimi i parametrave «fragmentor voltage» dhe «collision energy», për identifikimin dhe ndarjen «pentaerythritol tetranitratit» (PETN) me anë të “LC-MS/MS” . . . . .	104
<b>Msc. Tonin VOCAJ</b> Hetimi i vrasjeve, rëndësia e gjetjes dhe administrimit të provave . . . . .	112
<b>Msc. Nikolin DURAJ, Msc. Shpetim HUDAJ</b> Rëndësia e eksaminimit të provave materiale balistike dhe sqarimi i mekanizmit të ngjarjes, në këndvështrimin e balistikës kriminalistike. . . . .	134
<b>Dr. Vladimir IKONOMI, Dr. Viktor HAJDARI</b> Aspekte juridike dhe kriminalistike, të ekspertimit të dokumenteve joorigjinale . . . . .	148

<b>Msc. Kastriot GJOKA</b> Përtej kopjimit apo rikuperimit automatik, nga sistemet e kamerave të sigurisë (DVR) . . . . .	156
<b>Msc. Ela ZAIMI</b> Studimi i frekuencave alelike të popullatës shqiptare dhe, rëndësia e saj, për shkencën e biologjisë ligjore, në Shqipëri. . . . .	170
<b>Msc. Orest AFEZOLLI</b> Sistemi AFIS/APIS dhe zbatimi i kësaj teknologjie, në luftën kundër kriminalitetit . . . . .	176
<b>Msc. Eda GJOKA</b> Aspekte të dokumentimit ligjor, të dhunës me bazë gjinore. . . . .	194
<b>Dr. Valbona MUÇA, Dr. Eglantina DERVISHI, Dr. Eilsabeta KAFIA</b> Ndryshore mbi problematikat e sjelljes antisociale e delinkuente së të rinjve, në mjediset penitenciare në Shqipëri. . . . .	206
<b>Msc. Dashamir ÇALI</b> Teknologjia e informacionit në Policinë e Shtetit, në drejtim të dokumentimit ligjor të aktivitetit kriminal . . . . .	214
<b>Abstraktet në anglisht / Abstracts. . . . .</b>	242





## **AKADEMIA E SIGURISË**

KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, nëntor 2017, Tiranë

Në bashkëpunim me Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Fakultetin e Sigurisë në Shkup, Universitetin e Barit dhe Fakultetin e Mjekësisë në Monastir (Tunizi), Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia e Forenzikës së Kosovës

SHKENCAT LIGJORE DHE SFIDAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË  
FORENSIC SCIENCES AND CONTEMPORARY SECURITY CHALLENGE

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

**KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE**  
**Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë**  
*Nëntor 2017, Tiranë*

**Fokusi i konferencës**

Në format e tij bashkëkohore, kriminaliteti përbën sot një faktor me ndikim në rritje në mjedisin e sotëm strategjik e të sigurisë, i cili karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga të panjohura dhe nga mundësitë e zhvillimeve krejtësisht të paparashikueshme. Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit adekuat të rreziqeve të ardhshme, i detyron strukturat e sigurisë që të orientohen drejt krijimit të kapaciteteve polivalente, të cilat duhet të jenë të afta që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura.

Përmirësimi i sundimit të ligjit, përbën për ne një domosdoshmëri strategjike dhe kjo, ndërmjet të tjerave, kërkon fuqizimin dhe modernizimin e Policisë së Shtetit, përmes përmirësimit të kapaciteteve të hetimit dhe informacionit, me qëllim rritjen e kontrollit mbi territorin dhe përmirësimin e aftësive parandaluese dhe goditëse ndaj krimit. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, për të siguruar zbatimin e rreptë të ligjit, është prioritet i adresuar në “Planin kombëtar për integrimin evropian 2016-2020” dhe planin e veprimit në zbatim të tij. Problematika e kriminalitetit dhe procesi i hetimit rreth zbulimit, analizimit, masave dhe mënyrave të parandalimit, kërkon sofistikim të fushave specifike të shkencave ligjore, që përfshin aplikimin e metodave shkencore për të zgjidhur problemet që lidhen me ligjin, hetimin, mënyrat apo mjetet e përdorura. Ndërmarrja e projekteve, studimeve e kërkimeve në fushën e shkencave ligjore, përfshin aplikimet shkencore, punimet, trajnimet, studimet dhe analizat e thelluara, lidhur me fusha të ndryshme të shkencave ligjore, në kuadër të zhvillimit

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

dhe përmirësimit të këtyre shkencave, përmirësimit të punës së punonjësve e profesionistëve, të gjetjes së formave të reja, të metodave shkencore e teknologjike të zbulimit e hetimit të krimit, të rishikimit e ndikimit të tyre në aspektin ligjor e më gjerë, rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së testimave dhe intervistimeve profesionale, etj., në kuadër të ndërtimit të strategjive të nevojshme të identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të krimit. Kjo konferencë, shërben në kuadrin shkencor, për të ndihmuar institucionet, programet, agjencitë, individët, ekspertët, për të bashkëpunuar dhe për të ndarë burimet, informacionet dhe ekspertizën në lidhje me shkencat ligjore, aplikimin dhe rëndësinë e tyre, me në fokus krijimin e mundësive për rrjetëzim, bashkëpunim dhe këmbim të ideve me udhëheqës, profesionistë, ekspertë e studiues në nivel kombëtar e ndërkombëtar për përmirësimin, sofistikimin e zbulimin e metodave e mënyrave për hetimin e krimit dhe impaktin në sigurinë publike.

### **Objekti i konferencës**

Objekti i konferencës është trajtimi në mënyrë gjithëpërfshirëse nga disiplina të ndryshme të shkencave ligjore, nëpërmjet punimeve të mirëfillta shkencore në nivel të gjerë kombëtar e ndërkombëtar, i rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga kriminaliteti bashkëkohor, përgjithësimi i përvojës më të mirë, zgjerimi i dijeve aplikative, dhënia e rekomandimeve për hartimin e politikave për përmirësimin e punës në shërbim të një policimi më efektiv.

### **Qëllimi i konferencës**

Qëllimi i konferencës është mbledhja, përpunimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar shkencor të fushës së shkencave ligjore, për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor; trajtimi në këndvështrim analitik e në mënyrë shkencore të aplikimit të disiplinave të ndryshme të shkencave ligjore në hetimin e krimeve në Shqipëri, në aspektin ligjor e më gjerë, në varësi të fushave specifike e profesionale, kontributit dhe rëndësisë së tyre në punën e punonjësve të policisë e më gjerë; evidentimi i problematikave dhe nevojave për përmirësimin e punës nëpërmjet zhvillimit të dijeve, teknikave të reja e modeleve të përparuar të këtyre disiplinave, përballë sfidave të kriminalitetit bashkëkohor.

### **Synimi i konferencës**

Kjo konferencë synoi të bashkojë njëzëri akademikë, shkencëtarë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të shkencave ligjore, për të ndarë eksperiencat, praktikat, punimet shkencore dhe gjetjet, për të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të forensikës në raport me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

### **Tipi i konferencës**

Konferenca është shkencore ndërkombëtare, në një auditor me staf akademik të Akademisë së Sigurisë, studiues dhe ekspertë vendas dhe të huaj të çështjeve të sigurisë, drejtues dhe specialistë të strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive të tjera ligjzbatuese, përfaqësues të misionëve policore që asistojnë Policinë e Shtetit, përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve e universiteteve policore partnere të huaja.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

## Struktura e konferencës

### Sesioni I

Aspektet gjithëpërfshirëse të disiplinave forensike; impakti në sigurinë publike dhe në arsim, me nënçështje si:

- Praktikimi i shkencave ligjore në mjediset sfiduese: perspektivat ndërkombëtare.
- Sfidat dhe mundësitë në epokën e re të optimizimit të reformave kërkimore në shkencat ligjore.
- Shkencat ligjore në Shqipëri – perspektiva e zhvillimit të tyre.
- Hulumtime mbi kuptimin, saktësinë, besueshmërinë dhe matjen e vlefshmërisë të disiplinave të shkencave ligjore.
- Trajtim në aspektin ekonomik dhe të fondeve mbi kërkimin, zhvillimin dhe vlerësimin e shkencave ligjore.
- Këndvështrim mjekoligjor i zhvillimit të hetimit në skenën e krimit: metodat, identifikimi, zbulimi, interpretimi dhe evidentimi i problematikave.
- Aplikimi i disiplinave të shkencave ligjore për qëllimet e drejtësisë penale: ligjet civile dhe penale.
- Hulumtime dhe zhvillime për laboratorët e financuar nga burimet e shkencës ligjore për të vlerësuar testimin dhe përpunimin e dëshmimeve fizike.
- Studime rasti: menaxhimi dhe qasjet e suksesshme bashkëpunuese dhe multidisiplinare, për hetimin e vrasjeve të profilit të lartë dhe komplekse.
- Gabimet e sistemit të drejtësisë dhe bindjet e gabuara.
- Sfidat e policisë: identifikimi i substancave që mund të jenë lloje të ndryshme drogash të palejueshme nën metodologjinë që ofron forensika.
- Efikasiteti i testeve dhe intervistave më profesionale në fushën e forensikës, përballë vështirësisë dhe nevojës për identifikim.
- Analizë e thelluar mbi programin arsimor e trajnues në lidhje me ekspertizën e disiplinave të ndryshme të forensikës.
- Diapazoni i shkencave ligjore dhe kërkimet kriminale në policinë shqiptare dhe në policitë e vendeve fqinje.
- Aspekte ligjore në lidhje me forensikën në Shqipëri: modele praktikash.

### Sesioni II

Këndvështrime profesionale të shkencave forensike në hetimin e skenës së krimit, në aspektin ligjor e më gjerë, me nënçështje si:

- Evidencat forensike për marrjen e gjurmëve të gishtave: hulumtime dhe propozime.
- Analiza dhe interpretime për mënyrën e mbledhjes së provave dhe të dhënave në procesin e hetimit: metoda dhe mënyra të reja për përmirësimin e procesit.
- Analizë Instrumentale për aplikime të shkencave ligjore: niveli i efektivitetit në procesin e hetimit dhe në punën e punonjësit të policisë.
- Kriminialistika dhe kontributi i saj në këqyrjen e vendit të ngjarjes.
- Aspektet mjekoligjore të dëmtimeve: diagnoza specifike dhe studime rasti.
- Niveli i zhvillimit të entomologjisë ligjore në Shqipëri dhe matja e kohës që ka kaluar nga vdekja e trupit të viktimës.
- Këndvështrim analitik e krahasues i procedimit me dokumentacionin: organizimi, mbledhja, interpretimi i të dhënave dhe sfidat.

- Prezantimi i modeleve të dëshmimeve në sistemin gjyqësor: roli i ekspertizës forensike në organizimin dhe interpretimin e të dhënave.
- Hulumtime biometrike dhe analizë e ADN-së për identifikimin e burimeve të kampionit: rastet e pazgjidhura dhe ato të pasdënimit.
- Rëndësia e ndërtimit të profilit fizik e psikologjik të autorit e viktimës: këndvështrim nga psikologjia forensike.
- Perspektiva e balistikës kriminalistike në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- Aspektet forensike të çështjeve të migrimit.
- Teknologjitë e reja në fushën e forensikës, provat digjitale dhe krimet kibernetike.
- Droga të reja, çështje të reja, metoda të reja doping.
- Dhuna ndaj grave dhe personat vulnerabël.
- Terrorizmi dhe konfliktet e armatosura.
- Integrimi i provave forensike në hetimet nga oficerët e policisë: kujdesi në paraburgim.
- Zbatimi i metodave dhe teknikave të reja bashkëkohore në ekspertim në prova shkencore, procesin penal dhe civil.

### **Pjesëmarrja në konferencë**

Pjesëmarrja ishte ftesë e hapur, për stafin akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe nga vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare, partnere të Policisë së Shtetit etj.



*Sesioni II / Second Section*

Këndvështrime profesionale  
të shkencave forenzike në hetimin e skenës së krimit,  
në aspektin ligjor e më gjerë

# Kriminalistika dhe kontributi në këqyrjen e vendit të ngjarjes

Prof. Asc. Dr. Luan VELIQOTI

Universiteti "Luarasi", Tiranë

luanveliqoti@yahoo.com

## Abstrakt

Kriminalistika është shkencë e zbulimit dhe e të provuarit të krimit. Si e tillë lindja e saj është e hershme, sepse shoqëria njerëzore vazhdimisht ka qenë e interesuar të zbulojë krimet, që gjithashtu kanë qenë të vazhdueshme e shqetësuese për të. Në fillimet e saj, metodat dhe mjetet që ajo ka zbatuar kanë qenë sa empirike aq edhe në cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në gjysmën e dytë të shek. të XIX-të, meqenëse zhvillimet ekonomike e shoqërore në Evropë u shoqëruan edhe me rritje të kriminalitetit, gjë që shtronte kërkesën për luftën dhe parandalimin e tij, ajo merr formën e një shkence me objekt e qëllim konkret. Zbulimin dhe të provuarit e kryerjes së krimit shkencë e kriminalistikës e realizon nëpërmjet përpunimit dhe zbatimit të metodave shkencore teknike e taktike, si dhe të rekomandimeve metodike për të kërkuar, zbuluar, fiksuar e marrë gjurmë dhe sende prova materiale të krimit të kryer, me qëllim zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e veprave penale. Për të realizuar objektin e saj, shkencë e kriminalistikës bazohet në një metodologji dhe metoda e mjete teknike që janë ekskluzivisht të saj. E gjithë kjo veprimtari bazohet në legjislacionin penal e procedural penal dhe në etikën penale. Për këtë arsye ajo përfshihet dhe bën pjesë në shkencat juridike, në departamentin e shkencave penale. Për shkak të objektit të saj, të vështirësisë që ka zbulimi dhe të provuarit e krimit, kriminalistika ka disa veçori nga shumë shkencë të tjera, atë që përbën "natyrën shkencore të saj", të cilat janë: lidhja me shumë shkencë të tjera; formim dhe kualifikim i veçantë i lektorit që do ta zhvillojë këtë disiplinë; bazë laboratorike e didaktike e veçantë, mbështetja e veprimtarisë së saj në disa parime e metoda që janë ekskluzivisht të saj; zgjerimi dhe zhvillimi më i shpejtë i çështjeve që përfshin objekti i saj. Ndër mjetet e kërkimit të provës bën pjesë edhe këqyrja e vendit të ngjarjes. Për të kryer këtë veprim hetimor kriminalistika ka përpunuar një sërë metodash shkencore teknike e taktike, ka bërë një sërë shpjegimesh e rekomandimesh, që ndryshe quhet: "Natyra juridike e vendngjarjes", për të rritur efektivitetin, ligjshmërinë dhe nivelin shkencor të tij.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**natyra shkencore e kriminalistikës, natyra juridike e këqyrjes së vendit të ngjarjes, profilli i autorit të vendngjarjes.**



## 1. Hyrje

Në këtë punim trajtohet kuptimi i shkencës së kriminalistikës, vendin që ajo zë dhe lidhja me shkencën tjetër, brenda dhe jashtë bllokut të shkencave të jurisprudencës. Në të trajtohet natyra shkencore e saj, zhvillimi dhe perspektiva e saj në ndihmë të luftës kundër kriminalitetit. Kontributi i kriminalistikës për këqyrjen e vendit të ngjarjes konsiston në: përpunimin e metodave shkencore taktike dhe mjeteve teknike kriminalistike, si dhe duke dhënë një sërë shpjegimesh e rekomandimesh për: kuptimin e nocionit vendngjarje, masat përgatitore për ta kryer atë, natyra juridike dhe veçoritë që ajo mbart në krahasim me veprime të tjera hetimore që kryhen për mjetet dhe llojet e tjera të provave, metodat taktike të këqyrjes, këqyrja e objektit kryesor, ndërtimi i profilit të autorit të krimit, si dhe metoda për fiksimin dhe përskrimi e hollësishëm të rezultateve të këqyrjes në procesverbal, fotografi e skica. Në të trajtohet, gjithashtu edhe ndërtimi i profilit të autorit të krimit në një vendngjarje, për të ngritur versione hetimore të drejta, për të orientuar hetimin në drejtimin e duhur dhe shpejtuar në zbulimin e autorit të krimit. Meqenëse një pjesë e çështjeve të mësipërme janë të trajtuara e gjenden në literaturë, në këtë shkrim përqendrohet në disa elementë të natyrës juridike të këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe ndërtimi i profilit të autorit të saj.

Shkrimi mbyllet me disa përfundime dhe literaturën e shfrytëzuar për përgatitjen e tij. Përgatitja e këtij punimi është mbështetur në metodën e studimit, të analizës dhe të krahasimit. Për të është shfrytëzuar një literaturë e gjerë, si dhe praktika hetimore e gjyqësore. Në funksion të titullit të punimit, por edhe të lidhjeve me njëra-tjetrën të çështjeve të trajtuara në të, çështje të trajtuara jepen shumë shkurt me referencat përkatëse, ndërkaq që i është dhënë përparësi atyre të pa trajtuara më parë.

Punimi paraqet rëndësi mbasi zhvillon më tej kuptimin dhe rëndësinë e shkencës së

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

kriminalistikës, dhe bashkë me të, një kapitull të rëndësishëm të saj, një ndër mjetet e kërkimit të provës, siç është këqyrja e vendit të ngjarjes. Me rekomandimet dhe përfundimet e nxjerra e bëjnë atë një risi në literaturën e kriminalistikës, të luftës për zbulimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

## 2. Kriminalistika dhe lidhja me shkencat e tjera

Krimin, si një dukuri negative dhe bashkëshoqëruese e njerëzimit, e studiojnë disa shkencat, si: e drejta penale, procedura penale, kriminalistika, kriminologjia etj. Secila prej tyre e studion në funksion të objektit të vet, me qëllim që njohuritë e të tërave së bashku të bëjnë të mundur zbulimin dhe parandalimin e tij, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë luftë një kontribut të çmuar jep edhe kriminalistika, e cila është shkencë e zbulimit dhe e të provuarit të krimit. Si e tillë lindja e saj është e hershme, sepse shoqëria njerëzore vazhdimisht ka qenë e interesuar të zbulojë krimet, që gjithashtu kanë qenë të vazhdueshme e shqetësuese për të. Në fillimet e saj, metodat dhe mjetet që ajo ka zbatuar kanë qenë sa empirike aq edhe në cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në gjysmën e dytë të shek. të XIX-të, meqenëse zhvillimet ekonomike e shoqërore në Evropë u shoqëruan edhe me rritje të kriminalitetit, gjë që shtronte kërkesën për luftën dhe parandalimin e tij, ajo merr formën e një shkence me objekt e qëllim konkret. Zbulimin dhe të provuarit e kryerjes së krimit shkencë e kriminalistikës e realizon nëpërmjet përpunimit dhe zbatimit të metodave shkencore teknike e taktike, si dhe të rekomandimeve metodike për të kërkuar, zbuluar, fiksuar, marrë dhe ekzaminuar gjurmë dhe sende prova materiale të krimit të kryer. Për të realizuar objektin e saj, shkencë e kriminalistikës bazohet në një metodologji dhe metoda e mjete teknike, një pjesë e të cilave janë ekskluzivisht të saj. E gjithë kjo veprimtari bazohet në legjislacionin penal e procedural penal dhe në etikën penale. Për këtë arsye ajo përfshihet dhe bën pjesë në shkencat juridike, në departamentin e shkencave penale<sup>1</sup>.

Për shkak të objektit të saj, të vështirësisë që ka zbulimi dhe të provuarit e krimit, kriminalistika lidhet me shumë shkencat e tjera, njohuritë e të cilave i përshtat në funksion të objektit të vet. Kriminalistika ka lidhje të ngushtë me të *drejtën penale dhe procedurën penale*, të cilat përbëjnë bazën ligjore të saj. Metodat shkencore teknike, taktike e metodike që kriminalistika përpunon janë në funksion të objektit së të provuarit të një krimi, të evidentimit të elementëve përbërës të një figure vepr penale, që është objekt i së drejtës penale. Ndërkaq zbulimi dhe të provuarit e krimit bëhet nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provës dhe llojeve të tjera të provave, të parashikuara në shkencën e procedurës penale, çka kërkon që, krahas zbulimit të tyre, ato të formalizohen sipas këtyre dispozitave procedurale. Nga ana e vet kriminalistika, nëpërmjet metodave shkencore teknike e taktike të përpunuara prej saj, rrit efektivitetin e veprimeve hetimore të kryera për zbulimin e dhe formalizimin ligjor të provave. Kriminalistika lidhet edhe me kriminologjinë, me mjekësinë ligjore, psikiatrinë ligjore dhe të drejtën civile<sup>2</sup>.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>1</sup> Në këtë shkrim nuk trajtohet metodologjia, metodat dhe mjetet teknike që përdor kriminalistika, parimet ku ajo mbështetet, lindja dhe zhvillimi i saj, si dhe Policia e Shtetit, policia shkencore dhe organi procedural: policia gjyqësore, prokurori dhe gjykata, të cilat njohuritë e kriminalistikës i përdorin gjerësisht në zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e veprave penale. Për më gjerë shih: L. Veliqoti, *Kriminalistika*, Tiranë 2015, f. 13-37.

<sup>2</sup> Lidhja e kriminalistikës me shkencat e së drejtës penale, të procedurës penale, të kriminologjisë, të mjekësisë e psikiatrinë ligjore dhe të drejtën civile trajtohet shkurt, mbasi është e shtjelluar në literaturë. Për më gjerë shih: L. Veliqoti, *Kriminalistika*, Tiranë 2015, f. 17.

*Kriminalistika lidhet edhe me viktimologjinë*, si shkenca që studion viktimën. Metodrat dhe teknikat kriminalistike që përdoren për zbulimin e autorit të krimit, rrethanat dhe situatat në të cilat është kryer vepra penale dhe pasojat e shkaktuara, njëherësh sqarojnë edhe rolin e viktimës dhe faktorët viktimogjenë në të cilat kanë ndodhur rastet e viktimizimit. Përcaktimi i mekanizmit të krimit, mënyrës dhe mjetet e kryerjes së krimit, nga të cilat viktima është dëmtuar, ndihmojnë gjykatën për vendim të drejtë në gjykimin e çështjes konkrete në tërësi, si dhe për kërkesat e zhdëmtimit të viktimës në veçanti.

Zbulimi i shpejtë dhe i plotë i krimeve dhe autorëve të tyre, ndikon drejtpërsëdrejti në efektivitetin e mbrojtjes së viktimave nga akti kriminal, në sigurimin e dëmshpërblimit, si dhe në pengimin e viktimizimit të tyre në të ardhmen. "Hetuesi është zëri i publikut, në radhë të parë i viktimës", - thotë Prof. V. Latifi<sup>3</sup>.

Ndërkaq, viktimologjia me metodat e studimit të saj, me fenomenologjinë viktimologjike, me format, klasifikimin dhe tipologjinë e viktimave e ndihmon kriminalistikën në ngritjen e versioneve hetimore, në shpjegimin e mekanizmit të kryerjes së krimit, në ngushtimin e rrethit ku duhet kërkuar dhe zbuluar autori.

*Kriminalistika ka lidhje me politikën kriminale*, si shkencë që studion kriminalitetin me detyrë kryesore: marrja e masave për luftimin dhe parandalimin me efikasitet të tij dhe të dukurive antisociale. Në arritjen e këtij synimi ndikojnë njohuritë e të dy shkencave në fjalë. Nuk mund të ketë sukses në luftën kundër kriminalitetit pa i zbuluar ato, por nga ana tjetër lufta kundër kriminalitetit nuk mund të ketë sukses nëse nuk zbatohet një legjislacion penal adekuat për ndëshkimin e autorëve të krimit, si një ndër funksionet parandaluese të tij.

*Kriminalistika ka lidhje me shkencën e gjurmimit apo shërbimin e fshehtë*. Në veprimtarinë e tyre administrative, parandaluese të kriminalitetit, shërbimi i fshehtë, si ai i zbatuar nga Policia e Shtetit, ashtu edhe nga ai i zbatuar nga Shërbimi Informativ i Shtetit, përpos të tjerash, zbatojnë metodat shkencore, mjetet dhe teknikat kriminalistike për të zbuluar, dokumentuar dhe parandaluar një vepër penale. Ndryshimi është se në këtë stad rezultatet e arritura nuk kanë vlerën e provës. Ato bëhen të tilla, në çastin kur, mbi këto të dhëna prokurori ngre një akuzë dhe metodat e mjetet teknike kriminalistike zbatohen mbi bazën e vendimit të prokurorit. Nga ana tjetër, në një vepër penale, në veçanti në ato që fillojnë me vendngjarje, në ngushtimin e rrethit të personave si autor i krimit, në veprime të mëtejshme hetimor si: kontrollime, përgjime, arrestime etj., një ndihmesë të madhe për organin procedues jep bashkëpunimi dhe informacionet që vijnë nga shërbimet e mësipërme.

*Kriminalistika ka lidhje me logjikën*. Logjika është shkenca që studion tipare të caktuara të mendimit njerëzor, si mjet i realizimit të njohjes. Si çdo dukuri tjetër, mendimi respekton disa rregulla dhe ligje të organizimit të mendimit, që janë të përbashkëta për të gjithë njerëzit, për të dalluar arsyetimin e saktë nga ai i gabuar<sup>4</sup>.

Në procesin e njohjes njeriu kalon nga padija në dije, nga dija për fakte të veçanta në dije të përgjithësuar. Ky proces e përshkon tërë lëmin e kriminalistikës, mbasi krimet ndodhin të fshehta e të maskuara dhe që duhen zbuluar, pra të kalohet nga padija në dije. Kështu, p.sh., që organi procedues të arrijë në përfundimin se i dyshuari është autori i veprës penale, shfrytëzon të dhënat, gjurmët dhe provat në vendin e ngjarjes, të

<sup>3</sup> V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2006, f. 28

<sup>4</sup> L. Pirdeni, *Hyrje në logjikë*, Tiranë 2008, f. 22.

dhëna të dëshmitarëve etj. Në këtë kuptim, mendimi kalon nga disa dije për fakte të veçanta në dijen e përgjithshme, në sintezë.

Procesi i njohjes nëpërmjet mendimit fillon me njohjen empirike, njohjen shqisore, ndijim - perceptim – përfytyrim, mandej përfundon në njohje të përgjithësuara nëpërmjet abstragimit, nëpërmjet njohjes racionale e realizuar nga forma, si: koncepti, gjykimi dhe arsyetimi, metodologji që zbaton kriminalistika në realizimin e objekti të vet: zbulimin dhe të provuarit e krimit.

Njohja e së vërtetës arrihet nëpërmjet arsyetimit deduktiv. Aristoteli thoshte: “Logjika është instrument i arritjes të së vërtetës”. Ndaj dhe kjo shkencë është e lidhur dhe e vlefshme për kriminalistikën për zbulimin e së vërtetës në procesin penal.

*Kriminalistika ka lidhje me psikologjinë.* Psikologjia është shkenca që studion sjelljet, veprimet dhe reagimet njerëzore, realitetin psikik të çdo njeriu, të cilat shprehen nëpërmjet personalitetit dhe cilësive të tjera, si: karakteri, temperamentit, emocionet, motivet, shprehitë dhe inteligjenca.

Kriminalistika në realizimin e detyrës së vet, zbulimi dhe të provuarit e krimit, në veçanti në pjesën e hetimit kriminal, ka të bëjë me njerëz të ndryshëm - subjekte të procedimit penal, me psikikë të ndryshme, e cila duhen njohur dhe në përshtatje me këto veçori psikologjike, organi procedues organizon e ndërton mënyrën e komunikimit, taktikën e pyetjes, për të garantuar objektivitetin në procesin hetimor e gjyqësor, mundësi që na e jep shkenca e psikologjisë. *Asgjë (që njeriu punon ose krijon) nuk mund të kuptohet pa psikologji* - ka thënë Sigmund Freud.

*Kriminalistika ka lidhje me psikologjinë ligjore të krimit.* Psikologjia ligjore e krimit zgjidh një sërë çështjes në hetimin e një krimi. Për zbulimin e autorit të një krimi është i rëndësishëm përcaktimi i profilit të përcaktuar nga një psikolog kriminal<sup>5</sup>. Ky përcaktim arrihet në veçoritë psikologjike të individit, të shprehura në mekanizmin e kryerjes së krimit që, si rregull, shpreh personalitetin e autorit që e kryen. Nëpërmjet këtij profilizimi arrihet në tipizimin e personit që mund ta ketë kryer krimin, është një version se kush është dhe ku duhet kërkuar autori i krimit.

Të dhënat e psikologjisë kriminale ndihmojnë kriminalistikën edhe në pyetjen e personit të dyshuar, në ndërtimin dhe zbatimin e një taktike pyetjeje efikase, në bazë të veçorive psikologjike, të profilit kriminal të tij dhe të rolit që ka luajtur në kryerjen e krimit. Për këtë arsye studiuesit e kanë konsideruar profilizimin psikologjik të autorit të krimit si një “rrymë e tretë”<sup>6</sup> në shkencën e hetimit kriminal.

Përveç lidhjes me mjekësinë e psikiatrinë ligjore, kriminalistika ka lidhje edhe me histologjinë, anatominë e njeriut dhe anatominë dentare, si shkenca të fushës së mjekësisë.

*Histologjia* që studion indet dhe organet e njeriut, të dhënat për histofiziologjinë e lëkurës, me ndërtimin, funksionet dhe vetitë e saj, shfrytëzohen nga kriminalistika në studimin dhe ekzaminimin e vijave papilare. *Anatomia e njeriut*, që studion formën dhe strukturën e trupit në mënyrë përshkruese të së gjithë pjesëve përbërëse të tij, në mënyrë të veçantë të dhënat e anatomisë topografike shfrytëzohen nga kriminalistika për studimin dhe identifikimin e personit në bazë të tipareve të jashtme. Ndërsa të dhënat e *anatomisë dentare dhe fiziologjisë së dhëmbëve të njeriut*, shfrytëzohet nga kriminalistika për identifikimin e personit në bazë të dhëmbëve dhe gurmës së tyre.

Kriminalistika ka lidhje të ngushtë me degë të shkencave të natyrës, si: biologjia,

<sup>5</sup> Për më shumë shih: E. Dragoti, *Psikologjia ligjore e krimit*, Tiranë 2007, f. 8.

<sup>6</sup> Për më shumë shih: L. Veliqoti, “Natyra juridike e vendngjarjes dhe profile i autorit të saj”. *Jeta juridike*, nr.2/ 2017.

fiziologjia, kimia, fizika, matematika dhe informatika.

*Biologjia* studion karakteristikat, klasifikimin dhe sjelljen e organizmave, formimin dhe ndërsjelljen me njëra-tjetrën. Një ndër zbulimet kyçe të biologjisë – gjenetika, shfrytëzohet nga kriminalistika për identifikimin e njeriut në bazë të profilin gjenetik.

*Fiziologjia*, është një degë tjetër e shkencave natyrore që studion ndërtimin dhe veprimtarinë jetësore normale të organizmave të gjallë. Të dhënat në fushën e proceseve fiziologjike të metabolizmit të lëndëve të ndryshme, që organizmi i njeriut nxjerr në mjedisin e jashtëm nëpërmjet frymës dhe sekrecioneve gjatë aktivitetit njerëzor, shfrytëzohet nga kriminalistika për identifikimin e personit në bazë të erës, aromës së trupit të tij.

*Kimia*, si dega që studion lëndën në shkallë atomike dhe molekulare, kryesisht me grumbullimin e atomeve, si: gazet, kristalet dhe metalet, përbërjen, vetitë dhe reaksionet e tyre, të dhënat e kësaj shkence kriminalistika i shfrytëzon në fushën e falsifikimeve të dokumenteve, të ekzaminimeve kimike balistika dhe në veçanti të ekzaminimit të mikrogjurmëve me origjinë organike e inorganike, për të përcaktuar përbërjen e tyre - gazkromatografia.

*Fizika*, shkenca që studion dhe shpjegon dukuritë natyrore, disa nga zhvillimet kyçe të saj, si: teoria e gravitacionit, të mekanikës klasike, të elektromagnetizmit, të relativitetit dhe të fizikës optike shfrytëzohen nga kriminalistika në fushën e fotografisë, të balistikës apo në çështje të tjera që dalin në procesin ekzaminues të gjurmëve dhe të sendeve prova materiale.

*Matematika*, shkenca që studion raportet sasiore dhe cilësore të objekteve konkretë e abstrakt dhe të formave hapësinore, si dhe *informatika*, shkenca që studion strukturën, algoritmet dhe mekanizmat e përpunimit të informacionit-përpunimi automatik i informacionit-, shfrytëzohen nga kriminalistika në fushën e ekzaminimit por edhe në atë të përpunimit të informacionit, në krijimin e databazeve të kartotekës kriminalistike, si: për vijat dhe gjurmët papilare, për gjurmët e provave balistike (gëzhoja e predha), për gjurmët e profileve gjenetike të personave etj.

Kriminalistika ka lidhje gjithashtu me degë të inxhinierive si: *inxhinieria elektrike*, *inxhinieria elektronike dhe inxhinieria mekanike*. Në veçanti lidhje të ngushtë ka me shkencën e elektronikës, si degë e inxhinierisë elektrike, që studion vetitë dhe lëvizjet e elektroneve në zbrazëti, në gaze dhe në gjysmëpërçues. Të dhënat e këtyre shkencave kriminalistika i shfrytëzohen në fushën e kërkimi, zbulimit dhe ekzaminimit të gjurmëve e sendeve prova material të zbuluara në vendin e ngjarjes. Këto të dhëna shfrytëzohen gjithashtu edhe për identifikimin e personit në bazë të zërit<sup>7</sup>.

### 3. Natyra shkencore e kriminalistikës

Siç shihet nga shpjegimi i mësipërm, shkenca e kriminalistikës lidhet me shumë shkenca të tjera, çka përbën një veçori të saj. Por ajo ka edhe disa veçori të tjera, të cilat përbëjnë atë që ndryshe quhet: “natyra shkencore e kriminalistikës”. Në natyrën shkencore të kriminalistikës përfshihet: lidhja me shumë shkenca të tjera; formim dhe kualifikim i veçantë i lektorit që do ta zhvillojë këtë disiplinë; bazë laboratorike e didaktike e veçantë, mbështetja e veprimtarisë së saj në disa parime e metoda që janë

<sup>7</sup> Përkufizimi i objektit të shkencave të mësipërme, përveçse nga tekste respektivë universitarë, është bërë duke ju referuar edhe, *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 2002.

ekskluzivisht të saj; zgjerimi dhe zhvillimi më i shpejtë i çështjeve që përfshin objekti i saj.

a. *Lidhja me shumë shkencë.* Kriminalistika është ndër të paktat shkencë që lidhet me shumë shkencë të tjera. Këtë veçori e dikton objekti i saj: zbulimi dhe të provuarit e kryerjes së krimit. Zbulimi i një krimi është arritja e një e një njohje, e një dije, në këtë rast mbi autorin e tij dhe rrethanat në të cilat e ka kryer. Ashtu si çdo dije në një fushë tjetër të jetës e të shkencës edhe arritja e dijes në fjalë është e vështirë, ndaj për ta lehtësuar e bërë arë realitet në një shkallë sa më të lartë, shfrytëzohen të dhëna e njohuri të shumë shkencave të tjera.

b. *Formimi dhe kualifikimi i veçantë i lektorit të kriminalistikës.* Veçoria e mësipërme, - lidhja e kriminalistikës me shumë shkencë të tjera, çka do të thotë shumë njohuri të ndërthura në të, natyrshëm shtron pyetjen: Çfarë formimi dhe kualifikimi duhet të ketë lektori që do ta zhvillojë këtë lëndë në auditor?

Për ta zhvilluar me kompetencë profesionale e shkencore lëndën e kriminalistikës, nuk mjafton vetëm arsimimi i lartë në një degë, që së pari është ai i juristit, por duhet të ketë edhe një formim të lartë në një degë tjetër. Më afër është ai i lartë policor, por i përshtatshëm është edhe formimi në një nga degët e shkencave të natyrës apo të psikologjisë. Ndërkaq, krahas formimit teorik, lektori i zhvillimit të shkencës së kriminalistikës duhet të ketë edhe formim dhe eksperiencë praktike në fushën e policisë shkencore, apo të organit procedues. Ideale do të ishte t'i kishte të dy këto eksperiencë. Në pamundësi për ta bërë realitet përfitimin e kësaj eksperiencë nga një individ (lektori), rekomandohet bashkëpunimi dhe angazhimi i punonjësve të organit procedues në zhvillimin e lëndës së kriminalistikës, në çështje dhe tema të caktuara.

c. *Bazë të mjaftueshme të domosdoshme laboratorike e didaktike.* Kriminalistika është shkencë e zbatuar në praktikë, në funksion dhe në ndihmë të organit procedurës, të policisë shkencore dhe të avokatisë, për zbulimin, hetimin, gjykimin dhe parandalimin e krimeve. Si e tillë njohuritë e saj teorike konkretizohen dhe përvetësohen nga studentët duke u shoqëruar me një bazë të gjerë laboratorike e didaktike kriminalistike. Pasja në dispozicion të kësaj baze laboratorike bën të mundur zhvillimin me cilësi të lartë të lëndës së kriminalistikës. Kësisoj studentët fitojnë shprehësi praktike të metodave e mjeteve teknike kriminalistike për zbulimin dhe ekzaminimin e gjurmëve dhe sendeve prova material në vendin e krimit, fitojnë shprehësi për të formuar e kryer akte e veprime të ndryshme procedurale e hetimore, si dhe për metodikën e hetimit të një veprë penale konkrete.

d. *Mbështetja në metoda e parime ekskluzivisht të saj.* Realizimi i objektin të vet-zbulimi dhe të provuarit e kryerjes së krimit, dikton faktin që kriminalistika të mbështetet në metoda e mjete teknike ekskluzivisht të saj, siç janë ato të zbulimit dhe identifikimit të gjurmëve e të sendeve prova materiale të lëna nga autori i krimit. Gjithashtu, kriminalistika mbështetet edhe në parime gjithashtu ekskluzivisht të saj, siç janë parimi i shpejtësisë e befasisë dhe parimi i konfidencialitetit, neni 279 I K.Pr.P. , me qëllim që avantazhin kohë dhe befasinë që autori ka para kryerjes së veprës penal eta kthejë në favor të vet, të zbulimit dhe të provuarit e krimit<sup>8</sup>.

e. *Zhvillim dhe zgjerim relativisht të shpejtë i shkencës së kriminalistikës.* Kjo veçori është dialektike thuajse në të gjitha shkencat e tjera, por tek shkencë e kriminalistikës është më e theksuar dhe më e shpejtë për arsye, jo vetëm të ndryshimit të legjislacionit

<sup>8</sup> Për më gjerë shih: L. Veliqoti, "Natyra juridike e vendngjarjes dhe profile i autorit të saj", *Jeta juridike* nr. 2/2017.

penal ku ajo mbështet, por, çka është më kryesorja, për shkak të evolucionit të shkencës dhe teknologjisë të cilën individë të ndryshëm e shfrytëzojnë për të kryer vepra penale, apo të ndryshimit dhe perfeksionimit të mjeteve, teknikave dhe metodave që ata përdorin për të kryer krime. Kësisoj kriminalistika, si shkenca e zbulimit dhe e të provuarit të kryerjes së krimit, ndjek zhvillimin e shkencës e të teknologjisë për ta përshtatur atë në funksion të teknikave të e saj, të metodave dhe mjetet teknike kriminalistike adekuatë, për t'ju kundërvënë, metodave dhe mjeteve që përdorin autorët e krimeve. Në këtë mënyrë plotësohet dhe realizohet kërkesa e mësipërme: zhvillimi dhe zgjerimi i pandërprerë dhe relativisht i shpejtë i shkencës së kriminalistikës. “Nëse krimi do të arrijë të kryhet përmes metodave dhe teknikave të artit djallëzor, ne duhet t'i përgjigjemi përmes metodave dhe teknikave të artit shkencor”, A. Puccini, 1936<sup>9</sup>.

#### 4. Kontributi i kriminalistikës në këqyrjen e vendit të ngjarjes

Ndër mjetet e kërkimit të provës bën pjesë edhe këqyrja e vendit të ngjarjes. Për të kryer këtë veprim hetimor kriminalistika ka përpunuar një sërë metodash shkencore, taktike e mjete teknike, ka bërë një sërë shpjegimesh e rekomandimesh, si: për kuptimin e nocionit vendngjarje; masat përgatitore për ta kryer atë; natyra juridike dhe veçoritë që ajo mbart, në krahasim me veprime të tjera hetimore që kryhen për mjetet dhe llojet e tjera të provave; metodat taktike të këqyrjes; këqyrja e objektit kryesor; ndërtimi i profilin të autorit të krimit; si dhe metoda për fiksimin dhe përshkrimi e hollësishëm të rezultateve të këqyrjes në procesverbal, fotografi e skica. Marrë në konsideratë natyrën juridike të këqyrjes së vendit të ngjarjes, ky veprim hetimor personifikon kulmin e lidhjes midis shkencës së kriminalistikës me atë të procedurës penale.

Edhe pse për vendin e ngjarjes dhe këqyrjen e saj është shkruar shumë, nga autorë vendas e të huaj, vazhdon dhe do të shkruhet ende për të. Këtë gjë e dikton, jo vetëm fakti se është një ndër mjetet më të rëndësishme të kërkimit të provës dhe njëherësh për zbulimin e veprave penale, por edhe sepse autorët e krimeve në vazhdimësi ndryshojnë metodat dhe mjetet për kryerjen e krimeve, çka kërkon që të përshtaten e perfeksionohen edhe metodat dhe mjetet teknike të këqyrjes së këtyre vendngjarjeve.

Rrjedhojë e këtyre studimeve për vendin e ngjarjen, për këqyrjen dhe detyrat e saj ka një kuptim më të plotë e më të saktë. Kështu, vendi i ngjarjes konsiderohet: “Vendi, (mjedisi), ku ka ndodhur ose dyshohet se ka ndodhur vepra penale, çka sjell për organin procedues detyrimin (nenet 24, 30 të K.Pr.P) të kryejë këqyrjen e këtij vendi.”

Nga pikëpamja kriminalistike vendngjarje vlerësohen vetëm ato raste që pasohen me lëvizje, thyerje e dëmtime të sendeve a objekteve, dëmtime të shëndetit e jetës së personave, nga veprime të njeriut.<sup>10</sup>

Përkuftizimi i mësipërm i nocionit “vendngjarje” është në kuptimin e ngushtë, ndërsa në kuptimin e gjerë, vendngjarje konsiderohet jo vetëm vendi ku ka ndodhur vepra penale, por edhe vendi ku zbulohen rrethana që lidhen me pasojat e saj, gjurmë dhe prova materiale të saj, pavarësisht nga largësia midis këtyre dy vendeve. Në këtë kuptim mbështetet edhe përcaktimi i kufijve të vendngjarjes ku ushtrohet këqyrja, të cilët

<sup>9</sup> S. Meksi, *Vdekja nga dhuna*, Tiranë 2005, f. 7.

<sup>10</sup> Përveç veprimeve të njeriut, një ngjarje mund të kryhet edhe nga shkaqe natyrore apo nga shkaqe teknike e avari në punë, e në ndonjë rast edhe nga kafshët.

varen nga natyra e veprës penale dhe veçoritë e mjedisit ku ajo kryhet. Kështu, p.sh.: kufoma është vrarë në banesë dhe mandej është transportuar në një vend tjetër (ku është gjetur) për të humbur gjurmët, automjeti i larguar nga vendi i ngjarjes pas shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, automjeti i përdorur pas kryerjes së një vjedhje me dhunë, etj. Në këto raste, përpos banesës, vendit të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe vendit ku është kryer vjedhje me dhunë, vendngjarje konsiderohen respektivisht edhe vendi ku u gjet kufoma, vendi ku është zbuluar automjeti i dyshuar si shkaktar i aksidentit rrugor, si dhe vendi ku është zbuluar automjeti i përdorur pas largimit të vjedhjes me dhunë.

Pavarësisht nga lloji i vendit, mjedisit, ku ka ndodhur ngjarja, apo shkakut i ardhjes së saj, këqyrja e vendit të ngjarjes është: “*Veprimi hetimor i mbështetur në K.Pr.P. (nenet 198 - 201), nëpërmjet të cilit organi procedues kryen vëzhgimin shqisor të drejtpërdrejtë ose të përforcuar me mjete optike, të orientuar nga versionet hetimore të ngritura sipas metodave logjike, duke zbatuar metoda shkencore e mjete teknike kriminalistike,; për të zbuluar gjurmët dhe provat materiale të lëna nga autori; për fiksimin e hollësishtëm në procesverbal, fotografi e skica (nenet 188-198/3 të K.Pr.P), paketimin dhe marrjen e tyre; për të përcaktuar mekanizmin dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra penale; për të përcaktuar pasojat dhe shkakun e ndodhjes së veprës penale; për parandalimin e pasojave të mëtejshme që lidhen me veprën penale të ndodhur; si dhe për të zbuluar autorin e veprës penale.*”

Këqyrja kryhet edhe për persona, kufoma dhe sende (nenet 199-201 të K.Pr.P). Realizimi i tyre, krahas disa veçorive nga pikëpamja taktike, gjë që nuk është objekt i këtij shkrimi, mbështetet në rregullat e përgjithshme të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Në këto dispozita procedurale mbështeten kuptimi dhe detyrat e këqyrjes në përgjithësi, dhe të këqyrjes së vendit të ngjarjes në veçanti, si lloji më i rëndësishëm i këqyrjes dhe i mjeteve të kërkimit të provës. Ato janë baza e ndërtimit dhe zbatimit të metodave taktike të këqyrjes së vendit të ngjarjes.

Këqyrja e vendit të ngjarjes ka si qëllim:

- për të zbuluar gjurmët dhe provat materiale të lëna nga autori;
- për fiksimin, paketimin, marrjen dhe përshkrimin e hollësishtëm të tyre në procesverbal, fotografi e skica;
- për të përcaktuar mekanizmin dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra penale;
- për të përcaktuar pasojat dhe shkakun e ndodhjes së veprës penale;
- për parandalimin e pasojave të mëtejshme që lidhen me veprën penale të ndodhur;
- për të zbuluar autorin e veprës penale.

Pavarësisht nga mendime të ndryshme për nocionin “vendngjarje”<sup>11</sup>, me qëllim që trajtimi teorik të shërbejë në funksion të zbatimit me efektivitet në praktikë të tij, është e domosdoshme të trajtojmë natyrën juridike të këqyrjes së këtij “vendi”, veçoritë që ka si veprim hetimor në krahasim me veprime të tjera hetimore në përgjithësi dhe në veçanti, me ato të parashikuara në titullin (kapitullin): Provat, (nenet 149 -226 të K.Pr.P.).

## **5. Natyra juridike e këqyrjes së vendit të ngjarjes**

Çdo mjet i kërkimit të provës ashtu si edhe llojet e provave, kanë disa karakteristika

<sup>11</sup> Për më gjerë shih: L. Veliqoti, *Jeta juridike*, nr. 2 / 2017.



të veçanta, të cilat i dallojnë ato nga njëra-tjetra, jo vetëm nga pikëpamja procedurale, por edhe nga ajo kriminalistike. Duke evidentuar këto karakteristika del në pah vlera kriminalistike e secilës prej tyre, në funksion të zbatimit në praktikë gjatë procesit të zbulimit dhe e të provuarit të veprës penale. Një ndër mjetet e kërkimit të provës, këqyrja e vendit të ngjarjes, e parashikuar në kreun e III-të, të titullit IV-Provat, (neni 198 të K.Pr.P.) është një veprim hetimor që ka disa veçori, si: *Veprim hetimor i shpejtë, i papërsëritshëm, i pazëvendësueshëm, veprim i parë hetimor dhe që kryhet pa filluar procedimin penal.* Ndërkaq, meqenëse në këtë veprim hetimor tipar dallues është vëzhgimi (kontrolli, kërkimi) për zbulimin e gjurmëve dhe të provave materiale, ai dallohet edhe nga disa veprime të tjera hetimore që, gjithashtu, kanë këto tipare kriminalistike për realizimin e tyre, si: kontrolli, eksperimenti dhe ekspertimi, (nenet 176,178, 202 të K.Pr.P.) elementë dallues, të cilët përfshihen dhe plotësojnë natyrën juridike të këqyrjes së vendit të ngjarjes. E gjithë veprimtaria e grupit hetimor në vendin e ngjarjes, krahas mbështetjes në ligjin procedural penal, mbështetet edhe në parimet e kriminalistikës, me qëllim për të arritur rezultate optimale të hetimit dhe për të evituar gabimet e mundshme. Në këtë mënyrë hetimi kryhet *lege artis*<sup>12</sup>.

Meqenëse për elementë të natyrës juridike të vendngjarjes është trajtuar në literaturë<sup>13</sup>, më poshtë shpjegohen më të zgjeruar disa nga këta elementë, si: shpejtësia e këqyrjes së vendit të ngjarjes, lidhja me procedurën penale, si dhe ngjasimi me disa veprime të tjera hetimore.

a. *Këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor i shpejtë, thuajse emergjent, në veçanti për krimet e rënda*<sup>14</sup>.

Kjo veçori buron nga qëllimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes: zbulimi i gjurmëve e provave materiale, ndërprerja e pasojave të saj dhe zbulimi i autorit. Nëse nuk mbahet parasysh dhe të zbatohet në praktikën hetimore kjo veçori, atëherë këto detyra vështirësohen të kryhen, në mos bëhen të pamundura. Kalimi i kohës nga çasti i marrjes së njoftimit për ndodhjen e një krimi e deri në mbërritjen në vendngjarje është në disavantazh të grupit hetimor dhe anasjelltas për autorin e krimit, për shkak të dëmtimit të gjurmëve e të provave materiale.

Studimet dhe praktika kriminalistike tregojnë se, gjendja faktike e vendit të ngjarjes ndodhet në “dekompozim” të vazhdueshëm pas kryerjes së veprës penale, për shkak të disa faktorëve, të cilët konsiderohen si kontaminues (dëmtues) kryesorë të vendit të ngjarjes, gjë që e kushtëzoi këqyrjen si veprim hetimor të shpejtë; ata janë:

- Kushte atmosferike, në veçanti kur vendi i ngjarjes është në mjedis të hapur.  
- Të afërmit dhe miqtë e viktimës, të cilët ndërhyjnë të shqetësuar për pasojat e krimit dhe eventualisht për të ndërprerë pasojat e mëtejshme.

- Të dyshimtët (autorët), të cilët jo vetëm gjatë kryerjes së krimit mendojnë edhe për të mos lënë e njëherësh dëmtuar gjurmët e provat materiale, por edhe mbasi janë larguar nga vendi i krimit dhe po vërejnë që nuk ka interesim e veprimtari të organit procedues, rikthehen në vendin e ngjarjes për të marrë e zhdukur ndonjë gjurmë a provë materiale që mund të ketë ngelur.

- Kureshtarët dhe vjedhësit.

<sup>12</sup> N. Korajlic, D. Muharemi, Xh. Ademaj, *Fjalori terminologjia kriminalistike*, Prishtinë 2016, f. 334.

<sup>13</sup> Për më gjerë shih: S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë 2007, f. 347.

<sup>14</sup> Në rastet kur njoftimi është marrë menjëherë mbas ndodhjes së veprës penale, krahas masave me karakter hetimor, merren edhe masa të karakterit operativ e gjurmues me qëllim të zbulimit, dhe arrestimit të autorit të krimit. Njëherësh, në rast de ka të dëmtuar, krahas detyrave për këqyrjen e vendit të ngjarjes, grupi hetimor interesohet për gjendjen e tyre shëndetësore dhe eventualisht bën pyetjen e tyre.

- Pjesëtarët e grupit hetimor gjatë këqyrjes dinamike, ku ndërhyrja dhe lëvizja e tyre në vendngjarje është e pashmangshme. Kujdesi i lartë dhe zbatimi me profesionalitet i metodave taktike të këqyrjes, bën të mundur minimizimin e këtij faktori negativ. Shpejtësia shkuarjes në vendin e ngjarjes, përpos evitimit të faktorëve të mësipërm dëmtues, ka një sërë përparësish, si:

- Shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes rrit probabilitetin e arrestimit të autorit të krimit. Mbas kryerjes së veprës penale autori jo vetëm që nuk është larguar shumë, por veprimet e tij, pamja e jashtme, prania e mjeteve që lidhen me ngjarjen etj., krijojnë lehtësi për zbulimin e tij. Për shkak të kohës së pakët në dispozicion atij i kufizohet mundësia e gjetjes së personave për alibi, për dëshmi të rreme, apo të kthehet në vendin e krimit për të zhdukur gjurmët e lëna. Ndërkaq, organi procedues shfrytëzon mundësinë që i jep ligji për kushtet e flagrancës: arrestimin e autorit të veprës penale, (nenet 251, 252 të K.Pr.P.), , si dhe kryerjen e kontrollit (nenet 202/3, 298 të K.Pr.P), çka është një avantazh i madh për zbulimin dhe të provuarin e krimit.

- Shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes bën të mundur ndërprerjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale. Të dëmtuarit mund të dinë se kush është autori. Në këto kushte ndaj tij, apo ca më keq ndaj të afërmeve, mund të ndërmarrin veprime kriminale vetëgjyqësie. Ndaj prania e organit procedues, të asistuar edhe nga punonjës të policisë së shtetit, bën të mundur parandalimin e kryerjes eventuale të këtyre veprimeve.

- Gjithashtu, shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes mundëson evidentimin e dëshmitarëve të pranishëm. Pyetja e shpejtë e tyre bën të mundur marrjen e deklarimeve të plota e të sakta. Me kalimin e kohës perceptimi që ata kanë për ngjarjen zbehet, ndikohen nga të tjerë, apo ca më keq edhe mund të kërcënohen<sup>15</sup>.

Sipas Vodinelit<sup>16</sup>, sasia dhe cilësia e informacioneve dhe provave të siguruar në formë gjurmësh e objektesh, që kanë lidhje me veprën penale, janë në përpjesëtim të drejtë me kohën që ka kaluar nga çasti kur autori e ka kryer atë deri në çastin kur grupi hetimor fillon këqyrjen e vendi të ngjarjes. Shkurtimi i intervalit kohor nga ndodhja e ngjarjes deri në fillimin e këqyrjes së saj, pothuajse në të gjitha rastet, përbën kyçin e suksesit të grupit hetimor. Përparësia që autori ka me kalimin e kohës, kalon në anën e kundërt, në mundësinë e zbulimit dhe gjetjes së tij. Shumë kuptimplotë për rëndësinë që ka shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes është sentenca e thënë nga Locard: “*Koha që po kalon, është e vërteta që po ikën*”<sup>17</sup>.

Shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes bën të mundur të shfrytëzohet qeni gjurmues, pasi gjurma e aromës së trupit të autorit është e freskët, çka është një kërkesë për të pasur sukses të ndjekjes së saj me anën e qenit gjurmues<sup>18</sup>.

- Në rastet e aksidenteve rrugore, shkuarja me shpejtësi në vendin e ngjarjes bën të mundur rivendosjen e qarkullimit normal aq të domosdoshëm, jo vetëm për arsye ekonomike, por edhe për emergjenca të ndryshme të mundshme.

- Ka ngjarje, si, p.sh., zjarre, që koha e kryerjes së tyre është e gjatë, për disa orë e më tej. Ndaj shkuarja me shpejtësi e grupit hetimor në vendin e ngjarjes, përpos sa më sipër, në njëfarë mënyre i bën “dëshmitarë”, çka ndihmon në përcaktimin e mekanizmit të ngjarjes, në zbulimin e gjurmëve e të provave materiale, në hetimin e shpejtë e të

<sup>15</sup> Veçoria e shkuarjes me shpejtësi në vendin e ngjarjes mbahet parasysh kryesisht për vendngjarjet për të cilat organi procedues ka marrë dijeni menjëherë mbas ndodhjes së tyre.

<sup>16</sup> V. Vodinelit, *Kriminalistika*, Prishtinë 1970.

<sup>17</sup> H. Demolli, *Terrorizmi*, Prishtinë 2002, f. 26.

<sup>18</sup> Për më gjerë shih: L. Veliqoti, “Identifikimi i personit në bazë të aromës”. *Tribunë Juridike*, nr. 82 / 2010, f. 39.

plotë të saj.

b. *Këqyrja e vendit të ngjarjes, si rregull, pasohet me veprime të tjera hetimore të menjëhershme*, si: kontrollimi, pyetja etj., madje në ndonjë rast ato kryhen edhe gjatë këqyrjes kur në të marrin pjesë dy hetues (në ngjarjet e rënda: prokurori, oficeri i policisë gjyqësore) me qëllim që efektin kohë, si armikun kryesor të tyre, ta kthejnë në favor të hetimit e të zbulimit të veprave penale. Në praktikën hetimore e gjyqësore nuk ka asnjë veprim tjetër hetimor që të pasohet njëherësh me shumë veprime të tjera hetimore, përveçse këqyrja e vendit të ngjarjes, *çka përbën një veçori për të*.

Shkenca e kriminalistikës, siç dihet, përpos lidhjes me shumë shkencë të tjera, ka lidhje të ngushtë edhe me shkencën e procedurës penale. Procedura penale përbën bazën ligjore të teknikave dhe metodave shkencore që kriminalistika zbaton në funksion të zbulimit dhe të provuarit të krimit. Kjo lidhje është e gjerë, por: në *mënyrën më domethënëse ajo shprehet në këqyrjen e vendit të ngjarjes*. Në këtë kuptim, njohja e rregullave procedurale penale dhe aftësia e zbatimit të teknikave dhe metodave kriminalistike, njohja e natyrës juridike të këqyrjes së vendit të ngjarjes, duke e shoqëruar në kohë edhe me veprimet e mësipërme hetimore, përbën kyçin e suksesit në zbatimin e këtij veprimi hetimor, gjegjësisht objektivitetin dhe shpejtësinë e zbulimit të veprës penale, si dhe të suksesit në efektin parandalues të kriminalitetit në tërësi, si kulmi i realizimit të misionit dhe detyrës nga organi procedues<sup>19</sup>.

c. *Këqyrja e vendit të ngjarjes, në elementë të caktuar, ngjason me disa veprime të tjera hetimore, si: me eksperimentin, me ekspertimin dhe me kontrollin*, (nenet 176, 178, 202 të K.Pr.P.), por në çdo rast ky veprim hetimor ruan individualitetin e tij, si për nga qëllimi, përgatitja dhe detyrat që zgjidh, ashtu edhe nga metodat teknike e taktike të kryerjes. *Eksperimenti* lejohet kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur në një mënyrë të caktuar. Ai është riprodhimi për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit, (neni 176, i K.Pr.P). Vërtetimi i faktit për të cilin kryhet eksperimenti lidhet me një ngjarje kriminale, me një episod të saj, me një pjesë të mekanizmit të kryerjes së saj. Në këtë kuptim, nuk mund të ketë e të kryhet një eksperiment hetimor pa pasur një ngjarje kriminale, çka përbën edhe lidhjen midis tyre, por ai ndryshon nga këqyrja e vendit të ngjarjes, në veçanti nga përgatitja dhe metodat taktike të kryerjes së tyre.

- Gjurmët dhe provat materiale në vendin e ngjarjes zbulohen e fiksohen në gjendjen që ai paraqitet, në situatën që grupi hetimor gjen në çastin e mbërritjes në të. Ndërsa eksperimenti hetimor riprodhon një pjesë të mekanizmit të saj, riprodhon kushtet në të cilën ka ndodhur një fakt konkret, për të cilin organi procedues dyshon të ketë ndodhur në mënyrën e pretenduar, dyshim të cilin e sqaron nëpërmjet eksperimentit.

- Këqyrja e vendit të ngjarjes, si rregull, nuk përsëritet, ndërsa për eksperimentin është kërkesë ligjore dhe taktike të përsëritet, për të rritur bindjen në vërtetësinë që fakti, për të cilin kryhet eksperimenti, ka ndodhur në një mënyrë të caktuar.

- Ndryshimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes me eksperimentin hetimor konsiston edhe në vlerën provuese të rezultateve të arritura. Kështu, gjurmët dhe provat materiale të lëna nga autori e të zbuluara në vendin e ngjarjes kanë vlerën e provës, ndërsa tek eksperimenti hetimor vetëm rezultati negativ ka vlerë të tillë.

*Këqyrja e vendit të ngjarjes dhe ekspertimi janë burim i rëndësishëm prove. Në të*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>19</sup> Për më gjerë shih: H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, *Procedura Penale, Komentar*, Tiranë 2003, f. 252.

dy këto veprime hetimore ushtrohet këqyrje për të zbuluar gjurmë, çka përbën një lloj ngjasimi. Por midis tyre ka një sërë ndryshimesh, si:

- Gjurmët dhe provat materiale në vendin e ngjarjes konstatohen (zbulohen) nëpërmjet perceptimit të drejtpërdrejtë, ndërsa zbulimi i (gjurmëve) provës në rastin e ekspertimit kryhet në rrugë të tërthortë, duke ekzaminuar vetëm objektin (gjurmë apo send).

- Në realizimin e ekspertimit, gjatë procesit ekzaminativ, jo rrallë gjurma apo sendi objekt ekspertimi shoqërohet me shpërbërje të tyre. Ndërkaq gjatë procesit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, gjurmët dhe provat materiale jo vetëm që nuk duhet të dëmtohen por përkundrazi, është kërkesë ligjore ruajtja dhe fiksimi i tyre në gjendjen e vëzhguar e të zbuluar.

Objekt i këqyrjes janë personat, vendet, sendet, gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të shkaktuara nga vepra penale. Ndërsa objekt të ekspertimit mund të jenë jo vetëm gjurmët dhe sendet prova materiale, por edhe të dhëna të tjera ndaj tyre të marra në rrugë procedurale, p.sh., ekspertimi psikiatrik i personit të dyshuar të veprës penale<sup>20</sup>.

- Ndryshime ekzistojnë edhe në rregullimin juridik procedural të kryerjes së tyre. Në këtë kuptim, këqyrja kryhet nga organi procedues në praninë e specialistëve, kur shihet e nevojshme (nenet 198-202 të K.Pr.P), ndërsa ekspertimi kryhet nga specialisti i fushës mbi bazën e vendimit të marrë nga organi procedues. Përpos kësaj, këqyrja kryhet në mjedisin ku ka ndodhur (ose dyshohet) vepra penale, ndërsa ekspertimi kryhet në kushte laboratorike sipas një metodike konkrete, shoqëruar njëherësh me përdorim të mjeteve teknike e metodave shkencore<sup>21</sup>.

*Këqyrja e vendit të ngjarjes ka ngjashmëri edhe me kontrollin.* Në të dy rastet kërkohet për të zbuluar e fiksuar e marrë gjurmë dhe sende prova materiale. Por midis tyre ka disa ndryshime, që konsistojnë në bazën ligjore, në qëllimin, në përgatitjen dhe në mjetet e metodat taktike të kryerjes së tyre, si:

- Për këqyrjen e vendit të ngjarjes nuk kërkohet miratim paraprak nga gjykata, ndërsa kontrolli kryhet vetëm me vendim të gjykatës, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë kushtet e flagrancës (neni 202 i K.Pr.P.). Ndërkaq, këqyrja e vendeve dhe e sendeve që posedohen nga persona bëhet me urdhër të organit procedues, duke u dorëzuar fillimisht atyre një kopje të tij. Sipas rastit këta persona mund të urdhërohen të mos largohen deri sa të përfundojë këqyrja (neni 201 i K.Pr.P.).

- Këqyrja kryhet në mjedisin ku ka ndodhur ngjarja, ndërsa kontrolli kryhet në një mjedis tjetër, aty ku dyshohet se fshihen prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale<sup>22</sup>. - Në këqyrjen e vendit të ngjarjes, krahas njohurive të përgjithshme teorike e praktike për zbulimin eventual të gjurmëve e provave materiale sipas llojit dhe natyrës së veprës penale, nuk dihet paraprakisht se çfarë prej tyre do të zbulohen. Ndërsa në kontrollim ka një orientim, një synim për të gjetur mjetet me të cilat është kryer vepra penale, sendet, dokumente, persona e kufoma objekt kërkimi e kontrolli. informacion ky që buron nga këqyrja e vendit të ngjarjes dhe burime të tjera hetimore e procedurale.

<sup>20</sup> Për më gjerë shih: F. Tartale, *Ekspertimi si provë në procedimin penal*, Tiranë 2008, f. 24.

<sup>21</sup> Për më gjerë shih: L. Veliqoti, *Kriminalistika, vëllimi I*, Tiranë 2015, f. 49.

<sup>22</sup> Gjatë kontrollit mund të gjenden jo vetëm sende e prova materiale që kanë lidhje me veprën penale që u bë shkak për kryerjen e tij, por mund të zbulohen edhe: sende e prova materiale që në vetvete mbajtja e tyre përbën veprën penale të veçantë, ose sende e prova materiale që nuk kanë lidhje me atë veprë, por nëpërmjet tyre duket se më parë është kryer një krim tjetër. Pavarësisht nga lidhja ose jo me veprën penale për të cilën u krye kontrolli, në secilin rast sendet e provat materiale sekuestrohen (neni 207 i K.Pr.P.).

Për më gjerë shih: F. Hoxhati, *Flagranca dhe procesi penal*, Tiranë 2000, f. 104.

Megjithatë ka raste, në veçanti kur ngjarja ndodh në mjedise të mbyllura, që këqyrja e vendngjarjes shoqërohet edhe me veprime që i përkasin kontrollimit.

- Kontrolli kryhet vetëm mbasi ka është kryer një vepër penale, për të zbuluar në një vend, në një person apo në një banesë prova materiale ose sende që i përkasin veprës penale, ndërsa këqyrja e vendit të ngjarjes kryhet edhe pse nuk ka një vepër penale, sepse mungojnë pasojat e parashikuara nga ligji, p.sh., në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, (neni 290 i K.P.) ose mungon një element i saj, p.sh., subjekti, në një rast vetëvrasje etj., por fillimisht dyshohet për një vepër penale, gjë që sqarohet vetëm mbas këqyrjes së vendit të ngjarjes.

## 6. Përcaktimi i profilit të autorit të krimit

Çdo vepër penale në një farë mënyre pasqyron personalitetin, profilin e autorit që e ka kryer. Mbi bazën e veprimeve të kryera në vendin e krimit, të gjurmëve dhe provave materiale të zbuluara, mbështetet përcaktimi i profilit kriminal të autorit të tij. Ky profil ndihmon jo vetëm për të bërë një vlerësim të veprës penale në tërësi, por në veçanti për të kërkuar e zbuluar autorin e saj dhe për të zbatuar taktikën e duhur gjatë pyetjes së tij. Analiza e vendit të ngjarjes, e skenës së krimit, mund të sjellë të dhëna të rëndësishme mbi organizimin dhe mënyrën e kryerjes së krimit. Nga këto të dhëna natyrshëm lindin pyetje, cilat shërbejnë për të ndërtuar profilin e autorit të krimit, si:

- Çfarë e nxiti autorin ta kryente veprën penale në këtë vend dhe në këtë kohë?
- Çfarë veprash penale përzgjedh autori (objekti)?
- Çfarë personash (viktima) konkret përzgjedh autori?
- Çfarë metode dhe sipas saj çfarë mjetesh përdor autori i krimit?
- Sa është numri i autorëve të krimit sipas veprimeve dhe gjurmëve në vendin e ngjarjes?
- Çfarë përpjekjesh dhe masa ka marrë autori i krimit për të maskuar dhe evituar gjurmët në vendin e ngjarjes dhe më pas?

Gjatë hetimit të një krimi organi procedues shqyrton përfitimin që autori ka nga kryerja e tij, motivin që e shtyn ta kryejë atë. Sa më i qartë dhe i plotë të përcaktohet ky motiv, aq më afër përcaktojmë tipin dhe profilin e autorit të krimit dha anasjelltas.

Përcaktimi i profilit kriminal të autorit të krimit bazohet më shumë në instinktin, intuitën e organit procedues, se sa në një bazë të konsoliduar shkencore. Megjithatë praktika hetimore tregon se në disa krime, sidomos ato kundër jetës dhe shëndetit të personit, organi procedues mbështetet edhe në të dhëna konkrete, në mjetet dhe metodën e përdorur nga autori i krimit. Konceptet më të nevojshme për të bërë profilizimin e autorit të krimit janë: firma, tipologji, *modus operandi*, mjete provuese, lloje të viktimave, lloje të objekteve të vjedhura, mjete të përdorura etj. Në këtë kuptim, grupi hetimor duhet të analizojë edhe psikologjikisht skenën e krimit, përmes metodës logjike induktive, analogjisë dhe intuitës. Zbatimi i kësaj metode ngushton rrethin e personave të dyshuar, çka bën të mundur lehtësimin, shpejtimin dhe rritjen e objektivitetin në zbulimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Përcaktimi i profilit kriminal të autorit të krimit paraqet vështirësi. Si i tillë, ai jo gjithmonë përfundon gjatë procesit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Studimi i materialeve të grumbulluara në dosje, bashkëpunimi me shërbimet e fshehta, me publikun, me bankat, me medien etj., mundëson krijimin e një profili më të plotë kriminal të autorit të krimit (*modus operandi + modus vivendi*).

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Historikisht përpjekjet e para për profilizimin e kriminelit konsiderohet fillimi i Mesjetës, ku gjyqtarët e inkuizionit përpiqeshin të bënin profilin e heretikëve. Gjatë shekullit të 19-të Ç. Lombrozo, A. Bertillon, H.Gross etj. , trajtuan dhe zbatuan profilin kriminal të autorit të krimit, ndonëse në to u reflektuan mangësi shkencore të diktuara nga koha. Në nivele më të larta shkencore, puna për përcaktimin e profilit kriminal të autorit të krimit, nëpërmjet analizës së skenës së krimit, ka filluar në vitin 1995<sup>23</sup>.

Mbi bazën e studimeve të bëra vrasjeve seriale, FBI klasifikon veprimet e vrasjeve të organizuara nga ato të paorganizuara<sup>24</sup>.

Në një vrasje të planifikuar, si rregull, viktimat është e panjohur, trupi i kufomës i fshehur dhe skena e krimit reflekton një kontroll nga ana e autorit të krimit (nuk ka gjurmë e prova materiale evidente), personaliteti, profili, i autorit të krimit është i një personi inteligjent e me kapacitet për të kontrolluar emocionet. Ndërsa në një vrasje të paorganizuar, skena e krimit paraqitet kaotike dhe nuk është tentuar të fshihet kufoma, profili i autorit të krimit paraqitet me intelekt të ulët dhe me mangësi në jetën sociale. Studiuesi anglez David Canter, në studimin e tij ndaj: vrasjeve të kryera, përdhunimet dhe zjarrvëniet e qëllimshme<sup>25</sup>, i ndan në krime ekspresive, që janë të nxitura nga një situatë e rënduar emocionale të inatit, të urrejtjes dhe impulsivitetit; dhe në krime instrumentale, që janë ato krime në të cilat kërkon të fitosh diçka, p.sh., vrasje për grabitje, larje hesapësh, etj.

Një pjesë e autorëve të krimeve vlerësojnë se mund të tipizohen nga policia nëpërmjet veprimeve në vendin e krimit. Për të shmangur këtë rrezik ata përpiqen të ndryshojnë metodën e kryerjes së krimit në elementë të caktuar. Ndaj për të shmangur gabimet e mundshme në përcaktimin e profilit të autorit të krimit, kjo veprimtari kombinohet me veprimtari profesionale hetimore e gjurmuese.

Për të qenë sa më afër realitetit në përcaktimin e profilit të autorit të krimit, rrjedhimisht për të ndihmuar më shumë hetimin në zbulimin e tij, krahas metodës së kryerjes së krimit “Modus Operandi” – sjellja që autori mban gjatë kryerjes së krimit, mbahet parasysh dhe kombinohet edhe me mënyrën e jetesës “Modus Vivendi” të personave si autorë të dyshuar. Sjellja njerëzore nuk është gjithmonë produkt i personalitetit të shfaqur në krimin e kryer, por edhe e situatës në të cilën është duke vepruar, e kushteve dhe kufizimeve të situatës ku ndodhet.

Në këtë kuptim, për ndërtimin e profilit të autorit të veprës penale, mbahet parasysh edhe zona ku ka ndodhur krimi, kurba e krimeve në afërsi të vendbanimit, veprimtaria sociale e personave me precedentë penal, etj. Kështu, p.sh., në një qytet të vendit tonë, në një periudhë gati katër mujore ndodhën një numër krimesh të rënda: vjedhje me dhunë dhe me armë kundër pronës së qytetarëve, kryesisht bizhuteri.

Nga analiza dhe vlerësimi që ju bë kësaj situate kriminale për: mekanizmin - metodat dhe mjetet e përdorura, koha e kryerjes së tyre (në mesditë), mënyra dhe mjetet e përdorura për largimin nga vendi i ngjarjes, disa karakteristika të pamjes së jashtme të autorëve, - u konkludua se profili i tyre përmbante: ishin tre autorë të moshave 20-30 vjeç, me konstrukt atletik e gjatësi mbi mesatare, dhe banorë të zonës të ngjarjeve të mësipërme; në njërin nga vendngjarjet u gjetën gjurmë biologjike dhe një automjet i braktisur, që i përkiste shtetasit N.B. Mbi bazë edhe të informacioneve të grumbulluara dhe nën drejtimin e prokurorit u krye shoqërimi e ndalimi i shtetasit

<sup>23</sup> Për më gjerë shih: E. Dragoti, *Psikologjia ligjore e krimit*, Tiranë, 2007, f. 190.

<sup>24</sup> Për më gjerë shih: C. Munn, *FBI Academy*, 1992.

<sup>25</sup> Për më gjerë shih: G. Ponti, I. M. Betsos, *Compendio di criminologia*, Milano 2008.

në fjalë, u krye kontrolli i banesës ku u gjetën një sërë provash që lidheshin me ngjarjet e mësipërme, si dhe nga ekspertimi biologjik i kryer u konkludua se gjurmët biologjike, të zbuluara në vendngjarjen në fjalë, kishin të njëjtin profil gjenetik me atë të dyshuarit të mësipërm. Mbi bazën e këtyre provave, për të gjykata dha masën e sigurisë “Arrest me burg” për veprën penale “Vjedhje me armë në bashkëpunim”, nenet 140 e 25 të Kodit Penal<sup>26</sup>.

Në praktikën hetimore e gjyqësore mund të lindë nevoja për të ndërtuar jo vetë profilin e autorit të krimit, por edhe të viktimës së tij. Kështu, p.sh., sjellja e autorit të veprës penale mund të mos jetë e konkretizuar me veprime mekanike e përdorim mjetesh të ndryshme për ta realizuar atë, por mund të jetë e shoqëruar me dhunë psikologjike në mënyrë sistematike kundrejt një personi tjetër – viktimës. Në këto kushte mund të ndodhë që viktimja e dhunuar të kryejë një vepër penale. Në këto raste mund të lindë nevoja për të ndërtuar profilin e autorit të krimit, që është vetë viktimja e dhunuar. Për këtë qëllim na vjen në ndihmë një ndër shkollat e psikologjisë - bihejviorizmi<sup>27</sup>.

Kështu, p.sh., tipik është rasti i deponimit për “sindromën e gruas së rrahur”. “Në rastin shteti kundër Kelly, një grua u akuzua se kishte vrarë bashkëshortin e saj abuziv. Një psikolog u lejua të deponojë rreth studimeve psikologjike me gra në marrëdhënie të ngjashme abuzive, i cili konkludonte se ato ishin në frikë të vazhdueshme për jetën e tyre. Gjykata ishte e mendimit se dëshmia duhej të dëgjohej për të mbështetur pretendimin e saj se kishte vepruar në vetëmbrojtje.”<sup>28</sup>

Në përfundim, është e rëndësishme të mbahet parasysh se, ndërtimi i profilit të autorit të krimit nuk është provë, por ka karakter operativ. Në këtë kuptim ai shërben për të ngushtuar rrethin e personave ku duhen drejtuar hetimet. Ashtu si në tërë veprimtarinë hetimore edhe në këtë rast organi procedues mbështetet në etikën penale, në profesionalizëm dhe në parimin e prezumimit të pafajësisë (neni 4 i K.Pr.P.)

## 7. Përfundime

1. Njohja dhe konsiderimi i natyrës shkencore të kriminalistikës bën të mundur zhvillimin e saj me kompetencë profesionale e shkencore

2. Pajisja e studentëve me njohuri të thella për lëndën e kriminalistikës, është domosdoshmëri për zbatimin me sukses në praktikë të teknikave dhe metodave shkencore kriminalistike në luftën kundër kriminalitetit.

3. Kualifikimi dhe përditësimi i organit procedues me teknikat dhe metodat shkencore kriminalistike rrit efektivitetin e veprimtarisë së tij për zbulimin, hetimin dhe gjykimin me shpejtësi dhe objektivitet të veprave penale.

<sup>26</sup> *Bihejviorizmi* – shkenca e sjelljes, sjellje që buron nga shpirti, nga frymëmarrja, siç ka kuptimin fjala greke “psiko” nga e ka burimin e emrit shkenca e psikologjisë. Shkollë psikologjike, që lidhet me emrin e psikologut amerikan John. B. Watson, i cili në vitin 1913 shprehu mendimin se psikologjia duhet të jetë shkencë e sjelljes së jashtme, e matshme dhe objektive. Bihejvioristët besojnë se psikologjia duhet të jetë shkencë “solide” si fizika dhe kimia.

<http://sq.wikipedia.org/wiki/>

<sup>27</sup> Dosja penale nr. 67/2013.

<sup>28</sup> J. Smibert, *Parimet e provave*, Tiranë 2014, f. 175.

4. Njohja dhe konsiderimi i natyrës juridike të këqyrjes së vendit të ngjarjes, përbën një hallkë të rëndësishme në organizimin dhe kryerjen me cilësi të saj.

5. Organizimi dhe kryerje me efektivitet i këqyrjes së vendit të ngjarjes është baza e suksesit për zbulimin, dhe e të provuarit me objektivitet dhe shpejtësi të veprave penale.

6. Njohja dhe zbatimi me profesionalizëm i metodave kriminalistike për ndërtimin e profilit të autorit të veprës penale, përbën një ndihmë të çmuar në shpejtësinë e zbulimit, të hetimit dhe parandalimit të krimeve.



## Bibliografia

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.*
2. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 2002.
3. Kodi Penal i R.Sh., Tiranë 1995, me ndryshimet.
4. Kodi i Procedurës penale, Tiranë 1995, me ndryshimet.
5. S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë 2007.
6. V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2004.
7. L. Veliqoti, *Kriminalistika*, Vëllimi I, Tiranë 2015.
8. L. Veliqoti, Revista "Tribunë Juridike", Tiranë, nr.82/2010.
9. L. Veliqoti, Revista "Jeta juridike", Tiranë, nr.2/2017.
10. A. Hoxha, H. Islami, I. Panda, *Procedura Penale (kommentar)*, Tiranë 2010
11. E. Dragoti, *Psikologjia ligjore e krimit*, Tiranë 2007.
12. H. Demolli, *Terrorizmi*, Prishtinë 2012.
13. N. Korajlic, D. Muharemi, Xh. Ademaj, *Fjalori Terminologjia Kriminalistike*, Prishtinë 2016.
14. V. Vodinelic, *Kriminalistika*, Prishtinë 1970.
15. V. Vodinelic, *Dalja në vendin e ngjarjes*, Nasha Zakonost, Zagreb, nr.6/1975.
16. V. Vodinelic, *Këqyrja e vendit të ngjarjes*, Beograd, JRKK, nr.3/1977.
17. F. Tartale, *Ekspertimi si provë në procedimin penal*, Tiranë 2008.
18. F. Hoxhati, *Flagranca në procesin penal*, Tiranë 2000.
19. C. Munn, *FBI Academy*, 1992.
20. G. Ponti, I.M. Betsos, *Compendio di criminologia*, Milano 2008.
21. J. Smibert, *Parimet e provave*, Tiranë 2014.
22. *Dosja penale nr.67/2013.*
23. <http://sq.wikipedia.org/wiki/>

# Rëndësia e eksperimentit hetimor gjatë procesit të hetimit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Dekan në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit

Akademia e Sigurisë

[ilirjan.mandro@asp.gov.al](mailto:ilirjan.mandro@asp.gov.al)

## Abstrakt

*Gjatë procesit të hetimit, ndodhemi para fakteve dhe rrethanave, të cilat mund të jenë dhe "negative" në një ngjarje konkrete. Shpesh lind nevoja për verifikimin e fakteve që lidhen me ngjarjen, duke vërtetuar një rrethanë, fakt, ngjarje që ka ndodhur dhe si mund të ketë ndodhur. Mund të ndodhemi gjatë procesit të pyetjes së dëshmitarëve okularë, apo të dëmtuarve, të cilët japin shpjegime mbi rrethanat e ngjarjes, me elementë që në balancë të provave të gjetura dhe fiksura në vendin e ngjarjes, nuk kanë përputhshmëri dhe lidhje logjike. Të gjitha këto thënie-kundërrthënie duhen vërtetuar dhe mundësia më e mirë për saktësimin e tyre me objektivitet, është kryerja e eksperimentit hetimor. Në çdo rast kur hetimi është në "udhëkryq", kryerja e eksperimentit në zbatim të kërkesave ligjore dhe metodikave kriminalistike, është zgjidhja më e mirë e problemit. Verifikimi i mundësisë së të parit, apo të dëgjuarit të një bisede, mundësia e kryerjes së një veprimi kriminal, apo mundësia e kryerjes së disa veprimeve kriminale në njësi kohe të caktuar, janë momente ku në të shumtën e rasteve kryhen eksperimentet hetimore. Për të ilustruar materialin dhe për ta bërë më të kuptueshëm për lexuesin, janë ofruar nga praktika personale profesionale, disa eksperimente hetimore të zhvilluara për verifikimin e mundësisë së një vrasjeje, vjedhje me dhunë apo aksidenti automobilistik.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

## Fjalëkyçe:

eksperimentit hetimor, mjekësia ligjore, kërkesa procedurale, hetim, prova.

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Kuptimi dhe rëndësia

Gjatë zhvillimit të hetimit, apo procesit të gjykimit, lind nevoja e verifikimit të fakteve dhe rrethanave të cilat lidhen me ngjarjen. Në këtë proces është e rëndësishme të vërtetosh, nëse një veprim ka ndodhur dhe, mundësisht të verifikosh se si ka ndodhur. Në kuptimin procedural, eksperimenti është riprodhimi, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur, ose çmohet se ka ndodhur, duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit<sup>1</sup>.

Praktika hetimore, ka treguar se eksperimentet, në të shumtën e rasteve, kanë të bëjnë me verifikimin e rrethanave dhe fakteve. Zhvillimin e eksperimenteve, në vështirë historik, e konstatojmë edhe në “Kanunin e Lek Dukagjinit”.

Gjatë grindjes së dy bashkëfshatarëve, ata nxorën armët; në mes të krismave për të shuar këtë gjakderdhje u fut një grua, e cila ishte dhe shtatzënë. Me të shkuar në shtëpi, kjo grua dështon fëmijën e saj. Rasti u mor në shqyrtim nga Këshilli i Pleqve dhe u vendos të kryej një lloj prove, apo me saktë, në terminologji juridike, të themi “eksperimenti hetimor”, për aq sa mund të quhet i tillë. Pleqtë do të zhvillonin “eksperimentin”, duke zbratur dy armë në afërsi të një ene të mbushur me qumësht. Nga qitjet me armë zjarri, ena e qelqit u thye, plasi. Në këtë rast, Këshilli i Pleqve vendosi që “gruaja me shtat të xanë ashtë si maza e tamlit (qumështit)”. Në këtë rast, u arrit në konkluzionin se gruaja ka humbur fëmijën, dështoi, për shkak të krismave të armëve dhe personat që kishin qëlluar ishin fajtorë<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21. 3. 1995, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017; neni 176/1 “Kushtet e eksperimentit”.

<sup>2</sup> Bashkim Guberi, *Mjekësia Ligjore*, Tiranë: Universitetit i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, 1981, f. 12.

E rëndësishme në kryerjen e eksperimenteve, për organin e procedimit, është të vërtetohet nëse veprimet e kryera nga autori janë parë nga një pozicion i caktuar;<sup>3</sup> “a janë dëgjuar bisedat e zhvilluara nga persona konkretë, subjekte nën hetim apo gjykim?” dhe “a mundet që dëmtimet e shkaktuara në një objekt, apo çdo veprimtari tjetër kriminale, mund të kryhen në një kohë të caktuar nga një person i vetëm apo duhen dy apo më shumë persona?”. Gjithashtu, eksperimenti hetimor, ndikon edhe në vërtetimin e elementëve të tjerë, të cilët rruga e gjatë e hetimit i nxjerr për t’u verifikuar.

Në fazën e planifikimit të hetimit, një ndër momentet e rëndësishme që detyron organin e procedimit të zhvillojë eksperimentet hetimore janë dhe versionet hetimore. Në një ngjarje konkrete, hidhen disa versione hetimore dhe organi i procedimit, është i detyruar t’i verifikojë ato, me argumente bindëse dhe fakte të vërtetuara, duke e orientuar hetimin drejt një versioni, por jo në të gjitha rastet ndoshta përfundimtar. Versionet hetimore mund të klasifikohen nisur nga elementët e figurës së veprës penale, objektit, subjektit, anës objektive dhe anës subjektive. Gjatë veprimeve hetimore lindin “dyshime” për elementë të ndryshëm të procesit, por duhet pasur parasysh se “dyshimet” janë të zhveshura nga faktet; ato vetëm krijojnë pasiguri dhe mosbesim në vërtetësinë e tyre.

Të dhënat e para që merren në vendin e ngjarjes dhe që shërbejnë si bazë për fillimin e çështjes penale, në disa raste nuk janë të mjaftueshme për të ngritur dhe hedhur versione hetimore për autorësinë e ngjarjes. Mund të ngrihen versione vetëm për disa elementë të caktuar.

Bazat për ngritjen e versioneve janë:

a. provat materiale të fiksuar në vendngjarje, elementët e të cilëve janë të dukshëm apo të padukshëm;<sup>4</sup>

b. thëniet e dëshmitarëve, të dëmtuarve, në lidhje me përshkrimin e autorit apo mekanizmit të kryerjes së ngjarjes.

Të gjitha faktet që dalin nga procesi i hetimit dhe fazës së gjykimit të një vepre penale, verifikohen në mënyrë shkencore, vetëm me anë të eksperimentit hetimor.

*Eksperimenti hetimor* është riprodhimi, për aq sa është e mundur, i gjendjes, në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit. Pra, eksperimenti hetimor është një veprim/hetimor, i cili ka për qëllim të verifikojë dhe të saktësojë provat që janë mbledhur, versionet hetimore që janë ngritur dhe të nxjerrë elementë të tjerë provues, si në riprodhimin e ambientit dhe rrethanave të ngjarjes që duhen kontrolluar.

Eksperimenti lejohet të kryhet, kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt apo rrethanë e konstatuar gjatë procesit të hetimit apo gjykimit, ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur, në një mënyrë të caktuar. Rëndësia e eksperimentit hetimor qëndron në dy drejtime kryesore:

*Së pari:* Si metodë efikase për verifikimin e rezultateve të veprimeve hetimore apo gjyqësore, të kryera për verifikimin e saktësisë së thënieve të dëshmitarit, të pandehurit dhe së të dëmtuarit.

*Së dyti:* Si metodë efikase për gjetjen dhe marrjen e provave të reja kryesisht për:

a. verifikimin dhe konstatimin e mundësisë së kryerjes së një vepre kriminale në një mënyrë dhe metodë të caktuar;

<sup>3</sup> Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, *Procedura Penale, Komentar*, Tiranë: 2003, f. 228.

<sup>4</sup> Në vend ngjarje evidentohen prova të dukshme si: mjeti që ka kryer aksidentin, armët e përdorura në një vrasje, pozicioni i kufomës apo prova të tjera të padukshme zbulimi i të cilave kërkon përpunime të mëtejshme kimike apo laboratorike si gjurmë daktiloskopike, biologjike etj.

- b. evidentimin, zbulimin e mekanizmit të kryerjes së veprës penale;
- c. përcaktimin e shkallës dhe nivelin e mundësive që mund të ketë një person apo më shumë se një person për të kryer veprime të caktuara në vendin e ngjarjes;
- d. të zbuluar veprime të caktuara që mund të kryhen në vendin e ngjarjes për arritjen e qëllimit kriminal.

Me anë të eksperimenteve hetimore vërtetohet:

a) *Mundësia e të parit* të ngjarjes nga një distancë e caktuar, në një kohë të caktuar ditën ose natën. Thëniet e dëshmitarëve okularë apo e të dëmtuarve, duhen vërtetuar pasi i përket vërtetësisë së tyre dhe mundësisë që kanë pasur, për të parë ndoshta dhe në kushtet e një pamje të kufizuar, ngjarjen apo autorin. Eksperimenti hetimor nuk është vetëm një mjet verifikimi, por edhe një mjet saktësimi i të dhënave të dëshmimeve, që kanë dhënë dëshmitarët apo të dëmtuarit.

b) *Mundësia e të dëgjuarit*, si vërtetimi i faktit të mundësisë së dëgjimit të bisedave për një veprimtari kriminale, apo i zhurmave të shkaktuara në vendin e ngjarjes. Këto detyrojnë organin e procedimit për t'i vërtetuar ato.

c) *Mundësia e kryerjes së disa veprimeve*, si përgatitja e materialit shpërthyes, vendosja e tij në elektromotorin e jashtëm të kondicionerit, mundësia e ngjitjes dhe e largimit nga ky objekt etj.

d) *Mundësia e kryerjes së disa veprimeve të caktuara në një kohë të caktuar*, si vendosja e lëndës plasëse në një objekt tregtar, dhe po i njëjti mekanizëm shpërthimi është përdorur në një objekt tjetër rreth 3 km larg objektit të parë. Shpërthimi i dytë ka ndodhur në një interval kohor 35 minuta. Organi i procedimit, duhet të bëjë eksperimentin, për të vërtetuar se këto dy shpërthime kanë të njëjtin autor, apo kemi të bëjmë me dy autorë bashkëpunues me njëri-tjetrin, ku kanë përdorur të njëjtin mekanizëm shpërthimi.

## 2. Masat paraprake për kryerjen e eksperimentit

Eksperimenti hetimor, kryhet kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur në një mënyrë të caktuar.<sup>5</sup> Në procesin e hetimit, merren dëshmi, njihemi me rrethana për të cilat vendoset nëse është i domosdoshëm të kryhet eksperimenti hetimor, pra për të vërtetuar nëse mund të ndodhin ose jo, apo mund të dëgjojmë apo shikojmë nga një vend konkret. Verifikimi, saktësimi i dëshmimeve, apo mekanizmit të kryerjes së ngjarjes konkrete, ka rëndësi në ecurinë e procesit të hetimit apo gjykimit. Për zhvillimin e eksperimentit hetimor, zbatohen disa rregulla bazë<sup>6</sup> dhe, para zhvillimit të tij, përcaktohet qëllimi i zhvillimit të eksperimentit hetimor, rrethanat, elementët të cilët do të verifikohen dhe vërtetohen, personat që do të marrin pjesë në eksperiment, numri i të cilëve do të varet nga natyra e eksperimentit, vendet dhe vështirësitë që mund të hasen gjatë zhvillimit të tij, numri i grupeve që do të ngrihen, për zhvillimin e eksperimentit<sup>7</sup>,

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>5</sup> V. Qarri, *Njohuri mbi të Drejtën Procedurale Penale*, Tiranë: 2004, f. 66.

<sup>6</sup> *Kodi i Procedurës Penale në RSH*, Neni 177, "Rregullat e kryerjes së eksperimentit": 1. Vendimi i organit procedues për kryerjen e eksperimentit përmban një njoftim përmbledhës për objektin e tij dhe tregimin e ditës, të orës dhe të vendit ku do të kryhen veprimet. Në të njëjtin vendim ose në një tjetër të mëvonshëm, mund të caktohet një specialist për kryerjen e veprimeve të caktuara. 2. Organi procedues merr masa të përshtatshme për kryerjen e veprimeve, duke urdhëruar edhe fotografimet dhe filmimet, si dhe për të mos rrezikuar sigurinë e personave dhe atë publike.

<sup>7</sup> Ka raste që duhen ngritur disa grupe, ku njëri prej tyre qëndron në vendin e "burimit të provës" dhe tjetri në vendin ku është dëgjuar biseda, krisma e armës etj.

distanca dhe mënyra e vendosjes së këtyre grupeve.

Gjithashtu përcaktohen dëshmitarët, pjesëmarrës që do të jenë të pranishëm pranë grupeve të ngritura. Nëse vlerësohet do të jetë i pranishëm i pandehuri, mbrojtësi i tyre kur verifikohen veprimet e kryera prej të pandehurit në vendin e ngjarjes. Për këtë njoftohen me shkrim institucionet ku mbahet i pandehuri, për t'u sjellë në vendin e kryerjes së eksperimentit hetimor dhe marrjen e masave nga këto institucione për ruajtjen dhe sigurimin e tij. Gjatë zhvillimit të eksperimentit, të rëndësishme janë mjetet teknike që do të duhen gjatë këtij procesi, mjete që përcaktohen nga specialistët, oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori në varësi të llojit të eksperimentit që do të zhvillohet. Përpara se të kryhet eksperimenti hetimor, parapërgatiten provat materiale që do të përdoren gjatë zhvillimit të tij, prova të cilat përdoren vetëm me lejen e drejtuesit të procesit të hetimit.<sup>8</sup>

Është e rëndësishme, që para fillimit të kryerjes së eksperimentit hetimor, të jenë përcaktuar vendet ku do të zhvillohet. Ka rëndësi, studimi në detaje dhe vlerësimi i procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, në mënyrë që objektet, apo provat, të rivendosen në vendet ku kanë qenë në momentin e këqyrjes nga grupi i hetimit.

Në fillim të zhvillimit të eksperimentit hetimor, bëjmë fotografi dhe filmime të ambienteve ku do të zhvillohet eksperimenti, me të gjitha provat apo objektet e rivendosura. Në momentin e parë, do të krijohet një tabelë fotografike me mbishkrimin: “Pamje e vendit dhe provave materiale para fillimit të kryerjes së eksperimentit hetimor”<sup>9</sup>.

Veprimet procedurale, organizative, apo përgatitja për zhvillimin e eksperimentit hetimor, përfshin edhe disa masa që merren në vendin ku zhvillohet eksperimenti, masa këto që kanë të bëjnë me kushtet dhe rrethana të cilat duhet të jene sa më të përafërta me ato ku dhe kur ka ndodhur ngjarja. Praktika hetimore dhe kriminalistike, është gjendur para vështirësive në kryerjen e eksperimenteve hetimore, mbasi vendi ku ka ndodhur ngjarja ka ndryshuar për shkak të ndërtimeve të tjera që mund të jenë bërë apo ndryshim të territorit për interesa publike. Në këto raste merren masa nëse ai vend a mundet të kthehet në gjendjen e mëparshme ose jo.

Nga pikëpamja taktike këshillohet që dëshmitarët ose të pandehurit, veprimet e të cilëve verifikohen, të mos njihen me hollësitë e veprimeve që do të kryhen gjatë procesit të eksperimentit. Arsyeja e vetme, është se ndryshe kryhen veprimet në mënyrë të rrjedhshme, të pavullnetshme në momentin e kryerjes së një veprimi të caktuar, dhe ndryshe kryhen veprimet, në mënyrë të vullnetshme, në momentin e riprodhimit të rrethanave që lidhet me veprën penale. Për të mënjanuar sa më shumë ndikimin e tyre, dëshmitarët ose të pandehurit bëhen me dije, në formë të përgjithshme, për eksperimentin hetimor që do të kryhet. Ndryshe veprohet me dëshmitarët e pranishëm, avokatët mbrojtës dhe personat e tjerë; ata domosdoshmërisht marrin dijeni për gjithçka që do të kryhet në vendin e ngjarjes.

### 3. Rregullat kryesore për zhvillimin e eksperimentit

Të vendosësh kryerjen e një eksperimenti hetimor, duhet të jesh i parapërgatitur

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>8</sup> Rregulli në kryerjen e eksperimenteve është se ato kryhen me të njëjtat mjete që është kryer vepra, por ato mund të zëvendësohen me objekte të njëjta me to në të gjitha rastet kur, këto objekte prova, shkatërrohen dhe humbasin cilësitë e tyre.

<sup>9</sup> Është e rëndësishme kjo tabelë fotografike për fazat e tjera të hetimit apo gjykimin, mbasi gjykohet për ambientin, ndryshimet që mund të ketë pasur nga faktorë të ndryshëm, provat që përdoren, nëse janë ato që janë gjetur në vendin e ngjarjes apo janë të tjera të ngjashme me to.

mirë; të njohësh materialet e çështjes me të gjithë elementët e tij për shkak se në përfundim të eksperimentit, mbi bazën e rezultateve të arritura, do të konkludohet për një rezultat pozitiv apo negativ.

Vendimi i organit procedues për kryerjen e eksperimentit, përmban një njoftim përmbledhës për objektin e tij dhe tregimin e ditës, të orës dhe të vendit ku do të kryhen veprimet. Në të njëjtin vendim ose në një tjetër të mëvonshëm, mund të caktohet një specialist për kryerjen e veprimeve të caktuara.<sup>10</sup> E rëndësishme është marrja e të gjitha masave dhe krijimi i kushteve sa më ideale me skenën e krimit, apo vendet nga ku është parë kryerja e një veprimi të caktuar, apo janë parë persona, autorë të një ngjarjeje.

E rëndësishme gjatë këtij procesi, është marrja e masave që eksperimenti hetimor të zhvillohet në vendin ku ka ndodhur ngjarja, apo vendin në të cilën do të duhet verifikimi i rrethanave të ngjarjes. Në rastet kur nuk është e mundur të respektohet ky rregull, me miratim të organit të procedimit, veprimet eksperimentale kryhen në kushte laboratorike. Ky moment do trajtuar me rezervë, se jo në të gjitha rastet mund të arrihet përputhshmëria e rrethanave të vendit të ngjarjes me rrethanat e krijuara në kushte laboratorike.

Koha e zhvillimit të eksperimentit, domosdoshmërisht, të jetë sa më afër kohës së kryerjes së ngjarjes për të cilën zhvillohet ky eksperiment. Në të gjitha eksperimentet kushtet duhet të jenë maksimalisht afër realitetit, pra merren parasysh edhe faktorë të tjerë që ndikojnë, si: zhurmat (kantier ndërtimi, ambiente industriale, apo autostradë), zhurma të shkaktuara nga forca e erës në bregdet apo në mal, kushte të pamjaftueshme të ndriçimit etj.

Ndodh që eksperimenti nuk mund të zhvillohet në muaj të njëjtë me atë që ka ndodhur ngjarja. Koha këtu, do të përcaktohet e saktë. Nëse në janar, kur ka ndodhur ngjarja dhe dëshmitari pretendon se e ka parë siluetën e autorit gati në të ngrysur (rreth orës 16.00), në muajin korrik, dita është më e gjatë, kështu që eksperimenti nuk do të zhvillohet në orën 16.00 por në orën 20.40, moment ky që sapo fillon të erret, pra bëhet përqsaje e kohës së errësimit. Në këto raste, për perëndimin e diellit në kohë të ndryshme apo lindjen e tij, merret informacion nga specialistët e meteorologjisë.

Eksperimenti hetimor përsëritet disa herë dhe gjatë zhvillimit të tij, nuk duhet krijuar një bindje “e verbër” në atë çfarë arrihet me zhvillimin e një prove të vetme. Pavarësisht rezultatit të parë në favor ose jo të hetimit apo provave të tjera, eksperimenti hetimor zhvillohet disa herë dhe në çdo herë, situata përkeqësohet.

Nëse dëshmitari pretendon se në një klub nate ka dëgjuar “të flitet për vendosje lënde eksplozivi në banesën e shtetasit A. B.”, eksperimenti hetimor do të zhvillohet disa herë nën tingujt e muzikës apo zhurmave të tjera. Grupi ku janë personat që do të zhvillojnë bisedën, do flasin me intonacion normal që mund të bëhet në një tavolinë kur diskutohen probleme “delikate”.

Eksperimenti përsëritet disa herë duke “përkeqësuar situatën”, duke folur me zë më të ulët, apo volumi i muzikës në prova të ndryshme të eksperimentit hetimor do të rritet deri në një kufi të caktuar që i përgjigjet “muzikës normale” të ambientit. Rezultatet e çdo eksperimenti fiksohen me procesverbal, fotografim dhe videoregjistrim<sup>11</sup>.

Nëse zëri i bisedës vjen dhe rritet, atëherë jemi në kushtet e “përmirësimit të kushteve” të eksperimentit. Nëse zhurmat e ambientit do të rriten, do të jemi në “kushtet e

<sup>10</sup> Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905 datë 21. 3.1995, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017; neni 177 “Rregullat e kryerjes së Eksperimentit”.

<sup>11</sup> Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, *Procedura Penale, Komentar*, Tiranë: 2003, f. 229.

përkeqësimit” të kushteve të eksperimentit. Por, të jemi të kujdesshëm se asnjë njeri nuk bën biseda me zë të lartë, sidomos në rastet kur bisedohet për veprime të kundërligjshme e të një karakteri të mprehtë kriminal. Eksperimenti hetimor në asnjë rast nuk zhvillohet, nëse gjatë veprimeve të tij dëmtohet dinjiteti, morali, shëndeti, jeta e të tjerëve apo dëmtohet pasuria shtetërore apo private.

#### 4. Qëllimet për të cilat kryhet eksperimenti hetimor

Vërtetësia, argumentimi dhe vlerësimi i ekzistencës së provave materiale në një vendngjarje, realizohet vetëm me anë të kryerjes së eksperimentit hetimor. Legjislacioni procedural penal, si qëllim kryesor të zhvillimit të eksperimentit, përmend verifikimin e mundësisë së dëgjimit, shikimit, kryerjes së disa veprimeve të caktuara dhe kryerjes së disa veprimeve të caktuara brenda një kohe të caktuar.

*Ekspërimenti hetimor për të verifikuar mundësinë e të dëgjuarit.* Kryerja e këtij eksperimenti ka vështirësitë e veta, për faktin e vërtetimit të asaj çka pretendohet se është dëgjuar nga dëshmitari. Kryerja e këtij eksperimenti kërkon marrjen e masave për të bërë sa më afër realitetit ambientin, duke marrë parasysh faktorë që mund të dobësojnë ose ta forcojnë mundësinë e dëgjimit. Më lart folëm për disa elementë që duhen mbajtur parasysh gjatë zhvillimit të këtij eksperimenti.

Eksperimenti hetimor për të vërtetuar mundësinë e dëgjimit, përsëritet disa herë e për çdo përsëritje kushtet përkeqësohen. Rezultatet e çdo eksperimenti fiksohen me proces-verbal, fotografim dhe videoregjistrim. Gjatë zhvillimit të eksperimentit organizohen dy grupe, ku njëri prej tyre ndodhet në vendin ku është dëgjuar biseda apo zhurmat, dhe tjetri, aty ku mendohet se është burimi i bisedës, fjalëve apo zhurmave. Mbas çdo eksperimenti grupet ndërrojnë vendet.

Në vitin 199.. konstatohet rrëzimi i një mjeti, i cili transportonte lëndë drusore në terren tepër të thyer. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, u konstatua se drejtuesi i mjetit kishte mundur të hidhej nga makina, por ngarkesa e drurëve i kishte rënë mbi trupin e tij dhe dëmtimet masive që kishte marrë, i kishin shkaktuar vdekjen e menjëhershme.

Nga pyetja e banorëve, u mor një informacion se para se të dëgjohej zhurma e rënies së mjetit, ishte dëgjuar një krismë arme, por që për banorët vendas nuk ishte e jashtëzakonshme mbasi të gjithë kishin armë dhe gjuanin herë pas here.

Ky informacion u vlerësua dhe automjetit iu ribë edhe një rikëqyrje, ku u konstatua një çarje, vrimë, në gomën e parë të krahut të majtë të automjetit, e cila në këqyrje nuk u vlerësua dhe u mor si dëmtim i përgjithshëm i automjetit mbas rënies. Ky dëmtim, korrespondonte me një dëmtim të pjesës së metaltë të diskut, brenda hapësirës së gomës. Për të vërtetuar dhe konkluduar për këto dëmtime shkaku e ardhjes së tyre, u krye eksperimenti hetimor për mundësinë e dëgjimit të krismës së armës nga vendi i ngjarjes ku kishte rënë mjeti deri tek vendi ku dëshmitarët kishin dëgjuar krismën. Rezultatet e disa eksperimenteve rezultuan në të njëjtin përfundim.

Pra, “drejtuesit të automjetit i ishte zënë pritë, dhe goditur me armë zjarri.” Në përfundim të së gjithë procesit të hetimit, u arrit në përfundimin se “drejtuesi i mjetit duke parë personin që kishte zënë pritë me armë zjarri, për t’i shpëtuar goditjes, ishte hedhur nga makina, e cila për shkak të dëmtimit të marrë në gomën e parë, devijoi drejt humnerës; ngarkesa e drurëve bie mbi drejtuesin e mjetit, i cili për shkak të dëmtimeve të marra gjeti vdekjen”.

*Në rastin konkret, eksperimenti hetimor vërtetoi se nuk jemi para një aksidenti, por*



*një vrasjeje.*

Pjesëmarrësit në eksperimentet hetimore nënshkruajnë procesverbalin e eksperimentit jo për veprime të pjesshme, por për të gjitha veprimet që kryhen gjatë këtij procesi.

*Eksperimenti hetimor për të verifikuar mundësinë e të parit*, krijon mundësinë e verifikimit:

- të shikimit nga një distancë e caktuar,
- të shikimit në një kohë të caktuar (kohë me shi, diell apo vrenjtur),
- të shikimit në një orë të caktuar (ditën apo natën).

Të gjithë këta elementë, kanë vlerë për vazhdimësinë e procesit të hetimit. Thënie të ndryshme të dëshmitarëve okularë, apo të dëmtuarve gjatë procesit të pyetjes, duhet të vërtetohen, për sa i përket vërtetësisë së tyre dhe mundësisë reale që ata kanë pasur për të parë, ndoshta dhe në kushtet e një pamjeje të kufizuar, ngjarjen. Eksperimenti hetimor nuk është vetëm një mjet verifikimi, por edhe një mjet saktësimi për thëniet e tyre. Ky eksperiment, në bazë të kërkesave të përgjithshme të zhvillimit, kryhet në të njëjtin vend dhe kushte që kanë ekzistuar ose mendohet se kanë ekzistuar, kur ka ndodhur ngjarja.

Verifikimi i procesit të së parit mund të mos zhvillohet vetëm në ambiente të hapura, por edhe në ambiente të mbyllura, ku ndriçimi mund të jetë artificial. Në këto raste, zbatohen të njëjta kushte ndriçimi, si në momentin që ka ndodhur ngjarja. Vështirësi paraqet rasti, kur verifikohet mundësia e të parit në vende të hapura, në një kohë kur, nga momenti i ngjarjes e deri në momentin e verifikimit, ka kaluar një periudhë e gjatë kohore.

Përsëritja e eksperimentit, bëhet duke ulur (vështirësuar) ndriçimin, e në qoftë se përsëri dëshmitari okular, arrin të shohë objektin, atëherë bindemi plotësisht në vërtetësinë e thënieve, të vërtetuara këto dhe me anë të eksperimentit hetimor.

Në vjedhjen e një njësie tregtare, shtetasi F. R., me banim pranë kësaj njësie, gjatë pyetjes në cilësinë e dëshmitarit, tregon se ka konstatuar personin B. Y. në derën e njësisë, dhe në momentin që ka hapur dritaren, B. Y. ka dëgjuar zhurmë, ka lënë pranë hyrjes së njësisë tregtare një çantë të zeze dhe është larguar me shpejtësi. Gjatë këqyrjes, grupi i hetimit nuk konstatoi një provë të tillë, pra nuk u fiksua çantë në hyrje të njësisë tregtare, megjithatë kjo u lidh me ndonjë veprim të pakujdesshëm të punonjësve të njësisë të cilët konstatuan të parët vjedhjen.

Mbas shumë pyetjesh të punonjësve të njësisë, asnjëri prej tyre nuk mori përsipër gjetjen apo lëvizjen e kësaj çante. Gjithashtu u verifikua pozita e 56-vjeçarit B. Y. ku rezultoi si person i identifikuar kryesisht për vjedhje objektesh tregtare dhe banesa. Por, diçka që të bënte të dyshoje ishte moshja të cilën ai kishte. Kjo moshë dhe rëndesa e tij fizike, nuk justifikonte forcën e ushtruar në hapjen e derës kryesore si dhe, kapërcimin e një pengese të shkallëve, me një distancë rreth 1.8 m.

Faktet e mbledhura, e orientonin hetimin në një drejtim krejt tjetër nga ç'pretendonte në deponimet e tij, dëshmitari okular F. R. Gjithashtu, oficeri i policisë gjyqësore kishte konstatuar se kur F. R. vinte në zyrën e tij për t'u pyetur, nuk para orientohej mirë me objektet e zyrës; gjatë nënshkrimit të procesverbalit të pyetjes kishte vështirësi të shikimit. Në këto kushte, u vendos kryerja e një eksperimenti hetimor. Për të qenë të sigurt, në konkluzione, organi procedimit vendosi kryerjen e disa eksperimenteve (u kryen gjashtë eksperimente me ndriçime të ndryshme), ku u konstatua se shtetasi F. R., nuk ishte në gjendje të identifikonte njerëzit në distancën që pretendonte dhe aq me tepër, shtetasin

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

B. Y., të cilin “e quante autorë të vjedhjes”, se e kishte parë dhe njohur.

Eksperimenti u përsërit disa herë, duke ndryshuar distancat e të parit, duke afruar shtetasin F. R. sa më afër objektit ku pretendohet se kishte parë shtetasin B. Y. Rezultatet e arritura në eksperimentin hetimor, hodhën poshtë pretendimet e shtetasit F. R., për njohje dhe identifikim të autorit.

Mbasi u ripyet dhe njëherë, shtetasi F. R., dhe duke u vënë para “fakteve dhe rrethanave negative” të sjella prej tij, pranoi se shfrytëzoi rastin e thyerjes së njësisë tregtare për të fajësuar shtetasin B. Y., me të cilin kishte pasur konflikte të vjetra pronësie<sup>12</sup>.

*Eksperimenti hetimor për të verifikuar mundësinë e kryerjes së disa veprimeve të caktuara*, konsiston në verifikimin dhe vërtetimin e kryerjes së disa veprimeve të caktuara. Shpesh, kryerja e eksperimentit vërteton nëse kemi të bëjmë me një person apo shumë persona.

Në rrethin “H” gjendet kufoma e një personi, seksi mashkull, i groposur në një thellësi rreth 40 cm. Mbas një pune intensive hetimore, dyshimet e mundshme si autorë u hodhën për shtetasen V. B. Mbas ndalimit të saj ajo pranoi kryerjen e vrasjes.

Megjithëse V. B. pranoi autorësinë, elementë të veçantë të ngjarjes të evidentuara gjatë këqyrjes së skenës së krimit, nxitën organin e procedimit të vendosi kryerjen e eksperimentit hetimor, për të verifikuar mekanizmin e përdorur prej saj për të realizuar këtë vrasje dhe mundësinë e transportimit dhe groposjes së viktimës.

Gjatë zhvillimit të eksperimentit u provua se V. B., ishte në gjendje të transportonte viktimën<sup>13</sup> për rreth 3 km nga vendi i vrasjes, të hapte një gropë dhe ta mbulonte atë. Pra gjithçka ishte në mundësitë e saj fizike për të kryer të gjitha veprimet e mësipërme.

*Eksperimenti hetimor për të verifikuar mundësinë e kryerjes së disa veprimeve brenda një kohe të caktuar*, ka rëndësi për faktin se, vërteton në shumë raste fajësinë apo pafajësinë e personit të akuzuar. Si metodikë, ky eksperiment është i njëjtë nga kushtet, me atë të “verifikimit të mundësive të kryerjes së disa veprimeve të caktuara”. Ndryshimi i tyre qëndron në verifikimin e kohës, pra e dyshimtë është vetëm njësia “kohë”, gjatë së cilës mund të kryhet një veprim i caktuar.

Në një vendqëndrim të trajleve në portin detar të qytetit..., konstatohet vjedhja e njërit prej tyre në një hapësirë kohore 1.5 orë, kohë kjo kur të dy drejtuesit e mjetit qëndruan në një restorant për të darkuar. Mbas u kryen veprimet e para hetimore, u bë këqyrja e mjetit, u pyetën mjaft dëshmitarë, u kontrolluan kamerat e objektit si dhe shërbimet e rojës. Në përfundim të së gjitha këtyre veprimeve, u konstatuan “mjaft elementë negativë” dhe në këto kushte, u vendos të zhvillohej eksperimenti hetimor. Për këtë u përzgjedhën disa punëtorë të fuqishëm fizikisht dhe u vunë për të zbratur një trajler me ngarkesë malli, të njëjtë, me atë të pretenduar si të vjedhur. Në njësinë e kohës 1.5 orë u kryen disa veprime:

- u afua një mjet tjetër, i cili do të ngarkonte mallrat e marra nga trajleri i vjedhur (elementë ky, negativ, i verifikuar nga kamerat e sigurisë);

- u hapën, thyen drynat me të cilët ishin mbyllur dyert e trajlerit;

- u bë shkarkimi i trajlerit dhe ngarkimi i mjetit tjetër.

Në përfundim të kohës (1.5 orë) ishte shkarkuar vetëm 60% e ngarkesës së pretenduar si e vjedhur.

Në këto kushte, drejtuesit e mjetit trajler, u ndaluan dhe mbas disa seanca pyetjesh,

<sup>12</sup> Ilirjan Mandro, *Arkivi i punimeve kriminalistike; Ngjarje e vitit 1987 në rrethin V*, f. 287.

<sup>13</sup> Në këto raste përgatiten manekinë prej thesi dhe mbushen me material për të arritur një peshe të caktuar. Në rastin konkret ekspertet mjekoligjor përcaktuan se viktimia kishte një peshë 67-70 kg.

pranuan se në mënyrë sistematike bënin shitjen e mallrave të ngarkesës që transportonin, dhe me inskenimin e vjedhjes, donin të mbulonin vjedhjet e bëra në kohë të ndryshme.

## 5. Rezultatet e eksperimentit

Rezultatet e eksperimentit fiksohen me procesverbal, skicë, fotografim apo videoregjistrim<sup>14</sup>.

*Procesverbali* i mbajtur gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor, përveç të dhënave të përgjithshme që trajtohen në mënyrë klasike për çdo procesverbal, shpreh dhe evidenton qëllimin se përse zhvillohet ky eksperiment. Në pjesën përshkruese bëhet fjalë për kohën, vendin dhe kushtet e kryerjes së këtij eksperimenti hetimor, për çfarë veprimesh kryhen, se si u ndryshuan kushtet e zhvillimit dhe se pse u bënë këto veprime, dhe se sa herë u përsërit eksperimenti hetimor. Rezultatet e çdo përsëritje të eksperimentit hetimor, përshkruhen me hollësi.

Procesverbali përpilohet në vendin ku kryhet eksperimenti hetimor. Pjesa përfundimtare përmban deklaratimet e pjesëmarrësve në procesverbal, detyrimin për mospërhapjen, mosdeklarimin e rezultateve të arritura në këto eksperimente, kohën e fillimit dhe të përfundimit të kryerjes së eksperimentit. Gjithashtu, evidentohen fotografitë apo filmimet e bëra gjatë zhvillimit të procesit të eksperimentit dhe skica përkatëse, e bërë gjatë këtij procesi. Në rastin e eksperimentit hetimor ato ilustronë të gjitha veprimet që kryhen. Është mirë, që filmimet të jenë në plan të gjerë, ku të administrohen të gjitha veprimet që kryhen në vazhdimësinë e tyre.

*Vlerësimi i rezultateve të eksperimentit hetimor*, nga ana e organit të procedimit apo gjyqësorit, përfshin vlerësimin si nga përmbajtja ashtu dhe nga fuqia e tyre provuese.

*a- Në vlerësimin nga përmbajtja, mbahet parasysh:*

- nëse rezultatet përputhen ose jo me realitetin, pra me thëniet e marra dhe të administruara më parë nga i pandehuri, e dëmtuara, dëshmitari apo mbrojtja;
- nëse është krijuar e njëjta gjendje, hapësirë, vendosje provash, siç ka qenë në kohën e kryerjes së veprës penale;
- nëse janë marrë parasysh rrethanat e ndryshme, të ndodhura gjatë kryerjes së veprës penale;
- nëse janë marrë parasysh, rrethana të tjera të cilat ndikojnë në ecurinë e eksperimentit;
- nëse gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor, kanë marrë pjesë specialistët kriminalistë apo specialistë të tjerë, të cilët me konkluzionet dhe njohuritë e tyre, do të ndihmojnë për një proces objektiv dhe të drejtë;
- nëse janë zhvilluar disa prova, me disa grupe dhe në bazë të një metodike të caktuar procedurale, duke ndryshuar kushtet e zhvillimit të tyre.

*b- Në vlerësimin e fuqisë provuese të rezultateve, mbahen parasysh këto kritere:*

- kur rezultati i arritur gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor është kategorik negativ, duhet pasur kujdes në vlerësimin e këtij rezultati, pasi gjatë zhvillimit të eksperimentit, për të provuar mundësinë e të dëgjuarit, mund të ketë kushte të papërshtatshme, në të cilat zhvillohet eksperimenti;
- ndodh që në kohën e ngjarjes, dëshmitari mund të ketë dëgjuar ose parë ngjarjen, por gjatë kohës së riprodhimit të bisedës në eksperimentin hetimor, për arsye subjektive,

<sup>14</sup> Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, *Procedura penale, Komentar*, Tiranë: 2003, f. 229.

nuk ka qenë në gjendje të dëgjojë atë;

- kur rezultati është pozitiv, këto vlerësohen si konkluzione të mundshme duke i krahasuar ato me provat e tjera që disponohen nga organi i procedimit, dhe kur ekziston përputhje krijohet bindja e plotë se fakti ose rrethana ka ndodhur.

## 6. Raste praktike

### 6.1 Eksperiment hetimor për verifikimin e mundësisë së një vrasjeje

Në vitin 201..., shtetasi A. B. akuzohet për vrasjen e shtetasit C. D. Sipas pretendimit të A. B., ngjarja kishte ndodhur si më poshtë.

Rreth orës 22.00, shtetasi A. B. dhe C. D., bashkëqytetar të një qyteti, po udhëtonin drejt qytetit të tyre me mjetin tip “Reno”, në pronësi të shtetasit C. D. Papritur, në një kthesë të dyfishtë, konstatojnë bllokimin e rrugës me gurë dhe objekte të tjera të pakalueshme. Drejtuesi i mjetit, C. D., ngadalëson shpejtësinë për të gjetur mundësi kalimi, deri në ndalim të plotë të automjetit. Në këtë moment, dy persona të armatosur, me maska, u dalin para dhe nën kërcënimin e armës, nxjerrin nga makina shtetasin A. B. dhe e urdhërojnë të qëndrojnë në krahun e pasagjerit, në anën e djathtë të automjetit, me duart lart e të vendosura mbi kabinën e automjetit. Drejtuesin e mjetit, shtetasin C. D., e detyrojnë të dalë nga mjete dhe e urdhërojnë të ulet në sediljen e pasme të pasagjerit, në krahun e majtë të automjetit, pas sediljes së drejtuesit të mjetit. Po sipas thënies së shtetasit A. B., në momentin që shtetasi C. D. u ul në sediljen e pasme dhe një prej personave me maska mbylli derën e automjetit, u dëgjuan dy krisma dhe rënkim i shtetasit C. D.

Dy grabitësit hutohen dhe i kërkojnë shtetasit A. B., të kthejë makinën dhe ta dërgojë të plagosurin në njësinë më të afërt spitalore. Mbas kësaj ata largohen në errësirë poshtë rrugës në një vend të pyllëzuar. Mbas disa minutash dëgjohej dhe një e shtënë tjetër përgjatë rrugës së largimit të grabitësve. *Me gjithë përpjekjet e A. B. për të çuar në spital të plagosurin C. D., ky i fundit nuk mundi t’i shpëtojë dot vdekjes.* Gjatë procesit të gjykimit, gjykata vendos, që për sqarimin e disa rrethanave jo shumë të qarta, në dosjen e hetimit, të zhvillohet eksperimenti hetimor. Në vendim u përcaktua: objekti, qëllimi, pjesëmarrësit në eksperiment, vendi i kryerjes koha dhe një sërë elementësh të tjerë, të domosdoshëm për kryerjen e një eksperimenti konform rregullave procedurale. Në vendimin e marrë për kryerjen e eksperimentit, ndër të tjera u kërkuar:

1- Në momentin e qitjes me armë zjarri, a mund të përcaktohet pozicioni i qitësit, distanca e qitjes si dhe drejtimi i fluturimit të faktorëve plotësues të këtyre qitjeve?

2- Nisur nga tërësia e rrethanave të ngjarjes, pozicionit të viktimës së fiksuar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe qitësit, nëse përcaktohet, a ka mundësi teknike që faktorët plotësues të qitjes të mbivendosen në teshat, konkretisht, këmishën e shtetasit A. B.?

Për t’ju përgjigjur këtyre pyetjeve, u studiuar të gjithë elementët e fiksuar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, vendimet, së bashku me aktet e ekspertimit të bëra nga institucionet përkatëse, si dhe çdo material tjetër i administruar në dosje. Gjithashtu, u bë rikëqyrje e hollësishme e automjetit, në vendin ku mbahej i bllokuar dhe në ruajtje, ku u përqendrua kryesisht të automjeti në përgjithësi, dy brimat e hyrjes së predhave në derën e dytë të pasagjerit, drejtimin e depërtimit të predhave në pjesën e brendshme të derës dhe tejshkimin e dy predhave në sediljen e pasme të automjetit. Mbas bashkimit të brimave tejshkuese, me ndihmën e një thupre alumini me ngjyrë të

kuqe për vrimën e parë të goditjes dhe, ngjyrë blu për vrimën e dytë të goditjes, u konstatua se të dy thuprat takojnë majat e tyre në një distance të caktuar 70 cm në anën e jashtme të derës së dytë të pasagjerit. Kjo pikë bashkimi përkon me “prerjen fundore” të armës, në momentin e qitjes, në raport me sipërfaqen e derës së mbyllur të automjetit. Gjithashtu, u përcaktua distanca e kësaj pike takimi nga toka, në një lartësi 107 cm. Me ndihmën e një këndmatësi, duke e vendosur mbi thuprat e përdorura, u përcaktua këndi i mbajtjes së armës nga autori. Ky kënd ishte 22 gradë në momentin e të shtënës.

Për t’ju përgjigjur pyetjeve të shtruara nga gjykata, u zhvillua eksperimenti hetimor ku:

**Së pari:** Iu sugjerua shtetasit A. B., të vendosej në pozicionin që pretendonte së ka qenë vetë, në lidhje me automjetin, në momentin e goditjes së shtetasit C. D.

**Së dyti:** Nga grupi i hetimit, i caktuar për të marrë pjesë në eksperiment, u fiksua me procesverbal në mënyrë të hollësishme, pozicioni i trupit të shtetasit A. B., pozicioni i pjesës së gjoksit të shtetasit A. B., në lidhje me automjetin dhe hapësira boshe e mundshme, ku mund të depërtonin dhe mbivendoseshin mbetjet e barutit. Kjo hapësirë u evidentua se ishte 10 cm.

Gjithashtu u fiksua pozicioni i krahëve, të shtrirë pothuajse plotësisht mbi automjet, ku u bënë matjet e duhura për evidentimin e hapësirave dhe këndeve, nga ku mund të depërtonin dhe mbivendoseshin mbetjet e barutit, mbi gjoksin e shtetasit A. B.

**Së treti:** Të gjitha veprimet, u shoqëruan me procesverbal, fotografi dhe filmime nga kënde dhe pozicione të ndryshme, për të paraqitur dhe evidentuar qartë dhe saktë eksperimentin hetimor.

**Së katërti:** Grupi i eksperimentit hetimor, evidentoi saktë, mbi bazën e provave të fiksuara në vendin e ngjarjes, gëzhgojave të qitura vendndodhjen e qitësit, raportin e vendosjes së shtetasit A. B., në lidhje me vetë pozicionin e qitësit si dhe me vetë drejtimin e armës që kishte bërë shkrepen.

Mbas evidentimit, fiksimit në procesverbal, fotografimit dhe filmimit të së gjithë këtyre elementëve, qitjet eksperimentale u vendosën të bëhen në ambiente të tjera, për të shmangur mundësinë e aksidenteve mbi të pranishmit. Për të qenë korrekt, u vendos që të zhvillohen disa qitje eksperimentale në kushte dhe kohë të ndryshme të ditës.

	Qitjet/eksperimenti 1	Qitjet/eksperimenti 2	Qitjet/eksperimenti 3	Qitjet/eksperimenti 4
Vendi i qitjes eksperimentale	Poligon i mbyllur i qitjes pranë Akademisë së Policisë	poligon qitjeje i hapur pranë forcave speciale, pa pemë apo objekte ku mund të krijohë hije. <sup>15</sup>	poligon qitjeje i hapur pranë forcave speciale, pa pemë apo objekte ku mund të krijohë hije.	poligon qitjeje i hapur pranë forcave speciale, pa pemë apo objekte ku mund të krijohë hije.
shpejtësi të erës	0	0	0	0
temperatura	33 gradë C	31 gradë C	30,6 gradë C	21,5 gradë C
Koha e kryerjes së qitjes	Ora 15.00	Ora 15.30	Ora 16.15	Ora 06.30
Ndriçimi	normal	normal	normal	normal
Objekti	Manekin nr. 1 në shtatlartësinë e A. B.	manekin nr. 2 në shtatlartësinë e A. B.	manekin nr. 3 në shtatlartësinë e AB	manekin nr. 4 në shtatlartësinë e A. B.
Manekin veshur	bluzë të bardhë etiketa nr. 1	bluzë të bardhë etiketa nr. 2	bluzë të bardhë etiketa nr. 3	bluzë të bardhë etiketa nr. 4
Pengesa imitim dersh të automjetit	kompensata të prera në lartësinë e mjetit	kompensata të prera në lartësinë e mjetit	kompensata të prera në lartësinë e mjetit	kompensata të prera në lartësinë e mjetit
Arma e përdorur	AK-47 model 56, me qyte druri	AK-47 model 56, me qyte druri	AK-47 model 56, me qyte druri	AK-47 model 56, me qyte druri
Nr. të shtimeve	Dy	Dy	Dy	Dy
Këndi mbajtjes së armës	22 gradë	22 gradë	22 gradë	22 gradë

<sup>15</sup> Ambienti me hije dhe pemë krijon premisë të lëvizjes së ajrit, erës, dhe ndryshim të temperaturës së ambientit.

## 6.1.1 Rezultati i eksperimenteve

Mbas gjithë qitjeve eksperimentale dhe përpunimit laboratorik të bluzave për mbetje të faktorëve plotësues të qitjes, rezultoi se në pozicionin që ishte shtetasi A. B. dhe qitësi, në kushtet kur xhamat e automjetit ishin të mbyllur, mbetjet e bluzave të barutit nuk mund të kalonin dhe mbivendoseshin në sipërfaqen e parë të bluzës së shtetasit A. B.

### 6.2 Eksperiment hetimor për verifikimin e mundësisë së një vjedhjeje

Në vitin 201..., në familjen e shtetasit A. B. kishte një gëzim familjar dhe ishin ftuar të afërm të tij. Darka u shtrua në hollin e madh të ndenjes, në katin e parë. Rreth orës 22.30, darka përfundoi dhe të ftuarit u larguan për në banesat e tyre. Mbas pastrimit që iu bë ambientit të ngrënies, familjarët e shtetasit A. B., ranë për të fjetur në katin e dytë të banesës ku kishin dhe dhomat e gjumit.

Rreth orës 03:30 të mëngjesit, bashkëshortja e shtetasit A. B., dëgjon zhurmë në katin e parë, ngrihet dhe konstaton se bashkëshorti nuk ndodhej në krevat, menjëherë fillon të zbrësë shkallët dhe shikon bashkëshortin të shtrirë në hollin e katit të parë, në mes të një pellgu gjaku. Pranë tij ishte një thikë, tehu dhe doreza e të cilës ishin me gjak, gjithashtu konstaton heqjen nga muri të një fotografie, mbrapa së cilës A. B. kishte kasafortën, ku mbante një sasi lekësh.

Si person i dyshuar dhe i ndaluar për këtë ngjarje, ishte shtetasi C. D., gjurmët daktiloskopike të së cilit ishin identifikuar në një prej kanateve të dritares së katit të parë, poshtë shkallëve të brendshme që lidhte hollin e ndenjes me dhomat e fjetjes në katin e dytë. Kjo dritare nga këqyrja e vendit të ngjarjes, gjurmët e gjetura, planvendosjes së tyre në kanat (nga jashtë brenda), pozicioni dhe mekanizmi i përdorur, ishte identifikuar si dritarja prej nga kishte hyrë autori i ngjarjes. Duke qenë se mjaft “rrethana negative” ishin të pranishme në këtë ngjarje, ku:

- implikoheshin njerëz të afërt të shtetasit A. B., dhe konkretisht kunati i tij C. D.;
- gjurmët daktiloskopike të identifikuara në kanatën e dritares, që i përkisnin shtetasit C. D., “goditëshin” nga avokati mbrojtës, si gjurmë të lëna nga një person i ftuar për darkë, i cili mund të ketë dalë në dritare për tu freskuar, apo ka vënë duart në mënyrë të rastësishme;

U vendos zhvillimi i eksperimentit hetimor ku thelbi i kërkesave të shtruar ishte:

- A mund të përcaktohet mekanizmi i lënies së gjurmëve daktiloskopike në kanatën e dritares së katit të parë ?
- Nëse po, a mundet që shtetasi C. D., të mund t'i ketë lënë këto gjurmë nga pozicionet e tij brenda ambientit të dhomës ku ishte shtruar darka?

Për zhvillimin e eksperimentit hetimor u morën të gjitha masat organizative dhe procedurale, duke përcaktuar kohën e zhvillimit, qëllimin se ç’duhet të arrinim me anë të këtij eksperimenti, vendin e zhvillimit si dhe u përcaktuan pjesëmarrësit dhe ndarja në grupe të tyre, për monitorimin dhe zhvillimin e eksperimentit. U njoftuan institucionet përkatëse për të sjellë personin e ndaluar si të dyshuar të ngjarjes dhe mbrojtësin e tij.

Eksperimenti hetimor do të filmohej nga dy kamera, të instaluar njëra në ambientin e brendshëm me objektiv kryesor dritaren e hollit ku ishin evidentuar gjurmët daktiloskopike dhe, një kamerë tjetër, e vendosur në ambientin e jashtëm, po me objektiv kryesor dritaren nga ku do të hynte shtetasi C. D., për të fiksuar më mirë mekanizmin

e hyrjes, vendosjen e duarve, ngjitjen që do të bënte dhe detaje të tjera të nevojshme për hetimin.

Avokatët e shtetasit C. D., kërkuan të shikonin edhe njëherë tabelën fotografike të aktit të ekspertimit, ku përcaktohej mekanizmi i lënies së këtyre gjurmëve nga jashtë brenda, evidentuar kjo qartësisht me pozicionin e tri gishtërinjve të dorës së majtë dhe të djathtë në të dy anët e kanatës së brendshme të dritares, ku autori ishte mbështetur për tu futur në banesë.

Pasi iu bë i qartë të pranishmeve, vendimi i kryerjes së eksperimentit hetimor, iu kërkua shtetasit C. D., të mundësonte vendosjen e gjurmëve të duarve, ashtu si ai mendonte se mund të kishte prekur dritaren nga pozicioni brenda hollit. Procedurat e vendosjes, fiksimit dhe përshkrimit të gjurmëve ishin të njëjta në të tetë eksperimentet e kryera; konkretisht:

- pastrohej kanata e dritares nga eksperti kriminalist;
- shtetasi C. D., vendoste gjurmët e duarve, sipas versionit të tij, në kanatën e dritares;
- përpunoheshin këto gjurmë nga eksperti kriminalist, me pluhur daktiloskopik;
- evidentoheshin gjurmët dhe bëhej përshkrimi i tyre në procesverbalin e këqyrjes;
- bëheshin fotografi të shkallëzuara;
- përcaktohej dhe mekanizmi i lënies së tyre.

### 6.2.1 Rezultati i eksperimenteve

Gjurmët e fiksuara në vendin e ngjarjes, nuk mund të liheshin në asnjë rast apo mënyrë, nga pozicioni brenda hollit, i shtetasit C. D. Gjurmët e fiksuara në vendin e ngjarjes, ishin lënë gjatë kalimit të pengesës, dritares, nga autori i ngjarjes, që në rastin konkret ishte identifikuar me gjurmë daktiloskopike shtetasi C. D., gjatë hyrjes në banesë nga dritarja nga jashtë-brenda. Në përfundim, shtetasi C. D., pranoi autorësinë e ngjarjes dhe shpjegoi detaje:

Gjatë darkës, shtetasi A. B., mbasi pa që fëmijët që ishin në këtë gëzim familjar po loznin dhe kënaqeshin duke kërcyer, shkoi në dhomën tjetër, zhvendosi fotografinë mbas së cilës ndodhej kasaforta dhe mori një shumë të hollash. Kasafortën nuk e mbylli me kod por thjeshtë vendosi përsëri kornizën e fotografisë mbi të. Veprimet e tij u panë nëpërmjet pasqyrës së korridorit nga kunati i tij, shtetasi C. D.

Shtetasit C. D., i lind ideja e një veprimi kriminal, të vjedhjes së lekëve dhe vjedhurazi lë hapur një prej dritareve poshtë shkallëve të katit të parë me mendimin për të ardhur përsëri. Mbasi gjithçka përfundoi dhe njerëzit u larguan, C. D., që kishte bërë gati planin e tij, rikthehet dhe hyn nëpërmjet dritares të cilën e kishte lënë hapur më parë. Pa u menduar gjatë, ai mbahet në dy kanatat e dritares, për t'i krijuar vetes lehtësi në hipje dhe mosbërje zhurme dhe hyn në holl. Gjatë ecjes nëpër sallonin e ndenjes, në kushtet e një pamjeje të kufizuar, përplaset, godet objekte të ndryshme, shkon të kasaforta, të cilën e gjen të hapur, merr shumën e të hollave, por në momentin që do të largohej, ndeshet përballë me shtetasin A. B., i cili i çuditur për këtë "vizite" të kunatit të tij, kur e shikon dhe me lekët në dorë, tenton ta kapë dhe ta bllokojë atë.

Në këtë kohë, C. D., duke u shtyrë me A. B., afrohet pranë tavolinës ku merr një thikë dhe në pamundësi për tu liruar nga duart e A. B., e godet atë disa herë duke i shkakuar dhe vdekjen e menjëhershme. Më pas largohet me shpejtësi dhe panik, mbasi gjërat nuk kishin vajtur siç i kishte planifikuar në momentet e para.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

### **6.3 Eksperimenti hetimor për verifikimin e fajësisë në një aksident automobilistik**

Në vitin 198.... Në dalje të qytetit “X” aksidentohet shtetasi A. B. Në vend ngjarje shkoj grupi hetimor dhe konstatoi se aksidenti ishte kryer nga një autoveturë ku në krahun e djathtë të autoveturës, 4 m më mbrapa, ndodhej një mjet tip “Skoda”, i cili qëndronte në vendin e ngjarjes me drejtim veri-jug. Gjatë këqyrjes, u fiksua viktimja A. B., i cili ndodhej i shkelur nga rrotat e para të autoveturës. Gjithashtu, u konstatuan gjurmë frenimi, distanca ndërmyjet dy mjeteve, dëmtimi i mjetit autoveturë në pjesën e parë të saj, dëmtimet trupore të shtetasit A. B. Nga pyetja e dëshmitarëve të pranishëm, u përcaktua dhe mekanizmi i ngjarjes.

Automjeti tip “Skoda”, ishte parkuar në krahun e djathtë të rrugës, ku drejtuesi i saj duhet të kryente veprime administrative në dispacerinë, e cila ndodhej në krahun tjetër të rrugës (krahun e majtë). Për të kryer këto veprime, drejtuesi i mjetit dërgon shtetasin A. B., i cili ndodhej në kra-hun e pasagjerit, të automjetit tip “Skoda”. A. B., në mënyrë të shkujdesur zbret nga makina dhe me shpejtësi, pa kontrolluar nëse rruga është e lirë, kërkon të kalojë për të shkuar te dispanseria.

Në momentin e kapërcimit të rrugës, shtetasi A. B. përplaslet me autoveturën, e cila befasisht e godet, e merr zvarrë me pjesën e parakolpit dhe e shkel me dy rrotat e para. Reagimi i drejtuesit të mjetit autoveturë ishte i menjëhershëm, por megjithatë nuk mundi të mënjanonte pasojat e aksidentit. Mbas shumë seancash pyetjesh dhe hetimi, për të sqaruar fajësinë ose pafajësinë e këtij drejtuesi, u vendos kryerja e eksperimentit hetimor.

U kryen disa eksperimente hetimore dhe qëllimi ishte vërtetimi i thënies së drejtuesit të automjetit autoveturë, i cili “pretendon për një reagim të menjëhershëm mbi sistemin e frenimit” si dhe, thënieve të dëshmitarëve okularë, për mënyrën e shpejtë që viktimja A. B., i doli përpara automjetit. Në këto kushte, eksperimenti hetimor duhej t’i jepte përgjigje disa pikëpyetjeve të dala gjatë hetimit, si:

- mundësinë e të parit të viktimës A. B., nga drejtuesi i mjetit autoveturë;
- reagimin e drejtuesit të mjetit, në momentin e frenimit;
- shpejtësinë që autovetura ka pasur, në momentin e përplasjes me viktimën A. B.;
- rruga që do të përshkonte makina, në një kohë të caktuar për një shpejtësi të caktuar.

#### **6.3.1 Rezultati i eksperimentit**

Mbas shumë eksperimenteve të kryera me autoveturën, me shpejtësi të ndryshme të ecjes së saj, në asnjë moment drejtuesi i automjetit autoveturë, nuk do të ishte në gjendje të evitonte aksidentin. Këndi i shikimit të drejtuesit të automjetit autoveturë mbi viktimën ishte zero, mbasi momenti i të parit të viktimës, ndodhte në një distancë të shkurtër, kohë relativisht e pamjaftueshme për të reaguar, jo vetëm instinktet njerëzore të drejtuesit, por edhe për koha teorike reale e veprimit të mekanizmave të frenimit, deri në ndalim të mjetit. Në çfarëdolloj kushtesh, brenda normave të shpejtësisë, në parakalim të mjeteve të ndaluar, ky aksident nuk mund të evitohet. Parakalimi i mjetit “Skoda” nga ana e autoveturës, bazuar dhe në gjurmët e frenimit ishte bërë me një shpejtësi brenda normave të lejuara nga Kodi Rrugor. Pra, u vërtetuan thëniet e



dëshmitarëve dhe drejtuesit të automjetit.

## 7. Përfundime dhe rekomandime

Eksperimentet hetimore ndihmojnë jo vetëm hetimin dhe gjykimin në raste të vështira komplekse, por edhe në raste të tjera, kur ka mjaft prova ndoshta jo dhe aq direkte. Për shkak të rëndësisë dhe vështirësisë që paraqet kryerja e eksperimentit hetimor, është e këshillueshme që ky veprim procedural, të realizohet nga prokurori dhe gjykata.

Grupi që merr pjesë në eksperimentet hetimore, të ketë në përbërje të tij në mënyrë të detyrueshme edhe specialistë apo ekspertë me njohuri të posaçme teknike e shkencore, sipas llojit të ngjarjes apo veprës që hetohet dhe për të cilën zhvillohet eksperimenti.

Të jemi të kujdesshëm, se në rastet kur eksperimenti zhvillohet me të arrestuar, akuzuar, në këtë veprim duhet të sigurohet pjesëmarrja e mbrojtësit. Zbatimi i të gjitha kërkesave procedurale për zhvillimin e eksperimentit hetimor, rrit besimin në konkluzionin e një hetimi dhe dhënien e një vendimi të drejtë nga organet e drejtësisë.

## Referenca

1. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, *Procedura Penale*, Tiranë: 2003.
2. Skënder Begeja, *Planifikimi i Hetimit*.
3. Skënder Begeja, *Njohuri të përgjithshme mbi gjurmët traseologjike*. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1981.
4. Skënder Begeja, *Mikrogjurmët, roli i tyre në procesin e të provuarit*, Tiranë: 1987.
5. Vasilika Hysi, *Kriminalogjia*, Tiranë: 2010
6. Vasilika Hysi, *Hyrje në kriminologji dhe Penologji*, Tiranë: 2000.
7. Sokrat Meksi, *Vdekja nga Dhuna*, Tiranë: 2015.
8. Ilirjan Mandro, *Kqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri*, Tiranë: 2012.
9. Ilirjan Mandro, *Roli i Ekspertit në procesin penal, Manual për institucionet e gjykatës, prokurorisë dhe Policisë së Shtetit*, Tiranë: 2005.
10. Ilirjan Mandro, Agim Çiraku, *Metodika e hetimit të ngjarjeve automobilistike*, Tiranë: 2004.
11. Ilirjan Mandro, *Njohuri mbi Kriminalistikën, Pjesa e Parë*, Tiranë: 2011.
12. Ilirjan Mandro, *Njohuri mbi Kriminalistikën, Pjesa e Dytë*, Tiranë: 2016.
13. Ilirjan Mandro, Admir Belishta, *Pyetja në Procesin penal*, Tiranë: 2017.
14. Vesel Latifi, *Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë: 2009.
15. Bashkim Cuberi, *Mjekësia Ligjore*, Tiranë: 1981.
16. Henrik Ligori, *Manual i Procedurës Penale për Policinë Gjyqësore*, Tiranë: 1999.
17. Ferdinand Elezi, *Provat Penale dhe procesi i të provuarit*, Tiranë: 2012.
18. Instituti i Policisë Shkencore, *Konferenca e IV kriminalistike*, Tiranë: 1999.
19. Sotiraq Ristollari, *Metodika e Fotografisë Kriminalistike, Cikël leksionesh për ekspertët kriminalistë*, Tiranë: 1985.

# Ekspertimet kompjuterike, një sfidë e rëndësishme për luftën kundër krimit

— MSc. Arjan MUÇAJ

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër

arjan.mucaj@yahoo.com

## Abstrakt

*Siguria kombëtare, gjithnjë e më shumë është e lidhur me masat e marra nga shtetet kundër kriminalitetit. Krimi i organizuar është parë si risku kryesor, i cili cenonte sigurinë kombëtare. Përdorimi i teknologjisë së informacionit sot, pothuajse në të gjitha fushat e jetës, nga dita në ditë po njuh një rritje të madhe në botë. Sulmet kompjuterike në edicionet e lajmeve, po zëvendësojnë lajmet tradicionale të sulmeve me armë. Para rreth një muaji, pothuajse e gjithë bota, u prek nga një sulm masiv që paralizoi për orë të tëra infrastrukturë kritike. Për këtë sulm u raportua nga më shumë se 70 vende, përfshirë Britaninë e Madhe, SHBA-në, Kinën, Rusinë, Spanjën, Italinë dhe Tajvanin etj. Faktori kryesor që ka shërbyer për të zbuluar autorët e këtyre sulmeve, në pothuajse në të gjitha rastet, ka qenë ekspertiza shkencore. Megjithëse fushë e re, ekspertimi kompjuterik, është bërë një nga fushat kryesore të ekspertimit shkencor. Në të gjithë vendet e botës, pranë policisë, janë krijuar sektorë të ekzaminimit kompjuterik. Ekspertimi kompjuterik është shtrirë edhe në sektorin privat, ku shumë shoqëri janë specializuar në këtë fushë, siç janë përfshirë edhe struktura të arsimit të lartë. Ekzaminimet kompjuterike, ndihmojnë në zgjidhjen ligjore të sulmeve kompjuterike, por edhe të shumë çështjeve penale tradicionale. Laboratorë të fuqishëm janë krijuar pranë strukturave policore në botë. Ekzaminimet e tyre, kanë shërbyer si prova bazë në vendimet e gjykatave. Shqipërinë, përdorimi masiv i teknologjisë së informacionit, nuk e ka përjashtuar nga trendi në rritje i kriminalitetit në sistemet kompjuterike. Numri i rasteve të këtyre sulmeve është në rritje nga viti në vit. Shqipëria i është përgjigjur me ndryshime të rëndësishme ligjore, por edhe me ngritjen e strukturave specifike në luftën kundër këtyre sulmeve kompjuterike. Ekzaminimet kompjuterike dhe procedura e ekzaminimeve kompjuterike në Shqipëri paraqet një sfidë të rëndësishme për luftën kundër krimit. Në këtë punim do të bëhet një analizë e situatës në këtë drejtim në vendin tonë. Nga analiza do të evidentohen edhe situatat problematike duke propozuar edhe zgjidhje të tyre. Situata e ekzaminimeve kompjuterike në Shqipëri kërkon një mbështetje më të madhe financiare dhe me burime njerëzore. Për realizimin e ekspertimeve kompjuterike kërkohet edhe një bashkëpunim më i madh ndërmjet organit të akuzës dhe universiteteve.*

## Keywords:

**siguria kombëtare, ekzaminimet kompjuterike, ekspertiza shkencore, sulmeve kompjuterike.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit është shoqërua me rritjen e krimeve kompjuterike kudo në botë. Madje, një pjesë e këtyre krimeve, kanë shtrirje ndërkombëtare: para disa javësh një sulm masiv kompjuterik shënjoi infrastrukturën kritike në mbarë botën dhe u raportua të paktën nga 70 vende, përfshi Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-në, Kinën, Rusinë, Spanjën, Italinë dhe Tajvanin etj. Kjo situatë, i ka dhënë hov zhvillimit të ekspertizës kompjuterike, e cila është tashmë një nga fushat kryesore të ekspertimit shkencor. Kudo në botë, në strukturat e policisë shkencore janë krijuar sektorë të ekzaminimit kompjuterik dhe laboratorë shkencorë, të cilët mbështeten gjithashtu në struktura jashtëpolicore, që ndihmojnë në ekzaminimet kompjuterike. Ekzaminimet kompjuterike ndihmojnë në zgjidhjen ligjore të sulmeve kompjuterike, por edhe të çështjeve penale tradicionale dhe shpesh, ekzaminimet kompjuterike, janë prova përcaktuese në vendimet e gjykatave.

Edhe në Shqipëri, përdorimi i teknologjisë së informacionit, ka çuar në lindjen dhe rritjen e kriminalitetit në sistemet kompjuterike. Në përgjigje të këtij zhvillimi, janë bërë hapa të rëndësishëm në hartimin e legjislacionit përkatës dhe të ngritjes e forcimit të strukturave të hetimit dhe luftimit të këtij lloj krimi. Pranë policisë shkencore, është ngritur dhe funksionon sektori i ekzaminimeve kompjuterike. Ky sektor, është përballur me një mori vendimesh ekspertimi nga më të thjeshtët tek më kompleksët. Pothuajse në të gjitha çështjet e krimit të zakonshëm, por në veçanti në hetime të krimit të organizuar, ekzaminimi i telefonave të autorëve të dyshuar ka qenë masiv. Nga ekzaminimi i këtyre telefonave, janë përfituar prova të rëndësishme në favor të organit të akuzës, të cilat kanë shërbyer në vendimmarrjen e gjykatës. Akte ekspertimi kompjuterik, të përdorura në procese gjyqësore, kanë qenë vendimtarë në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve.

Ekzaminimet kompjuterike dhe procedura e ekzaminimeve kompjuterike në

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

Shqipëri, paraqet një sfidë të rëndësishme për luftën kundër krimit. Në këtë punim do të bëhet një analizë e situatës në këtë drejtim, në vendin tonë. Nga analiza do të evidentohen edhe situatat problematike, duke propozuar edhe zgjidhje të tyre. Situata e ekzaminimeve kompjuterike në Shqipëri, kërkon vëmendje të madhe nga vendimmarrësit e strukturave policore, të prokurorisë dhe të ministrive përkatëse.

## 2. Ekspertimi kompjuterik në botë

Ekspertimi kompjuterik është një nga degët më të reja të ekspertimit. Ky lloj ekspertimi në disa vende të botës, përdoret me termin “ekzaminimet digjitale” dhe ka të bëjë me analizimin e “sistemeve kompjuterike”. Përkufizimi i sistemit kompjuterik jepet qartësisht në “Konventën për krimin në fushën e kibernetikës”, Neni 1:

a) “Sistem kompjuterik” do të thotë çdo lloj pajisje apo grup i ndërlidhur ose pajisje të lidhura, një ose më shumë prej të cilave, vazhduese të një programi kryejnë procesime automatike së të dhënave.

b) “Të dhëna kompjuterike”, do të thotë çfarëdo lloj përfaqësimi faktesh, informacioni apo konceptesh, në një formë të përshtatshme për procesim, në një sistem kompjuterik, që përfshin një program të përshtatshëm për punën e një sistemi kompjuterik, për të kryer një funksion.

Nga përkufizimi kuptohet që, ekspertimet kompjuterike, nuk përfshijnë vetëm kompjuterët, por çdo pajisje e cila mbi bazën e një programi, kryen procese automatike së të dhënave. Për të bërë një përmbledhje të ekzaminimeve kompjuterike në grupime të mëdha, do të përcaktonim se ekspertimet kompjuterike mund të ndahen në:

- ekspertimet e kompjuterëve,
- analiza e të dhënave,
- ekspertimi i pajisjeve mobile,
- ekspertimi i rrjetit,
- ekspertimi video,
- ekspertimi audio.

Provat kompjuterike, janë nga provat më të brishta që shqyrtohen në proceset penale. Për këtë arsye, ekzaminimet kompjuterike janë të lidhura ngushtësisht me fazat para ekspertimit, që nga mbledhja e tyre, sekuestrimi, ekspertimi dhe paraqitja e tyre në gjykatë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë përgatitur manualë, në të cilët përcaktohen saktësisht hapat dhe mënyra e mbledhjes së provave kompjuterike, për të mos vënë në dyshim vërtetësinë e këtyre provave. Ekspertimi kompjuterik, në fillimet e tij, ka nisur si një ekzaminim i kompjuterëve, por me kalimin e viteve sistemet kompjuterike përfshinë pajisje të ndryshme, të cilat janë sot në përdorim të përditshëm. Në proceset penale, ato përdoren në shumicën e tyre, për të provuar një dyshim ose akuzë, por mund të përdoren edhe për të hedhur poshtë një dyshim ose alibi. Ato përdoren për të hetuar një shumëllojshmëri të gjerë të krimit, duke përfshirë pornografinë e fëmijëve, mashtrimet, spiunazhin, ndërhyrjen në internet, vrasjen dhe përdhunimin. Në botë, sot, ekspertimet kompjuterike janë duke u pranuar gjerësisht si prova në sistemet gjyqësore të SHBA-së dhe Evropës. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë përdorur prej vitesh ekspertimet kompjuterike, për të zbuluar autorë të disa prej veprave penale të rënda, por edhe për dënimin e tyre nga ana e gjykatave. Në disa nga këto


çështje penale, ka qenë pothuajse e vetmja provë; provat e përfituara nga ekspertimi kompjuterik<sup>1</sup>.

Një nga çështjet më të debatuar në kohët e fundit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është dyshimi për ndërhyrje në sistemin elektronik të votimit në zgjedhjet e vitit 2016. Ndërhyrja e parë e provuar, ka qenë në serverët e Komitetit Kombëtar Demokratik, prej të cilit u zbulua dhe u publikua korrespondenca me e-mail<sup>2</sup>. Nga ekspertimi kompjuterik, FBI-ja duhet të zbulojë personat apo organizatat e përfshira në këtë veprimtari.

### 3. Situata në Shqipëri

Shqipëria prej vitesh po ecën me hapin botëror, në përdorimin e internetit dhe të sistemeve kompjuterike. Qeveria dhe shoqëria shqiptare, kanë ndërmarrë shumë nisma të cilat kanë bërë që edhe në Shqipëri, të bëhet domosdoshmëri dhe normalitet përdorimi i sistemeve kompjuterike. Në Shqipëri, e përdorin internetin 1 932 024 njerëz, shifër që përfaqëson 66.4% të popullatës, me një rritje 24 herë nga viti 2000<sup>3</sup>.

**Tabela 1. Treguesit e përdorimit të internetit në Shqipëri**



Përdorimi në rritje i sistemeve kompjuterike dhe i internetit, ka bërë që edhe në Shqipëri të ketë një numër të madh të veprave penale, të cilat janë të lidhura me sistemet kompjuterike. Vetëm veprat penale kompjuterike, kanë njohur një rritje të madhe prej vitit 2009, në kohën kur janë bërë edhe ndryshimet në Kodin Penal, duke shtuar 11 vepra penale të reja të lidhur me sistemet kompjuterike. Numri i veprave penale në të cilat janë përdorur sisteme kompjuterike është shumë herë më i madh. Prej vitit 2009 deri në vitin 2014 veprat penale kompjuterike janë rritur me 17 herë. Hetimi dhe gjykimi i procedimeve për veprat penale kompjuterike, pothuajse në të gjitha

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »


<sup>1</sup> Vendimi i dënimit nga gjykata amerikane të Michelle Theer e akuzuar për vrasjen e bashkëshortit të saj. Në gjykim nga prokurorët u paraqit pothuajse si e vetmja provë 88,000 e-maile dhe mesazhe të ekzaminuara në kompjuterin e Theer. *State v. Theer*: <http://caselaw.findlaw.com/nc-court-of-appeals/1201672.html>

<sup>2</sup> Agjencia e lajme CNN online datë 26 korrik 2016, aksesuar për herë të fundit datë 19.09.2017 në faqen : <http://edition.cnn.com/2016/07/25/politics/democratic-convention-dnc-emails-russia/index.html>

<sup>3</sup> Statistika e datës 30 korrik 2017 e marrë nga "Internet World Stats" faqe në internet <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm> aksesuar për herë të fundit në datën 19 shtator 2017.

rastet, ka kërkuar edhe ekzaminime përkatëse. Ekzaminimi kompjuterik, megjithëse është një nga fushat më të reja të ekzaminimeve që realizohen në procesin penal, është bërë edhe në Shqipëri pjesë e provave të shqyrtuara nga gjykatat shqiptare.

**Tabela 2: Treguesit statistikorë të veprave penale kompjuterike në Shqipëri <sup>4</sup>**



Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar si një nga provat kryesore në procesin penal ekspertimet. Ekspertimet janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, në Kreun II, “Llojet e provave”, nga neni 178 deri në nenin 186 të këtij kodi. Në nenin 178, është përcaktuar se “*Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore*”. Me ligjin numër 35/2017, *Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale*, është bërë një ndryshim i rëndësishëm në kapitullin e ekspertimeve. Ligji penal, pas datës 1 gusht 2017, lejon ekspertimin nga ekspertë të huaj, pa ju nënshtruar procedurës së letër-porosisë. Kjo do të mundësojë, që në rastet kur ekspertimi nuk mund të kryhet nga lista e ekspertëve të regjistruar pranë gjykatës, të caktohen edhe ekspertë të huaj.

Ekspertimet tradicionale më të përdorura në procesin penal, kanë qenë ekspertimet daktiloskopike balistike, mjekoligjore etj. Në vitin 2009, në Policinë e Shtetit është shtuar edhe “sektori i ekzaminimeve kompjuterike dhe audio-video”. Ky sektor ka përbërë një volum të madh ekspertimesh kompjuterike. Kërkesat e organit të akuzës si edhe gjyqësorit, kanë qenë gjithnjë e më shumë, për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme penale.

Ekspertimet, që prej fillimit të punës së këtij sektori, kanë qenë në përgjithësi për ekspertim kompjuteri, ekspertim pajisjesh mobile, në veçanti telefona celularë, karta SIM, CD DVD, pajisje regjistrimi audio ose video etj.

Specifika e të dhënave, që kërkohet nga çdo ekspertim kompjuterik, është e lidhur me çështjen që po hetohet ose po gjykohet. Nuk mund të jepet një listë shteruese e të dhënave që janë të domosdoshme të merren nga ekspertimi kompjuterik, por në mënyrë të përmblendhur po rendisim të dhënat kryesore, të cilat janë kërkuar nga ekspertime kompjuterike:

- data dhe ora e sistemit;
- emri i përdoruesit të pajisjes;
- faqe interneti të konsultuara nga përdoruesi;
- pjesë nga mesazhe apo programe chat-i, të cilat nuk mund të ruhen apo regjistrohen në mënyra të tjera në sistemin e kompjuterit;
- komunikimet me ose pa kabull (“wireless”);
- dokumente (“file”) të fshirë.

<sup>4</sup> Treguesit statistikor për kriminalitetin në Shqipëri i referohen të dhënave të Zyrës së Statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Raportit vjetor viti 2013 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Një nga ekspertimet që ka zënë vend më shumë në botë, por edhe në Shqipëri, është edhe ekspertimi i pamjeve video, audio ose i fotografive. Kërkesa e parë që kërkohet nga një regjistrim audio, video ose për një fotografi, është vërtetësia e regjistrimit nëse ka ose jo ndërhyrje. Analiza e fotografive, në veçanti në rastet e pornografisë me të mitur, kërkon që t'ju jepet përgjigje kërkesave, si:

- modeli i aparatit fotografik që ka prodhuar foton;
- numri serial i aparatit fotografik;
- data dhe koha e fotografisë;
- pozicioni gjeografik ku është bërë fotografia.

Shërbimi i telefonisë së lëvizshme, gjithnjë e më shumë po zë një vend mjaft të rëndësishëm në jetën e përditshme të çdo njeriu. Ai aktualisht është bërë mjete kryesor i komunikimit, duke krijuar një epërsi të dukshme në raport, si me telefoninë fikse, ashtu edhe me mjetet e tjera të komunikimit. Kjo epërsi lidhet me komoditetin që ofron ky lloj shërbimi dhe tendencën njerëzore për ta përqafuar sa më parë komoditetin. Duke u bërë një ndër mjetet kryesore të komunikimit, ai ndikon ndjeshëm në lehtësimin e aktivitetit njerëzor, ku mes të tjerash, fatkeqësisht, përfshihet dhe aktiviteti kriminal. Njohja e mirë e teknologjisë së pajisjeve mobile, në veçanti të telefonisë, do të shoqërohet dhe me një sërë avantazhesh, të cilat duhet të njihen dhe të përdoren në funksion të hetimit të kriminalitetit.

Ekspertimet e telefonave celularë në *sektorin e ekzaminimeve kompjuterike dhe audio-video*, janë rritur shumë nga viti në vit. Shumica e hetimeve nga organi i akuzës, shoqërohen me ekspertime të telefonave celularë. Të dhënat që përfitohen nga ekspertimi i këtyre pajisjeve janë shumë të rëndësishme për procesin penal. Nga telefonat celularë, mund të përfitohen të dhëna në lidhje me listën e kontakteve të përdoruesit, komunikime telefonike të përdoruesit, numra të tjerë të përdorur në këto aparate, komunikime nga programe të instaluar në aparat, vendndodhja gjeografike e përdoruesit të telefonit, fotografi, regjistrime audio ose video, historikë të konsultimeve në internet etj.

Në zhvillimin e hetimeve sa më të plota dhe rezultative, njohja e informacioneve që disponojnë shoqëritë e telefonisë celulare, për shkak të aktivitetit të tyre, është mjaft e rëndësishme. Evoluimi me hapa mjaft të shpejtë i kësaj teknologjie, bën të mundur që autorët e veprave penale, të mos jenë të njohur në kohë në lidhje me mundësitë. Nga shoqëritë e telefonisë së lëvizshme, me interes për hetimet dhe gjykimin, mund të merret informacion për:

- *Tabulatet në formë elektronike dhe të printuara*, që janë një pasqyrim në formë elektronike ose të printuar i faktit se një numër për të cilin kemi interes, ka komunikuar me numra të tjerë, të thirrur prej tij ose që e kanë thirrur atë.

- *Numrat IMEI*, numri identifikues i aparatit, që ka përdorur një numër telefonik të caktuar në një periudhë të caktuar kohore, të kërkuar nga ana e prokurorisë.

- *Antenat*, që lidhen me informacion me interes për hetimin, për sa i përket vendit nga ka komunikuar një përdorues në një moment të caktuar.

- *Identifikimi i abonentëve*, duke marrë nga shoqëritë e telefonisë së lëvizshme, fotokopje të dokumenteve që kanë shërbyer për të identifikuar abonentin në momentin e blerjes së kartës.

Informacioni që merret nga këto shoqëri shërben si indice, por edhe si provë e rëndësishme në hetimin dhe në gjykimin e shumë çështjeve penale, por jo vetëm. Gjykata e lartë, në një vendim civil, është shprehur se është e domosdoshme për vendimmarrjen studimi i tabulateve:

“... në të tilla kushte për zgjidhjen e kësaj çështje, merr rëndësi studimi i tabulateve telefonike të administruara, .... për të vërtetuar ose jo pretendimet e palës paditëse”<sup>5</sup>

Në një vendim tjetër, po kjo gjykatë, ka konsideruar si provë komunikimet e shumta telefonike, për të provuar bashkëpunimin në trafikimin e lëndës narkotike:

“... fakt ky i provuar me tabulatet telefonike që tregojnë bisedat e shumta ndërmjet të gjykuarve një ditë para kapjes së lëndës narkotike...”<sup>6</sup>

Informacioni i marrë për vendndodhjen e të gjykuarit, ka shërbyer si provë në vendimin numër 1059 datë 14. 7. 2010, të Gjykatës së Lartë:

“...deklarimet e të gjykuarit ..., gjejnë konfirmim edhe në analizën e tabulateve telefonike dhe të qelizave celulare, të cilat kanë përcaktuar vendndodhjen e numrit celular në përdorim nga i gjykuari...”

Të dhëna me interes për hetimin dhe gjykimin, merren edhe nga shpërndarësit e internetit<sup>7</sup>:

- të dhëna për ndjekjen dhe identifikimin e burimit të komunikimit;
- identitetin e pajtimtarit;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin e datës, kohës dhe kohëzgjatjes së komunikimit;
- adresa IP.

Të dhënat e përfituara nga ekspertimet kompjuterike, kanë qenë të rëndësishme dhe vendimtare për procese penale në Shqipëri. Kolegji penal i gjykatës së lartë, është shprehur:

Bazuar në konkluzionet e ardhura nga ekspertët, Kolegji Penal vlerëson se materiali audioviziv që iu nënshtrua ekspertimit nuk është origjinal. Në këtë material audioviziv u vërtetua mundësia dhe probabiliteti i lartë i ndërhyrjeve në përmbajtje si rezultat i anomalive të pashpjegueshme

*Më poshtë ky kolegji vendos :*

“...nuk rezulton e provuar që në bisedën e datës ... mes dëshmitarit ... dhe të pandehurit ...”<sup>8</sup>

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur përfundimisht pas ekspertimit kompjuterik të realizuar nga kjo gjykatë, se nuk provohet një nga faktet më të rëndësishme të këtij procesi penal. Përdorimi i ekspertimeve kompjuterike në proceset penale, ka bërë që numri i kërkesave për ekspertim, si edhe i akteve të realizuara, të rritet nga viti në vit. Nga gushti i vitit 2009, kur ka filluar punën sektori i ekzaminimeve kompjuterike dhe audio-video, në Policinë e Shtetit, deri në vitin 2016, numri i kërkesave për ekspertim kompjuterik është rritur 18 herë dhe numri i akteve të ekspertimit është rritur me 23 herë. Në total, janë dërguar 3725 vendime ekspertimi dhe janë realizuar 3154 ekspertime kompjuterike.


<sup>5</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë numër 332 datë 05.02.2008

<sup>6</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë numër 135 datë 24.01.2011

<sup>7</sup> Neni 101 i ligjit nr. 102/2012 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”


<sup>8</sup> Vendimi i Gjykatës së Lartë Shqipëri, nr. 8 datë 16.01.2012





**Tabela 3. Vendime të dërguara për ekspertim dhe akte të realizuara 2009 -2016**

Numri i sistemeve kompjuterike që janë dërguar për ekspertim kompjuterik prej gushti të vitit 2009, deri në vitin 2016, është 15-fish, nga 105 në vitin 2009, në 1642 në vitin 2016. Numri total, i sistemeve kompjuterike të ekspertuara deri në vitin 2016, është 10810, numër relativisht i lartë.



**Tabela 4. Pajisje të ekspertuara nga viti 2009-2016**

Përqindjen më të lartë të pajisjeve të ekspertuara e zënë telefonat celularë 39% të së gjithë pajisjeve.




Tabela 5. Pajisje të ekspertuara nga viti 2009 -2016

#### 4. Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë periudhës që ka filluar aplikimi i ekspertimit kompjuterik, janë vënë re disa problematika. Një nga problematikat që është përmendur më lartë, në fushën legislative, ishte procedura me letër–porosi, për të caktuar ekspertë të huaj. Me ndryshimin në Kodit të Procedurës Penale, kjo situatë është zgjidhur, duke i lënë hapësirë organit të akuzës që të caktojë drejtpërdrejt ekspertë të huaj. Pajisjet dhe programet e përdorura nga ana e ekspertëve të policisë shkencore, janë të gjitha të certifikuara si pajisje dhe programe të licencuara nga shtetet përkatëse, për ekspertim kompjuterik. Gjykata e Lartë, pas caktimit të ekspertëve, u kërkoi përdorimin e programeve dhe pajisjeve të licencuara. Për këtë situatë, duhet të shikohen iniciativa ligjore për caktimin e institucioneve që do të licencenin pajisjet dhe programet që përdoren për ekspertim kompjuterik, por jo vetëm.

Në shumë vendime për kryerjen e ekspertimit kompjuterik, organi i akuzës nuk ka qenë shumë i qartë në formulimin e kërkesave. Kërkesat kanë qenë të përgjithshme, pa u përqendruar në faktet që duhen të evidentohen. Me rritjen e kapacitetit ruajtës të pajisjeve kompjuterike, bërja e një kopje të njëjtë të së dhënave kompjuterike me atë objekt ekspertimi, kërkon investime të mëdha në pajisje ruajtëse. Kjo situatë kërkon një specializim më të mirë të oficerëve të policisë gjyqësore, si edhe të prokurorëve që angazhohen në hetimin e rasteve, ku kërkohen njohuri të posaçme në fushën e teknologjisë së informacionit.

## Referenca

1. State v. Theer: <http://caselaw.findlaw.com/nc-court-of-appeals/1201672.html>
2. Agjencia e lajme CNN online datë 26 korrik 2016, aksesuar për herë të fundit datë 19. 9. 2017, në faqen: <http://edition.cnn.com/2016/07/25/politics/democratic-convention-dnc-emails-russia/index.html>.
3. Statistika e datës 30 korrik 2017, e marrë nga "Internet World Stats": <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>,
4. aksesuar për herë të fundit në datën 19 shtator 2017.
5. Zyra e Statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Raporti Vjetor, viti 2013, Prokurori i Përgjithshëm.
6. Vendim i Gjykatës së Lartë, numër 332, datë 5. 2. 2008.
7. Vendim i Gjykatës së Lartë, numër 135, datë 24. 1. 2011.
8. Neni 101 i ligjit nr. 102/2012, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".
9. Vendimi i Gjykatës së Lartë Shqipëri, nr. 8 datë 16. 1. 2012.

# Forenzika digjitale në shërbim të ligjit

**Msc. Blerim KRASNIQI**

Agjencia e Kosovës për Forenzikë

blekras@gmail.com

## Abstrakt

*Ky punim, ka për qëllim të trajtojë në mënyrë shkencore, rolin e pajisjeve elektronike të cilat janë bërë një pjesë e rëndësishme e jetës sonë dhe po bëhen thelbësore për aktivitetet në shtëpi, në vendin e punës dhe në shumicën e profesioneve duke qenë vegla kyçe të punës. Pajisjet e ndryshme elektronike, përveç se kanë për qëllim përdorimin e "rregullt" dhe të ligjshëm për çfarë edhe janë përcaktuar, shpesh përdoren edhe për qëllime të paautorizuara dhe të paligjshme. Përdorimi i paligjshëm i pajisjeve elektronike, për kryerjen e ndonjë veprë penale i bënë këto pajisje me vlerë të veçantë forenzike dhe trajtimi i tyre, duke përdorur metoda të aprovuara forenzike, bën që provat digjitale të nxjerra nga to, të prezantohen si prova të vlefshme në gjykatë. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informative dhe vërja e saj në shërbim të ligjit, ka bërë revolucion në parandalimin dhe luftimin e veprave penale. Provat digjitale të nxjerra nga pajisjet elektronike janë gjithnjë e më shumë të prezantuara si prova të vlefshme në gjykatë. Dëshmia digjitale përfshinë informacione, të cilat mund të gjenden në pajisje elektronike, duke përfshirë informacionet që mund të gjenden në kompjuter, incizimet e zërit, video dhe imazhet digjitale. Këto dëshmi janë thelbësore në gjetjen e kryesve të krimeve kibernetike por gjithashtu janë të vlefshme për identifikimin e personave përmes video dhe imazheve digjitale apo përmes identifikimit të tyre përmes ekzaminimit të tyre. Andaj, ky punim shkencor përpiqet të shqyrtojë rëndësinë e zbatimit të forenzikës digjitale, duke përdorur metoda të aprovuara shkencore dhe vënies se saj në funksion të ligjit.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**forenzika digjitale, krimet kibernetike, procesi i forenzikës, metodat e aprovuara, çështjet ligjore.**

## 1. Hyrje

Në fillim të përdorimit të teknologjisë informative, nga dëshmitë digjitale janë konsideruar kryesisht dëshmitë digjitale që kishin të bënin me krime kompjuterike. Me kalimin e kohës kjo ka ndryshuar tërësisht, pasi në ditët e sotme në secilin krim që ndodh, do të gjejmë pajisje elektronike në të cilat mund të gjejmë dëshmi të rëndësishme për hetime të mëtejshme apo edhe për inteligjencë.

Çdo ditë e më tepër, rëndësia e forenzikës digjitale, në raport me zbatuesit e ligjit, është në ngritje e sipër për faktin se teknologjia secilën ditë e më shumë përdoret për kryerjen e veprave penale, qoftë si mjet me të cilin është kryer vepra penale apo si mjet i cili ka qenë cak (objektiv) i veprës penale. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informative e së bashku me të edhe Interneti, ka bërë që përveç shërbimeve dhe lehtësimeve që i ofron në jetën e përditshme dhe profesionale, të përdoret po ashtu edhe nga kriminelet për të kryer vepra të ndryshme penale, trend ky, i cili është gjithnjë në rritje e sipër. Përdorimi i internetit për kryerjen e veprave penale, e ka ndryshuar plotësisht hetimin e vendit të krimit dhe në përgjithësi hetimin, sepse tani interneti ia mundëson një kriminel kryerjen e një vepre, ndaj një personi i cili jeton në një shtet tjetër, duke përdorur një server, i cili ndodhet në një vend të tretë, duke kaluar kufijtë shtetërorë - gjegjësisht duke kaluar në legjislacion ndërkombëtar. Për shkak të dinamikës së funksionimit të internetit, një ueb-faqe mund të hapet, të përdoret për një afat të shkurtër kohor për qëllime të caktuara dhe të ndryshohet, apo edhe fshihet në tërësi.

Gjithsesi, interneti është duke ndryshuar plotësisht konceptin e hetimit të vendit të krimit dhe rrjedhimisht forenzika digjitale, është duke u bërë pjesë e përditshme e punës së zbatuesve të ligjit dhe, në të ardhmen e afërt, secili zbatues i ligjit do të duhet të këtë njohuri themelore rreth teknologjisë dhe forenzikës digjitale.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 2. Forenzika digjitale

Në krahasim me shkencat tjera forenzike, forenzika digjitale është shumë më e re prandaj është edhe më pak e njohur për sistemin gjyqësor dhe më pak e kuptueshme. Në kuptimin më të ngushtë, forenzika digjitale është procesi i gjetjes dhe interpretimit së të dhënave digjitale, duke i ruajtur ato në formën origjinale dhe duke u kujdesur që gjatë këtij procesi të përdoren metoda të vlefshme dhe të aprovuara paraprakisht me qëllim të dokumentimit të vlefshmërisë së informacionit digjital. Gjithsesi, forenzika digjitale si proces, ndërthet në vete më shumë veprime, të cilat duhet të jenë pjesë e përkufizimit të qartë dhe si e tillë, krahas zhvillimit dhe përdorimit me të shpeshtë të saj, forenzika digjitale si proces, duhet ripërkufizuar. Fillimisht, definicioni i referohej vetëm kompjuterëve, një koncepti me të ngushtë, mirëpo me zhvillimin e teknologjisë dhe zbulimin e pajisjeve tjera të komunikimit, definicioni i mësipërm duhet zhbërthyer dhe përfshirë edhe procese tjera. Prandaj, përkufizimi i kompletuar në funksion të zbatimit të ligjit, i cili njëherazi edhe shërben si model për legjislacione të ndryshme, e përkufizon forenzikën digjitale si:

Përdorimi i metodave të provuara shkencërisht, për identifikimin, ruajtjen, mbledhjen, vlerësimin, ekzaminimin (analizën), interpretimin, dokumentimin dhe paraqitjen e provave digjitale të nxjerra nga burimet digjitale në gjykatë si dëshmi të vlefshme<sup>1</sup>.

Dëshmia digjitale, përfshin informacione, të cilat mund të gjenden në pajisje të ndryshme digjitale si dhe, mund të gjenden në formate të ndryshme si audio incizime, video incizime, informacione tjera rreth kompjuterit dhe programeve, të cilat i ka pasur në përdorim, si dhe mënyrës së përdorimit të tyre. Në komunikimin modern, bartja e informacioneve bëhet përmes një numri të madh të pajisjeve në rrjete, andaj, forenzika digjitale brenda saj ka shumë ndarje, për arsye të specifikave të cilat kanë këto pajisje e që secila prej tyre, ka rol të veçantë në ruajtjen dhe bartjen e informacioneve, të cilat në rastet e caktuara mund të kenë vlerë të madhe forenzike.

Njëra prej pajisjeve, përdorimi i së cilës është në zgjerim e sipër e që dita ditës po përdoret me të madhe për bartje informacionesh dhe komunikim, është telefonja mobile dhe si e tillë, është duke paraqitur mjaft sfida në raport me ekzaminimin e tyre dhe nxjerrjen e informacioneve me vlerë forenzike.

### 2.1 Forenzika e telefonisë së lëvizshme

Forenzika e telefonisë mobile (së lëvizshme/celular) është degë e forenzikës digjitale, e cila po ashtu i referohet në tërësi rregullave të përgjithshme të forenzikës digjitale. Përkundër kësaj, kjo fushë është shumë më komplekse se sa ç' duket në shikim të parë. Telefonat mobil (telefonat e mençur/"smart") përditë e më shumë janë kompjuter në miniaturë, se sa vetëm telefona mobil, duke qenë të pajisur me harduer dhe softuer edhe më të avancuar se sa vet kompjuteri. Në anën tjetër, përdorimi i tyre për shkak të shërbimeve të shumta që i ofron dhe mundësive të mëdha e të lehta të komunikimit, është gjithnjë në zgjerim e sipër. Në nivel global, në 104 shtete të ndryshme, 80% e të

<sup>1</sup> The Digital Forensic Research Conference DFRWS 2001 USA Utica, NY (Aug 7th 8th), [http://dfrws.org/sites/default/files/sessionfiles/a\\_road\\_map\\_for\\_digital\\_forensic\\_research.pdf](http://dfrws.org/sites/default/files/sessionfiles/a_road_map_for_digital_forensic_research.pdf), shikuar më 20 shtator 2017.

rinjve futen në internet, derisa abonimet e telefonisë mobile janë rritur më shumë se 20% në vit në pesë vitet e fundit dhe, pritet të arrijnë në 4.3 miliard në fund të vitit 2017<sup>2</sup>.

Për t'u mundësuar këto shërbime të shumta, përdoren edhe programe të ndryshme e secilën ditë më të avancuara dhe me nivel të ngritur të sigurisë. Mirëpo si pajisje, ofron shumë informacione nëse është pjesë e implikuar në ndonjë vepër penale, e cila gjatë procesit forenzik mund të ketë të ruajtura informacione me vlera të mëdha forenzike. Në anën tjetër, tabletët nuk përdoren më vetëm si pajisje argëtimi. Pajisur me procesor të fuqishëm dhe kapacitet të memories, madje edhe tabletët më të vegjël, janë të aftë të ekzekutojnë plotësisht sistemin operativ *Windows* dhe programin aplikativ të *Microsoft Office*. Prandaj, rëndësia e forenzikës së telefonisë mobile nuk duhet të nënvlerësohet, por t'i kushtohet rëndësi e veçantë<sup>3</sup>.

Informacionet dhe materialet të cilat mund të gjenden në telefona mobil, siç janë, komunikimi, sms, email, rrjete sociale, komunikimi përmes rrjetit, fotografi, videoincizime, audioincizime, gjeolokacionin, memorie, transaksione bankare, blerje *online* etj., mund të ofrojnë dëshmi të sakta dhe shumë të vlefshme forenzike.

## 2.2 Video-forenzika

Video forenzika është ekzaminim shkencor, e cila ka për qëllim qartësimin, krahasimin, matjen e objekteve, vlerësimin dhe përcaktimin e vërtetësisë së video-materialeve për çështjet ligjore<sup>4</sup>. Kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë shohim vendosje të kamerave të sigurisë si në prona private, ashtu edhe në prona e institucione publike. E gjithë kjo, bëhet për ngritje të nivelit të sigurisë së qytetareve dhe mbrojtjes së pronës. Megjithatë, jo gjithmonë kamerat e sigurisë arrijnë të regjistrojnë video të qarta dhe cilësore përmes së cilave do të vërehet qartë se çka ndodhur dhe do të identifikoheshin autorët e ndonjë krimi. Për këtë arsye, në shumicën e rasteve është e nevojshme ndërhyrja forenzike në qartësimin e video-materialeve të cilësorisë së dobët dhe kjo, kryesisht për identifikimin e personave dhe të mjeteve të luajshme, qofshin mjete në veprim motorik apo edhe mjete tjera.

Po ashtu, me teknikat e avancuara të videoeditimit, profesionistët e këtij lëmi, mund të heqin apo shtojnë ndonjë person ose objekt në video-material me qëllim të degradimit të personalitetit apo, edhe shantazhimit të tij. Rrjedhimisht, të gjitha këto e bëjnë rolin e video-forenzikës në procese gjyqësore shumë të rëndësishëm. Identifikimi i personave të dyshimtë përmes qartësimin të video materialeve si dhe përcaktimi i vërtetësisë së video materialit me qellim të zbardhjes së vërtetës, janë dhe mbetën dy prej proceseve kyçe në video forenzike. Me dinamikën e zhvillimit të teknologjisë dhe duke parë nevojat e kohës, është duke u zhvilluar dhe tani është në fazën testuese krahasimi biometrik 1:1 dhe kërkimi automatik i personave përmes kamerave të sigurisë në masë të njerëzve, d.m.th. funksionojnë në bazë të dy principeve, principit të identifikimit dhe principit të verifikimit<sup>5</sup>.

<sup>2</sup> <http://www.itu.int/en/ITU/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2017.pdf>, shikuar me 13 shtator 2017.

<sup>3</sup> Oleg Afonin, Vladimir Katalov, *Mobile Forensics – Advanced Investigative Strategies*.

<sup>4</sup> SWGIT: *Scientific Working Group of Imaging Technology - Best Practices for Forensic Video Analysis, Version 1.0* 2009.01.16, <http://www.crime-scene-investigator.net/swgit-section7.pdf>, shikuar me 02 shtator 2017.

<sup>5</sup> P. Jonathon Phillips, A. Martin, C.I. Wilson, M. Przybocki, *An Introduction to Evaluating Biometric Systems*, <http://www.face-rec.org/databases/151436.pdf>, shikuar më 11 shtator 2017.

Ky sistem ndryshe njihet edhe si *Sistemi Automatik i Identifikimit Biometrik* i cili bën krahasime automatike 1:1 dhe 1: databazë dhe, sisteme të tilla janë paraparë për vende si, transporti publik, (aeroport, metro), stadione, shëtitore dhe në përgjithësi vende publike, aty ku frekuentimi i njerëzve është i madh. Gjithsesi, në të gjitha rastet e mësipërme, dhe jo vetëm, video forenzika dhe metodat e reja të kërkimit dhe verifikimit paraqesin një mundësi që të kemi dëshmi të vlefshme forenzike në kohë reale me qëllim të parandalimit të krimit apo të prezantimit si dëshmi të rëndësishme në gjykatë.

## 2.2 Audio-forenzika

Audio forenzika i referohet marrjes (nxjerrjes), pastrimit, ekzaminimit, caktimit të vërtetësisë dhe prezantimit të të gjeturave si prova të pranueshme në gjykatë<sup>6</sup>. Si proces, ka dy veprime të rëndësishme brenda vetes, pastrimi i regjistrimeve të zërit nga zhurmat e ndryshme dhe përcaktimi i vërtetësisë së regjistrimit të zërit. Jo gjithmonë, mund ta kemi të pastër dëshminë, për futjen në proces të ekzaminimit, për caktimin e vërtetësisë; madje në shumicën e rasteve, regjistrimet janë të cilësisë shumë të dobët, për të cilat duhet trajtim i kujdesshëm gjatë pastrimit të zërit. Të dy këto veprime janë të lidhura ngushtë ndërmjet vetes dhe natyrshëm kryhen sipas kësaj radhe, pasi nuk mund të fillohet procesi i përcaktimit të vërtetësisë para se të bëhet pastrimi.

Pastrimi i zërit, është një kërkesë me së e zakonshme apo edhe më vjetra në tërë procesin e audio-forenzikës. Fillimisht, përdorimi i shiritave magnetik për regjistrim analog të zërit, ambienti jo i qetë, hapësira ku ka shumë njerëz apo edhe vetë pajisjet e regjistrimit, kanë krijuar dëshmi joideale për ekzaminim të mëtutjeshëm. Zhurmat e regjistruara në shirita magnetikë, ka qenë vështirë të largohen dhe në të shumtën e herëve nuk është arritur rezultati ideal apo rezultati i kërkuar. Mirëpo, kjo ka ndryshuar me zhvillimin e teknologjisë dhe me digjitalizimin e pajisjeve për regjistrim të zërit. Pajisjet digjitale për regjistrim të zërit, tani mund të regjistrojnë zërin në distanca shumë të largëta dhe në rastet ideale, me një qartësi shumë të madhe. Gjithsesi digjitalizimi i pajisjeve dhe krijimi i programeve forenzike për audio, e ka bërë edhe me të lehtë pastrimin e regjistrimeve duke mundësuar përdorimin e programeve të ndryshme për pastrim të zërit, pa ndikuar asnjëherë në cilësi të regjistrimit edhe pse, edhe tani, në shumicën e rasteve, regjistrimet e zërit lënë shumë për të dëshiruar për shkak të faktorëve të ndryshëm. Të gjitha këto, ndikojnë pastaj në caktimin e vërtetësisë së autorëve apo edhe në qartësimin e ndonjë situatë konfuze.

Caktimi i vërtetësisë është veprimi i dytë, që ndodh në procesin e ekzaminimit dhe si i tillë, ka shumë rëndësi, pasi në këtë pikë përcaktohet përmes parametrave shkencorë, nëse zëri i regjistruar i takon personit në fjalë, gjegjësisht sqarohet ndonjë situatë e caktuar për të cilën ka mëdyshje. Gjatë shekullit të kaluar, në shumicën e rasteve të hetimeve të fshehta, regjistrimi i zërave ka qenë një prej dëshmimeve kyçe dhe përmes tij, është dëshmuar në gjykatë, ndërsa në raste të aksidenteve ajrore, regjistrimi i zërave ende mbetet një prej dëshmimeve kyçe.

Me kalimin e kohës dhe zhvillimin e teknologjisë, është zhvilluar edhe audio-forenzika duke e automatizuar procesin e identifikimit të zërit në mënyrë automatike. Meqenëse zëri është karakteristikë individuale e secilit njeri (siç janë gjurmët e

<sup>1</sup> Robert C. Maher, *Audio Forensic Examination*, [http://www.montana.edu/rmaher/publications/maher\\_ieeespmag\\_0309\\_84-94.pdf](http://www.montana.edu/rmaher/publications/maher_ieeespmag_0309_84-94.pdf), shikuar me 20 shtator 2017.



gishtërinjve) atëherë përmes krahasimeve biometrike, mund të identifikohet folësi pavarësisht se në çfarë gjuhë flet. Krahasimi biometrik i zërit është një teknologji, e cila përdor karakteristikat e veçanta të secilit zë të regjistruar, duke e krahasuar me zërin model apo edhe me databazën e zërave. Databaza e tillë e deponimit të zërave të personave të dyshimtë, njihet ndryshe si *Sistemi Automatik i Identifikimit të Folësit - ASIS (Automated Speaker Identification System)*, i cili krahason zërin model, me zërat e regjistruar paraprakisht dhe të deponuar në databazë.

Kjo databazë funksionon mbi parimin e njëjtë sikurse sistemi AFIS, që është për gjurmët e gishtërinjve dhe që iu shërben agjencive të zbatimit të ligjit, për të identifikuar personat e dyshimtë. Meqenëse, sistemi biometrik i krahasimit të zërit, të cilin e shfrytëzon ky lloj sistemi dhe mundësia e gjetjes së folësit, pavarësisht se çfarë gjuhë flet, ky sistem, në të ardhmen do të këtë aplikim më të madh, duke i shërbyer zbatuesve të ligjit në përkrahje të hetimeve respektivisht në marrje të vendimeve më të sakta, duke u bazuar në parametra shkencorë<sup>7</sup>.

### 3. Procesi i forenzikës - 4 parimet bazë

Me qëllim të krijimit të një standardi të procesit të forenzikës, si dhe trajtimit të dëshmimeve digjitale, gjithmonë në interes të trajtimit sa më të mirë të tyre për shkak të ndjeshmërisë së pajisjeve digjitale dhe rrezikut nga ndonjë dëmtim i mundshëm, gjithmonë është punuar në drejtimin që të krijohen rregulla të pranueshme nga ekspertët forenzik. Për këtë arsye, janë krijuar udhëzime të ndryshme, të cilat kanë shërbyer për unifikimin e veprimeve apo për udhëzimin e ekspertëve se cilat veprime të ndërmarrin, gjatë procesit të forenzikës. Në mes tyre, më e pranueshmja, që deri më tani ka gjetur aplikim të gjerë dhe vazhdon të aplikohet deri në të ardhmen, është rregulli: “Katër parimet bazë të forenzikës digjitale”.

*Parimi 1:* Asnjë veprim i ndërmarrë nga agjencitë e zbatimit të ligjit, personat e punësuar në këto agjenci apo agjentët e tyre nuk duhet të ndryshojnë të dhëna, në të cilat më pas mund të mbështetën në gjykatë<sup>8</sup>.

*Parimi 2:* Në rrethanat kur një person e sheh të nevojshme të qaset në të dhënat origjinale, ai person duhet të jetë kompetent për ta bërë këtë dhe të jetë në gjendje të japë prova, që shpjegojnë rëndësinë dhe implikimet e veprimeve të tyre<sup>9</sup>.

*Parimi 3:* Duhet të krijohet dhe të ruhet një dokumentim, ose një regjistrim i detajuar i të gjitha proceseve që zbatohen në provat digjitale. Një palë e tretë e pavarur, duhet të jetë në gjendje, të bëjë të njëjtin ekzaminim dhe të arrijë të njëjtin rezultat<sup>10</sup>.

*Parimi 4:* Personi përgjegjës për ekzaminimin/hetimin, ka përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar respektimin e ligjit dhe këtyre parimeve<sup>11</sup>.

Këto katër parime bazë të forenzikës digjitale, edhe sot, shërbejnë si udhëzues për nxjerrjen e rregullave tjera, të cilat e plotësojnë procesin e forenzikës digjitale në detaje dhe njëherazi i shërbejnë ekspertëve gjatë tërë procesit të forenzikës. Është qenësore që gjatë procesit gjyqësor, rregullat e procesit të forenzikës digjitale, të dëshmojnë një

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

<sup>7</sup> <http://www.agnitio-corp.com/resources/faqs/technology/what-voice-biometrics>, shikuar me 21 shtator 2017.

<sup>8</sup> DAC Janet Williams QPM, ACPO *Good Practice Guide for Digital Evidence*, mars 2012, [http://www.digital-detective.net/digital-forensics-documents/ACPO\\_Good\\_Practice\\_Guide\\_for\\_Digital\\_Evidence\\_v5.pdf](http://www.digital-detective.net/digital-forensics-documents/ACPO_Good_Practice_Guide_for_Digital_Evidence_v5.pdf), shikuar më 21 shtator 2017.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Po aty.

objektivitet dhe integritet të procesit, andaj respektimi dhe përmbajtja e këtyre rregullave do ta mundësojë një gjë të tillë.

## 4. Metodatat e aprovuara

Forenzika digjitale, me qëllim të bërjes së ekzaminimit sa më cilësor duhet të përfshijë, brenda vetës edhe metodatat të cilat janë të aprovuara dhe përmes së cilave mund të monitorohet në çdo kohë, cilësia e procesit të ekzaminimit. Këto metoda, të cilat dëshmojnë se ofrojnë cilësi të procesit të ekzaminimit, në një formë, paraqesin edhe unifikim të metodave mes agjencive të zbatimit të ligjit qoftë edhe në shtete të ndryshme. Procedurat e forenzikës digjitale ndahen kryesisht në tre kategori kryesore, që do i shohim më poshtë.

### 4.1 Gjithmonë krijohet kopje të dëshmisë digjitale dhe ekzaminimi të bëhet në kopje

Eksperti forenzik duhet të kujdeset, që kopja të krijohet në bazë të metodave të aprovuara forenzike, në mënyrë që të sigurohet se kopja e evidencës, paraqet në tërësi evidencën origjinale dhe është kopjuar bit-për-bit, pa pësuar asnjë ndryshim<sup>12</sup>.

### 4.2 Dëshmimi i vërtetësisë së kopjes së dëshmisë digjitale

Eksperti forenzik duhet të dëshmojë së dëshmia e kopjuar, është identike me dëshminë origjinale dhe se gjatë procesit të kopjes, nuk ka pësuar ndryshim. Kjo, bëhet kryesisht përmes llogaritjes të vlerës së “hash”-it<sup>13</sup>.

### 4.3 Bërja e ekzaminimit në kopjen e krijuar

Në këtë fazë, eksperti forenzik përdor metoda dhe procedura teknike të ndryshme, në varësi të llojit të ekzaminimit dhe specifikave që kërkohen në kërkesën për ekzaminim<sup>14</sup>.

Aplikimi i këtyre metodave, të cilat përfaqësojnë një standard ndërkombëtar, dëshmojnë për një cilësi të procesit të ekzaminimit dhe si rezultat përfundimtar, dëshmojnë për një cilësi të raportit përfundimtar apo për gjetjet nga ekzaminimi.

## 5. Krimet kibernetike

Krimi kibernetik është një fushë e krimit që po zhvillohet shpejtë dhe përfshin, çdo veprim kriminal që merret me kompjuterë dhe rrjet. Krimet, të njohura deri tani veçmas, si: krimet e urretjes, telemarketingu dhe mashtrimet në internet, vjedhjet e identitetit dhe vjedhjet e llogarisë së kartës së kreditit, konsiderohen si krime kibernetike kur aktivitetet e paligjshme kryhen nëpërmjet përdorimit të një kompjuteri dhe interneti. Sipas, *Vlerësimit të Kërcënimit të Krimit të Organizuar në Internet (IOCTA)*, krimi

<sup>12</sup> J. Philip Craiger, *Computer Forensics Procedures and Methods*, <http://www.cyberace.org/Publications/craiger.forensics.methods.procedures.DRAFT.pdf>, shikuar më 23 shtator.

<sup>13</sup> J. Philip Craiger, *Computer Forensics Procedures and Methods*, <http://www.cyberace.org/Publications/craiger.forensics.methods.procedures.DRAFT.pdf>, shikuar më 23 shtator.

<sup>14</sup> Po aty.

kibernetik po bëhet gjithnjë e më agresiv dhe konfrontues. Kjo mund të shihet në forma të ndryshme të krimit kibernetik, duke përfshirë krimet e teknologjisë së lartë, shkeljet e të dhënave dhe zhvatjet seksuale<sup>15</sup>.

Efekti i krimit kibernetik, mund të jetë jashtëzakonisht shqetësues për viktimat, dhe jo domosdoshmërisht vetëm për arsye financiare. Viktimat mund të mendojnë se privatësia e tyre është shkelur dhe se ata janë të pafuqishëm. Kriminelët apo organizatat kriminale, gjithnjë e më shumë po shfrytëzojnë shpejtësinë dhe anonimitetin e internetit, për të kryer një gamë të larmishme veprimtarish kriminale që nuk njohin kufij, qoftë fizikë apo virtualë, shkaktojnë dëmtime serioze dhe paraqesin kërcënime shumë reale për viktimat në mbarë botën. Prirjet e reja në krimin kibernetik, po shfaqen gjatë gjithë kohës, me kostot e paparashikuara për ekonominë globale që shkojnë në miliarda dollarë. Në të kaluarën, krimi kibernetik u krye kryesisht nga individë ose grupe të vogla. Sot, po shohim rrjete mjaft komplekse kibernetike që sjellin njerëz nga e gjithë bota në kohë reale, për të kryer krime në një shkallë të paparë. Përveç kësaj, krimi kibernetik përfshin gjithashtu krime tradicionale të kryera nëpërmjet internetit. Sipas raportit të eksperteve të sigurisë kibernetike, të prezantuar në forumin ekonomik botëror, për rreziqet e sigurisë kibernetike për vitin 2017, kriminelët kibernetikë sa vjen dhe përmirësohen, duke i sofistikuar edhe sulmet e tyre. Hakerët, hackerët e sponsorizuar nga shtetet, apo edhe vet shtetet, gjithnjë e më shumë po synojnë sistemet dhe rrjetet e kontrollit industrial, rrjetet e energjisë, impiantet kimike, sistemet e aviacionit, rrjetet e transportit, sistemet e telekomunikacionit, rrjetet financiare dhe madje edhe objekte bërthamore<sup>16</sup>.

Ky raport tregon se niveli i sigurisë kibernetike, duhet të drejtohet drejt infrastrukturës kritike të secilit vend, pasi pamundësimi i funksionimit të cilësdo infrastrukturë, e cila konsiderohet infrastrukturë kritike, e vështirëson ose edhe e pamundëson funksionimin normal të secilit shtet. Gjithsesi, është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që të luftohen kriminelët kibernetikë, të vetëm, duke pas parasysh që sulmi mund të vijë nga cilado anë e globit. Në anën tjetër, është e pamundur të sigurohen të gjitha asetet e shtetit në mënyrë të barabartë, përkundër kostos së lartë të investimeve në teknologji dhe në siguri. Secila teknologji, ka pikat e saj të dobëta, të cilat kërkohen nga kriminelët kibernetikë dhe në pamundësi që të krijohen sisteme të sigurta dhe të padepërtueshme, duhet të fokusohemi më shumë, në parandalim duke e ngritur nivelin e vetëdijes tek përdoruesit, sepse pika më e dobët në tërë sistemin, është faktori njeri. Prandaj, në vend që të fokusohemi në ngritjen e nivelit të sigurisë së aseteve, e pastaj të merremi me pasojat, duhet që fokusi ynë të jetë parandalimi dhe ngritja e nivelit të vetëdijes së përdoruesve të internetit, sepse rreziqet do të ekzistojnë dhe do të përparojnë gjithnjë e më shumë, ndërsa ne duhet të mësohemi që të bashkëjetojmë me to.

## 6. Çështjet ligjore

Prej fillimit të aplikimit të forenzikës digjitale, në shërbim të ligjit, është punuar në drejtimin e krijimit të standardeve apo të unifikimit të procesit të forenzikës, me qëllim të krijimit të rregullave të cilat do të krijonin një standard të pranueshëm, brenda

<sup>15</sup> <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/cybercrime>, shikuar më 24 shtator 2017.

<sup>16</sup> Fireeye, Marsh & McLennan, *Cyber Risk Report*, janar 2017.

<https://www.fireeye.com/content/dam/fireeye-www/global/en/current-threats/pdfs/rpt-world-eco-forum.pdf>, shikuar më 24 shtator 2017.

agjencive të zbatimit të ligjit brenda një shteti apo edhe me gjerë. Krimet kibernetike, i tejkalojnë kufijtë shtetëror andaj krahas rregullave duhet të bëhet edhe standardizimi i ligjeve apo thënë me qartë, duhet që secili ligj t'i përfshijë të njëjtat vepra penale, pasi një vepër e sanksionuar në një shtet, mund të mos jetë vepër penale në një shtet tjetër. Për këtë arsye, në vitin 2001 Këshilli i Evropës, miratoi *Konventën për Luftimin e Krimeve Kibernetike*, në të cilën përcaktohen veprat penale të kryera duke përdorur teknologjinë informative<sup>17</sup>.

Përmes kësaj konvente, kërkohet që shtetet të cilat e miratojnë këtë konventë, të kenë të njëjtat vepra të sanksionuara në ligjet e tyre, me qëllim të unifikimit të sanksionimit të veprave penale të kësaj natyre. Po ashtu, përmes kësaj konvente, kërkohet edhe krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit, të cilët janë të domosdoshëm në hetimin e këtyre veprave penale pasi veprat e kësaj natyre, në të shumtën e rasteve, kryhen duke shfrytëzuar rrjetet kompjuterike në disa shtete, e që kërkojnë angazhimin e agjencive të ligjit, të po atyre shteteve. Andaj, pranimi i këtyre standardeve dhe unifikimi i ligjeve dhe rregullave do ta krijonte një standard të pranueshëm të rezultateve, të cilat dalin si rezultat i ekzaminimeve të forenzikës digjitale dhe të cilat, do të ishin të pranueshme, mes shteteve që aplikojnë të njëjtin standard.

## 7. Përfundime

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe rritja e numrit të pajisjeve digjitale të lidhura në rrjet, të cilat gjithnjë e më shumë po prodhohen me kapacitet më të madh memorieje, ka rritur njëherazi edhe sasinë e të dhënave që duhen ekzaminuar. Kapacitetet e memories, të vendosura lokalisht në pajisje dhe, ato të vendosura në serverët e kompanive që ofrojnë shërbime të tilla dhe të sigurisë së të dhënave, veç sa rrisin kohën e procesit të ekzaminimit. Nga ana tjetër, automatizimi i sistemeve të ekzaminimeve forenzike dhe krahasuese, siç janë ato të audio dhe video-forenzikës, do të ndihmonte edhe më shumë dhe më shpejt në identifikimin e personave, pasi do ta shkurtonte kohën deri të arritja e rezultateve, apo edhe mund të jepte dëshmi në kohë reale.

Forenzika digjitale ka pasur rol kyç në dënimin e shumë kriminelëve duke këtu përfshirë terroristët, abuzuesit seksualë dhe kriminelë të ndryshëm, të përfshirë në vepra të ndryshme të krimeve kibernetike; dhe roli i saj, sa vjen e shtohet. Ligjet e vjetra dhe mospërditësi i tyre, mos përcjellja e zhvillimeve të teknologjisë dhe përditësi i metodave dhe procedurave teknike të forenzikës digjitale, paraqesin sfidë në vete. Mospërditësi i tyre, do të krijonte ngecje të madhe dhe serioze, pasi një veprim që sanksionohet me ligj në një shtet, mund të mos sanksionohet në ndonjë shtet tjetër dhe po ashtu, një rezultat i ekzaminimit forenzik në një shtet, për shkak të procedurave të vjetruara dhe jashtë standardit të unifikuar, mund të mos pranohet si rezultat i vlefshëm, në një shtet tjetër. Ngecjet në aspektin ligjor, gjithsesi shkojnë në favor të kriminelëve kibernetikë dhe rezultatet e forenzikës digjitale, mund të mos pranohen si dëshmi të vlefshme në gjykatë.

Në të ardhmen e afërt, për shkak të dinamikës dhe zhvillimit të shpejtë të teknologjisë informative, komunikimit dhe fshirjes së shpejtë të gjurmëve, në vend të ngjarjes do të

<sup>17</sup> Council of Europe, *Convention on Cybercrime Budapest*, European Treaty Series - No. 185, 23.November.2001 <https://rm.coe.int/1680081561>, shikuar me 23 shtator.

shkojë laboratorin e forenzikës digjitale, në vend që të sillt pajisja digjitale në laborator. Ky veprim, do të përshpejtohte kohën e shkuarjes deri të informacioni, duke identifikuar kryesit e veprës dhe do të mundësonte veprim të menjëhershëm të agjencive të zbatimit të ligjit, respektivisht prokurorisë dhe gjykatës, duke pasur rezultatet e ekzaminimit në kohë sa më të shkurtër nga vendi i ngjarjes.

Për shkak të globalizimit dhe ofrimit të shërbimeve të internetit nga kompani të ndryshme, nga anë të ndryshme të globit, është në zhdukje e sipër procesi i vendosjes së shiritit të verdhë në vendin e ngjarjes, pasi vendi i ngjarjes do të jetë diku në një vend tjetër, shtet tjetër e gjeëgjësisht do të jetë në botën virtuale, i vendosur diku në serverët e kompanive, të cilat i ofrojnë këto shërbime. Informacionet e marra nga ekzaminimet forenzike, të dala si rezultat i forenzikës digjitale, janë informacione me vlerë të madhe forenzike, të cilat do t'ia lehtësonin dhe mundësonin agjencive të zbatimit të ligjit, marrjen e vendimeve të sakta ndërsa gjykatës do t'i mundësonte gjykim të drejtë dhe të bazuar në fakte shkencore.

## Bibliografia

1. *The Digital Forensic Research Conference DFRWS 2001 USA Utica, NY (Aug 7th - 8th)*, [http://dfrws.org/sites/default/files/sessionfiles/a\\_road\\_map\\_for\\_digital\\_forensic\\_research.pdf](http://dfrws.org/sites/default/files/sessionfiles/a_road_map_for_digital_forensic_research.pdf), shikuar me 20 shtator 2017.
2. <http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2017.pdf>,
3. shikuar me 13 Shtator 2017, 20:00h.
4. Oleg Afonin, Vladimir Katalov, *Mobile Forensics – Advanced Investigative Strategies*.
5. SWGIT: *Scientific Working Group of Imaging Technology - Best Practices for Forensic Video Analysis*, Version 1.0 2009,
6. <http://www.crime-scene-investigator.net/swgit-section7.pdf>, shikuar me 02 shtator 2017.
7. P. Jonathon Phillips, A. Martin, C.I. Wilson, M. Przybocki, *An Introduction to Evaluating Biometric Systems*, <http://www.face-rec.org/databases/151436.pdf>,
8. shikuar me 11 shtator 2017.
9. Robert C. Maher, *Audio Forensic Examination*, [http://www.montana.edu/rmaher/publications/maher\\_ieeespmag\\_0309\\_84-94.pdf](http://www.montana.edu/rmaher/publications/maher_ieeespmag_0309_84-94.pdf),
10. shikuar me 20 shtator 2017.
11. <http://www.agnitio-corp.com/resources/faqs/technology/what-voice-biometrics>, shikuar me 21 shtator 2017.
12. DAC Janet Williams QPM , *ACPO Good Practice Guide for Digital Evidence*, mars 2012, [http://www.digital-detective.net/digital-forensics-documents/ACPO\\_Good\\_Practice\\_Guide\\_for\\_Digital\\_Evidence\\_v5.pdf](http://www.digital-detective.net/digital-forensics-documents/ACPO_Good_Practice_Guide_for_Digital_Evidence_v5.pdf), shikuar me 21 shtator 2017, 21:00h
13. J. Philip Craiger, *Computer Forensics Procedures and Methods*, <http://www.cyberace.org/Publications/craiger.forensics.methods.procedures.DRAFT.pdf>, shikuar me 23 shtator.
15. Council of Europe, *Convention on Cybercrime Budapest*, European Treaty Series - No. 185, 23. November.2001 <https://rm.coe.int/1680081561>, shikuar me 23 shtator.
16. <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/cybercrime>,
17. shikuar më 24 shtator 2017.
18. Fireeye, Marsh & McLennan, *Cyber Risk Report*, janar 2017.
19. <https://www.fireeye.com/content/dam/fireeye-www/global/en/current-threats/pdfs/rpt-world-eco-forum.pdf>, shikuar me 24 shtator 2017.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# Parandalimi i akteve terroriste – strategjia ligjore në Kosovë, Shqipëri, EU dhe SHBA

— Dr. Sc. Xhemajl ADEMAJ<sup>1</sup>

Agjencia e Kosovës për Forensikë  
xhemajl.ademaj@gmail.com

— Dr. Sc. Blerim OLLURI<sup>2</sup>

Agjencia e Kosovës për Forensikë  
blerim.olluri@rks-gov.net

## Abstrakt

*Punimi shkencor me titull "Parandalimi i akteve terroriste - strategjia ligjore në Kosovë, Shqipëri, EU dhe SHBA", trajton se terrorizmi nuk është një fenomen i ri. Ka qenë prej kohësh një metodë e veprimeve të dhunshme nga organizatat dhe individët që përpiqen të arrijnë qëllime politike. Në të vërtetë, terrorizmi nuk është një fund, por më tepër një modus operandi. Sulmet e 11 shtatorit 2001 mbi Qendrën Tregtare Botërore dhe Pentagon, demonstruan në mënyrë dramatike rrezikun që aktet terroriste mund të kenë për qytetarët dhe banorët e Shteteve të Bashkuara. Këto sulme vdekjeprurëse përforcuan faktin se terrorizmi është një problem i rëndësishëm për pjesën tjetër të botës për një kohë të gjatë. Përderisa sulmet e 11 shtatorit ishin të jashtëzakonshme, është e rëndësishme të kuptohet se terrorizmi ka një histori të gjatë. Vështirësitë e luftimit të terrorizmit janë të ndryshme, por edhe të varura nga mënyrat e kryerjes së akteve terroriste, mjetet dhe armët e përdorura për kryerjen e terrorizmit, si dhe nga vendi dhe territori ku aktet terroriste kryhen. Zbulimin dhe parandalimin e akteve terroriste, që kanë pasoja të përmasave të gjera, e vështirëson edhe mungesa e pajisjeve tekniko-teknologjike, elektronike dhe ligjore të shtetit, i cili duhet t'i kundërvihet terrorizmit.*

**Fjalëkyçe:**  
**terrorizmi, luftimi, strategjia, ligji.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>1</sup> Xhemajl Ademaj, Ph.D., Drejtor i departamentit në Agjencionin e Kosovës për Forenzikë, dhe anëtar i rregullt i Akademisë Amerikane të Shkencave Forenzike, ligjërues i lëndëve kriminalistike në kolegjin FAMA.

<sup>2</sup> Blerim Olluri, Ph.D., Kryeshf Ekzekutiv i Agjencionit të Kosovës për Forenzikë, ligjërues i lëndës terrorizmi në kolegjin AAB.

## 1. Hyrje

Realiteti ndërkombëtar është i ngarkuar me kriza dhe me përlëshje ushtarake, si dhe me sfida e kërcënime joushtarake, që sjellin implikime në fusha të ndryshme, e që kanë rëndësi për plotësimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, gjegjësisht, sigurinë e shoqërisë dhe shtetit në tërësi. Kundërthëniet e shumta shkaktojnë rritjen e të gjitha formave të dhunës në nivel global, e cila vepron në mënyrë të veçantë në sigurinë dhe stabilitetin e secilit shtet. Në kuadër të saj, duhet ta shohim terrorizmin si një çmenduri dhe kërcënim për botën bashkëkohore; si fenomen shumëdimensional, që paraqet rrezik dhe kërcënim shumë të madh për vetë shtetin dhe njerëzimin.

Terrorizmi është shprehur shumë kohëve të fundit në botë, veçanërisht që nga sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, mirëpo sulme terroriste ka pasur edhe më herët në shumë vende të botës, kryesisht në vendet perëndimore dhe Izrael, e pa u lënë anash edhe Kosova e Shqipëria. Terrorizmi sot konsiderohet njëri ndër kërcënimet më serioze për sigurinë kombëtare të secilit vend, por gjithashtu është edhe njëri ndër kërcënimet më serioze për sigurinë këtyre shteteve, që do ta shtjellojmë në këtë punimin, sidomos duke pasur parasysh prirjet globale të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Objekt i studimit në këtë punim, është trajtimi i terrorizmit dhe akteve të tija nga ana legislative dhe strategjike, të cilat, si të tilla, paraqesin një dukuri të rrezikshme shoqërore, me të cilën rrezikohen dhe atakohen individët dhe të mirat e ndryshme materiale, të vendeve me sisteme të ndryshme ekonomike dhe politike. Me qëllim studimin dhe shtjellimin më të mirë, në punim kam paraqitur format e terrorizmit sot dhe, aspektet ligjore si metodë luftimi, ku secila nga dy pjesët trajtohet me një qasje shkencore.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

Terrorizmi nuk është vetëm një kërcënim për të gjitha shoqëritë, por edhe një sulm ndaj vlerave që përcaktojnë sundimin të ligjit në bashkësinë ndërkombëtare, respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjes së civilëve, besimit ndërkulturor, tolerancën dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve. Përpjekjet e antiterrorizmit, gjithashtu mund të kenë sukses më të mirë, duke ndjekur terroristët në të gjitha vendet e botës. Kundërpërgjigja e plotë shumëpalëshe për terrorizmin, kërkon kurajë politike si dhe reflektim më të thellë në lidhje me vetë terrorizmit dhe mjetet në dispozicion për të luftuar atë. Tani që kemi hyrë në shekullin njëzetinjë, terrorizmi vazhdon të mbetet një kërcënim serioz, ndaj interesave kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë, ndaj globalizimit dhe paqes botërore. Në këtë fillimshkulli janë dhjetëra vende, nga pothuajse të gjitha kontinentet që janë të goditura nga sulmet terroriste, veçanërisht SHBA-të dhe Evropa, pa lënë anash mundësitë e rrezikut për Shqipërinë dhe Kosovën. Për këtë, me të drejtë, thuhet për terrorizmin se paraqet “rrezik për kohën në të cilën jetojmë”.

## 2. Historik i shkurtër për terrorizmin si rrezik në rritje dhe sfidë për sigurinë

Fenomeni i terrorizmit mund të kuptohet ashtu siç duhet, vetëm nëse fillojmë së trajtuar nga historiku i tij, pra do ta filloj elaborimin nga historiku. Pra, historia e terrorizmit është aq e vjetër sa gatishmëria njerëzimit për të ndikuar në politikë me përdorimin e dhunës. Terrorizmi si një mjet ekonomikisht i leverdishëm për terroristët, në funksion të një konflikti me intensitet të ulët, që gjeneron frikësim psikologjik dhe forcë fizike në kundërshtim me ligjin, ka rrënjë të vjetra<sup>3</sup>. Kërcënimet me ushtrimin e dhunës janë përdorur historikisht për të frikësuar individë apo qeveri në mënyrë që ato t’iu binden kërkesave të ushtruesve të dhunës. Mbi këtë bazë, terrori ka qenë një taktikë e njohur për të arritur objektiva ushtarako-politike dhe për këtë mund të sjellim shembuj që nga historia e perandorisë romake, ku Jul Cezari kishte si praktikë të merrte robër për të siguruar nënshkrimin e të mundurve. Duke u afruar në shekuj, veprimet si masakra e përgjakshme e Shën Bartolomeut, e vitit 1572<sup>4</sup> dhe “terrori” i zyrtarizuar nga jakobinët, në vitet 1791-1794, gjatë Revolucionit Francez, në kërkim të republikës, duke asgjësuar aristokracinë, përbëjnë shembujt më klasikë të terrorizmit.<sup>5</sup> Po ashtu, shembuj të terrorizmit që nga kohët e hershme janë sulmet e ndërmarra nga ekstremistët fetarë izraelitë, të njohur me emrin *zelotët*, kundër romakëve në Judën e pushtuar, si dhe në misionet martirizuese të *hashashinëve* (vrasësve) që kishin në shënjestër kryqtarët në Lindjen e Mesme. Përvoja e tyre vërtetoi se terrorizmi mund të jetë tërheqës, efikas, e i vazhdueshëm edhe kur mjetet janë pak a shumë primitive.<sup>6</sup>

Në periudhat e mëpasshme, duke filluar nga shekulli XVI deri në vitet e fundit të shekullit XVIII, disa shtete evropiane detare përdorën piratët, ose kusarët e detit, për të terrorizuar lundërtarët në dobi të arritjes së objektivave të politikës së jashtme. Gjatë Revolucionit Francez, në kohën e Sundimit të Terrorit (1793 - 94), terrorizmi nga

<sup>3</sup> Yonah Alexander, *Combating Terrorism, Strategies of ten countries* (përktheu Stavri Pone), University of Michigan 2002, f. 16.

<sup>4</sup> Republika e Shqipërisë, Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes, disertacion *‘Financimi i Terrorizmit rast studimor Shqipëri’*, kolonel MSc. Eduard Bala, Tiranë, 2013 f. 21.

<sup>5</sup> Marisa Linton, *‘The Terror in the French Revolution’*. Kingston University. [http://www.port.ac.uk/special/france1815to2003chapter1\\_20545.en.pdf](http://www.port.ac.uk/special/france1815to2003chapter1_20545.en.pdf)

<sup>6</sup> [http://terrorism.about.com/od/what\\_is\\_terroris/p/Terrorism.htm](http://terrorism.about.com/od/what_is_terroris/p/Terrorism.htm)



“lart” e nga “poshtë” ishte diçka e zakonshme. Një numër grupesh evropiane, të ushqyera me teori politike ekstremiste (p.sh. me ideologjitë majtiste e djathtiste) dhe me nacionalizmin militant, arritën disa suksese taktike. Duke përdorur vetëvrasjen dhe veprimtari të tjera terroriste, si vënie bombash, terroristët vranë një numër të madh sundimtarësh evropianë, përfshirë carin Aleksandër II në vitin 1881. Vrasja e arkidukës austriak në Sarajevë, i futi fuqitë e mëdha në Luftën e Parë Botërore, megjithëse autori i saj nuk kishte pasur këtë qëllim. Edhe periudha midis dy luftërave botërore, u karakterizua nga disa valë sulmesh në rajone të ndryshme të botës si Azia dhe Lindja e Mesme, ku grupet nacionaliste luftonin për t’u çliruar nga sundimi kolonial.<sup>7</sup>

Shumë qeveri nuk kanë arritur të vlerësojnë gjerësinë dhe ndërlikimet e kërcënimit terrorist ndaj shoqërive të sotme. Si rrjedhim, një numër i madh vendesh, përfshirë disa demokraci perëndimore, nuk i janë përkushtuar seriozisht punës për ta përballuar me efektshmëri këtë sfidë. Një nga arsyet madhore për këtë mosarritje është pësjtjellimi përkufizues e moral rreth faktit se ç’është në vetvete terrorizmi. Çdo shtet i pavarur i rezervon vetes autoritetin ligjor për ta përkufizuar terrorizmin në kontekstin e çështjeve të brendshme e të jashtme<sup>8</sup>.

Aktualisht fenomeni i terrorizmit si një nga kërcënimet më serioze globale, është bërë objekt studimor jo vetëm i studiuesve të njohur, në të gjitha shkollat dhe universitetet e botës, por edhe analistëve e specialistëve në agjenci të inteligjencës, sigurisë, ligjëbërëse dhe zbatuese. Përgjigje për pyetjet se “çfarë është terrorizmi?” apo “çfarë kuptojmë me akte ose veprimtari terroriste?”, mund t’i gjejmë në përcaktimet e studiuesve të ndryshëm, qofshin ata ushtarakë, filozofë e politologë nga e kaluara deri më sot. Dikush e përcakton terrorizmin si përdorim i dhunës dhe frikësimit për të nënshtruar njerëzit ose për të arritur një qëllim apo synim të caktuar politik, ndërsa një prej studiuesve të shquar të lashtësisë, kinezi Sun Tzu, e koncepton terrorizmin në këtë mënyrë “Vrit një të frikësosh dhjetëmijë”<sup>9</sup>. Sot terrorizmi është një kërcënim në rritje: “Kamikazët me bomba, armët e shkatërrimit në masë dhe sistemet e tyre të lëshimit, financimi i terroristëve dhe terrorizmi (kimbernetik) kompjuterik janë disa forma të aktivitetit terrorist që përbëjnë sot kërcënimin në rritje kundër paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.”<sup>10</sup> Por, llojet kryesore të terrorizmit janë: fetare, etnike, nacionaliste ose ideologjike. Ekzistojnë edhe pak grupe që janë më të vështirë për t’u vendosur brenda një kategorie të dhënë, për shkak të kompleksitetit të motivacioneve të tyre<sup>11</sup>.

### 3. Strategjitë ligjore për parandalimin e terrorizmit

#### 3.1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Edhe pse terrorizmi si dukuri nuk është i ndonjë date të re, nga natyra bashkëkohore e kërcënimeve terroriste ka ndryshuar edhe dukuria e tij. Është fakt se terroristët sot objektivisht kanë mundësi të zhvillimit dhe të posedimit të armëve për shkatërrim në masë, prandaj paraqet rrezik mjaft të qartë dhe real. Duke u nisur nga supozimi i cekur, pikërisht veprimi preventiv i SHBA-së në luftën kundër terrorizmit do t’i pengojë

<sup>7</sup> Yonah Alexander, *op. cit.*, f. 16.

<sup>8</sup> Po aty, f. 15.

<sup>9</sup> Kudret Selimaj, “Konteksti historik dhe dukuritë e terrorizmit në Evropë” Revista - *Çështje Evropiane dhe të Sigurisë* – 22, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, f. 86.

<sup>9</sup> Xhavit Shala, *Ballkani, Gjeopolitika dhe siguria II*, Tiranë, 2009, f. 187.

<sup>10</sup> Alan Collins, *Studime bashkëkohore të sigurisë*, (përkthim Enri Hide), Tiranë, 2010, f. 374.

<sup>11</sup> Alan Collins, *Studime bashkëkohore të sigurisë*, (përkthim Enri Hide), Tiranë, 2010, f. 374.

terroristët potencialë që të prodhojnë apo të kenë në posedim armë për shkatërrim në masë<sup>12</sup>.

Që nga vitet 1970, kur terroristët ndërkombëtarë filluan të kryenin sulme të mëdha kundër interesave amerikane, terrorizmi i ka shqetësuar të gjitha administratat e SHBA-së. Këto sulme drejtoheshin kryesisht nga grupe arabe që i kundërviheshin politikës amerikane në lidhje me konfliktin arabo-izraelit, ose kryheshin nga grupe të ndryshme radikale, që sfidonin influencën dhe fuqinë amerikane. Uashingtoni filloi to shikonte terrorizmin ndërkombëtar si problem të sigurisë kombëtare që kërkonte një përgjigje më të fuqishme dhe më të efektshme<sup>13</sup>.

Strategjia nacionale e luftës kundër terrorizmit, paraqet një nga disa strategjitë e specializuara, të cilat “e përcjellin” Strategjinë nacionale të sigurisë. Do të fitojmë në luftën e ideve dhe në këtë mënyrë do t’i zvogëlojmë kushtet që u përshtaten promovimit dhe zgjerimit të vizioneve destruktive të ndryshimeve politike. Dhe në fund, do të përdorim çdo gjë që e kemi në dispozicion për t’i mbrojtur SHBA-të, qytetarët tanë dhe interesat tona në tërë botën nga sulmet terroristë<sup>14</sup>.

Në një shekull të ri, mundësitë për Amerikën janë të bollshme, por rreziku për sigurinë mbetet.

Strategjia e re e sigurisë kombëtare, i pozicionon Shtetet e Bashkuara për të mbrojtur interesat kombëtare nëpërmjet udhëheqjes së fortë dhe të qëndrueshme. Ajo përcakton parimet dhe prioritetet për të udhëhequr përdorimin e fuqisë dhe ndikimit amerikan në botë. Ajo, përparon një model të lidershit amerikan, të rrënjosur në themelin e forcës ekonomike dhe teknologjike të Amerikës dhe vlerat e popullit amerikan. Ajo redukton përkushtimin tonë ndaj aleatëve dhe partnerëve dhe mirëpret, kontributet konstruktive të fuqive përgjegjëse në rritje. Ajo sinjalizon vendosmërinë dhe gatishmërinë tonë, për të penguar dhe, nëse është e nevojshme, për të mposhtur kundërshtarët e mundshëm. Ajo afirmon rolin udhëheqës të Amerikës brenda një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla që funksionojnë më së miri nëpërmjet qytetarëve të fuqizuar, shteteve përgjegjëse dhe organizatave efektive rajonale dhe ndërkombëtare. Dhe shërben si një busull për mënyrën se si kjo administratë, në partneritet me Kongresin, do ta udhëheqë botën përmes një panorame të ndryshueshme të sigurisë drejt një paqeje më të qëndrueshme dhe një prosperiteti të ri<sup>15</sup>.

Strategjia e SHBA-ve është shumë e fuqishme për të ndaluar dhe ndryshuar fenomenin e terrorizmit për hir të sigurisë të Amerikës dhe për të ruajtur stabilitetin ndërkombëtar.

- Së pari, strategjia shqyrton mjedisin kërcënues të terrorizmit dhe natyrën e armikut me të cilin përballemi.

- Së dyti, ajo përcakton qëllime të gjera, ose “përfundimet”, për politikën amerikane kundër terrorizmit dhe çfarë fitore do të duket. Përfundimisht, paraqet në detaje prioritetet kryesore kundër terrorizmit, ose “mjetet”, që nevojiten për të arritur qëllimet tona kryesore, duke përfshirë: (1) kundër sulmet për të mbrojtur komunitetet tona; (2) të ndalojë rekrutimin dhe radikalizimin në vend; (3) mbajnë terroristët larg nga Amerika; (4) të luftojë kundër armikut; (5) luftimi i udhëtimit terrorist dhe ndërprerja e burimeve financiare; (6) mohojnë xhihadistëve qasje në armët e shkatërrimit në masë; (7) të

<sup>12</sup> Freedom and fear are at war, *National strategy for Combating Terrorisma*, f. 1.

<sup>13</sup> Yonah Alexander, *Combating Terrorism, Strategies of ten countries*, University of Michigan 2002, f. 32.

<sup>14</sup> Freedom and fear are at war, *National strategy for Combating Terrorisma*, f. 29.

<sup>15</sup> USA, *National Security Strategy*, Washington, 2015, f. 4.

bllokojë terroristët nga kthimi në fushën e betejës; (8) të parandalojë shfaqjen e rrjeteve të reja dhe strehëve të sigurta; dhe (9) të fitojë betejën e ideve<sup>16</sup>.

### **3.2. Strategjia e BE-së kundër terrorizmit**

Reagimi i BE-së kundër sulmeve terroriste më 11 shtator 2001 ka qenë i shpejtë, e për të cilën gjë janë mbajtur shumë tubime, janë nxjerrë shumë konkluzione, janë ndërmarrë shumë iniciativa dhe shumë aksione, si dhe janë ndërmarrë masa të ndryshme në fushën diplomatike, legjislative, të qarkullimit dhe atë financiare. Së pari u takuan Këshilli i Jashtëzakonshëm i ministrave të judikaturës dhe të atyre të punëve të brendshme më 20 shtator 2001. Këshilli në fjalë në konkluzionet e veta ka theksuar se serioziteti i ngjarjeve të cekura e detyron Bashkimin (Unionin) për një realizim sa më të shpejtë të lirisë, të sigurisë dhe të drejtësisë, si dhe për përforsimin e bashkëpunimit me partnerët, e sidomos me SHBA-në. Një ditë më vonë, më 21 shtator 2001, është mbajtur tubimi i jashtëzakonshëm i Këshillit të Evropës (tubimi i forumeve më të rëndësishme politike të BE-së që i përbëjnë shefat e shteteve dhe të qeverive), në të cilin janë nxjerrë konkluzionet dhe plani i aksionit me të cilat në shkallën më të lartë është definuar përgjigja e BE-së<sup>17</sup> në raport me sulmet terroriste në SHBA. Këshilli i Evropës e ka përcaktuar solidaritetin e vet me popullin amerikan dhe ka vendosur që lufta kundër terrorizmit të jetë qëllim prioritar i BE-së.

Vetëm disa ditë pas sulmit, në rendin e ditës të institucioneve të BE-së kanë qenë disa propozime në bazë të së cilave është hartuar dhe pastaj nga Këshilli i Jashtëzakonshëm i Evropës më 21 shtator, është miratuar plani i aksionit. Planin e aksionit e ka definuar politikën e BE-së për luftimin e terrorizmit dhe kështu përmban shumë masa në katër fusha kryesore:

1. në forcimin e bashkëpunimit policor dhe të asaj të judikaturës midis shteteve anëtare midis të cilave rëndësi të veçantë kanë miratimi i urdhërarrestit evropian, i krijimit të ekipeve të përbashkëta antiterroriste si dhe miratimi i listës së organizatave terroriste;

2. në ndërtimin e instrumenteve ndërkombëtare me ratifikimin e konventave ekzistuese pariale antiterroriste, si dhe me miratimin e konventës së përgjithshme për luftën kundër terrorizmit në nivel të KB-së që në mënyrë gjithëpërfshirëse do ta rregullonte këtë materie;

3. në luftën kundër financimit të terrorizmit duke miratuar legjislacionin përkatës që do të mundësonte ngrirjen e llogarive të personave fizikë dhe atyre juridikë të dyshuar për financimin e terrorizmit;

4. në forcimin e sigurisë së trafikut ajror<sup>18</sup>.

### **3.3 Shqipëria**

Një reagim efektiv dhe i fokusuar në parandalimin ndaj terrorizmit duhet të përfshijë një element të fortë të drejtësisë penale: ai i cili udhëhiqet nga një kornizë ligjore normative dhe të përfshira në parimet bazë të sundimit të ligjit, procesit të duhur dhe respektimit të drejtave të njeriut<sup>19</sup>.

<sup>16</sup> Michael T. McCaul, *A National Strategy to Win The War Against Islamist Terror*, 2016, USA, f. 14.

<sup>17</sup> *European Union Con-solidated versions of the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community*, f. 12.

<sup>18</sup> Po aty, f. 4.

<sup>19</sup> United Nations Office on Drugs And Crime, *Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism*, New York, 2009, f. 6-7.

Në fjalimin e tij në Komitetin e Këshillit të Sigurimit kundër terrorizmit më 6 mars 2003, Sekretari i Përgjithshëm i atëhershëm, z. Kofi Annan, theksoi nevojën “për të zhvilluar një program ndërkombëtar të veprimit, bazuar në një angazhim të palëkundur për të mbështetur sundimin e ligjit”. Dhe, më tej deklaroi se “meqë terrorizmi përfshin përdorimin e llogaritur të dhunës në kundërshtim me ligjin, reagimi ynë ndaj terrorizmit duhet të synojë të sigurojë sundimin e ligjit.”<sup>20</sup>

Bazuar në këtë që u tha nga Kofi Anan, Shqipëria si shtet demokratik i ka kushtuar një qasje më bashkëkohore luftimit të terrorizmit.

Kodi Penal parashikon katër kategori veprash penale kundër terrorizmit (neni 230-234):<sup>21</sup>

- financimi i terrorizmit (Neni 230/a);
- fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin (Neni 230/b);
- dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit (Neni 230);
- kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur (Neni 230/ç);
- grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit (Neni 230/d);
- rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit (Neni 231);
- stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste (Neni 232);
- nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste (Neni 232/a);
- kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste (Neni 232/b);
- organizata terroriste (Neni 234/a)<sup>22</sup>.

*Shqipëria angazhohet* plotësisht për të përmbushur në mënyrë aktive dhe t’u përkushtuar me të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit, duke e konsideruar atë si rrezikun dhe armikun numër një të paqes, sigurisë dhe demokracisë në botë.

- Pengimi i përdorimit të territorit shqiptar si bazë për planifikimin, organizimin, kryerjen e krimeve terroriste, apo nxitjen e pjesëmarrjen në këto krime në çdo formë; përfshirë parandalimin e hyrjes së elementeve terroriste apo fitimin nga ana e tyre të statusit të refugjatit, apo të së drejtës së qëndrimit si individ apo kolektiv, për t’u organizuar trajnuar, gjetjen e armëve apo çdo aktivitet tjetër i kamufluar.

- Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve me shtetet e tjera kontraktuese, në veçanti me SHBA-në dhe vendet e tjera për problemet e luftës kundër terrorizmit<sup>23</sup>.

- Forcimi i sistemeve për zbulimin e transportit, eksportimit, grumbullimin e armëve, municioneve dhe eksplozivave e armëve të tjera të dëmtimit në masë.

- Forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e veçantë të personave të rëndësishëm.

- Forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme shtetërore dhe private dhe mjetet e transportit publik, për parandalimin e akteve terroriste.

- Vënien në zbatim për mbrojtjen dhe sigurinë e personave dhe misionëve diplomatike dhe konsullorë; të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të akredituara

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Ligji Nr. 9086, datë 19.6.2003 (neni 7) “Financimi i terrorizmit”, dhe Ligji Nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 79.

<sup>22</sup> Kodi penal i Shqipërisë, *Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare*, janar 2016.

në vendin tonë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat rregullojnë këtë fushë.

- Rritjen e masave të sigurisë dhe koordinimin me çdo shtet në lidhje me informimin, me qëllim për të ekspozuar objektivat e grupeve dhe organizatave terroriste, të pengojë skemat e tyre dhe të bëjë të ditur rrezikun që paraqesin për sigurinë dhe stabilitetin.

- Të krijojë bazën e të dhënave për mbledhjen dhe analizën e informacioneve mbi elementet, grupet, lëvizjet dhe organizatat terroriste, si dhe të monitorojë zhvillimet në lidhje me fenomenin e terrorizmit dhe të eksperimentave të suksesshme në luftën kundër tij. Ky informacion duhet rifreskuar dhe të shkëmbehet me autoritet kompetente të shteteve të tjera, sipas kufizimeve të marrëveshjeve dhe procedurave<sup>24</sup>.

### 3.4. Strategjia ligjore e luftimit të terrorizmit në Kosovë

Policia e Kosovës është “mekanizëm institucional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila merret me parandalimin, ndjekjen dhe luftimin e terrorizmit”<sup>25</sup>. Deri në periudhën e shpalljes së pavarësisë, përgjegjësinë e plotë për ruajtjen e rendit, qetësisë si dhe parandalimin, luftimin e të gjitha akteve të dhunës, përfshirë edhe luftimin e akteve terroriste, e ka bartur bashkësia ndërkombëtare përmes prezencës civilo-policore-ushtarake në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, në segmente të caktuara barten përgjegjësitë tek institucionet vendore gradualisht, këtu dua të potencoj transferimin e kompetencave në rrafshin e sigurisë te Policia e Kosovës në vitin 2010, në këtë kontekst dua të nënvizoj krijimin e Drejtorisë së Antiterrorizmit.

Policia “ka të drejtë t’i ndalojë personat dhe të mbledhë informacione të rëndësishme për Procedurën Penale”<sup>26</sup>, lidhur me pjesëmarrjen në organizata terroriste, nxitje dhe financim të terrorizmit.

Policia e Kosovës duke u bazuar në normat juridike në vendin tonë si dhe sipas Strategjisë Nacionale Kundër Terrorizmit, Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe planit të veprimit, i cili buron nga kjo strategji monitoron çdo aktivitet të personave fizikë dhe juridikë për të cilën siguron informata se mund të paraqesë rrezik për rendin kushtetues tani dhe në të ardhmen apo mund të kryejnë ndonjë veprë penale, e gjithë kjo bëhet me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të ndonjë veprë penale të mundshme<sup>27</sup>.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohet PK-ja, është “një institucion i njohur” shumë mirë i trajnuar dhe ka kapacitet për të ndaluar dhe luftuar terrorizmin, krimin e organizuar duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera në vend dhe me ato ndërkombëtare, kërkohet të rritet bashkëpunimi dhe komunikimi në ndarje të informacioneve<sup>28</sup>.

Drejt realizimit të misionit si organe për zbatimin e ligjit, institucionet përkatëse obligohen që veprimet e tyre t’i kryejnë në harmoni me legjislacionin përkatës, “duke mos i shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale”<sup>29</sup>.

Kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm islamik është rritur ngadalë në Kosovë, që nga konflikti i vitit 1999, i ndihmuar pjesërisht përmes financimit nga organizatat e huaja që predikojnë ideologji ekstremiste. Rreth 250-300 luftëtarë të huaj terroristë nga Kosova kanë

<sup>23</sup> Vendim nr. 1140, - Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit, Qeveria e Shqipërisë, 2008.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\_kunder\_Terrorizmit\_2012-2017.pdf

<sup>26</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr:37/28 dhjetor 2012, Prishtinë, Kodi i Procedurës Penale

<sup>27</sup> www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia.21.

<sup>28</sup> Fitim Shishani: Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, botimi i vitit 2006, Prishtinë, f. 8.

<sup>29</sup> mpb-ks.org/?page=1,46,333.

udhëtuar në Siri dhe Irak për të luftuar për Shtetin Islamik të Irakut dhe Levantit (ISIL) ose Frontin al-Nusrah, prej të cilëve rreth 50 janë vrarë<sup>30</sup>. Qeveria e Kosovës miratoi strategjinë gjithëpërfshirëse dhe planin e veprimit për luftim të ekstremizmit të dhunshëm. Qeveria e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin kundër terrorizmit me Shtetet e Bashkuara.

Shtetet e Bashkuara kanë mentoruar dhe ndihmuar institucionet për zbatimin e ligjit dhe institucionet gjyqësore në raste aktive kundër terrorizmit. Nëpërmjet programit për kontroll të eksportit dhe siguri kufitare, programit ndërkombëtar për ndihmë dhe trajnim në hetime penale (ICITAP), Programit për zhvillim, ndihmë dhe trajnim prokurorial jashtë vendit (OPDAT) dhe zyrës për bashkëpunim në çështje të mbrojtjes (ODC), Shtetet e Bashkuara kanë ofruar mundësi trajnimi në aspekte të ndryshme kundërterrorizmi. Kosova ka një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që i mbulon të gjitha aspektet kriminale që lidhen me terrorizmin.

Kodi Penal i Kosovës ndjek modelin e OKB-së për legjislacionin penal kundër terrorizmit dhe i kriminalizon të gjitha format e terrorizmit, përfshirë kryerjen, ndihmën, lehtësimin, rekrutimin, trajnimin dhe shtytjen për të kryer vepra terroriste. Ai gjithashtu kriminalizon fshehjen ose moslajmërimin e terroristëve ose grupeve terroriste, organizimin dhe pjesëmarrjen në grupe terroriste dhe përgatitjen e veprave terroriste kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së shtetit të Kosovës. Ai e përkufizon një grup terrorist si një grup të strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit.

Përveç kësaj, Kodi i Procedurës Penale ua ofron autoriteteve të gjitha kompetencat e nevojshme për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e tilla, përfshirë mundësinë për të përdorur masa të fshehta si përgjimi, agjentët e fshehtë, zbulimi i të dhënave financiare dhe përgjimi i komunikimeve kompjuterike<sup>31</sup>. Ligji nr. 03/1-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë në mënyrë efektive, ky ligj themelon edhe *Njësinë për Inteligjencë Financiare*, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), si institucionin qendror të pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpëlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit<sup>32</sup>.

## 4. Përfundime

*Prej këtij hulumtimi shkencor kemi nxjerrë këto përfundime:*

- Terrorizmi është bërë vërtet një kërcënim global, që kërkon një përgjigje globale dhe parandaluese. Kjo duhet të përfshijë një strategji të gjerë iniciativash afatshkurtra dhe afatgjata, duke filluar nga trajtimi i kushteve themelore, që favorizojnë përhapjen e terrorizmit në ndërtimin e kapaciteteve shtetërore, për të parandaluar dhe luftuar atë.

- Në masën që aktivitetet kundër terrorizmit bazohen në një proces efikas të drejtësisë penale, që respekton parimet e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, ato mund të ofrojnë një përgjigje paqësore, të përgjegjshme dhe legjitime ndaj terrorizmit.

- Masat antiterrorizëm, mund të vlerësohen edhe brenda kontestit të parandalimit,

<sup>30</sup> Raporti i Departamenti Amerikan i Shtetit mbi terrorizmin, 2 qershor, 2016, pjesa për Kosovën, f. 1.

<sup>31</sup> DASH, Mbi terrorizmin, 2016, pjesa për Kosovën, f. 4.

<sup>32</sup> Ligji nr. 03/1-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, 2010, Prishtinë.

kundërpërgjigjes ndaj sulmeve, bashkëpunimit ushtarak dhe efekteve të masave të sigurisë mbi liritë dhe të drejtat civile.

- Në këtë punim, kemi pasqyruar edhe vështirësitë e luftimit të terrorizmit, të cilat janë të ndryshme, por edhe të varura nga mënyrat e kryerjes së akteve terroriste, mjetet dhe armët e përdorura për kryerjen e terrorizmit, si dhe nga vendi dhe territori ku aktet terroriste kryhen.

- Zbulimin dhe parandalimin e akteve terroriste që kanë pasoja të përmasave të gjera, e vështirëson edhe mungesa e pajisjeve tekniko-teknologjike, elektronike dhe bërthamore të shtetit, i cili duhet t'i kundërvihet terrorizmit.

- BE-ja, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, kërcënohet edhe nga grupet ekstremiste apo organizatat e ndryshme terroriste ndërkombëtare, të cilat mund të kenë si cak prezencën e madhe ndërkombëtare në Kosovë dhe Shqipëri, për shkak të angazhimit të tyre në luftën globale kundër terrorizmit.

- Sulmet terroriste në superfuqinë botërore, më 11 shtator 2001, kanë treguar se fuqia ekonomike, politike dhe ushtarake nuk është garanci për sigurinë - as për shtetin më të fuqishëm në botë. Nga ky sulm, ka ndryshuar edhe vetë natyra e luftës. Lufta sot, paraqet konfliktin asimetrik të dhunës, i cili radhitet në luftërat e gjeneratës së katërt.

- Asnjë shtet më nuk mund t'u garantojë qytetarëve të vet se mund t'i mbrojtë të gjithë në çdo vend dhe në çdo kohë. Mjetet ushtarake dhe taktikat e luftimit ndërmjet shteteve, nuk e kanë më të njëjtin rol.

- Sistemi ekzistues juridik ndërkombëtar dhe sistemi i sigurisë, gjithashtu nuk mund t'i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme një kërcënimi të këtellë.

- Natyra e ndryshuar e kërcënimit kërkon edhe përgjigje tjetër. Reforma e institucioneve ndërkombëtare paraqet një proces, i cili kërkon kohë dhe pajtueshmëri politike të aktorëve udhëheqës botërorë. Terrorizmi kërkon përgjigje urgjente.

- Prandaj, strategjitë e ngritura për luftimin e terrorizmit në BE, Shqipëri dhe Kosovë, mund të nxjerrim si përfundim se, duhet të jenë të avancuara dhe profesionale, duke u harmonizuar gjithmonë dhe të përkrahura nga SHBA-ja.

## Literatura

1. Alan Collins, *Studime bashkëkohore të sigurisë*, (përkthim Enri Hide), Tiranë, 2010.
2. European Union Consolidated versions of the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community, fq. 12.
3. Eduard Bala, "Financimi i Terrorizmit rast studimor Shqipëri" (disertacion) Tiranë, 2013
4. Fitim Shishani: Roli i Policisë në Parandalimin e Kriminalitetit, botimi i vitit 2006, Prishtinë
5. Freedom and fear are at war, National strategy for Combating Terrorism, fq. 29.
6. Handbook on Criminal Justice Responses to Terrorism, UNITED NATIONS OFFICE ON DRUGS AND CRIME. New York, 2009
7. Kodi Penal, 2012, Prishtinë
8. Kodi i Procedurës Penale, 2012, Prishtinë
9. Kodi Penal i Shqipërisë, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, janar 2016
10. Ligji nr. 03/l-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, 2010, Prishtinë
11. Ligji Nr. 9086, datë 19.6.2003 "Financimi i terrorizmit" Tiranë
12. Strategjia kundër Terrorizmit 2012-2017 Kosovë pdf
13. Marisa Linton, "The Terror in the French Revolution". Kingston University. [http://www.port.ac.uk/special/france1815to2003chapter1\\_20545.en.pdf](http://www.port.ac.uk/special/france1815to2003chapter1_20545.en.pdf)
14. Michael T. McCaul, A NATIONAL STRATEGY TO WIN THE WAR AGAINST ISLAMIST TERROR, 2016, USA, fq.14
15. Raporti i Departamenti Amerikan i Shtetit mbi terrorizmin, 2016, pjesa për Kosovën
16. USA, NATIONAL SECURITY STRATEGY, Washington, 2015, fq.4
17. vendim nr.1140, - strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit, Qeveria e Shqipërisë, 2008
17. [www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia)
18. Yonah Alexander, Combating Terrorism, Strategies of ten countries, University of Michigan 2002
19. Xhavit Shala, *Ballkani, Gjeopolitika dhe siguria II*, Tiranë, 2009.

# Pajisjet eksplozive të improvizuara (PEI), në praktikën kriminalistike të policisë shkencore

— MSc. Dritan ZOTO  
Instituti i Policisë Shkencore  
dritan.zoto@asp.gov.al

---

## Abstrakt

*Njohja nga ana e specialistëve kriminalistë, oficerëve të policisë gjyqësore të pajisjeve eksplozive të improvizuara (PEI), si ndërtimi dhe pjesët përbërëse të tyre, apo mënyrat e inicimit të lëndës eksplozive, i ndihmon dhe i orienton në këqyrjen e vendit të ngjarjes, si pjesë e grupit hetimor. Rëndësia e sigurimit të perimetrit të vendit të ngjarjes dhe e këqyrjes së tij, në rastet e përdorimit të lëndëve eksplozive, të një territori relativisht të madh për gjetjen e pjesëve, përcjellësve (tel/at) dhe elementëve të tjerë përbërës, të një PEI, të shpërndara nga presioni i shpërthimit, për të përcaktuar në mënyrë sa më shkencore mekanizmin e ngjarjes; ekzaminimet laboratorike që u bëhen pjesëve apo elementëve të tjerë përbërës të një PEI, të gjetura në vendin e ngjarjes, për zbulimin e gjurmëve daktiloskopike, gjurmëve biologjike (ADN) apo edhe thirrjeve telefonike të një karte SIM, - ndihmojnë, që të gjitha organin procedues, në dokumentimin dhe zbulimin e autorit të veprës penale. Në këtë punim, janë trajtuar disa njohuri të përgjithshme mbi “pajisjet eksplozive të improvizuara” (PEI) të ndeshura në praktikën kriminalistike të policisë shkencore.*

## Fjalëkyçe:

**pajisje të improvizuara, PEI, burimi i energjisë, çelës, përcjellës, radio, aparat telefonic celular, sinjal, frekuencë.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »



## 1. Hyrje

Në ngjarjet e rënda kriminale me përdorim lëndësh eksplozive, të vendosura zakonisht në automjete, por edhe në objekte të ndryshme, kërkohet një menaxhim sa më i mirë i këqyrjes së vendit të ngjarjes, në lidhje me kërkimin, zbulimin dhe mbledhjen e provave materiale pas shpërthimeve. Vendngjarjet në rastet e shpërthimeve të lëndëve eksplozive, kanë një dinamike dhe mekanizëm të ndryshëm nga vendngjarjet e tjera, pasi pasojat e shpërthimit të lëndës eksplozive, ndjekin disa etapa, si: copëzimi, presioni i shpërthimit dhe çlirimi i nxehtësisë. Copëzat e nxehura, si pasojë e presionit të shpërthimit dhe fragmentimit, mund të shkaktojnë edhe zjarre në distancë të largët nga vendi i shpërthimit. Si rezultat i presionit të shpërthimit, pjesët e fragmentuara, mund të jenë pjesë të sistemit ndezës, kapsollës elektrike, por mund të jenë dhe objekte të tjera si, pjesë makinash, xhama dritaresh etj. Gjatë një shpërthimi, si rezultat i presionit dhe valëve shpërthyesë copat e xhamit, mund të shtyhen në një distancë deri në 100 m, ndërsa pjesë apo objekte të tjera, deri në 1200 m.

Praktika ka treguar se, në ato raste kur është treguar kujdes në sigurimin e perimetrit dhe ruajtjes së vendit të ngjarjes nga patrullat e policisë, të cilat mbërrijnë të parat në vendin e ngjarjes, janë arritur të sigurohen prova materiale të cilat pas ekzaminimeve kriminalistike në Institutin e Policisë Shkencore, kanë çuar në zbulimin e autorit të veprës penale.

## 2. Përgatitja e pajisjeve eksplozive të improvizuara (PEI)

Pajisjet eksplozive të improvizuara, nuk janë prodhime industriale civile apo

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

ushtarake, por projektohen dhe përgatiten nga njerëz që kanë njohuri teknike, aftësi si dhe materialet e nevojshme për krijimin e tyre. Një pajisje eksplozive e improvizuar, përbëhet nga dy elementë kryesorë të cilët janë, *ngarkesa eksplozive* dhe *sistemi ndezës*.

### 2.1 Ngarkesa eksplozive e një PEI-je

- Nga eksplozivë për përdorime civile.

Këto lloj eksplozivësh, përdoren për qëllime civile si, në miniera, për nxjerrje gurësh në gurorë, në hapjen e rrugëve të reja apo zgjerimin e tyre, hapjen e tuneleve etj., dhe me i zakonshëm është dinamiti. Duke qenë se kanë një përdorim të gjerë në përdorimet civile dhe lehtësia në gjetjen e këtij lloj eksplozivi, favorizon përdorimin e tij edhe për kryerjen e akteve kriminale dhe terroriste<sup>1</sup>.

- Nga eksplozivë ushtarake.

Këto lloj eksplozivësh, përdoren për qëllime ushtarake dhe hasen në formë kallëpesh si, Trinitrotoluene (TNT) me peshë të ndryshme që variojnë 200 gr., 400 gr. e 1000 gr.; C-4 (*eksploziv plastik*), i cili është i përpunueshëm dhe merr forma të ndryshme, si dhe eksplozivi me të cilin janë të mbushura armatimet ushtarake.




Fig. 1. Trinitrotoluene (TNT) me peshë 200 gr.

Nga praktika kriminalistike e vendit tonë, janë ndeshur raste të përdorimit edhe të armatimeve ushtarake si, granata dore copëzuese, mina këmbësorie apo antitank, si ngarkesa eksplozive të lidhura me detonatorin<sup>2</sup>.




Fig. 2. Minë antitank e përdorur si ngarkesë eksplozive e lidhur me detonatorin dhe celular.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Servizio Polizia Scientifica, *Gli Esplosivi*, 1992.

<sup>2</sup> Terrorist Weapons & Explosive Devices.

<sup>3</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Krujë dhe IPSH, 2016.

<sup>4</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Shkodër dhe IPSH, 2015.

- Nga *eksplozivë artizanalë*, më të zakonshmit janë përzierje të plehut të nitrat amonit me naftë ose siç njihet nga ana teknike “ANFO”.

## 2.2 Sistemi ndezës, i një PEI-je

- *Elektrik*, i cili përbëhet nga burimi i energjisë (*bateria*), çelësi (*radio, telefon celularë, orë, kronometër etj*), përcjellësi (*teli/at*) dhe ngarkesa (*kapsolla, eksploziv*).




Fig. 3. Skema e thjeshtë e sistemit ndezës elektrik të një PEI.

- *Jo elektrik*, i cili realizohet me anë të fitilit zjarrpërcjellës (*me djegie*), shtypje (*eksplozivi parësor me ndjeshmëri të lartë*) dhe kimik (*përzierje kimikatesh që shpërthejnë kur bien në kontakt me njëra-tjetrën*).

Nga praktika kriminalistike e vendit tonë, janë konstatuar në shumë ngjarje me lëndë eksplozive, ku janë përdorur pajisjeve eksplozive të improvizuara (*PEI*). Si burim të energjisë në sistemin ndezës të një PIE, zakonisht janë përdorur bateri me tension 9 V (*volt*) të tipit standard, ndërsa si çelës është përdorur aktivizimi në distancë, duke u vënë në punë me anë të valëve të radiove komunikuese me njëra tjetrën, aparateve telefonike celular apo sistemeve të hapjes së dyerve të garazheve.

Çdo pajisje elektronike që mund t'i përgjigjet një sinjali elektromagnetik, mund të përdoret për të aktivizuar (*ndezur*) në distancë një pajisje eksplozive të improvizuar.



Fig. 4. Pajisje aktivizimi në distancë, duke shfrytëzuar sisteme të hapjes së dyerve të garazheve.<sup>4</sup>

*Aktivizimi në distancë i një PIE me anë të:*

a. *Radiove komunikuese*, realizohet nëpërmjet valëve elektromagnetike që transmetohen nga dhënësi (*transmetuesi*) në një frekuencë (MHz) të caktuar në formë sinjali, i cili kapet nga antena e radiomarrësit.

Sinjali i kapur nga antena e radiomarrësit i cili është i lidhur me PEI me aktivizim në distancë, pas marrjes së sinjalit, vepron si çelës ndezës dhe lejon burimin e energjisë të ndezë pajisjen dhe të shpërthejë lëndën eksplozive.




Fig. 5. Radio komunikuese e adaptuar si çelës.<sup>5</sup>

b. *Aparateve telefonike celulare*, realizohet duke kryer modifikime të jashtme të aparatit të telefonit celular. Sinjali elektrik i cili dërgohet te altoparlanti ose motori i vibratorit (*dridhjet*), pas modifikimeve të bëra dërgohet tek detonatori/kapsolla duke shkaktuar ndezjen e tij.

Modifikimet që u bëhen aparateve telefonike celulare, konsistojnë në:

- Lidhjen e përcjellësve (*telave*) me detonatorin/kapsollën, në pikat e kontaktit të altoparlantit (*pasi është hequr*) dhe sinjali elektrik i cili krijon zërin në altoparlant, dërgohet tek detonatori/kapsolla.

- Lidhjen e përcjellësve (*telave*) me detonatorin/kapsollën, në pikat e kontaktit të sistemit të motorit të vibratorit (*dridhjeve*) dhe sinjali elektrik i cili krijon dridhje, dërgohet tek detonatori/kapsolla.




Fig. 6. Aparat telefonik celular i modifikuar për marrjen e sinjalit elektrik nga motori i vibratorit (*dridhjet*).<sup>6</sup>

Nëse energjia elektrike që del nga bateria e aparatit telefonik celular, nuk gjeneron rrymë elektrike të mjaftueshme, atëherë energjia e baterisë së aparatit telefonik celular, mund të përdoret për të ndezur një çelës që aktivizohet nga *energjia me relë*. Kur

<sup>5</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tropojë dhe IPSH, 1998.

<sup>6</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Vlorë dhe IPSH, 2016.

aplikohet energjia në ushqyes, *relëja* vihet në veprim dhe mundëson një rrymë të ndryshuar (18 VDC) ose me SCR (*ridrejtues rrymë me silic*) për të ndezur detonatorin/kapsollën.

Aparati telefonik celular, i jep ridrejtuesit të rrymës (SCR) voltazhin e duhur për të nisur një sinjal dhe vetë SRC-ja, lejon kalimin e rrymës elektrike nga një bateri e jashtme, tek detonatori/kapsolla. SRC-ja në vetvete është një çelës me pozicion fiks, që ndizet nga energjia që del nga bateria e aparatit telefonik celular.




**Fig. 7. Adaptimi i një SRC-je, e cila lejon kalimin e rrymës elektrike nga dy bateri të jashtme tek detonatori. (1. SRC, 2. Bateria e jashtme 2x9Volt, 3. Fish lidhëse e celularit, 4. Telat lidhës të detonatorit).<sup>7</sup>**

Përdorimi i aparateve telefonikë celularë, të lidhur me PEI me aktivizim në distancë, ka një avantazh të madh, pasi rrezja e veprimit është e pakufizuar, por praktika kriminalistike e vendit tonë, ka treguar se PEI me aktivizim në distancë nga aparati telefonik celular, kanë dhe një të metë, pasi mund të aktivizohet nga një telefonatë e thirrëse e gabuar dhe siç ka ndodhur, i ka shpërthyer autorit në dorë, pa arritur të realizojë qëllimin e tij<sup>8</sup>.

### 2.3 Detonatorët/kapsollat

Si pjesë përbërëse e sistemit ndezës të një PEI-je, është edhe detonatori/kapsolla elektrike. Detonatori përbëhet nga veshja (*kasa*), e cila mund të jetë prej materiali alumini, bakri ose bronzi, përzierësi piroteknik, i cili vesh majat e dy telave elektrike dhe, nga ngarkesa eksplozive. Ngarkesa është lëndë eksplozive e lartë primare me veti të fuqishme copëtuese (*brizantine*).



**Fig. 8. Detonator/kapsollë elektrike me veshje alumini dhe përzierja piroteknike e një detonatori me veshje bakri<sup>9</sup> (1. Përzierësi piroteknik; 2. Majat e telave të detonatorit; 3. Veshja (kasa) prej materiali bakër)**

<sup>7</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Vlorë dhe IPSH, 2014.

<sup>8</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë, datë 5. 3.2005.

<sup>9</sup> Praktika e Institutit të Policisë Shkencore, 2017.

### 3. Pjesë të tjera përbërëse të një PEI-je

3.1 *Kontejneri (kutia)* ku vendosen lënda eksplozive dhe përbërësit e tjerë të një PEI-je, zakonisht zgjidhen prej materiali plastik të fabrikuar, në formë kutish për përdorime të ndryshme ose, të modifikuara nga vetë prodhuesit e pajisjeve eksplozive të improvizuara.

Përmasat e kontejnerit (*kutisë*) të një PEI, ndryshojnë në vartësi të sasisë dhe llojit të lëndës eksplozive (p.sh. një kallëp TNT 200 g ka përmasa 10x5x2.5 cm, ndërsa C4 merr forma të ndryshme). Kontejnerët plastikë, duke qenë prej materiali relativisht të butë, adaptohen dhe përshtaten më lehtë në vendosjen e lëndës eksplozive brenda tyre, si edhe nxjerrjen/shtrirjen e telave të detonatorit/kapsollës, çelësit/ve, pajisjes SRS (*ridrejtues rryme me silic*) apo ngjitjen e magneteve për fiksimin/ngjitjen e PEI-it në objekte metalike (automjete, etj.).




Fig. 9. Kontejner (kuti) plastike në të cilën është vendosur lënda eksplozive C4 dhe detonatori/kapsolla.<sup>10</sup>  
(1. Kontejneri plastik, 2. Lënda eksplozive C4, 3. Detonatori/Kapsolla)

2.2. *Shiritat ngjitës*, zakonisht përdoren për të izoluar kontaktet e telave të detonatorit/kapsollës me pajisjet e tjera si, baterinë, SRS (*ridrejtues rryme me silic*) ose për ta bërë sa me të fortë, fiksuar, vetë kontejnerin (*kutinë*) apo kontejnerin me sistemin ndezës si radio, celular etj.

Në disa raste, në mungesë të kontejnerit, prodhuesit e pajisjeve eksplozive të improvizuara, shiritat ngjitës i përdorin për të mbështjellë të gjitha pjesët përbërëse të PEI-t, për të qenë sa më të fiksuar dhe të qëndrueshme.



Fig. 10. Mbështjellja e të gjitha pjesëve përbërëse të PEI-t, me shirita ngjitës në mungesë të kontejnerit.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Durrës dhe IPSH, 2015.

<sup>11</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2016.

2.3. *Magneti/ët*, fiksohen me kontejnerin e PEI-t dhe shërbejnë për të bërë ngjitjen, në objekte metalike (*automjete*). Për një ngjitje sa më të mirë të magnetit, nga praktika kriminalistike e vendit tonë është evidentuar se, shfrytëzohen magnetet e marra nga altoparlantët e amplifikatorëve të sinjalit audio të automjeteve.




Fig. 11. Magnete të fiksuara në kontejnerët e PEI (1. Kontejneri, 2. Magnet)<sup>12</sup> dhe altoparlanti të cili i është marrë magneti.<sup>13</sup>

2.4. *Materiale fragmentimi*, të vendosura në një PEI, mund të jenë bulona, dado, sfera çeliku ose qelqi, gozhdë, copa shufrash metalike etj., dhe kanë si qëllim, që përveç shpërthimit të lëndës eksplozive, materialet e fragmentimit, të shkaktojnë dëmtime të rënda apo vdekjen e objektivit. Në të shumtën e rasteve, materiale fragmentimi përdorin vetëvrasësit (*kamikazë*), në jelekët me eksploziv, për kryerjen e akteve terroriste.<sup>14</sup>




Fig. 12. Materiale fragmentimi të futura në një qese plastike (1) si: bulona e vridha të dimensioneve e formave të ndryshme, dado me dimensione të ndryshme si dhe sfera të diametrave e peshave të ndryshme, të mbështjellja me shirita ngjitës (2) në një PEI.<sup>15</sup>

Nga praktika kriminalistike e vendit tonë, janë hasur shumë pak raste të vendosjes së materialit fragmentues së bashku me lëndën eksplozive.

Në një nga rastet e ndeshura, ku lënda eksplozive e PEI-së për shkak të difektimit të saj (*njëra nga kapsollat*) nuk plasi dhe nga ekzaminimi në kushte laboratorike, u evidentua materiali fragmentues, i përbërë nga bulona të përmasave dhe diametrave të ndryshëm: dado për filetime në bulona me diametër të ndryshëm, sfera çeliku me diametër dhe peshë të ndryshme si dhe rondele bulonash me trashësi dhe diametër të ndryshëm.

Në një tjetër rast, nga këqyrja e vendit të ngjarjes pas shpërthimit të lëndës eksplozive

<sup>12</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Durrës dhe IPSH, 2015.

<sup>13</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Shkodër dhe IPSH, 2015.

<sup>14</sup> FBI, Explosive Unit, *Hetimi i pashpërthimit*, 2005.

<sup>15</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2016.

(PEI), u konstatuan materiale fragmentues, në formë segmentesh me gjatësi të variueshme nga 2.5-3 cm, të prera nga shufra metalike të cilat përdoren në ndërtim për krijimin e armaturave. Materiali fragmentues, kishte shkaktuar dëmtime të shumta si në ambientin ku shpërtheu PEI, por edhe në trupin e viktimës.



Fig. 13. Material fragmentimi në formë segmentesh metalike të gjetura në këqyrjen e vendit të ngjarjes pas shpërthimit të PEI.<sup>16</sup>

### 3. Këqyrja e vendit të ngjarjes

*Këqyrja e vendit të ngjarjes*, ka një rëndësi të madhe në rastet e passhpërthimeve të lëndëve eksplozive, pasi nga shpërthimi si rezultat i presionit dhe valëve shpërthyesë, pjesë përbërëse të PEI, apo objekte të tjera, shpërndahen në një rreze deri në 1200 m. Praktika ka treguar se, në ato raste kur është treguar kujdes në sigurimin e perimetrit dhe ruajtjes së vendit të ngjarjes, nga patrullat e policisë të cilat mbërrijnë të parat në vendin e ngjarjes, janë arritur të sigurohen prova materiale, të cilat kanë çuar në zbulimin e autorit të veprës penale.

Aspekti më i rëndësishëm pas shpërthimit të një PEI-je, është *kontrolli i zonës* së vendit të ngjarjes nga njësia antiexplosiv, për pajisje apo objekte të tjera shpërthyesë, që nuk kanë plasur dhe që paraqesin rrezik për jetën. Pas kontrollit të zonës dhe sigurimit të saj se nuk ka pajisje të tjera shpërthyesë, vijon puna për kryerjen e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga organi procedues.

Këqyrja e vendit të ngjarjes pas shpërthimeve, kërkon nga ekspertët kriminalistë, marrjen e masave për moskontaminimin e provave materiale, marrjen e mostrave nga krateri i shpërthimit (*dhë, asfalt*) apo nga objekte të tjera që mbartin gjurmë të mbetjeve të lëndës eksplozive pas shpërthimit, për ekzaminime kimike.



Fig. 14. Marrja e mostrave nga veshjet e ekspertëve që do të marrin pjesë në këqyrjen e vendit të ngjarjes.<sup>17</sup>

<sup>16</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2014.

<sup>17</sup> Trajnim me FBI, EXPLOSIVE UNIT, 2017.



Në gjetjen e pjesëve përbërëse të një PEI-je, në një territor me shtrije të madhe pas shpërthimit, kërkohet kujdes i veçantë nga eksperti kriminalist, pasi nga shumë objekte të shpërndara nga shpërthimi, duhet të marrë si prova materiale, pikërisht ato pjesë/objekte që i përkasin pajisjes eksplozive të improvizuar si, pjesë kontejneri, copa të detonatorit/kapsollës, pjesë celulari, kartë SIM (e padëmtuar ose e dëmtuar), pjesë baterie 9V, çelësa, qarqe elektronike, tela elektrik, shirita ngjitës, material fragmentimi etj.




Fig. 15. Pjesë celularësh dhe çelës qarku të gjetura në vendngjarje të ndryshme të lidhura me PEI.<sup>18</sup>

## 4. Ekzaminimet kriminalistike

Ekzaminimet kriminalistike, që u bëhen pjesëve apo elementëve të tjerë përbërës të një PEI-je me cilësinë e provave materiale, të gjetura në vendin e ngjarjes pas shpërthimeve, ndjekin disa etapa në vartësi të llojit të ekzaminimeve që do t'ju nënshtrohen si më poshtë.

### 4.1. Përpunimi laboratorik i pjesëve të një PEI të gjetura në vendin e ngjarjes, me metoda kimiko-fizike, për zbulimin e gjurmëve papilare.




Fig. 16. Gjurmë papilare e zbuluar me metoda kimike në celularin e një PEI, në vendin e ngjitjes së telave të detonatorit.<sup>19</sup>

Më pas gjurmët papilare të gjetura, pas fotografimit dhe vlerësimit të tyre për numrin e mjaftueshëm të karakteristikave krahasuese, hidhen në sistemin e kompjuterizuar AFIS/APIS, ku bëhet krahasimi automatik me të gjithë databazën e personave të ndaluar e arrestuar me numër unik kriminal.

<sup>18</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2015.

<sup>19</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2015.

#### 4.2. Përpunimi laboratorik i pjesëve të një PEI të gjetura në vendin e ngjarjes, në tamponimin dhe ekzaminimin e tyre për nxjerrjen e profileve të AND-së.

Më pas, profili/et e nxjerra (në rastet kur mund të gjenden), hidhen në sistemin e kompjuterizuar CODIS, ku bëhet krahasimi automatik me të gjithë databazën e profileve të AND-së.

#### 4.3. Ekzaminimi i pjesëve të një PEI

Ekzaminimi i pjesëve të një PEI, si *aparati celular apo karta SIM*, kur ato nuk janë shumë të dëmtuara dhe është mundësia e ekzaminimit të tyre, konsiston në nxjerrjen e informacioneve nga aparati telefonik celular, në lidhje me thirrjet telefonike (*hyrësdalëse*), numër telefoni të ruajtur nëse ka, nxjerrjen e numrit IMEI të aparatit telefonik celular, mesazheve (*SMS*) apo informacioneve të tjera të ruajtura në kartë.




Fig. 17. Kartë SIM e gjetur në vendin e ngjarjes e cila është e pa dëmtuar dhe e përshtatshme për t'u ekzaminuar.<sup>20</sup>

#### 4.4. Ekzaminimet balistike dhe traseologjike, të pjesëve të një PEI të gjetura në vendin e ngjarjes

*Ekzaminimet balistike dhe traseologjike*, të pjesëve të një PEI të gjetura në vendin e ngjarjes, konsistojnë në përcaktimin e mekanizmit/mënyrës së inicimit të PEI-së (*elektrike, joelektrike*), lëndës eksplozive të përdorur (*pjesë municionesh luftarake*) apo pjesëve përbërëse të tij (*detonatori/kapsolla, çelësi/a*), gjurmëve të mjetit prerës të lëna në tela, gjurmëve traseologjike lënë në pjesë të kontejnerit, apo në pjesë të kapsollës, etj.




Fig. 18. Tela të detonatorit dhe pjesë të relësë, të gjetura në vendin e ngjarjes, si dhe pjesë qarku elektronik e sistemit të hapjes së garazheve, të cilat i nënshtrohen ekzaminimeve traseologjike.<sup>21, 22</sup>

<sup>20</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Tiranë dhe IPSH, 2015.

<sup>21</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Krujë dhe IPSH, 2014.

<sup>22</sup> Praktika e Laboratorit të Policisë Shkencore Durrës dhe IPSH, 2014.

#### 4.5. Ekzaminimet kimike, të mostrave të mbetjeve të lëndëve eksplozive pas shpërthimeve

Ekzaminimet kimike, të mostrave të mbetjeve të lëndëve eksplozive pas shpërthimeve, janë analiza që kryen në të gjitha laboratorët e shkencave ligjore sot në botë,<sup>23</sup> me aparaturën GCMS (*gazkromatograf masspektrometer*).

Mostrat e marra nga krateri i shpërthimit apo nga objekte të tjera, në afërsi të vendit të pashpërthimit, me tamponë të posaçëm, u nënshtrohen analiza sasiore në aparaturën GCMS, për përcaktimin e llojit të lëndës eksplozive, komponentëve kimikë përbërës të lëndës eksplozive dhe më pas, krahasimin e tyre me standardet laboratorike.




Fig. 19. Test paraprak për detektimin e llojit të lëndëve eksplozive.<sup>24</sup>

## 5. Përfundime

Në këtë punim të parë, mbi pajisjet eksplozive të improvizuara (PEI) të ndeshura në praktikën kriminalistike të vendit tonë, jepen njohuritë e përgjithshme të cilat ndihmojnë ekspertët kriminalistë, por edhe punonjës të tjerë të policisë në ruajtjen, sigurimin e vendit të ngjarjes pas shpërthimeve si dhe, rritjen e cilësisë së këqyrjes së vendit të ngjarjes.

## 6. Rekomandime

1. Shihet si i domosdoshëm, krijimi i një baze të dhënash në IPSH, në lidhje me përbërësit e pajisjeve eksplozive të improvizuara (PEI) të përdorura në vendin tonë, në bashkëpunim me njësinë antiexploziv të reparitit RENE.A.
2. Katalogimi i pjesëve përbërëse të PEI-it, të gjetura në vendngjarje të ndryshme,

<sup>23</sup> Analisi di Residui di Esplosione e di Incendi, 1992.

<sup>24</sup> Instituti Policisë Shkencore, 2017.

për t'u përdorur për krahasime me pjesë të gjetura në ngjarje të tjera, nëse ka apo jo përputhje të “modus operandit” në ndërtimin e tyre, apo edhe për efekte trajnimi dhe studimi.

## Literatura

1. Servizio Polizia Scientifica, *Gli Esplosivi*, 1992.
2. “Analisi di residui di esplosione e di incendi”, *III Convegno Nazionale Di Criminalistica*, 1992.
3. Hessisches Landeskriminalamt, *Terrorist Weapons & Explosive Devices*, 2000.
4. FBI, Explosive Unit, *Hetimi i passhpërthimit*, 2005.



---

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Akreditimi - e ardhmja e Institutit të Policisë Shkencore shqiptare

— MSc. Xhevair ÇELOALIAJ

Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore

[xhevahir.celoaliaj@asp.gov.al](mailto:xhevahir.celoaliaj@asp.gov.al)

## Abstrakt

Akreditim është procedura në bazë të së cilës një organizëm kombëtar i autorizuar, vlerëson kompetencën e një organizmi të vlerësimit të konformitetit për të kryer detyra specifike të tilla si testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim. Kompetenca është çelësi për të siguruar transparencën, besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ofrojnë Organizmat Vlerësimit të Konformitetit të Akredituara, bazuar në standardet të miratuara ndërkombëtare. Standardet ndërkombëtare ISO/IEC 17025 janë kërkesat e përgjithshme për akreditimin e policisë shkencore, që është e domosdoshme për legjitimitetin e veprimtarisë së saj në procesin e kryerjes së veprimtarisë për ekspertimet e llojeve të ndryshme. Akreditimi është pjesë e infrastrukturës ligjore dhe teknike së cilësia dhe përbën një nga kolonat e tempullit të besueshmërisë së bashku me standardet, metrologjinë, certifikimin dhe menaxhimin e cilësisë. Akreditimi është mjeti më efektiv i tregut dhe një pasaportë për pranimin e shërbimeve nga kontraktohet që kërkojnë organizma vlerësimi konformiteti të pavarur dhe kompetent. Akreditimi shikohet si indikator i besueshëm i kompetencës teknike.

## Fjalëkyçe:

akreditimi, sistemi i menaxhimit, cilësia, kompetenca, kontrolli i aftësive, standarde, testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Në këto tre dekadat e fundit kryerja e ekspertimeve kriminalistike (ose siç quhet ndryshe shërbimi i policisë shkencore, ose ekspertimi ligjor), ka njohur zhvillime shumë të rëndësishme në vendet e Evropës dhe të SHBA-së. Këto zhvillime janë sa i përket zhvillimit e përsosjes së metodave dhe teknikave të reja të përdorur në këtë fushë për identifikimin e personave, objekteve dhe testeve për ngjarjet e ndryshme kriminale (kemi zhvillime të vullshme në identifikimin me anë të profilit të ADN-së, ekspertimin dixhital dhe zhvillimin e kimisë ligjore).

Por zhvillimet më interesante në këtë fushë, i përkasin hartimit të standardeve ndërkombëtare ISO 17025, që garantojnë cilësinë dhe besueshmërinë, si dhe procesit të akreditimit të laboratorëve për këto standarde. Standardet ISO 17025 nuk adresohen në mënyrë specifike për ekspertimin kriminalistik, ose të shkencave ligjore, por mbulojnë të gjithë laboratorët që kryejnë analizime apo kalibrime, duke përfshirë natyrshëm edhe laboratorët që kryejnë ekzaminime kriminalistike.

Qëllimi kryesor i këtyre standardeve ISO, është që të zbatojmë metodologji të njëjtë, që të krijojnë të njëjtin produkt nga e njëjta organizatë ose midis organizatave. Pra, në këtë fushë, produkti (*akti i ekspertimit ose testimi i kryer*), të njihet dhe pranohet me besueshmëri brenda vendit dhe midis vendeve. Pranimi i rezultateve të ekspertimit kriminalistik dhe testeve të kryera midis vendeve, lehtësohen nëse laboratorët veprojnë mbi këto standarde dhe, nëse ato janë akredituar nga organizmat përkatëse kombëtare, të njohura reciprokisht.

Garantimi i cilësisë sipas standardeve ISO, është thelbi i gjithë procesit të akreditimit. Me pak fjalë, akreditimi është një proces që synon të na garantojë të jemi të besueshëm e të barasvlershëm me klientët tanë dhe homologët tanë. Pse është i domosdoshëm dhe

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

nga buron detyrimi për të akredituar institucionet e shkencave ligjore që kryejnë aktivitete laboratorike?

Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar “Vendimin kuadër 2009/905/ JHA” i datës 30.11.2009. Ky vendim titullohet “Për akreditimin e ofruesve të shërbimeve të shkencave ligjore që kryejnë aktivitete laboratorike. Në këtë vendim përcaktohet se “Shtetet anëtare (të BE – së, shënimi ynë), duhet të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të shkencave ligjore që kryejnë veprimtari laboratorike të akreditohen nga një organ akreditues kombëtar, në përputhje me EN/ISO 17025. Miratimi i këtij vendimi është komplementar me traktate, rezoluta e rekomandime të më hershme të organizmave të BE-së, në kuadër të marrëdhënieve ndërkufitare e të luftës kundër kimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, përcaktimit të normave e të sigurisë së cilësisë tregut<sup>1</sup>.

Shqipëria, qysh në fillim vitet ‘90 ka shprehur aspiratën për anëtarësimin në BE. Prej vitesh ajo ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në dhe, është në pritje të çeljes së negociatave për anëtarësim. Një ndër detyrimet që vendi ynë ka për tu anëtarësuar me të drejta të plota, është edhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së. Në kuadër të rekomandimeve që rrjedhin nga Kapitulli 24 i BE-së, *Liria, Siguria dhe Drejtësia*, një nga detyrimet e Policisë së Shtetit është edhe akreditimi i ofruesve të ekspertimeve kriminalistike. Fillesat për nisjen e kësaj rruge të akreditimit të Institutit të Policisë Shkencore Shqiptar, janë në vitin 2013. Nën kujdesin e prezencës së OSBE-së dhe të partnerëve të tjerë strategjik të Policisë së Shtetit, u bënë përpjekjet e para për të ngritur strukturën e menaxhimit të cilësisë që do t’i paraprinte implementimit të standardeve 17025 dhe 9001 etj.

Në këtë prezantim, do të bëjmë një përmbledhje të shkurtër për kuptimin e akreditimit, rëndësinë e tij, fazat nëpër të cilat do të kalojë ky proces sa i vështirë, por edhe jetik për zhvillimin e Institutit të Policisë Shkencore Shqiptare dhe integrimin e tij në organizmat ndërkombëtare si ENFSI<sup>2</sup> etj. Shpresojmë se edhe pjesëmarrja e IPSH-së me punimet e specialistëve të fushave përkatëse në këtë konferencë, veç të tjerave, është një kontribut i rëndësishëm edhe në funksion të këtij procesi të nisur tashmë.

## 2. Vështrim i përgjithshëm mbi akreditimin

Çështjet e cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve, janë bërë thelbësore për njerëzit në të gjithë botën. Një pikë kyçe për garantimin e kompetencës dhe të cilësisë, për ta arritur atë, është akreditimi nga trupa kombëtare akredituese. Procesi i akreditimit në vetvete, është një veprimtari relativisht e re, në funksion e garantimit të cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve. Në vendet anëtare të BE-së është e normuar me Rregulloren EC Nr 765/2008 të Parlamentit Evropian (etj.), ku janë përcaktuar kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Në këtë rregullore, ndër të tjera, është përcaktuar se akreditimi jepet nga një organ kombëtar akreditimi, i cili ka kompetencë ekskluzive për të vlerësuar nëse një laborator, i plotëson kërkesat e pacaktuara nga standardet e harmonizuara ndërkombëtare<sup>3</sup>.

Akreditimi është procedura në bazë të së cilës një organizëm kombëtar i autorizuar,

<sup>1</sup> Neni 4 i Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së, 2009/905/ JHA i 30 nëntorit 2009.

<sup>2</sup> ENFSI – Rrjeti Evropian i Instituteve të Shkencave Ligjore

<sup>3</sup> Neni 4, Rregullore EC-765-2008, “Akreditimi, Mbikëqyrja e Tregut”.



vlërëson kompetencën e një organizmi të vlerësimit të konformitetit për të kryer detyra specifike të tilla si testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim. Kompetenca është çelësi për të siguruar transparencën, besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ofrojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit. Akreditimi është pjesë e infrastrukturës dhe përbën një nga kolonat e tempullit të cilësisë së bashku me standardet, metrologjinë, certifikimin dhe menaxhimin e cilësisë.

Akreditimi është mjeti më efektiv i tregut dhe një pasaportë për pranimin e shërbimeve nga klientët (në kontekstin e veprimtarisë së ekspertimit ligjor janë subjektet e procedimit penal apo civil, personat fizik e juridik) që kërkojnë organizma vlerësimi konformiteti të pavarur dhe kompetent. Akreditimi vlerësohet si një indikator i besueshëm i kompetencës teknike, aftësive e njohurive. Akreditimi është një mekanizëm që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë dhe ndihmon autoritetet, ekonominë dhe shoqërinë, që të gjejnë nëse laboratorët e provave, organizmat e inspektimit, certifikimit (*Organizma të Vlerësimit të konformitetit*) plotësojnë detyrat specifike. Kompetenca e një laboratorit, është treguese e disa elementëve përbërës të aftësive individuale të personelit, të infrastrukturës teknike, strukturës dhe organizimit dhe të menaxhimit të organizatës. Kur flitet për aftësitë personale (individuale) të individit (specialistit) kjo ka të bëjë me këta elementë:



- *Kompetenca personale.*

- Njohuri të thella në një fushë të caktuar të dijës dhe të shkencës. Kështu kemi parasysh aftësimin nëpërmjet specializimeve të posaçme, dhe me një kritere rigoroz vlerësimi.

- Zotërimin e teknikës si domosdoshmëri për të vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë e fituara.

- Eksperienca, është domosdoshmëri në ushtrimin e një veprimtarie konkrete në praktikë. Gjithë dijet, njohuritë dhe aftësitë e fituara nuk janë të mjaftueshme, do të duhet domosdoshmërisht të ushtrohen nëpërmjet një eksperience të vazhdueshme në përmbushje të veprimtarisë konkrete.

- Kualifikimi i vazhdueshëm. Theksojmë se gjithë këto cilësi të përshkruara më lartë, nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë, prandaj është i domosdoshëm, kualifikimi e trajnimi i vazhdueshëm. Në kuadër të standardeve ndërkombëtare ISO, aftësitë e specialistëve duhet të maten periodikisht (*testet e zotësisë*).

- *Infrastruktura teknike.*

- Kjo ka të bëjë me teknikën adekuate për të mundësuar realizmin praktik të veprimtarisë së fushës. Në këtë kuptim, për të realizuar misionin e caktuar në lidhje me testet apo analizat apo kalibrimet, është më se e nevojshme, që të disponohet një tërësi pajisjesh tekniko-shkencore për realizuar një metodë të caktuar (*p.sh., për të bërë përcaktimin e përqindjes së THC-së, në një lëndë të dyshuar si narkotike, do të duhet pajisja GC/MS për materialet bimore etj.*).

- Po ashtu, ka të bëjë me përshkrimin e saktë dhe të qartë të proceduarve teknike. Duhet të përshkruhen dhe të dokumentohen të gjitha hapat që duhet të ndiqen gjatë punës me pajisjet dhe me aparaturat (*p.sh., procedurat e teknike për analizën e ADN-së, ekzaminimin e gjurmëve daktiloskopike, etj., etj.*).

- *Struktura organizative dhe menaxhimi.*

- Në këtë kuptim, duhet që të jetë e shprehur qartë në statutin e organizatës, qartësia e vendimmarrjes së institucionit në lidhje me objektin dhe fushën e veprimit, përcaktimin e detyrave dhe funksionit të specialistëve të fushës etj.

- Paanshmëria dhe paanshmëria. Ky tregues, nënkupton që të orientohesh drejt objektivitetit dhe të qenit larg ndikimeve të strukturave të tjera, që do të vinin në dyshim pa cënueshmërinë e interesave të klientit. Pra, dhënia e produktit (*aktit të ekspertimit me objektivitet dhe pa ndikime apo paragjykime*).

- Menaxhimi i cilësisë, duhet jetë pjesë përbërëse e strukturës së organizatës dhe duhet të përcaktojë mënyrën se si kjo organizatë (*laboratori*), do të përmbushë detyrat në të ardhmen, në lidhje me garantimin e cilësisë së produktit. Kjo ka të bëjë me një sërë masash si, garantimi i zbatimit të proceduarve dhe kontrolli i vazhdueshëm se si realizohen ato. Ka të bëjë me përmirësimin dhe korrigjimin e jokonformiteteteve etj., që do të garantonin qëndrueshmëri të cilësisë së produktit dhe që do ta bëjnë e mbajnë atë, të besueshëm te klienti dhe të barasvlershëm, edhe nëpërmjet shërbimeve apo organizatave homologe.

- Qëllimi i akreditimit është që të përcaktojë kompetencat e organizmave të vlerësimin të konformitetit (*përputhshmërisë*), për përmbushjen e veprimtarisë sipas standardeve ISO.

- *Akreditimi kryet për tre linja:*

- për laboratorët testues kalibrues (*17025, ku përfshihet edhe natyra e punës së Policisë Shkencore*);

- për organizmat certifikuese të produkteve (*ISO 45011; organizmat certifikuese të sistemeve të cilësisë ISO 45012 dhe organizmat e certifikimit të personelit (ISO17024)*);
- për organizmat inspektues (ISO 45004).
- *Përfitimet nga akreditimi:*
  - kompetencë,
  - pavarësi,
  - njohje ndërkombëtare,
  - rritje e profesionalizmit.

### **3. Situata në lidhje me procesin e akreditimit të IPSH-së**

Zyrtarisht, procesi i akreditimit të IPSH-së, nuk ka nisur ende. Me qëllimin e madh për të përmbushur këtë sfidë, janë kryer disa veprimtari që kanë pasur si synim, përgatitjen e terrenit që kjo sfidë të bëhet një objektivi i arritshëm, duke konsistuar në informimin e stafit të IPSH-së për standardet ndërkombëtare ISO 9001 e 17025 si dhe për akreditimin e institutit. Gjithashtu, nën kujdesin e prezencës së OSBE-së në Tiranë, është organizuar një tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe të Institutit të Policisë Shkencore. Qëllimi i kësaj tryeze, ishte sensibilizimi i këtyre strukturave të shtetit për rëndësinë e përfshirjes së IPSH-së në procesin e akreditimit.

Gjatë kësaj periudhe, ka pasur një sërë veprimesh pozitive, që janë kryer në drejtim të përgatitjes për implementimin e standardeve ndërkombëtare ISO 17025 dhe më tej, akreditimi i IPSH-së për këto standarde. Një ndër hapat më pozitiv dhe efektiv është krijimi i funksionit të menaxherit të cilësisë, në organigramën e IPSH-së dhe bërja funksional i këtij shërbimi, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e sistemit të cilësisë dhe garantimit të këtij sistemi. Disa hapa po aq të rëndësishme janë edhe kryerja e investimeve në pajisje tekniko-shkencore, duke bërë modernizimin e disa prej laboratorëve si, te ekzaminimi teknik i dokumenteve, balistikës, kimisë, ekzaminimit kompjuterik dhe daktiloskopisë. Këto investime, përkthehen në metoda të reja dhe bashkëkohore të ekzaminimit.

Sot në Institutin e Policisë Shkencore, funksionojnë 7 laboratorë në të cilët këto ekspertime kriminalistike:

- *Laboratori i biologji ADN-së*, ku kryhen ekzaminime të provave materiale biologjike deri në identifikimin e autorëve të ndryshëm me anë të profilit të ADN-së, etj.
- *Laboratori i vendit të ngjarjes dhe përpunimit të gjurmëve të duarve*, ku realizohet përpunimi kimiko-fizik i objekteve e provave materiale të ngjarjeve të ndryshme kriminale dhe bëhet vlerësimi i gjurmëve papilare, të marra në ngjarjet kriminale, nga ekspertët në drejtoritë vendore.
- *Laboratori i daktiloskopisë*, që merret me ekzaminimet daktiloskopike, administrimin e kartelave të gjurmëve daktiloskopike të ngjarjeve, dhe administrimin e bazës së të dhënave dhe sistemit të gjurmëve të duarve AFIS.
- *Laboratori i balistikës*, ku ekspertohen provat materiale me natyrë balistike, traseologjike, restaurim të numrave të fshirë në metale (armët e zjarrit, apo shasitë e automjeteve).

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

- *Laboratori i ekzaminimeve digjitale*, që merret me zbardhjen e të dhënave nga provat materiale me natyrë digjitale (kompjuterë, celularë, DVR etj).

- *Laboratori i kimisë*, që kryen ekzaminimin e lëndëve të dyshuara narkotike, të eksplozivë, faktorët plotësues të qitjes me armë zjarri etj.

- *Laboratori i ekzaminimit grafik dhe teknik të dokumenteve provë materiale*.

Në këto lloje ekzaminimesh, prej specialistëve përkatës, përdoren po të njëjtat metoda si ato që përdoren prej Rrjetit Evropian të Instituteve ENFSI<sup>4</sup>. Metodatat që ne përdorim nuk janë të validuara (*vlerësuara*) dhe kjo është një mangësi (*jokonformitet për akreditimin*). Kur themi këtë jokonformitet, kemi parasysh që konkluzionet tona janë të bazuara shkencërisht dhe të besueshme, por për tu akredituar, duhet që të kryhet procesi i vlerësimit të metodave të ekzaminimeve përkatëse.

Nga ana e IPSH-së, janë hartuar dhe miratuar procedurat standarde teknike të punës, dhe ka nisur për herë të parë procesi i kalibrimit të pajisjeve nga Instituti i Metrologjisë. Pavarësisht këtyre hapave të hedhur, situata në të cilën ndodhet IPSH-ja, nuk është shumë premtuese për nisjen e procesit të akreditimit. Nga analiza e zhvillimeve të këtij procesi në rajonin e Ballkanit Perëndimor, na rezulton se shumica e vendeve, e kanë nisur këtë proces dhe kanë arritur të kryejnë akreditimet e disa laboratorëve dhe metodave të përdorura sipas standardeve ISO 17025.

Vetëm Instituti Policisë Shkencore Shqiptare, jo vetëm që nuk e ka akreditimin e ndonjë prej laboratorëve apo metodave, por ne ende nuk e kemi nisur si proces (*që nga nisja e masave për të përmbushur gjithë rekomandimet e standardeve ISO, përgatitjeve për akreditimin, aplikimit e deri në marrjen e akreditimit, do të duhen 3-4 vjet*).

Për fat keq, ambientet ku është i akomoduar aktualisht IPSH, jo vetëm që nuk janë të përshtatshme dhe jashtë çdo kriteri të standardeve ISO, por duke qenë se janë të përkohshme, janë një pengesë shumë e madhe për nisjen e procesit të akreditimit, pasi në to nuk mundet të nisët procesi i akreditimit të IPSH-së.

## **4. Faktorët e që e ndihmojnë dhe ata që e frenojnë procesin e akreditimit**

Pavarësisht gjendjes në të cilën ndodhet aktualisht procesi i akreditimit të IPSH-së, ne kemi analizuar dobësitë, mangësitë dhe jokonformitetet kundrejt detyrimeve të standardeve ISO, si dhe kemi identifikuar faktorët që e frenojnë, dhe më kryesorja, se kush janë faktorët që e ndihmojnë procesin e akreditimit. Disa nga këta faktorë që e pengojnë, dhe ata që e favorizojnë, ose që e ndihmojnë procesin e akreditimit, po i rendisim më poshtë:

a) *Faktorët janë frenues për nisjen dhe realizimin e procesit të akreditimit.*

- Ka nevojë për plotësime dhe rregullime të kuadrit ligjor në lidhje me veprimtarinë e IPSH-së. Aktualisht, veprimtaria rregullohet pjesërisht me Kodin Procedurës Penale dhe Civile, VKM nr. 278 datë 2. 6. 2000, "Për Krijimin e Institutit të Policisë Shkencore; Ligji për Policinë e Shtetit 108/2014, i ndryshuar; Rregulloren e Policisë Shkencore të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, si dhe në Procedurat Standarde të Punës.

- Një ndër faktorët më të dukshëm, por edhe më jetësorë është mungesa e një godine të përshtatshme për akomodimin sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare.

<sup>4</sup> ENFSI – Rrjeti Evropian i Instituteve të Shkencave Ligjore.

Ambienti i akomodimit, kushtet e punës së punonjësve e siguria e shëndetit të tyre, kushtet dhe regjimi i punës së pajisje jo vetëm që janë kërkesa të domosdoshme, të standardeve ISO 17025, por janë ndër aktivitetet e para që organi akreditues verifikon (*qysh në vizitën e parë para vlerësues organi akreditues verifikon konformitetin e godinës dhe kushteve të punës*)<sup>5</sup>.

- Nuk është kryer implementimi i plotë dhe i sistemuar i kërkesave të standardeve ndërkombëtare ISO 17025. Kryesisht nuk është bërë përcaktimi dhe hartimi i politikës së cilësisë dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit administrativ dhe të cilësisë, pikërisht sipas kërkesave të këtyre standardeve.

- Kapacitetet aktuale që ka instituti, aktualisht janë të kufizuara (teknikat, proceset dhe fondet ose burimet e financimit për këtë proces).

- Në lidhje me trajnimet e vazhdueshme, ka një vakum shumë të madh dhe kryesisht trajnimet dhe kontaktet e ekspertëve të IPSH-s ëme homologët e vendeve të BE-së, ose të vendeve të rajonit, të akredituara, janë në nivele minimale.

- Instituti nuk është njësi shpenzuese më vete dhe ka nevojë urgjente për një sektor mbështetjes logjistike. Procedurat e prokurimeve, në këtë mënyrë për IPSH-në, bëhen shumë konfuze dhe jo efektive, përveç që janë të pamjaftueshme. Kjo është një pengesë serioze dhe është në kundërshtim me kërkesat e standardeve ISO 17025.

- Nuk është gjetur e përcaktuar ende një mentor i cili do të udhëheqë IPSH-në drejt plotësimin të kërkesave të akreditimit. Këtu shtohet mungesa e fondeve për të mundësuar këtë aktivitet më se të nevojshëm.

#### *b) Faktorët që favorizojnë procesin e akreditimit të IPSH-së.*

Në analizën tonë ne nuk duam ti shohim gjërat vetëm bardhë e zi. Kjo do të çonte në mungesë të objektivitetit dhe do të binim në pesimizëm. Analiza jonë synon që të jetë sa më objektive e shkencore me qëllim që pasi të identifikojmë si faktorët favorizues edhe ata frenues, të bëjmë të mundur përcaktimin e qartë të rrugës për nisjen e procesit të akreditimit nga ana e organeve të vendimmarrjes.

#### *Ndër këta faktorë favorizues të procesit të akreditimit po rendisim:*

- Në rrugën për tu anëtarësuar me të drejta të plota në BE, një ndër detyrimet që vendi ynë ka, është edhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së. Në kuadër rekomandimeve që rrjedhin nga Kapitulli 24 i BE-së, *Liria, Siguria dhe Drejtësia*, një nga detyrimet e Policisë së Shtetit është edhe akreditimi i ofruesve të ekspertimeve kriminalistike. Ky detyrim është një ndër faktorët më të rëndësishëm, në favor të nisjes dhe realizimit të procesit të akreditimit.

- Aderimi i Shqipërisë në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunimin ndërkufitar të vendeve të BE-së, në funksion të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe krimeve të rënda etj. Këtu do të rendisim marrëveshjen e Prüm-it (*Gjermani*) dhe PCC-SEE, ku vendi ynë ka detyrime konkrete.

- Përfshirja e dy sektorëve në testet e zotësisë (*nëpërmjet UNODC për sektorin e kimisë dhe finalizimi për herë të parë i testeve të zotësisë për sektorin e ADN-së, nëpërmjet GEDNAP*). Këto teste zotësie, kur kalohen me sukses, janë një dëshmi e rëndësishme e vlefshmërisë së përdorur prej laboratorit konkret.

- Implementimi dhe funksionimi i pozicionit të *menaxherit të cilësisë* në IPSH. Po bëhen rreth dy vjet, që jo vetëm është çelur funksioni organik i *menaxherit të cilësisë*,

<sup>5</sup> Ligji dhe rregullorja e akreditimit.

por ai po bëhet përherë e më funksional në përmbushje të detyrave e kërkesave që rrjedhin prej standardeve ISO 17025.

- Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të punës (PSO) për çdo laborator dhe çdo metodë të përdorur prej tyre. Në gjysmën e parë të vitit 2017, për herë të parë u përmbush një ndër detyrimet apo rekomandimet kryesore të standardit ISO 17025 që është, hartimi dhe miratimi i PSO<sup>6</sup>.

- Ndërgjegjësimi i stafit mbi nevojën dhe domosdoshmërinë e implementimit të standardit ISO 17025 dhe të akreditimit të laboratorëve të IPSH-së. Tashmë, te stafi i IPSH-së, klima është në favor të përfshirjes së IPSH-së në këto procese transformues e integruese.

- Një faktor tepër i rëndësishëm dhe që ndikon pozitivisht në rrugën drejt nisjes së procesit të akreditimit, është edhe parashikimi që është në bërë në Planin e Veprimit afatgjatë për zbatimin strategjisë së Rendit Publik për periudhën 2013-2020. Në këtë plan, është përcaktuar si objektiv i Policisë Shkencore, si pjesë e Policisë së Shtetit, akreditimi i IPSH-së dhe anëtarësimi në Rrjetin Evropian ENFSI<sup>7</sup>. Ky plan veprimi, hartuar dhe miratuar në zbatim e VKM-së nr. 663 datë 17. 7. 2013, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit 2001-2020".

## 5. Rruga drejt akreditimit të IPSH-së

Procesi i akreditimit në vetvete, nuk është një veprimtari shumë e komplikuar. Përkundrazi, rruga për të shkuar deri në momentin e aplikimit për akreditim është shumë e vështirë. Për të përgatitur laboratorin për akreditim duhet të ndërmerren një sërë masash tekniko-organizative dhe të shoqërohen me vendime të organeve vendimmarrëse, kërkimin dhe sigurimin e fondeve të konsiderueshme (*por jo të pa përballueshme!*) etj.

Nga momenti i nisjes së veprimeve për akreditim, implementimin e standardeve ndërkombëtare ISO 17025, aplikimin dhe përmbylljen e procesit deri në marrjen e certifikatës së akreditimit, kërkohet një kohë jo më pak se 3-4 vjet.

Përpara se të përshkruajmë hapat që hidhen dhe veprimet kryen për realizimin e procesit të akreditimit, do të përpiqemi të sqarojmë disa pyetje:

Si do të akreditohet Instituti i Policisë Shkencore (*organizëm që kërkon vlerësimin e konformitetit*)? A mund të akreditohet ai, si një trup i vetëm, për tërë laboratorët? A do të akreditohet vetëm një laborator për të gjitha metodat që ai kryen, apo do të akreditohet ky laborator vetëm për njërën prej metodave?

Siç e kemi thënë edhe më sipër në këtë material, fusha e veprimtarisë së instituteve të ekspertimeve ligjore, përfshihet ose mbulohet nga standardi ISO 17025 dhe akreditimi do të bëhet pikërisht për konformitetin e standardit ISO 17025.

Nga rekomandimet dhe përvoja e vendeve që e kanë realizuar akreditimin e instituteve të tyre, rezulton se nuk është e mundur që një institut të mundet të akreditojë të gjithë laboratorët e tij për të gjitha metodat që përdor çdo laborator. Në kushte tepër ideale, kjo edhe mund të ndodhë, por vetëm në kushte ideale. Po si ndodh, në fakt?

<sup>6</sup> Standardi Shqiptar EN ISO/IEC 17025:2005, 4.2.5

<sup>7</sup> Planin e Veprimit afatgjatë për zbatimin strategjisë së Rendit Publik për periudhën 2013-2020, pika III. 3.2 Objektiv: Rritja e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, terrorizmit e korrupsionit.

Për akreditimin, në përgjithësi, institutet e policisë shkencore nisin fillimisht me laboratorët e biologjisë, kimisë ligjore e me radhë. Kjo, për arsye se në këto laboratorë zhvillohen metoda të mirëfillta shkencore dhe të larmishme. Por, edhe për këta laboratorë, në përgjithësi, nuk është e mundur që qysh me hapin e parë të kërkesës për akreditim, të realizojnë të gjitha metodat që përdorin.

Pra, është e rëndësishme, që procesi i akreditimit të nisë qoftë edhe me një laborator. Por këtu, do të kemi parasysh se vetëm një laborator specifik, nuk do të mund të vlerësohet i veçuar nga pjesa tjetër e institutit, por si pjesë përbërëse e tij. Kjo përbën edhe filozofinë bazë të garantimit të cilësisë.

Laboratori përkatës, do të jetë patjetër pjesë e një “ambienti ISO 17025” dhe instituti patjetër do të duhet të përmbushë një varg kriteresh nga standardi ISO 17025.

Pra me pak fjalë, organizata ose laboratori (në rastin tonë instituti) që synon për të realizuar akreditimin, më parë i duhet të bëjë një punë shumë të madhe për implementimin e kërkesave të standardit ISO 17025.

Pasi e ndien se laboratori i ka implementuar dhe ngritur sistemet e rekomanduara në standardet ndërkombëtare ISO, i drejtohet Organizmit Kombëtar për Akreditim<sup>8</sup>.

### **5.1 Organizmi kombëtar (shqiptar) i akreditimit**

Autoriteti i vetëm kombëtar shqiptar i akreditimit është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA). Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), është autoritet publik që vepron si shërbimi kombëtar i akreditimit në Republikën e Shqipërisë. Veprimtaria e këtij enti ka të bëjë me garantimin e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve si dhe besimin në atë se si kjo është vlerësuar.

### **5.2 Si mund të akreditohej?**

Më poshtë po rendisim hapat që do të ndjekë një organizëm që kërkon vlerësimin e konformitetit (OKV), siç është parashikuar në procedurat e punës së DPA.

#### **1- Kërkesa për njohjen e procedurës**

Organizmat e vlerësimit të konformitetit (*OVK – laboratorë testues/kalibrues, organizma certifikues/inspektues*) bëjnë kërkesë pranë DPA-s, të cilën e dërgon me faks ose letër, për tu njohur me procedurat e akreditimit dhe dokumentet përkatës për të qenë i akredituar. Pas bërjes së kërkesës, OVK-së i caktohet një takim paraprak, i cili zhvillohet nga sekretariati i DPA-së, në të cilin i sqarohen të gjitha procedurat e akreditimit, tarifat si dhe dokumentet që ai duhet të dorëzojë pranë DPA-së për aplikim. Në këtë takim, përfaqësuesit të OVK-së i jepet paketa e dokumentacionit, të cilën ai mund ta tërheqë edhe nëpërmjet faqes së internetit të DPA.

#### **2- Aplikimi për akreditim**

OVK do të quhet që ka aplikuar për akreditim pasi ka plotësuar formularin e kërkesës për akreditim sipas OVK, “check”-listën përkatëse, dhe ka dorëzuar pranë DPA të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e standardit (ISO) për të cilin ai kërkon të akreditohet.

Nëse ka moskonformitete të rënda që cenojnë akreditimin, dhe kur dokumentet e dorëzuara nga OVK nuk përputhen me standardin për të cilin do të akreditohet, i

<sup>8</sup> Rregullorja EC Nr 765/2008 të Parlamentit Evropian.

kërkohet OVK t'i plotësojë të gjitha këto mangësi dhe t'i dorëzojë sërish pranë DPA . Nëse ka moskonformitete, që nuk e cenojnë akreditimin, procedura e akreditimit vazhdon.

DPA i dërgon OVK-së, koston paraprake. Nëse OVK është dakord me koston atëherë nënshkruhet marrëveshja midis DPA-së dhe OVK-së. N qoft se OVK-ja nuk është dakord, procedura ndërpritet. Afati për aprovimin ose jo të koston, është 2 muaj. Pas këtij afati, nëse OVK-ja kërkon përsëri të akreditohet, procedura fillon nga e para. Nëse OVK-ja është dakord me koston paraprake, atëherë ai duhet të paguajë 40% të saj, që në këtë fazë.

### *3- Paravlerësimi*

Vizita para vlerësuese kryhet në ambientet e OVK-së. Nëse nga kjo vizitë identifikohen jokonformitete të rëndësishme, i lihen OVK-së që të ndërmarrë veprime korrigjuese në lidhje me to dhe me jokonformitetet e gjetura në dokumentacion. Jokonformitetet i raportohen me shkrim, në një raport paravlerësimi. Pas kryerjes së veprimeve korrigjuese, OVK-ja lajmëron DPA-në me shkrim, për plotësimin e veprimeve korrigjuese dhe për gatishmërinë e pritjes së vizitës vlerësuese.

### *4- Vizita vlerësuese*

Qëllimi i vizitës vlerësuese është që të verifikojë nëse OVK-ja plotëson kërkesat e standardit për të cilin kërkon të akreditohet, verifikimin e zbatimit të procedurave dhe të vlerësojë kompetencën teknike.

### *5-Raporti i vlerësimit*

Rezultatet e vlerësimit, jepen në një raport të grupit të vlerësimit, i cili i sugjeron DPA-s të japë ose jo akreditimin, apo ta pezullojë atë në varësi të moskonformiteteve të gjetura.

### *6-Vendimi*

Drejtori i Përgjithshëm i DPA-së, në bazë të vlerësimit të gjithë informacionit të marrë dhe pasi informon dhe merr opinionin e Bordit Këshillimor të Akreditimit, merr vendimin nëse do të akreditojë, ose do ta refuzojë certifikatën e akreditimit. Akreditimi është i vlefshëm për katër vjet.

### *7-Mbikëqyrja e akreditimit*

Vizitat mbikëqyrëse organizohen nga DPA të paktën 1 herë në vit me qëllim që të sigurojnë që OVK e akredituara, vazhdojnë të funksionojnë në përputhje me standardin për të cilin janë akredituar. DPA mund të organizojë vizita mbikëqyrëse shtesë (të paplanifikuara), në rast se vihet dyshim në lidhje me vazhdimësinë e plotësimit të kërkesave të akreditimit, si p.sh. në rastet e ndryshimeve në OVK, ankesave nga klientët ose përdoruesit, nga raportet e vlerësuesve teknikë, etj.

### *8-Rinovimi i akreditimit*

Në përfundim të periudhës së akreditimit apo riakreditimit, OVK mund të bëjë një kërkesë për rinovim të akreditimit pranë DPA, në rast se dëshiron të riakreditohet. Me marrjen e kërkesës për riakreditim, DPA-së nis procedurën e akreditimit. Në mënyrë që OVK të mos punojë pa akreditim (nëse është e interesuar), i rekomandohet të aplikojë



disa muaj më parë.

## 6. Përfundime

1. Akreditimi i IPSH-së, është sot një kërkesë për të qenë anëtar me të drejta të plota të Komunitetit Evropian të Shkencave Ligjore.

2. Rruga drejt akreditimit nuk është e lehtë, megjithatë ajo nuk përbën një sfidë të paarritshme. Ndërgjegjësimi i aktorëve që do të përfshihen në realizimin e këtij procesi, motivimi dhe mbështetja brenda dhe nga jashtë, e bën akreditimin një objektiv real e plotësisht të realizueshëm.

## Literatura

1. EN ISO / IEC 17025, *Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues.*
2. *Guidat e Akreditimit të Laboratorëve Ndërkombëtar, ILAC-G-19: 2002 "Udhëzime për laboratorët e shkencave ligjore".*
3. Udhëzuesit EURACHEM / CITAC, SWGDRUG

### Akte ligjore

4. *Ligji Nr. 116/2014, dt. 11.09.2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit".*
5. *Ligj 10489 datë 15. 12. 2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.*
6. *VKM nr. 667, datë 29. 7. 2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".*
7. *Vendim nr. 737, datë 9. 9. 2015, "Për përcaktimin e tarifave të akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.*
8. *VKM nr. 738, datë 09.09.2015, "Për shpërblimet e anëtarëve të Bordit të akreditimit dhe grupeve teknike të punës"*

### Legjislacioni European

9. *Rregullore EC-765-2008 - Akreditimi, Mbikëqyrja e Tregut.*
10. *Vendimi EC 768-2008 - Notifikimi – Kuadri i përbashkët për tregtimin e produkteve*
11. *Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme së Akreditimit.*
12. *Rregullore e Bordit të Akreditimit.*
13. *Rregullore e Komiteteve Teknike.*

# Optimizimi i parametrave «fragmentor voltage» dhe «collision energy», për identifikimin dhe ndarjen «pentaerythritol tetranitrati» (PETN) me anë të “LC-MS/MS”

— Cand. PhD Milazim TAHIRUKAJ

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
m.tahirukaj@hotmail.com

— Dr. Sc. Blerim OLLURI

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
blerim.olluri@rks-gov.net

— Dr. Sc. Xhemal ADEMAJ

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
xhemajl.ademaj@gmail.com

## Abstrakt

Ekzistojnë metoda të ndryshme për identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve organikë e në veçanti të PETN-së, por kohët e fundit, kromatografia e lëngët me detektor të spektrometrisë së masës së dyfishtë, ka filluar që të zërë vend në hulumtimet e shumta shkencore, nga ana e shkencëtarëve të forenzikës, për gjetjen e parametrave të përshtatshme për identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve organikë në përqendrime të ultë, në piktogram apo edhe në fentogram. Prandaj, duke i parë të arsyeshme nevojat, ne kemi filluar që të krijojmë parametrat optimale për “collision energy” dhe “fragmentor voltage”, për identifikimin dhe ndarjen e PETN-së nga eksplozivët e tjerë, duke përdorur instrumentin kromatografi i lëngët me detektor të spektrometrisë së masës së dyfishtë, me modelin e joneve “APCI”, kolona Zorbox SB – C18 600 bar 3X50 mm 3.5 µm dhe fazë mobile: metanol / isopropanol / ujë (1:3:6) si dhe 0.1% kloroform. Në studimet tona kemi gjetur vlerat optimale të “collision energy” dhe “fragmentor voltage”, për identifikimin dhe ndarjen e PETN-së nga eksplozivët e tjerë, ku ndryshimi i vlerave të energjisë së copëzimit, ndikon mjaft në formën e copëzimit e molekulës të cilën studiojmë, fraksionet e copëzimit të molekulës në të gjitha nivelet dhe kjo, na lehtëson identifikimin e molekulës së eksplozivit të panjohur; dhe, të gjitha fraksionet, përputhen me njohuritë paraprake tona mbi strukturën e PETN-së dhe njohuritë për copëzimet e mundshme të saj, përveç ndarjes së shkëlqyeshme që arrihet me këtë teknikë dhe limitit të detektimit deri në fentogram.

## Fjalëkyçe:

PETN, “collision energy”, “fragmentor voltage”, “LC-MS/MS”.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Eksplzivët janë të klasifikuar në disa mënyra, bazuar në kritere të ndryshme. Kështu, eksplozivët janë ndarë në: eksplozivë të lartë dhe të ulët, bazuar në tipin dhe shpejtësinë e veprimit që bëjnë. Dallimet në mes dy tipave, lidhen me përdorimin e tyre. Eksplozivat e lartë përdoren si mbushës detonator, përkundër atyre të eksplozivave të lëvizshëm (propellant). Eksplozivët e lartë edhe më tutje, ndahen në dy grupe, duke u bazuar në funksionin e tyre në eksplozion:

a) primarë (fillestarë), që përdoren për të filluar shpërthimin (p.sh. “blasting caps” - kapsollë);

b) sekondarë, pjesa kryesore e eksplozivit.

Eksplzivët, po ashtu klasifikohen sipas strukturës së tyre kimike. Grupi më i rëndësishëm është ai i komponimeve organike, që përmban grupin nitro ( $\text{NO}_2$ ). Ato ndahen më tutje, bazuar në vendin ku lidhet  $\text{NO}_2$  në strukturë atomike. Komponimet nitro përmbajnë grupe C- $\text{NO}_2$ , një grup të *nitro etseret* (C-O- $\text{NO}_2$ ) dhe *nitro aminet* (C-N- $\text{NO}_2$ ). Dallimi në mes eksplozivëve ushtarakë dhe industrialë, qëndron në aplikimin dhe dizajnimin e eksplozivëve, prandaj kjo nuk duhet të merret si një listë definitive e eksplozivave.<sup>1</sup>

Për eksplozivët, ka shumë përkufizime të cilët janë dhënë gjer më sot, mirëpo shumica e tyre përkufizohen si komponime kimike në gjendje të ekuilibrit kimik, të cilat pas intervenimit mbi to nga jashtë, në formë të goditjes, nxehtësisë, gërvishtjes etj., shkaktojnë reaksione kimike që përcillen me lirim të masës së madhe të nxehtësisë dhe produkteve të gazit të liruara, presion të lartë, i cilit ka efekt shpërthyes dhe shkatërrues.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Jehuda Yinon and Shmuel Zitrin, *Modern Methods and Applications of Explosives*, f.1.

Po ashtu, substancat eksplozuese mund të përkufizohen si substanca të ngurta ose të lëngëta, të cilat pas inicimit nga jashtë, lirojnë nxehtësi, dritë, zhurmë, gaz, mjegull ose tym apo kombinime të këtyre; që janë pasojë e reaksioneve jodetonuese të vetëqëndrueshme dhe të reaksioneve kimike ekzotermike.<sup>3</sup>

Si metodë pune instrumentale për *optimizmin e parametrave e në veçanti “collision energy” dhe “fragmentor voltage”*, për të bërë identifikimin dhe ndarjen e eksplozivit PETN nga eksplozivët e tjerë, është përdorur kromatografia në fazë të lëngët, me masë spektrometrin e dyfishuar (LC-MS/MS).

PETN – *Pentaerythritol tetranitrati*, është një eksploziv i fuqishëm, me ngjyrë të bardhë, me ndjeshmëri të mesme ndaj goditjeve; nuk ka të dhëna për faktorët atmosferik nëse kanë ndonjë ndikim; nuk tretet në ujë; mund ta përballojë nxehtësinë gjatë shkrirjes, deri në 141 °C.

*Tetranitrate Pentaerythritoli* (PETN), i njohur gjithashtu si *Penta*, korpent, penthrite (ose, rrallë dhe kryesisht, në gjuhën gjermane, si *nitropenta*), është nitrat ester e pentaerythritol. *Penta* i referohet pesë atomeve të karbonit të skeletit neopentane. PETN-ja, është një nga eksplozivët më të fuqishëm të njohur, me një faktor relativ të efektivitetit, 1.66.<sup>4</sup>

PETN-ja, e përzier me një “plasticizer” (substancë, zakonisht një tretës, i shtuar një rrëshire sintetike për të shtuar plasticitetin dhe fleksibilitetin dhe për të zvogëluar brishtësinë) formon një eksploziv plastik. Si një përzierje me RDX dhe shtesa të tjera të vogla, formon një tjetër semteks plastik shpërthyes. Kompleksi u zbulua në bomba të përdorura nga ana e terroristit të bombave të vitit 2001, në këpucë, në 2009, në sulmin me bombë në Ditën e Krishtlindjeve, dhe në 2010, në sulmin me bombë në një avion mallrash. Më 7 shtator 2011, në një bombë të shpërthyer në kompleksin e Gjykatës së Lartë, në Delhi të Indisë, e cila kishte lënë të vdekur 13 vetë dhe kishte plagosur më shumë se 70, dyshohej se terroristët kishin përdorur PETN-në si shpërthyes.<sup>5</sup>

Përdorimi më i zakonshëm i PETN është si një eksploziv me aftësi të lartë shkatërruese.




Figura 1. Struktura e Pentaerythritol tetranitratit (PETN).

<sup>2</sup> Eksplozivët-manual trajnuet, Akademia e Bombave, Turqi

<sup>3</sup> Kaptina 2.2-Dispozitat specifike të Klasës1 ADR-Marrëveshja Evropiane mbi Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme.

<sup>4</sup> “PETN (Pentaerythritol tetranitrate)”. <http://www.globalsecurity.org/military/systems/munitions/explosives-nitrate-petn.htm>. Parë në dt. 29 mars 2010.

<sup>5</sup> Kumar, Vinay. *Nationwide alert as NIA takes up probe*. *The Hindu* Chennai, India, 2011.

- formula molekulare  $C_5H_8N_4O_{12}$
- masa molekulare  $316.14 \text{ g mol}^{-1}$
- densiteti  $1.77 \text{ g/cm}^3$  at  $20^\circ\text{C}$
- pika e shkrirjes,  $141.3^\circ\text{C}$
- i ndjeshëm ndaj goditjeve
- i ndjeshëm ndaj fërkimeve
- shpejtësia eksplozive  $8400 \text{ m/s}$ .

## 2. Materiali dhe metodat e punës

Si metodë pune instrumentale për optimizimin e parametrave, e në veçanti energjinë e përplasjes (“collision energy”) dhe tensionit fragmentues (“fragmentor voltage”), për të bërë identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve organikë është përdorur kromatografia e lëngët, me spektrometrin e masës së dyfishtë (LC-MS/MS).

Mostra standarde e eksplozivëve organikë, është porositur nga kompani e licencuar për standardë të eksplozive “AccuStandard”. Ne e kemi përdorur standardin e PETN-së më përqendrim sasior  $0.1 \text{ mg/ml}$ . Nga mostrat e përmendura, kemi bërë optimizimin e metodës për identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve organike, e në veçanti PETN, do të ilustrojmë mënyrën e optimizimit të tensionit fragmentues (“fragmentor voltage”) dhe energjisë së përplasjes (“collision energy”).

### 2.1 Reagjentët e përdorur

Gjatë pjesës eksperimentale, për trajtimin paraprak të mostrave dhe përgatitjen e fazave mobile kemi përdorur kimikate të pastërtisë së lartë, të prodhimeve të ndryshme siç janë:

- ujë i dejonizuar (niveli i cilësisë -II-),
- metanol ( $\text{CH}_3\text{OH}$ ) për përdorim në HPCL,
- acetoni ( $\text{CH}_3\text{COCH}_3$ ) për përdorim në HPCL,
- izopropanol (2 - Propanol) ( $\text{C}_3\text{H}_8\text{O}$ ) për përdorim në HPLC,
- kloroform ( $\text{CHCl}_3$ ) për përdorim në HPCL,
- gaz azoti ( $\text{N}_2$ ) 99.999 %.

#### Tretësirat:

- tretësira për fazën mobile: metanol, izopropanol, ujë i dejonizuar (1: 3: 6) si dhe 0.1% kloroform;
- tretësira për tretjen e mostrës: metanol, ujë i dejonizuar (1:1) si edhe tretësira alternative për tretjen e mostrës: Acetoni.

### 2.2 Përgatitja e mostrave për analizë

Pasi mostra jonë ka qenë standarde, e tretshme në methanol: ujë në raport (1:1) me përqendrim  $0.1 \text{ mg/ml}$ ; me këtë rast, ne kemi marrë një (1) mikroshepe qelqi dhe me mikropipeta të kalibruara, i kemi marrë nga  $100 \mu\text{l}$  nga standardi i eksploziveve të lartcekura dhe pastaj, i kemi shtuar nga  $450 \mu\text{l}$  metanol dhe  $450 \mu\text{l}$  ujë, deri në  $1 \text{ ml}$ .

### 3. Optimizimi i kushteve eksperimentale

Për optimizimin e parametrave të cekura më poshtë, janë bërë qindra matje deri te parametrat e përshtatshëm për identifikim dhe ndarje të eksplozivit organik që ne kemi pasur objekt studimi. Mostra analizohet me instrumentin: kronatografi i lëngët - spektrometri i masës (LC-MS/MS).

- mostra analizohet me instrumentin: kronatografi i lëngët – spektrometri i masës së dyfishtë ( LC - MS/MS),

- faza mobile: 60 % ujë + 30 % izopropanol + 10% metanol si dhe 0.1% kloroform

- rrjedhja e fazës mobile: 0.5 ml/minutë,

- temperatura e kolonës: 35 °C,

- burimi i jonizimit: MMI,

- modeli i jonizimit APCI,

-Sasia e mostrës për injektim: 20 µL,

- limiti kohor për identifikimin e mostrës: 10 minuta,

- kolona – Zorbox SB – C18 600 bar 3 x 50 mm x 3.5 µm.

*Parametrat e instrumentit (MS - konditat) (metoda: EXPLOSSIVE-MMI-APCI.m)  
për: PETN.*

Parametrat	Value (+)	Value (-)
- Gas Temp (OC)	150	150
- Vaporizer Temp	250	250
- Gas Flow (l/min)	8 8	
- Nebuluizer (psi)	50	50
- Capillary (V)	2000	2000
- Charing Voltage (V)	0	0
- Corona Current Pos (µA)	0	0
- Corona Current Neg (µA)	0	0
- Burimi i jonizimit:	MMI	
- Modeli i jonizimit:	APCI	

Emri i eksplozivit	Proc. ion	Prod. ion	Dwell	Frag. (V)	CE (V)	Polariteti
PETN	391	217	25	150	24	Negativ

**Tabela 1. Optimizimi i parametrave të eksplozivave (metoda: EKSPLOZIVAT - MMI -APCI.m)  
për : PETN.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

### 4. Rezultatet

Në këtë punim me instrumentin LC-MS/MS, ku kromatografia e lëngët është e lidhur me spektrometerin e masës së dyfishtë, kemi krijuar metodën me kushte optimale për identifikimin dhe ndarjen e PETN.

Në vazhdim, në këtë kapitull do të paraqiten rezultatet eksperimentale dhe do të bëhet diskutimi i tyre.

Rezultatet e fituara eksperimentale për optimizimin e parametrave të tensionit fragmentues dhe energjisë së përplasjes, i kemi paraqitur në mënyrë skematike.

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »




Figura 2. Matja për energjinë e përplasjes për PETN.

Në figurën e mësipërme është paraqitur në mënyrë skematike vlera optimale e energjisë së përplasjes për PETN me fazë mobile: metanol, izopropanol, ujë i dejonizuar (1: 3: 6) si dhe 0.1% kloroform dhe kolona - zorbox SB – C18 600 bar 3 X 50 mm X 3.5 µm. Nga kjo shihet qartë se vlera optimale e energjisë së përplasjes për PETN është 24 eV.




Figura 3. Matja për tensionin fragmentues për PETN.

Në figurën e mësipërme është paraqitur në mënyrë skematike vlera optimale tensionit fragmentues për PETN me fazë mobile: metanol, izopropanol, ujë i dejonizuar (1: 3: 6) si dhe 0.1% kloroform dhe kolona - zorbox SB - C18 600 bar 3 X 50 mm X 3.5 µm. Nga kjo shihet qartë se vlera optimale e tensionit fragmentues për PETN është 150 V.

## 5. Konkluzioni

Në fund të këtij punimi, për optimizimin e parametrave për identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve organikë me LC-MS/MS, mund të nxjerrim disa përfundime e sugjerime, si:

- Kemi konstatuar se për eksplozivin PETN, joni molekular është 391 dhe joni bazë 217 me fazën mobile: metanol, izopropanol, ujë i dejonizuar (1: 3: 6) si dhe 0.1% kloroform. Ndërsa, është gjetur vlera optimale e tensionit fragmentues (150 V) për

ndarjen dhe identifikimin e eksplozivit në përzierje dhe në përqendrime të vogla, deri në fentogram, në mostrat që sillen nga hetuesit si të pashpërthyer dhe pas eksplozimit. Po ashtu është gjetur vlera optimale edhe për energjinë e përplasjes, që është (24 eV).

- Në studimin tonë, objekt studimi kanë qenë eksplozivët organikë si: HMTD, HMX, RDX, TATB, EGDN, 1,3,5-TNB, 1,3-DNB, TETRYL, 4A-DNT, NB, NG, 2A-DNT, TNT, 2,6-DNT, 2,4-DNT, HNS, 2-NT, 4-NT, 3-NT, TATP dhe CARBAMITE, për krijimin e metodës, për identifikimin dhe ndarjen e eksplozivëve duke bërë optimizimin e parametrave në LC dhe MS/MS dhe ndarjen e PETN-së nga eksplozivët tjerë.

## Literatura

1. Albright, David (July 1994). "South Africa and the Affordable Bomb". *Bulletin of Atomic Scientists*.
2. Bell, Suzanne. *Forensic Chemistry*. Pearson Education, New Jersey 2006.
3. Beveridge, Alexander. *Forensic Investigation of Explosions* (Volume 24 of International Forensic Science and Investigation). Taylor and Francis 2010.
4. Cooper, Paul W., *Explosives Engineering*, New York, Wiley-VCH, 1996
5. Çullaj, Alqi. *Metodat instrumentale të analizës kimike*, Tiranë, SHBLU 2006.
6. *Eksplozivët-manual trajnues*, Akademia e Bombave Turqi.
7. Hadden, Nina. *Basic liquid chromatography*. Varian Aerograph, 1971.
8. Inghram, Mark Gordon. *Modern Mass Spectroscopy*. Washington D.C 1954.
9. Kumar, Vinay. "Nationwide alert as NIA takes up probe". *The Hindu*, Chennai, India, 2011.
10. Meyer, Rudolf; Kohler, Josef; Homburg, Axel. *Explosives*, Germany 2007.
11. Mišoviæ, Jelica; AST, Teodor. *Instrumentalne metode hemijske analize*. Beograd 1989.
12. Pula, Xhevdet; Beqiri, Luljeta. *Teknologjia Kimike, ETMMK*. Prishtinë 1986.
13. Schubert, Hiltmar; Kuznetsov, Andrey (red.). *Detection of Explosives and Landmines Methods and Field Experiences* (Proceedings of the NATO Advanced Research Workshop, held in St. Petersburg, Russia, 9-14 September, 2001) Springer 2002.
14. Skoog, Douglas A.; West, Donald M.; Holler, F. James. *Analytical chemistry: a modern approach to analytical science*. Wiley-VCH 2004
15. Watson, Dadid G. *Analiza farmaceutike*. Tiranë 2007.
16. Yinon, Jehuda; Zitrin, Shmuel. *Modern Methods and Applications in Analysis of Explosives*. Israel 1996.
17. Yinon, Jehuda. *Advances in Forensic Applications of Mass Spectrometry*. CRC Press 2004.
18. "PETN (Pentaerythritol tetranitrate)". <http://www.globalsecurity.org/military/systems/munitions/explosives-nitrate-petn.htm>. Retrieved March 29, 2010.
19. Kaptina 2.2-Dispozitat specifike të Klasës1 ADR-Marrëveshja Evropiane mbi Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme.





---

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Hetimi i vrasjeve, rëndësia e gjetjes dhe administrimit të provave

MSc. Tonin VOCAJ

Akademia e Sigurisë

tonin.vocaj@asp.gov.al

## Abstrakt

*Hetimi i vrasjeve, dokumentimi i veprimtarisë kriminale të autorëve dhe vënja e tyre para drejtësisë ka qenë dhe mbetet një sfidë e vazhdueshme e organeve të ndjekjes penale në mbarë botën. Evidentohet fakti se është pikërisht hetimi i krimeve kundër jetës, ajo veprimtari, e cila sqaron dhe dokumenton elementët e domosdoshëm të veprës penale si dhe, vërteton plotësisht kryerjen e saj dhe individualizon përgjegjësinë penale të autorëve të këtyre krimeve të rënda. Hetimet e plota e të gjithanshme bëjnë të mundur sqarimin e rrethanave, përcaktimin e motivit të krimit, zgjidhjen e trilemës, vrasje, vetëvrasje apo vdekje aksidentale. Po kështu, nëpërmjet hetimit bëhet e mundur gjetja, marrja dhe administrimi i provave të shumëllojshme që dokumentojnë veprimtarinë kriminale dhe përgjegjësinë e autorëve të këtyre veprimeve kriminale. Ndër objektivat kryesore të hetimit të krimeve kundër jetës, parësore duhet të jenë ato të vërtetimit të kryerjes së veprës penale nga autori si dhe, përcaktimi i motivit dhe qëllimit të kryerjes së veprës. Elementët e anës subjektive janë të rëndësishëm për të përcaktuar dispozitën konkrete, por edhe shkallën e fajit e të përgjegjësisë së autorit të veprës penale. Hetimet e krimeve kundër jetës janë komplekse dhe një rëndësi të dorës së parë në këto hetime, marrin aplikimi i teknikave kriminalistike, kryerja e ekspertimeve të nevojshme si dhe aplikimi i metodave bashkëkohore të analizës së të gjithë elementeve të hetimit, për të nxjerrë konkluzione objektive dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të këtyre krimeve të rënda. Procesi i të provuarit në hetimin e vrasjeve, ka si objekt të gjitha njoftimet që lidhen me elementët e figurës së veprës penale, marrëdhëniet shoqërore që ka cenuar, koha, vendi, mënyra kryerjes, rrethanat, pasojën dhe lidhjen shkakësore me të, autorin, bashkëpunimin, rrezikshmërinë, fajësinë dhe formën e fajit, motivet dhe qëllimin në kryerjen e saj dhe çdo gjë që lidhet dhe është në interes të zgjidhjes së drejtë të çështjes penale.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**krime kundër jetës, vrasja, vetëvrasja, vdekja aksidentale, provat, mjetet për kërkimin e provës, teknikat kriminalistike, ekspertimi, eksperimenti, metodat analitike.**

## 1. Hyrje

Vrasja është një ndër krimet më të rënda, që konsiston në heqjen e jetës të një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Teoria e së drejtës penale, e përkufizon vrasjen si më poshtë: “Me vrasje kuptohet ajo vepër (veprim ose mosveprim) i kundërligjshëm, me anë të së cilit i hiqet jeta një personi tjetër, me dashje ose nga pakujdesia”<sup>1</sup>.

Nga një analizë e përgjithshme statistikore, e vrasjeve të ndodhura nga viti 1991, evidentohet një rritje e ndjeshme e krimit të vrasjes dhe në mënyrë të veçantë, në vitin 1997, kjo, edhe si rezultat i krizës së gjithanshme që kaloi vendi, e shoqëruar me rënie në duart e popullatës të një numri të konsiderueshëm armatimesh nga depot e ushtrisë.

Sipas të dhënave statistikore kemi:

në vitin 1991 kanë ndodhur 205 vrasje, zbuluar 177, ose 86%; në vitin 1992 kanë ndodhur 251 vrasje, zbuluar 226, ose 90%; në vitin 1993 kanë ndodhur 268 vrasje, zbuluar 243, ose 91%; në vitin 1994 kanë ndodhur 265 vrasje, zbuluar 228, ose 86%; në vitin 1995 kanë ndodhur 210 vrasje, zbuluar 177, ose 84%; në vitin 1996 kanë ndodhur 248 vrasje, zbuluar 208, ose 84%; në vitin 1997 kanë ndodhur 1542 vrasje, zbuluar 674, ose 44%; në vitin 1998 kanë ndodhur 573 vrasje, zbuluar 337, ose 59%; në vitin 1999 kanë ndodhur 496 vrasje, zbuluar 330, ose 67%; në vitin 2000 kanë ndodhur 275 vrasje, zbuluar 209, ose 76%; në vitin 2001 kanë ndodhur 208 vrasje, zbuluar 171, ose 82%; në vitin 2002 kanë ndodhur 179 vrasje, zbuluar 147, ose 82 %; në vitin 2003 kanë ndodhur 144 vrasje, zbuluar 112, ose 78%; në vitin 2004 kanë ndodhur 119 vrasje, zbuluar 104, ose 87%; në vitin 2005 kanë ndodhur 131 vrasje, zbuluar 100, ose 76%; në vitin 2006 kanë ndodhur 87 vrasje, zbuluar 75, ose 86%; në

<sup>1</sup> Ismet Elezi, *E drejta penale, Pjesa e posaçme* (Tiranë: Kumi, 2014), 35.

vitin 2007 kanë ndodhur 105 vrasje, zbuluar 93, ose 90%; në vitin 2008 kanë ndodhur 88 vrasje, zbuluar 72, ose 82%; në vitin 2009 kanë ndodhur 89 vrasje, zbuluar 79, ose 89%; në vitin 2010 kanë ndodhur 124 vrasje, zbuluar 101, ose 81.4%; në vitin 2011 kanë ndodhur 135 vrasje, zbuluar 117, ose 86.6%; në vitin 2012 kanë ndodhur 130 vrasje, zbuluar 112, ose 86%; në vitin 2013 kanë ndodhur \_\_\_\_\_ vrasje dhe janë zbuluar \_\_\_\_\_, ose %; në vitin 2014 kanë ndodhur 103 vrasje, zbuluar 76, ose 73.8%; në vitin 2015 kanë ndodhur 59 vrasje, zbuluar 51, ose 86.5%; në vitin 2016 kanë ndodhur 75 vrasje, zbuluar 62, ose 88%<sup>2</sup>.

Nga një vështrim i përgjithshëm i statistikës së mësipërme, evidentohet fakti i një numri mjaft të lartë vrasjesh, por edhe i një trendi të përgjithshëm të uljes së numrit të këtyre krimeve të rënda, i cili duhet të shikohet si një tregues i përmirësimit të vazhdueshëm të treguesve të sigurisë publike në vend.

Hetimi i krimeve kundër jetës, zbulimi i autorëve, dokumentimi i plotë ligjor i veprimtarisë së tyre kriminale dhe vënien e tyre para drejtësisë, mbetet një detyrë mjaft e rëndësishme e organeve të zbatimit të ligjit dhe, në mënyrë të veçantë, të organit të prokurorisë dhe policisë gjyqësore.

Hetimi i krimeve kundër jetës është detyrë shumë komplekse, kërkimore, që i besohet Policisë Gjyqësore (sektorët e krimeve të rënda në drejtoritë vendore të policisë dhe komisariatet e rretheve gjyqësore). Policia gjyqësore që heton krimet kundër jetës duhet ta kryejë këtë detyrë duke respektuar të gjitha detyrimet dhe kufizimet ligjore të parashikuara në legjislacionin procedural penal, si dhe duke u udhëhequr nga parimi i objektivitetit në hetime.

Oficerët e policisë gjyqësore duhet të kryejnë hetime profesionale dhe të aplikojnë të gjitha procedurat dhe teknikat hetimore, të shfrytëzojnë teknikat kriminalistike, të aplikojnë me objektivitet analizën e fakteve dhe provave deri në arritjen e konkluzionit përfundimtar. Përcaktimi i drejtë i motivit dhe qëllimit të një vrasje, është një ndihmë e rëndësishme në rezultatin e hetimeve dhe në zbulimin e vënien para drejtësisë të autorëve të këtyre krimeve të rënda.

## 2. Rëndësia e gjetjes dhe administrimit të provave në hetimin e vrasjeve

Kuptimi i provës penale jepet në nenin 149 të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.Penale), dispozitë në të cilën përcaktohen edhe elementët përbërës të saj. Nga kuptimi që i jep provës penale, legjislacioni ynë, mund të bëjmë përkufizimin e mëposhtëm; *provë penale konsiderohet çdo njoftim, e dhënë, fakt apo rrethanë, që lidhet me një veprë penale të caktuar, që merret prej burimeve të njohura dhe parashikuara nga ligji procedural, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe çdo njoftim me interes për zgjidhjen e drejtë të çështje.*

Qëllimi që ndjek hetimi i vrasjeve, është që nëpërmjet fakteve e provave që merren e administrohen nga policia gjyqësore, të vërtetohet në mënyrë bindëse ekzistenca ose jo e veprës penale (vrasjes), identifikimin e autorëve të vrasjes dhe përgjegjësisë së tyre

<sup>1</sup> Statistikat zyrtare të Policisë së Shtetit.

dhe në tërësi të gjitha fakteve e rrethanave që lidhen me këtë veprë penale. Policia gjyqësore e ka të pamundur të perceptojë drejtpërdrejt veprën penale kur ajo ndodh, sepse në pjesën dërmuese të rasteve policia gjyqësore merr dijeni për këtë krim pas ndodhjes së tij. Organet e procedimit penal, duke përdorur mjetet e kërkimit të provave dhe nëpërmjet burimeve tyre, arrijnë të marrin njoftime të cilat përbëjnë atë që quhet provë penale.

Objekt të provuari në krimet kundër jetës, ka të bëjë me të gjitha njoftimet që lidhen me elementët e figurës së veprës penale, marrëdhëniet që ka cenuar, kohën, vendin, mënyrën e kryerjes, rrethanat, pasojën dhe lidhjen shkakësore me të, autorin, bashkëpunimin, rrezikshmërinë, fajësinë dhe formën e fajit, motivet dhe qëllimin në kryerjen e saj, faktet nga të cilat varet respektimi i ligjit si dhe çdo gjë që lidhet dhe është në interes të zgjidhjes së drejtë të çështjes penale.

Është evident fakti se, si në hetimin e veprave penale në përgjithësi dhe në hetimin e vrasjeve, është e domosdoshme gjetja dhe administrimi i provave penale, pa të cilat është e pamundur të përcaktohet fakti i ndodhjes së vrasjes, identifikimi i autorëve dhe shkalla e përgjegjësisë së tyre. Faktet dhe provat në hetimet për krimet kundër jetës mund të klasifikohen si më poshtë:

a. *Fakte që provojnë kryerjen e veprës penale.* Në radhë të parë, këto fakte japin njoftime e provojnë nëse ka ndodhur ose jo vrasja, nëse ka ndodhur sjellja kriminale e autorit të veprës penale, veprime ose mosveprime që parashikohen në seksionin e parë dhe të dytë të kreut të dytë (*Veprat penale kundër personit, Krimet kundër jetës*) të Kodit Penal. Këto prova mund të konsiderohen si prova të fillimit ose jo, të procedimit penal. Fakte të cilat provojnë ekzistencën apo jo të vrasjes, dhe nëse ajo rezultojnë të ketë ndodhur, edhe kohën, vendin ku ka ndodhur, mënyrën se si ka ndodhur etj. Një provë e tillë, mund të jetë p.sh., konkluzioni i ekspertimit mjekoligjor në rastin e vdekjes së papritur të një personi. Prova për të provuar nëse jemi apo jo para veprës penale të vrasjes, ndër të tjera janë rezultatet e ekspertimit mjekoligjor, që provojnë nëse vdekja ka qenë natyrale apo ka qenë rezultat i dhunës, helmimit nga faktorë subjektiv etj.

b. *Fakte që provojnë kryerjen nga autori të vrasjes dhe cilësimin e saj ligjor.* Këto prova kanë rëndësi thelbësore për gjithë procesin penal, sepse ato lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me dy parimet kryesore të procedurës penale: atë të prezumimit të pafajësisë dhe, të barrës së të provuarit në procesin penal. Zakonisht, të njëjtat fakte e prova japin njoftime, si për autorësinë në kryerjen e veprës penale, ashtu edhe për cilësimin ligjor të saj. Kjo, për faktin se elementët dhe njoftimet që japin këto prova, janë të ndërthurur me njëra-tjetrën. Sikurse kemi thënë, rrethi i njoftimeve në procesin penal është i gjerë, por objekti dhe qëllimi i njohjes, janë vetëm ato fakte dhe rrethana, të cilat lidhen me *veprimet dhe qëndrimet e njeriut, individit* në një ngjarje konkrete, e ndodhur në një vend dhe kohë të caktuar, veprime këto, të cilat nga ligji penal material janë konsideruar si veprë penale. Pavarësisht nga koha e kryerjes veprës penale, rrethanave etj., kujdesi i treguar nga autori për të fshehur gjurmët në kryerjen e saj, faktet dhe të dhënat që lidhen me objektin e të provuarit, janë realitet në çdo veprë penale, rëndësi ka që ato të gjenden dhe të administrohen nga burime dhe në mënyrën e kërkuar nga ligji.

c. *Fakte që provojnë fajësinë ose jo të autorit të veprës penale.* Këto prova provojnë, nëse autori i veprës penale është apo jo fajtor, në kryerjen e veprës penale. Pra, nëse është kryer në një nga format e fajit, që parashikon instituti i përgjegjësisë penale në ligjin penal material. Faktet të cilat provojnë fajësinë e të akuzuarit në kryerjen e veprës

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

penale, prova këto, të cilat vlerësohen e çmohen nga prokurori gjatë hetimeve paraprake dhe nga gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes së të pandehurve në kryerjen e veprës penale.

*d. Fakte që lidhen me përgjegjësinë penale, civile dhe dënimin e të pandehurit.* Janë fakte të cilat e ngarkojnë ose e përjashtojnë nga përgjegjësia penale apo civile të pandehurin. Këto prova provojnë ekzistencën ose mungesën e shkaqeve ligjore që e ngarkojnë apo e përjashtojnë nga përgjegjësia penale të pandehurin. Këto prova japin njoftime në lidhje me respektimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në kreun e II-të, pjesa e përgjithshme e Kodit Penal, mbi përgjegjësinë penale ose jo, të personit, në kryerjen e veprës penale.

### **3. Marrja e dijenisë për kryerjen e krimeve kundër jetës**

“Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”<sup>3</sup>.

Është e rëndësishme të kuptohet se policia gjyqësore e ka për detyrë të kundërveprojë me iniciativë kundër çdo vepre penale dhe për ta bërë këtë, ka në dispozicion struktura të kualifikuara, për të zbuluar veprimtarinë kriminale të fshehtë apo të hapur, ka personel të mjaftueshëm, të përgatitur dhe të gatshëm për tu gjendur menjëherë në çdo vendngjarje ku ka ndodhur një vepër penale, ka mjetet e nevojshme për të ndjekur dhe kapur autorët, për të gjetur dhe fiksuar gjurmët e krimit dhe provat materiale.

Zakonisht, njoftimin për krime kundër jetës e merr shërbimi i sallave operative. Njoftimi bëhet nga qytetarët ose subjektet tjera, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit, si telefon, e-mail, mesazh, kallëzim i drejtpërdrejt, etj. Në disa raste krimet kundër jetës mund të konstatohen edhe drejtpërdrejt nga oficerët e patrullave të përgjithshme të policisë ose punonjës të tjerë të Policisë së Shtetit.

Pavarësisht nga rrethanat e marrjes dijeni, policia është e detyruar të kryejë verifikime të menjëhershme të vërtetësisë së informacionit të marrë, për kryerjen e një krimi kundër jetës. Në vendin e ngjarjes duhet të dërgohen patrulla të përgjithshme të policisë për të siguruar vendin e ngjarjes, për të ndihmuar të plagosurit, për të ndërprerë pasojat e tjera që mund të vinë nga vepra penale. Në vendin e ngjarjes, patrulla e përgjithshme duhet të veprojë për arrestimin e personave të dyshuar, kufizimin dhe përcaktimin e kufijve të vendit të ngjarjes, identifikimin e personave të pranishëm në vendin e ngjarjes dhe të rolit të tyre në këtë ngjarje, të largojë dëshmitarët dhe personat e tjerë jashtë perimetrit të sigurisë, të marrë masa për mbrojtjen e gjurmëve dhe të provave materiale nga dëmtimi, etj.

Marrja dijeni për krimin dhe masat e shpejta për verifikimin e informacioneve, janë të rëndësishme për organizimin e veprimeve të shpejta hetimore dhe operative, që do të shpjen në sqarimin e ngjarjes dhe në kryerjen e hetimeve cilësore e rezultative. Por, duhet theksuar se, megjithëse këto veprime janë të rëndësishme, ato duhen shoqëruar me masa të tjera organizative, në caktimin e personelit kompetent dhe të trajnuar në kryerjen e detyrave në vendin e ngjarjes, caktimin e ekspertëve të nevojshëm dhe respektimin e procedurave standarde të punës në gjetjen, fiksimin dhe marrjen e provave.

<sup>3</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Neni 30.

## 4. Arrestimi në flagrancë i tetë të dyshuarve

Patrulla e Përgjithshme e Policisë apo çdo punonjës tjetër policie që arrin i pari në vendin e ngjarjes ka detyrimin që të arrestojë autorin e dyshuar të krimit, kur ai kapet në flagrancë, pra kapet në kryerje e sipër të veprës penale; menjëherë pas kryerjes së veprës penale; kapet me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer krimin. Është e rëndësishme që autori i krimit të arrestohet duke treguar kujdesin maksimal, që të mos dëmtohen gjurmët që gjenden në trupin e tij. Atij duhet të mos i lejohej t'i pastrojë duart dhe t'i largojë njollat e gjurmët. Autori i arrestuar duhet të futet në automjetet e policisë ose në ambiente të veçanta, nën vëzhgimin e oficerëve të policisë duke treguar kujdes që të mos të mos i dëmtojë apo asgjësojë mikrogjurmët që gjenden në trupin apo në veshjen e tij. Në të tilla raste është i rëndësishëm përdorimi i mjeteve të posaçme, si shtresat prej najloni, PVC-je etj.

Këto veprime duhen dokumentuar nga oficerët e policisë që kryejnë arrestimin në flagrancë. Në ambientet e policisë shkencore, me të arrestuarin në flagrancë, mund të vazhdojnë veprimet hetimore të përpunimit të mëtejshëm kriminalistik të gjurmëve dhe provave që gjenden në trupin apo në rrobat e tij. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, i arrestuari në flagrancë pyetet me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në lidhje me rrethanat e ngjarjes.

## 5. Sigurimi dhe ruajtja e vendit të ngjarjes

*“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë”<sup>4</sup>.*

Zbulimi i veprës penale varet nga mbledhja e suksesshme e provave, në lidhje me atë vepër penale të kryer. Oficeri i parë i policisë që arrin në vendin e ngjarjes, luan një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen dhe mbledhjen e provave materiale d.m.th. të “dëshmitarëve të heshtur”. Është shumë e rëndësishme që oficeri i policisë i parë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen nën kontroll dhe mbrojtjen e vendit të kryerjes së veprës penale dhe, të vendeve të tjera, ku mund të gjenden provat materiale.

Prishja e paqëllimtë e integritetit të vendit të ngjarjes nga ana e punonjësve të policisë, kureshtarë dhe mbikëqyrësve, paraqet një problem të madh. Në vendin e ngjarjes, në shumë raste, gjenden prova të cilat çojnë në arrestimin e të dyshuarve. Por, për fat të keq, në disa raste, këto prova që mund të kenë vlerë, shkatërrohen ose bëhen të padobishme për shkak të veprimeve të pakujdeshme në vendin e ngjarjes.

Oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje ose që gjendet aty, duhet të sigurojë vendin e ngjarjes deri sa të arrijë grupi hetimor. Pas përfundimit të këqyrjes së vendngjarjes, duhet të ndërmerren masa për të rivendosur gjendjen e mëparshme. Veprimet e oficerit të policisë për sigurimin e vendit të ngjarjes, janë vendimtare për të ruajtur, siguruar dhe mbledhur të gjitha provat që mund të shkatërrohen, nëse nuk sigurohen siç duhet. Oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje, duhet ta sigurojë atë, t'i japë ndihmë çdo personi të lënduar, të sigurohet që provat nuk janë prishur, të

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

*“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”*

<sup>4</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Neni 300/1.

pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të ngjarjes dhe nëse ka mundësi, të vihet në ndjekje të autorit.

Një prej aspekteve më të rëndësishme të sigurimit të vendit të ngjarjes, është ruajtja e vendit të ngjarjes me dëmtim minimal të provave materiale. Reagimi i parë ndaj një rasti duhet të jetë i shpejtë dhe me përgjegjësi. Gjithashtu, oficeri i policisë që shkon i pari në vendngjarje ka për detyrë t'i raportojë prokurorit/oficerit të policisë gjyqësore, në lidhje me ngjarjen e ndodhur, si dhe për çdo masë të marrë, çdo ndryshim të vendit të ngjarjes, të gjitha veprimet e kryera, dëshmitarët e evidentuar, nëse është prekur apo lëvizur nga vendi ndonjë send, apo nëse kanë qenë të detyruar për të hyrë në territorin e vendit të ngjarjes. Për këto të dhëna punonjësi i policisë përgatit edhe një informacion me shkrim.

## 6. Këqyrja e vendit të ngjarjes dhe sekuestrimi i provave

Këqyrja e vendit të ngjarjes është një veprim hetimor mjaft i rëndësishëm, me anë të së cilit organi procedues kontrollon drejtpërdrejt mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson, gjurmët dhe provat materiale, sqaron mekanizmin e ngjarjes dhe rrethana të tjera që kanë rëndësi për çështjen. Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprimi i parë hetimor dhe kriminalistik, me anë të së cilit hidhen themelet e hetimit të ardhshëm. Sa më të mira të jenë këto themele, aq më i plotë dhe i shpejtë do jetë hetimi. Këqyrja e vendit të ngjarjes është veprim hetimor i pazëvendësueshëm dhe i papërsëritshëm.

Këqyrja e vendit të ngjarjes, është një veprim hetimor, me anë të së cilit organi procedues percepton drejtpërsëdrejti mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson gjurmë e prova materiale dhe sqaron rrethana që kanë rëndësi për çështjen. Ky veprim hetimor është njëherësh edhe burim i pasur informacioni, me anë të së cilit sqarohet mekanizmi i ngjarjes në bazë të gjurmëve, studiohet personaliteti i personave që kanë marrë pjesë në këtë ngjarje, veçanërisht veçoritë psikologjike të tyre<sup>5</sup>.

Në këqyrjet e vendit të ngjarjes në rastet e krimeve kundër jetës është e rëndësishme që të përcaktohet nëse ndodhemi para krimit të vrasjes, vetëvrasjes apo të një ngjarjeje aksidentale apo natyrore; “në cilin vend dhe në cilën kohë ka ndodhur vrasja?”; “cili është identiteti i viktimës?”; “sa autorë kanë marrë pjesë në kryerjen e vrasjes?”; “cila ka qenë rruga e ardhjes në vendin e ngjarjes së autorit?”; dinamika e veprimit të tij dhe rruga e largimit; “nga çfarë vendesh mund të shikohej kryerja e vrasjeve dhe a kanë qenë dëshmitarët në vende të tilla që të mund të konsiderohen dëshmitarë okularë?”; “cili është motivi i kryerjes së vrasjes?”; “kush janë autorët e dyshuar?”; etj.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet verifikimit të faktit se, “a është vendi i gjetjes së kufomës vendi i vërtetë i kryerjes së vrasjes?” Me ndihmën e ekspertit të mjekësisë ligjore duhet të përcaktohet koha e përafërt e vdekjes së viktimës, sepse përgjigjet sa më të sakta në këto dy pyetje të arta të kriminalistikës (për vendin dhe kohën), mundësojnë verifikimin më të lehtë të alibisë së mundshme të autorit të dyshuar.

### 5.1 Veprimet që kryhen në mjedisin ku është kryer vepra penale

Veprimet që kryhen nga grupi hetimor në këtë fazë kalojnë në vetvete në disa

<sup>5</sup> Skënder Begeja, *Kriminalistika* (Tiranë: P.S.H., 2015), 337.



etapa. Këto veprime synojnë në këqyrjen, zbulimin dhe fiksimin e gjurmëve dhe provave materiale që lidhen me veprimet e autorit dhe mjete që ka përdorur ai për realizimin veprës penale. Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se punonjësit e policisë që kanë marrë masat për sigurimin e vendit të ngjarjes, vazhdojnë ta mbikëqyrin atë, për siguri dhe normalitet të veprimeve që kryen në vendin e ngjarjes, deri në përfundim të saj.

*Në etapën e parë*, grupi hetimor hedh një vështrim të përgjithshëm në mjedisin ku është kryer vepra penale. Më pas bëhet fotografimi orientues dhe i përgjithshëm i mjedisit, ku është kryer vepra penale, duke i përshkruar këto të dhëna dhe në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe skicës së vendit të ngjarjes. Pastaj, në bazë të llojit dhe veçorive të ambientit ku është kryer vepra penale, përcaktohet pika e fillimit të këqyrjes, në qendër ose në periferi dhe një të njëjtën kohë përcaktohet dhe një pikë referimi që do t'i referohemi gjatë veprimeve që do të bëjmë në vendin e ngjarjes.

*Në etapën e dytë*, përcaktojmë mënyrën e lëvizjes në vendin e ngjarjes. Në varësi të veçorive që ka mjedisi, mund të përcaktohen mënyra të ndryshme për të lëvizur në vendin e ngjarjes, si p. sh., mënyrë spirale nga qendra në periferi ose nga periferia në qendër; me breza; duke e ndarë mjedisin në sektorë, etj.

*Në etapën e tretë*, fillon këqyrja dhe fiksimi i sendeve objekteve, gjurmëve dhe provave që gjenden në mjedisin ku është kryer vepra penale. Fillimisht, sendet dhe objektet që gjenden në vendin e ngjarjes këqyren, përshkruhen dhe fiksohen në gjendje statike, pra: rregullt primar në këqyrje, është se grupi hetimor këqyr dhe fikson çdo gjë që perceptohet direkt në gjendjen statike dhe, në asnjë rast nuk bëjmë përshkrime që bazohen në thëniet e dëshmitarëve apo të dëmtuarit, të cilët mund të kenë lëvizur sende dhe objekte nga vendi i ngjarjes. Në këqyrjen statike të sendeve, objekteve dhe gjurmëve, përshkruajmë çdo gjë që ka të bëjë me karakteristikat e veçanta dhe të përgjithshme të tyre si: dispozicionet e vendosjes së këtyre sendeve në raport me sendet dhe objektet për rreth, duke bërë dhe matjet përkatëse, të cilat pasqyrohen në skicën, fotografimin dhe filmimin që bëhet në vendin e ngjarjes.

Mbas këqyrjes statike, fillon këqyrja dinamike e sendeve dhe objekteve që ndodhen në vendin e ngjarjes. Kjo lloj këqyrje është e domosdoshme, pasi këqyrja statike nuk i zgjidh të gjitha problemet që lidhen me gjurmët dhe provat, pra është e domosdoshme që këto sende dhe objekte që i janë nënshtruar këqyrjes statike të lëvizin dhe të këqyren edhe ato pjesë, që nuk kanë qenë perceptuar në këqyrje statike, me qëllim kërkimin, zbulimin dhe fiksimin gjurmëve dhe provave materiale. Pra, dhe në këtë nën fazë, çdo gjë përshkruhet në procesverbal, fotografohet, skicohet, dhe mund të filmohen sipas rastit.

Veprimet e mëtejshme kanë të bëjnë me mbylljen e procesit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, e cila fiksohet në procesverbalin e këqyrjes, ku shënohet ora e fillimit dhe e përfundimit të këqyrjes, veprimet që i kryen për fiksimin e rezultateve të këqyrjes dhe nënshkrimin e procesverbalit të këqyrjes, nga të gjithë pjesëmarrësit e grupit hetimor pasi e kanë lexuar atë.

Nga përshkrimi i mësipërm del qartë se, rezultatet e këqyrjes së vendit të ngjarjes fiksohen në katër mënyra:

- përshkrimi në procesverbal; skica e vendit të ngjarjes; fotografimi; filmimi i vendit të ngjarjes.

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, është e rëndësishme që të shpjegohen edhe disa çështje të tjera të rëndësishme për hetimin, si: pozicioni i viktimës dhe autorit në momentin e vrasjes; konstruksioni fizik i autorit dhe pamja fizike e viktimës; “çfarë gjurmësh mund

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

të ketë lënë viktima mbi autorin e vrasjes?"; "a është autori i dëmtuar dhe nëse po në cilat pjesë të trupit?"; "a ka pasur përleshje dhe a i është grisur apo dëmtuar autorit, ndonjë prej veshjeve të tij?"; "a i ka viktima sendet personale (dokumente, lekë, etj.) apo janë marrë nga autori i vrasjes?"; "autori ka vepruar në terren të njohur apo të panjohur?"; "a ka përdorur autori automjete?"; etj.

## **5.2 Veprimet që kryen mbas këqyrjes së vendit të ngjarjes**

Mbas mbarimit të veprimeve në vendin e ngjarjes, grupi hetimit rikthehet edhe njëherë në pikën e fillimit, ku kemi filluar lëvizjen në mjedisin e vendit të ngjarjes, për të bërë një retrospektive të së gjithë veprimeve që janë kryer. Kjo ka për qëllim që të sigurohemi se në vendin e ngjarjes është këqyruar, fiksuar dhe vlerësuar çdo gjë; në rast të kundërt, në rast se ka rrethana që janë anashkalluar, duhet të vlerësohen, duke u këqyruar dhe t'i fiksojmë në procesverbalin e këqyrjes.

Merren masa të plota dhe të sigurt për paketimin e gjurmëve, më qëllim që ato të mos tjetërsohen dhe dëmtohen gjatë transportit. Bëhet sekuestrimi i gjurmëve dhe provave të marra nga vendi i ngjarjes. Ky lloj sekuestrimi është kompetencë e policisë gjyqësore dhe duhet gjithmonë që t'i paraprijë vënies në lëvizje të ekspertimit përkatës; përgatitjes së materialeve për kryerjen e ekspertimit kriminalistik, në varësi të gjurmëve dhe provave të fiksuara në vendin e ngjarjes dhe hartimit të vendimeve përkatëse, për të vënë në lëvizje ekspertimin kriminalistik dhe dërgimin e materialeve në laboratorin e policisë shkencore.

## **5.3 Gjurmët dhe provat në vendin e vrasjes**

Në varësi me mënyrën e kryerjes, mjetet e përdorura, vendin dhe kohën së kryerjes së vrasjes, lëvizjes dhe sjelljes së autorit para, gjatë, dhe pas kryerjes së vrasjes, si edhe faktet nëse ka bërë rezistencë viktima ose nëse pasur përleshje midis tyre në vendin e ngjarjes, është e mundur që të gjenden gjurmë dhe prova të shumëllojshme, të cilat mund të jenë të autorit apo të viktimës. Se çfarë gjurmësh do të gjenden në vendin e ngjarjes, në çfarë gjendje do të jenë ato dhe se sa do të jenë ato të rëndësishme, varet nga sa kohë ka kaluar prej ngjarjes, koha e njoftimit të policisë për ngjarjen dhe nga ruajtja që i është bërë vendit të ngjarjes.

Në vendin e ngjarjes së krimeve kundër jetës, zakonisht mund të gjenden gjurmë dhe prova, si më poshtë: gjak, spermë, fije floku, pështymë, jashtëqitje, prova të tjera biologjike (sekrecione), gjurmë daktiloskopike, gjurmë këmbësh, mbetje të thonjve, gjurmë dhëmbësh dhe pluhur, mbetje ngjyrash, rroba apo mbetje rrobash, aroma, etj. Në vendin e ngjarjes, në krimin e vrasjes, zakonisht gjendet gjurmë të gjakut të viktimës, por mund të gjenden edhe gjurmë të gjakut të autorit të vrasjes, i cili mund të jetë plagosur apo dëmtuar.

Në shumë raste, këto mjete gjenden në rrugëkalimin që ka përdorur autori i krimit, për t'u larguar nga vendi i ngjarjes. Të rëndësishme për t'u gjetur dhe ekzaminuar nëpërmjet profilit të AND-së, janë provat biologjike, si: gjaku, sperma, pështyma, fijet e flokut apo qime të tjera, mbetje në thonjtë e viktimës nga përleshja me autorin, etj.

Në vendin e ngjarjes, mund të gjenden dhe të sekuestrohen me cilësinë e provës materiale, sende të autorit të vrasjes si, shkop, çantë, çadër, orë, zinxhirë, vathë, llullë, kapelë, doreza, pallto, këpucë, çizme, sandale, atlete, pulla, copa të grisura të rrobave,

letra, kaseta, dokumente personale, dokumente të tjera, etj.

Në vartësi të llojit të mjeteve të përdorura nga autori i krimit të vrasjes, në vendin e ngjarjes mund të gjenden edhe disa gjurmë e pjesë, si dhe mjeti me të cilin është kryer vrasja. Në qoftë se vrasja është kryer me armë zjarri, në vendin e ngjarjes gjenden gjurmë të barutit, gëzhjojave, flakës, plumba, etj. Ka raste që në vendin e ngjarjes gjendet edhe arma të cilën ka përdorur autori i vrasjes.

Me interes të madh për ekspertime të mëtejshme balistike janë sidomos plumbi i shkrepur dhe gëzhjoja. Gjurmët e goditjes së gjilpërës së armës në fishek janë gjurmë identifikuese, sepse nëpërmjet ekspertizës balistike mund të vërtetohet se prej cilës armë është kryer vrasja. Në vendin e ngjarjes gjenden shumë shpesh gjurmë gjaku, i cili mund të gjendet në vetë viktimën, në mjetet e afërta, në mure, në dysheme, në tavan, etj., por gjurmë gjaku të viktimës mund të gjenden edhe në rrobat e autorit. Gjurmë të gjakut të autorit, mund të gjenden në rrobat e viktimës, në vendin e ngjarjes ose në rrugën e largimit të autorit nga vendngjarja. Në vendin e kryerjes së vrasjes mund të gjenden edhe gjurmë thonjsh, dhëmbësh, penjsh, qimesh dhe gjurmë vijash papilare të viktimës, të cilat kanë rëndësi të veçantë në qoftë se gjenden në trupin e personit të dyshuar.

Disa gjurmë të autorit mund të gjenden edhe në trupin apo rrobat e viktimës. Përveç gjurmëve të gjakut, gjurmë të tilla mund të jenë edhe gjurmët e qimeve, dhëmbëve, thonj, penjsh, etj., por edhe gjurmët e mjeteve të kryerjes së vrasjes, të cilat mund të jenë të ndryshme, në varësi të mjetit të përdorur.

Në trupin apo në rrobat e viktimës dhe autorit, mund të gjenden edhe mikrogjurmë specifike, si papastërtia nën thonj, ku mund të ketë gjurmë të gjakut, lëkurës ose veshjes së autorit apo të viktimës. Këto mikrogjurmë janë të rëndësishme për përcaktimin e mënyrës së kryerjes së vrasjes dhe dinamikës së ngjarjes kriminale. Gjurmët dhe provat e gjetura në vendin e ngjarjes, kanë rëndësi të madhe për ecurinë e hetimit dhe identifikimin dhe arrestimin e autorit të vrasjes. Këto gjurmë dhe prova do shërbejnë si bazë për ngritjen e versioneve hetimore, por edhe për vazhdimin e ekzaminimeve të mëtejshme kriminalistike nëpërmjet kryerjes së ekspertimeve të ndryshme.

#### 5.4 Këqyrja e kufomës

Dëshmia kryesore, se gjendemi para krimit të vrasjes është trupi pa jetë që gjendet në vendin e ngjarjes, prandaj gjetjes së kufomës duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Trupi pa jetë gjendet zakonisht në vendin e ngjarjes, por mund të bëhet edhe transportimi i tij për t'i dhënë ndihmën e shpejtë dhe për pasojë trupi mund të gjendet në qendrat spitalore. Trupi i viktimës, mund të gjendet edhe në vende të tjera, ku mund ta ketë dërguar autori i vrasjes, me qëllim fshehjen, asgjësimin, varrosjen, krijimin e rrethanave të rreme me viktimën, etj. Në të gjitha rastet, kufoma i nënshtrohet këqyrjes në vendin e ngjarjes, por edhe kryerjes së autopsisë në ambientet e mjekësisë ligjore ose në spitale.

Të gjitha elementet e përshkrimit dhe kontrollit, evidentohen në procesverbalin e këqyrjes së kufomës dhe fotografohen. Me rëndësi të veçantë, është kontrolli i jashtëm i kufomës. Ai duhet të jetë i detajuar, sepse gjatë transportimit të kufomës për në morg, mund të ndryshojnë ose të asgjësohen gjurmë të rëndësishme, të cilat mund të mos jenë gjetur gjatë këqyrjes, por edhe që të mos shfaqen gjurmë që nuk kanë të bëjnë me veprën penale të vrasjes dhe autorin e saj, të cilat mund të ndikojnë negativisht në rrjedhën e hetimeve dhe në ngritjen e versioneve hetimore.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Në vendin e ngjarjes ndërmerren masa për përcaktimin e identitetit të kufomës, në përputhje me procedurat kriminalistike për këtë qëllim, sepse ky fakt është i rëndësishëm për krijimin e versioneve dhe për planifikimin e rrjedhës së mëtejme të përpunimit kriminalistik. Vendi i gjetjes së kufomës duhet të fiksohet saktë në procesverbalin e këqyrjes dhe në skicën e vendit të ngjarjes. Është i domosdoshëm edhe përshkrimi i detajuar i pozicionit në të cilën është gjetur kufoma, sidomos i pozicionit së duarve e këmbëve. Është me interes të veçantë, që të përshkruhen edhe gjërat që mund të gjenden në duart e viktimës, si dhe gjendja e rrobave dhe e këpucëve. Pasi bëhet fiksimi i kufomës në procesverbal, eksperti kriminalist duhet ta fotografojë kufomën në kuadrin e përgjithshëm të vendit të ngjarjes, pastaj do ta fotografojë kufomën më gjurmët e dukshme, duke pasur kujdes që gjurmët të fotografohen me fotografi të veçanta.

Këqyrja e kufomës bëhet sipas rregullave kriminalistike të përshkrimit të personit dhe duhet të përmbajë gjininë, gjatësinë, moshën, ngjyrën dhe formën e flokëve, hundës, syve, veshëve dhe syve. Qëllimi i këqyrjes së kufomës është gjetja e gjurmëve dhe provave materiale që mund të gjenden në trupin apo në rrobat e tij. Vëmendja përqendrohet në gjetjen e gjurmëve të autorit të krimit, si dhe të gjurmëve të dheut në këpucët, duart apo rrobat e viktimës, me qëllim të përcaktimit të vendit të gjetjes së kufomës dhe vendit të kryerjes së vrasjes. Mjeku ligjor përshkruan në mënyrë të detajuar të gjitha dëmtimet e dukshme tek viktima, si dhe prezencën e njollave kufomore ose të shtangimit të kufomës.

*Nga këqyrja e kufomës dhe autopsia mund të marrin përgjigje një sërë çështjesh në interes të hetimit, si:*

- Cili është shkaku i vdekjes?
- Çfarë dëmtimesh e plagësh ekzistojnë, përveç dëmtimeve e plagëve vdekjeprurëse?
- Me çfarë mjeti janë shkaktuar dëmtimet?
- Cilat dëmtime janë shkaktuar kur trupi ka qenë i gjallë dhe cilat pas vdekjes?
- Kur ka ndodhur vdekja?
- A ka dëmtime që mund të jenë shkaktuar gjatë përleshjes apo mbrojtjes?
- A ka qenë viktima në gjendje të dehur?
- A ka vuajtur viktima nga ndonjë sëmundje dhe cili ka qenë ndikimi i saj në vdekje?
- A janë gjetur në duar apo nën thonj mikrogrurmë dhe çfarë?
- A ka viktima dëmtime ose ndryshime specifike që mund të jenë indikativë në raport me autorin (gërvishtje me thonj, kafshim me dhëmbë, fije flokësh, mjekre, etj.)?

### **5.5. Provat që gjenden në vrasjet me armë zjarri**

Praktika hetimore e gjyqësore, po përballet me vepra penale ku si mjet i kryerjes së saj është përdorimi i armëve të zjarrit<sup>6</sup>. Armët e zjarrit përdoren si mjete në krimet kundër jetës së personit, vjedhje me dhunë, vjedhje me armë, vjedhje me pasojë vdekjen, në veprat terroriste etj. Zgjidhja e problemeve balistike, gjatë hetimit të këtyre veprave penale, ku janë përdorur armët e zjarrit është e lidhur me një sërë problemesh të tjera taktike, teknike dhe metodike kriminalistike, që në tërësinë e tyre bëjnë të mundur hetimin, gjykim të shpejtë objektiv e të plotë të veprave penale.

<sup>6</sup> Ilirjan Mandro, *Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri* (Tiranë: Ilar, 2002), 9.

Nëse arma e zjarrit gjendet në vendin e ngjarjes, duhet vepruar me kujdes për gjetjen, fiksimin dhe sekuestrimin e saj. *Së pari*, duhet të gjendet, të fotografohet dhe të përshkruhet në procesverbal. Paketimi i armës së zjarrit duhet të bëhet me kujdesin më të madh. Kujdesi është i nevojshëm për shumë arsye. *Së pari*, arma mund të jetë e mbushur me fishek në follenë e fishekut. *Së dyti*, gjatë paketimit mund të dëmtohen gjurmët e vijave papilare në armë. Në rastin e parë është e nevojshme që arma të vendoset në siguresë, të nxirret krehri, dhe me kujdes të nxirret fisheku nga foleja e fishekut. Nëse është e mundur, para ekzaminimit daktiloskopik arma mund të preket vetëm me dorëza dhe, në pjesët në të cilat është e sigurt se nuk mund të gjenden gjurmët e vijave papilare. Arma pakëtohet në kuti kartoni, në mënyrë të tillë që ajo të fiksohet që të mos lëvizë dhe të mos dëmtohen gjurmët gjatë transportit. Bashkë me armën e zjarrit, për ekspertim është e nevojshme të dërgohet municioni i nxjerrë nga krehri.

Për identifikimin e armës, nga e cila është kryer qitja, është e nevojshme që nga arma e dërguar të realizohen disa qitje prove, në mënyrë që të konstatohet nëse gjurmët në predha dhe në gëzhoja i përgjigjen tytës së armës së zjarrit të dërguar për ekzaminim.

Predha është pjesa luftarake e fishekut. Çdo predhë e shkrehur ka energji të madhe kinetike, e për këtë arsye edhe fuqi të madhe depërtuese. Në bazë të predhës, si gjurmë mund të bëhet identifikimi i tytës përmes së cilës është shkrehur. Është e njohur, se predhat depërtojnë më lehtë në materiale të buta, e ndër të tjera kalojnë mjaft lehtë përmes trupit të njeriut dhe të kafshës. Nëpërmjet materieve gjysmë të forta, predhat kalojnë pjesërisht deri sa të mos humbin energjinë e vet dhe të ndalen, ndërsa nëpërmjet materialeve të forta nuk kalojnë, por deformohen dhe shkatërrohen, kjo në varësi të konstruksionit të vetë predhës.

Në shumë raste, në vrasjet me armë zjarri gjenden dhe sekuestrohen predha të rikoshetura, por që edhe ato kanë vlera identifikuese dhe duhen sekuestruar dhe nënshtruar ekspertimeve vlerësuese e krahasuese. Predhat që kanë mbetur në trupin e viktimës, si pasojë e veprimit të armës së zjarrit, nxirren nëse viktimja është e vdekur; ato gjenden dhe nxirren gjatë autopsisë dhe në rastet kur viktimja është plagosur, predhat nxirren gjatë ndërhyrjes kirurgjikale.

Vështirësia më e madhe gjatë hetimit të vrasjeve, me përdorim të armës së zjarrit është gjetja e predhave. Në çdo rast të gjetjes së predhave, është e domosdoshme që ky veprim të pasqyrohet në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe të sekuestrimit të provave materiale. Gjithashtu, në këto raste, vendi i gjetjes së predhave duhet të skicohet dhe të fotografohet. Paketimi i predhave të gjetura bëhet në qese PVC ose në qese letre, dërgohet në policinë shkencore dhe u nënshtrohet ekspertimeve të nevojshme. Në rastet e vrasjeve me armë zjarri, gëzhojat zakonisht gjenden në vendin e ngjarjes, sepse dinamika e ngjarjes pengon autorin që t'i gjejë dhe t'i fshehë ato. Gjurmët në gëzhojë formohen për shkak të veprimit të shulit, nxjerrësit, jashtëqitësit, të gjilpërës goditëse, të folesë së fishekut dhe të krehrit të municionit. Rëndësia kriminalistike e gjurmëve në gëzhoja dhe të gëzhojës si gjurmë, qëndron në faktin se mbart një sërë karakteristikash identifikuese individuale dhe grupore. Menjëherë, në vendin e ngjarjes në bazë të gëzhojës, mund të përcaktohet kalibri i armës së zjarrit nga e cila është realizuar qitja dhe në disa raste edhe lloji i armës. Pas ekspertimit të gëzhojave të gjetura në vendin e ngjarjes, nëpërmjet ekspertimit balistik mund të identifikojmë edhe armën konkrete me të cilën është kryer vrasja.

Në vrasje me armë zjarri, në shumë raste gjenden në vendin e ngjarjes, në trupin e viktimës ose në duart apo rrobat e autorit bloza e barutit dhe një numër i vogël i

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

grimcave gjysmë të djegura ose të padjegura të barutit. Grimcat e padjegura ose gjysmë të djegura të barutit dhe bloza e barutit dalin nga tyta pas shkrehjes së predhës, kurse një pjesë e vogël e djegies së barutit dhe e grimcave të padjegura, ose gjysmë të djegura të barutit, dalin gjatë procesit të nxjerrjes së gëzhhojës dhe bien në dorën e qitësit, me të cilën është realizuar qitja, dhe në disa raste, edhe në rrobat e qitësit. Në bazë të këtyre gjurmëve, mund të bëhet vlerësimi i largësisë nga e cila është realizuar qitja, si dhe mund të identifikohet qitësi në rastin e gjetjes së gjurmëve të tilla, në duar ose në rroba. Këto gjurmë, mund të gjenden si tek viktimja, ashtu edhe tek autori i vrasjes.

Dallimi themelor midis municionit të gjuetisë dhe të municionit luftarak, qëndron në faktin që, fisheku i gjuetisë është i mbushur me saçme dhe nuk përmban predhë si municion luftarak. Saçmat nuk janë të atilla që të mund të bëhen ekzaminime paraprake. Në saçme mbesin vetëm gjurmët statike dhe dinamike. Gjurmët statike nga veprimi reciprok i saçmës, kurse gjurmët dinamike nga muret e brendshme të tytës së armës. Gjurmët varen nga madhësia e saçmës; sa më e madhe që të jetë saçma, aq më të mëdha janë edhe gjurmët. Përveç saçmës, nga arma e gjuetisë, pas shkrehjes del tapa e kartonit me të cilën është mbyllur fisheku, pastaj shtupa që gjendet midis mbushjes së barutit dhe të saçmës. Edhe tapa e kartonit edhe shtupa, bëjnë pjesë në gjurmë specifike të armës së gjuetisë me tytë të lëmuar. Nëse gjurmët e mësipërme dhe fisheku gjenden në vendin e ngjarjes, fiksohen dhe paketohen në të njëjtën mënyrë si edhe gëzhhojat, dhe me pas, u nënshtrihen ekspertimeve të nevojshme me synim identifikimin e armës së gjuetisë, që është përdorur si mjet për kryerjen e krimit.

## 5.6 Provat biologjike në krimet kundër jetës

Përdorimi i teknikave të gjenetikës molekulare në përcaktimin ose ndërtimin e të ashtuquajturit profil gjenetik i individit është shndërruar sot në një nga mënyrat kryesore të identifikimit të personave për arsye nga më të ndryshmet, penale dhe civile.

Biologjia e mjekësisë ligjore është një aplikacion i biologjisë (gjenetika, biokimia dhe biologjia molekulare) që aplikohet në zgjidhjen e disa problemeve që ngrihen në lidhje me administrimin e drejtësisë<sup>7</sup>. Kjo është një shkencë që ushtrohet në shërbim të ligjit. Më praktikisht ajo është studimi i gjakut dhe materialeve të tjera fiziologjike dhe ka të bëjë me përcaktimin e një fakti që mund të jetë një shqetësim/problem, në një hetim ligjor mjekësor. Analiza e gjurmëve dhe mikrogjurmëve, me origjinë organike dhe inorganike është objekt i shkencave ligjore si biologjia ligjore, kimia ligjore dhe fizika ligjore. Me mikrogjurmë do të kuptojmë: “*formimet tërësore lëndore pak të dukshme ose të padukshme nga syri i njeriut.*”<sup>8</sup>

Duke u nisur nga ky kuptim për mikrogjurmët, vërejmë se ato për efekt studimi ndahen në katër grupe kryesore: 1. gjurmët me origjinë biologjike; 2. me prejardhje organike; 3. me prejardhje inorganike; 4. me prejardhje të përzier.

ADN ose ndryshe *Acidi Dezoksiribonukleik*, është emri i një kompleksi kimik që gjendet pothuajse në çdo qelizë të organizmit<sup>9</sup>. ADN-ja është e njëjtë në të gjitha qelizat e të njëjtit organizëm. Në provë AND-je mund të përfitohet nga çdo gjë biologjike, që gjendet në vendin e ngjarjes ose që mund të sekuestrohet gjatë hetimeve, të tilla prova biologjike mund të përmendim gjak, spermë, flokë, inde, eshtra, organe, pulpë dhëmbi,

<sup>7</sup> Sokrat Meksi dhe Bardhyl Çipi, *Mjekësia Ligjore* (Tiranë: Arbëria, 2003), 10.

<sup>8</sup> Skënder Begeja, *Kriminalistika* (Tiranë: 2005), 44.

<sup>9</sup> Luan Memushi, *Biologjia Humane* (Tiranë: SHBLU, 2006).

sekrecione trupore, lot, pështymë, djersë, urinë, thonj, etj. ADN-ja i shërben hetimit për identifikimin e mbetjeve/gjurmëve; sigurimin e një raporti për çdo person të veçantë, të ndodhur në një vend të caktuar; përcaktimin e pronësisë së sendeve personale, të tilla si veshjet, etj; lidhjet familjare përcaktuese në interes të hetimit.

Është e rëndësishme që provat biologjike në vendin e ngjarjes, duhet të kërkohen, zbulohen, fiksohen, merren dhe paketohen duke respektuar procedurat standarde me qëllim dërgimin e tyre në laborator të padëmtuara dhe të mbrojtura nga ndikimi i faktorëve të jashtëm që mund të tjetërsojnë përmbajtjen e këtyre provave të rëndësishme. Materialet biologjike që hasen më shpesh në vendngjarjet kriminale dhe, që prej të cilave mund të përftohet profili i ADN-së, janë: gjak, pështymë, sekrecione vaginale, spermë, fije floku etj<sup>10</sup>.

### 5.6.1 Llojet e provave biologjike

1. *Gjaku dhe njollat e gjakut.* Gjaku është një lëng që përbëhet nga komponentë qelizorë si: qelizat e kuqe të gjakut, qelizat e bardha të gjakut, trombocitet. Gjaku në gjendje të lëngët, menjëherë pas ndodhjes së krimit, ose në gjendje të thatë kur ka kaluar një kohë, janë kategoria më e rëndësishme e gjurmëve dhe mikrogjurmëve biologjike në thuasje të gjitha llojet e vrasjeve. Vendi i ngjarjes ku kanë ndodhur vrasja, përmban gjithmonë mbetje gjaku, të cilat shpesh duke qenë në sasi deri mikroskopike, nuk tërheqin vëmendjen për t'i zhdukur ato. Gjaku është një burim i mirë për të përcaktuar profilin e ADN-së<sup>11</sup>. Sasia që kërkohet për të analizuar ADN-në është reduktuar gradualisht me kalimin e viteve, duke qenë se teknika ka përparuar dhe është bërë gjithnjë e më e ndjeshme. Tashmë njolla shumë të vogla (me madhësi përafërsisht 1 mm) mund të analizohen me anë të substratit ku ndodhet njolla, pavarësisht se njolla mund të jetë trajtuar më parë.

Kushtet e gjetjes së njollës dhe mosha e njollës, kontribuojë në suksesin për të siguruar një profil ADN-je. Me rëndësi për të pasur sukses në përfitim të një profili ADN-je, është që objektet të cilat kanë ende një njollë gjaku të njomë, duhet të thahen në mënyrë të natyrshme përpara se të paketohen; pra procesi i tharjes nuk duhet përshpejtuar, dhe nëse është e mundur, është mirë që i gjithë sendi/objekti, mund ose duhet të dërgohet në laborator. Përcaktimi i profilit të ADN-së së njollave të gjakut, paraqet rëndësi të madhe në llojet e krimeve si, vrasje, plagosje, etj., pasi mund të shërbejë për identifikimin e autorit, pavarësisht alibive të tij apo edhe si një provë përjashtuese, për persona të tjerë të dyshuar.

2. *Njolla sperme, materiali vaginal, pështymë, materiale feçe dhe urinë.* Këto njolla kanë rëndësi të veçantë në krimet seksuale për vërtetimin e aktit seksual të kryer dhe për zbulimin e autorit të krimit.

- *Sperma* mund të klasifikohet në dy kategori:

a) *Spermë me spermatozoid*, spermë e përfutur nga një mashkull me shëndet normal, që përmban spermatozoid që janë të pasur me ADN. Metoda e përdorur e ekstraktimit e veçon spermën nga materiali tjetër qelizor, si për shembull qelizat vaginale.

b) *Spermë pa spermatozoide.* ADN-ja mund të sigurohet nga qelizat që bien gjatë derdhjes së spermës. Sperma, kur bije në tesha thithëse, krijon njolla në ngjyrë hiri, të cilat e forcojnë rrobën kurse në lëkurën e trupit, në objekte jothithëse, sperma duke u

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>10</sup> Sokrat Meksi, *Mjekësia Ligjore për Shkencat Juridike* (Tiranë: 2009).

<sup>11</sup> Sokrat Meksi dhe Bardhyl Çipi, *Mjekësia Ligjore* (Tiranë: Arbëria, 2003).

tharë, formon një shtresë sipërfaqësore, si luspa të shndritshme. *Sperma dhe njollat e spermës*, mund të gjenden në rastet e krimeve seksuale, por veçanërisht e rëndësishme është në rastet kur nga krimet seksuale ka ardhur si pasojë vdekja e të dëmtuarës. Identifikimi i spermës në mostrat vaginale dhe/ose në rrobat e viktimës mund të ndihmojnë në vërtetimin e pretendimeve të viktimës dhe analiza e ADN-së mundëson identifikimin e burimit të spermës.

- *Pështyma*. ADN-ja në pështymë mund të analizohet nga një shumëllojshmëri substraktesh, për shembull mund të jetë tek bishtat e cigares, njollë pështyme në maska, enët që përdoren për të pirë lëngje, pullat/kapaku i zarfit, njolla pështyme që përdoren për të zënë gojën, artikujt ushqimore, etj. Në hetime, prania e pështymës mund të vërtetojë deklarin e viktimës ose dëshmitarit si dhe mund të sigurojë profilin e ADN-së së autorit të veprës penale. Është e rëndësishme që mostrat e pështymës të merren, si nga i dyshuari ashtu edhe nga viktimja.

- *Sekrecionet vaginale ose lëngu vaginal*, përmban qeliza nga shtresa e brendshme e vaginës dhe si rrjedhim përbën një kampion të përshtatshëm për analizë ADN-je. Kjo mund të gjendet në rastet e krimeve seksuale, në pjesën e jashtme të prezervativit ose në sende që janë përdorur për të sulmuar seksualisht një viktimë, në veshje apo në trupin e autorit të veprës penale apo në materiale të përdorura prej tij.

- *Materiale feçe*, mund të gjenden në vendin e ngjarjes, në ambientet të cilat ka përdorur autori etj. Jashtëqitjet sigurojnë një burim të mirë për ADN-në mitokondriale.

- *Urina*. Nga qelizat e urinës, gjithashtu mund të nxirret ADN-ja.

3. *Flokë dhe qime*. Janë prova materiale që takohen shpesh në praktikë në ngjarje të ndryshme si vrasje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhje me thyerje etj. Ato janë mjaft rezistente ndaj agjentëve të shkatërrimit, prandaj gjenden në vendin e ngjarjes edhe pas një kohe të gjatë<sup>12</sup>. Flokët dhe qimet mund të gjenden në trupin e teshat e viktimës ose së të dyshuarit, në mjetet, veglat ose armët me të cilat është kryer krimi, etj.

Kampionet e fijeve të flokut, të shkullura, (që përmbajnë materialin e rrënjës), janë një burim i mirë ADN-je<sup>13</sup>. Rezultatet, ndonjëherë, mund të sigurohen edhe nga një rrënjë e vetme floku. Nga ana tjetër, rrënjët e fijeve të flokut që bien, janë të vdekura dhe megjithëse ato janë të papërshtatshme për profil STR, ato mund të sigurojnë një burim të pasur për ADN-në mitokondriale. Është shumë e rëndësishme që të kemi një këqyrje të kujdesshme, me qëllim gjetjen, fiksimin dhe marrjen e flokut të gjetur në vendngjarje, të cilat më pas do të përdoren për përfitim e profilin të ADN-së. Flokët e rëna duhet të mbliidhen veçmas dhe jo të grumbullohen bashkë, në qoftë se flokët nuk janë në mënyrë të dukshme në një tufë.

4. *Mbetje të indeve trupore*. Në këtë grup, hyjnë mbetjet prej indesh të buta dhe prej eshtrash. Ato gjenden sidomos në ngjarje të vjetra ku kanë ndodhur vrasje, avari e aksidente në pune, në transport, etj. Në varësi të kohës që ka kaluar nga data e ngjarjes dhe ndikimit të kushteve atmosferike, mbetje indesh të buta e kockore, paraqiten në gjendje të freskët, të dekompozuar, të mumifikuar (të thatë), ose të skeletizuar. Midis këtyre mbetjeve, një rëndësi të veçantë kanë pjesëzat e lëkurës që mund të mbeten nën thonj, të përziera ose jo, me gjak dhe pjesëza flokësh ose qimesh, si dhe me materiale të tjera si, pluhur, grimca dheu ose llaçi, fije stofi, pjesëza ushqimore e të tjera, të cilat

<sup>12</sup> Njeriu ka 100-150 mijë fije floku e qime; çdo ditë i bien 30-100 fije, kështu që i gjithë floku e qimet ndërrohen për 5-6 vjet, rritet 0,4 mm në ditë, tek kufoma e mashkullit pas vdekjes rritet 0,5 mm në ditë del në embrion në muajin e tetë dhe kur lind kanë gjatësi 2-3 cm, ndërsa janë përgjysmë më të holla se në moshë të pjekur.

<sup>13</sup> Sokrat Meksi dhe Bardhyl Çipi, *Mjekësia Ligjore* (Tiranë: Arbëria, 2003).



shfrytëzohen sipas kërkesave të ekzaminimit të mikrogjurmëve për identifikimin e autorit të krimit. Kocka dhe dhëmbët, janë prezentë në raste të këqyrjeve kur gjenden kufoma të dekompozuara ose gjenden mbetje kockore, të kafkave, etj., po kështu këto prova janë prezentë edhe në rastet kur gjenden kufoma të mbytura në ujë, etj.

### 5.6.2 Kërkimi i provave biologjike

Kërkimi i provave biologjike, është një proces i rëndësishëm që kërkon një vëmendje të posaçme nga grupi hetimor dhe në mënyrë të veçantë nga eksperti kriminalist dhe mjeku ligjor që këqyr vendin e ngjarjes. Ky proces orientohet mbi vetë viktimën, rreth saj, mbi autorin e krimit dhe tek mjetet e kryerjes së krimit<sup>14</sup>.

*Mbi viktimën*, ato zakonisht ndodhen në pjesët e ndryshme të teshave të saja (përpara, ose prapa, në pjesët e brendshme, etj.) ose mbi vetë trupin në kavitetet natyrale (hundë, gojë, veshë, organe gjenitale).

*Rreth viktimës*, ato duhen kërkuar mbi tokë, mure, dysheme, doreza dyersh dhe dritaresh, parmakë shkallësh, sirtarë, skaje tavolinash, pajisjet hidrosanitare etj. Qëllimi është që të evidentohen mbetje biologjike të autorit, por edhe ato që nuk i takojnë atij, por personave të tjerë bashkautorë të krimit.

*Tek autori* ato duhen kërkuar në duar, në parakrahë e pjesë të tjera të trupit. Kujdes u duhet kushtuar vendeve pak të ekspozuara si, pjesëve ndërmjet gishtave, nën thonj, flokë etj. Tek teshat kërkimi përqendrohet sidomos tek vendet e fshehta: xhepat, manshetat, tegelat e rrobave dhe të këpucëve, etj.

*Tek mjetet e kryerjes së krimit*, sidomos mbetje gjaku duhen kërkuar në pjesët që kanë kontaktuar me viktimën si tehu e maja e thikës, pjesët bashkuese të tehut me dorezën, tyta e armës etj., por edhe tek pjesët mbajtëse, si dorezat, ku depozitohet gjak nga duart e autorit.

Në kërkimin e flokëve dhe qimeve në vendin e ngjarjes, duhet pasur parasysh fakti se ato, sipas intensitetit të kontaktit, kalojnë nga i dëmtuari tek agresori ose mjeti i përdorur dhe anasjelltas. Tek viktimja flokë dhe qime nga të autorit, gjenden në duart sidomos nën thonj, dhe në teshat e veta; tek i dyshuari në trupin e në teshat si dhe në mjetet ose armët e përdorura prej tij; në automjetet nëpër sedilje dhe në pjesët me të cilat është goditur viktimja, etj. Kërkimet për njollat e gjakut dhe mbetjet e tjera biologjike, duhen bërë në gjithë territorin dhe objektet e vendit të ngjarjes, duke i këqyru ato me kujdes në mënyrë sistematike. Kërkimi në terren të hapur është më i vështirë, por duhet bërë dhe të këqyren me vëmendje fijet e barit, gjethet e bimëve etj., ku edhe pas shiut, dëborës e faktorëve të tjerë atmosferike mund të kenë mbetur gjurmë gjaku.

### 5.6.3 Studimi i mbetjeve biologjike në vendin e ngjarjes

*Studimi i mbetjeve biologjike në vendin e ngjarjes* na mundëson shpjegimin e mekanizmit të ngjarjes dhe përcaktimin e disa karakteristikave të autorit. Mbetjet e gjakut, në vendin e ngjarjes mund të gjenden: në formën e një “pellgu”, të një “njollë” të lëngshme ose të thatë, të një “pike” ose rrugë pikash, të një gjurmë në formë rrëshqitje ose zvarritje ose të spërkave të depozituara në objekte të ndryshme. Pavarësisht nga forma e depozitimit, nga studimi i tyre në vendin e ngjarjes, mund të përcaktohet nëse vendi i gjetjes së kufomës është edhe vendi i ekzekutimit. Gjetja e një sasive të vogël gjaku pranë viktimës, është tregues se ai nuk është ekzekutuar aty,

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>14</sup> Bardhyl Çipi, *Mjekësia Ligjore* (Tiranë: 2003).

por është transportuar pas vrasjes.

Në bazë të shtresave që ka kaluar, p.sh. disa çarçafë ose dysheku, llogaritet sasia e gjakut dhe mbi këtë bazë përcaktohet nëse është pikërisht aty vendi i vrasjes. Në bazë të numrit të madh të pllakave të parketit në banesë, tek të cilat konstatohen mbetje gjaku, edhe pasi ai të jetë larë, përcaktohet se aty është vendi i vrasjes së viktimës. Mungesa e gjakut pranë trupit (shtratit) të kufomës, është tregues i një transportimi pas vdekjes; gjurmët e fshirjes në teshat e viktimës janë tregues i zvarritjes së tij pas plagosjes ose vrasjes; spërkat e gjakut në shpinën e dorës së autorit, në teshat ose pjesë të fytyrës e trupi të tij, janë tregues i autorësisë së tij etj.

Drejtimi dhe shpejtësia e largimit e autorit të plagosur nga vendi i ngjarjes mund të përcaktohet nëse në rrugë ka pika gjaku, ndërsa largësia dhe ritmika e rënies së pikave midis tyre tregon nëse ka vrapuar ose ka ecur normalisht, nëse pikat vijnë duke u shpeshtuar ose pakësuar në vartësi të koagulimit të gjakut ose shtimit të hemorragjisë.

pozicioni i viktimës në momentin vdekjes, mund të përcaktohet nga drejtimi i rrjedhjes së gjakut të koagulluar në fytyrë dhe trupin e viktimës.

Flokët dhe qimet e zbuluara në vendin e ngjarjes, apo tek viktima, ndihmojnë për të përcaktuar nëse aty është zhvilluar përlëshje midis viktimës dhe autorit; nga mundësia e gjetjes së tipave të ndryshme, mund të arrijmë në konkluzionin nëse janë më shumë se një autorë (*nga ngjyra, gjatësia, forma e flokëve dhe qimeve të gjetura*); mjeti i përdorur (*nëse gjenden pika gjaku, fije floku e qime të prera ose të këputura, etj*); *kur kemi zhvendosje të viktimës*, nëse është përdorur automjeti i gjetur afër vendit të ngjarjes për të transportuar kufomën etj.

Njollat e spermës, dhe lëngjet vaginale, në pamje serologjiko-ligjore vlejné për të përcaktuar grupet A, B dhe AB të gjakut të personit, ndërsa nuk shërbejnë për grupin "O", të cilin e kanë rreth 40% e popullatës së botës. Nëpërmjet njollave të spermës, lëngut vaginal e pështymës, përveç disa konkluzioneve për faktin nëse ka ndodhur ose jo krimi dhe përcaktimit të rrethanave të tjera që kanë lidhje me natyrën e tij, më tej ato shërbejnë për identifikimin e personit nëpërmjet ADN-së.

Mbi bazën e këtyre konstatimeve mund të rikonstruktohet skena e ngjarjes (bëhet një tip retrospektive e ngjarjes), e cila ndihmon për të shpjeguar dinamikën dhe mekanizmin si ka ndodhur ngjarja, për të përcaktuar vendet se ku mund dhe duhen kërkuar gjurmët e provat materiale. Interpretimi i mbetjeve të gjakut, sasia, shpeshësia, forma e tij, në vendin e ngjarjes, që ndihmon për të rikonstruktuar e imagjinuar mënyrën si ka ndodhur ngjarja, është me vlerë për hetimin e nisur, për të kuptuar nëse jemi përpara një veprë penale dhe për të zbuluar autorin apo autorët e saj, por nga ana tjetër kërkon përgatitje të oficerëve të policisë gjyqësore dhe të ekspertëve kriminalistë, për të bërë një interpretim të drejtë të provave të gjetura, të cilat ndihmojnë në ecurinë e hetimeve në ngritjen e versioneve hetimore, etj.

## 5.6 Identifikimi i viktimës

Identifikimi i viktimës është një veprim mjaft i rëndësishëm hetimor, i cili i hap rrugë vazhdimit të suksesshëm të hetimeve në tërësi, por ngritjes së versioneve hetimore në veçanti. Në këtë kuadër zakonisht viktimat identifikohen në vendin e ngjarjes nga dëshmitarët, të afërmit apo persona të njohur. Shpeshherë viktimat kanë me vete dokumente identiteti që lehtësojnë identifikimin e tyre.

Për identifikimin e viktimave përdoren metoda kriminalistike ku krahasohen

shenjat juridike, faktike dhe biologjike sipas të cilave një person dallon nga të tjerët. Çdo person merr shenja juridike në bazë të dispozitave ligjore (emrin, mbiemrin, gjendjen familjare, shtetësinë, vendbanimin, etj.). Këto shenja mund të zbatohen në mënyrë të njëjtë ashtu si janë fituar. Njeriu i fiton shenjat faktike që në lindje (datën e lindjes, vendin e lindjes, përkatësinë nacionale, etj.). Edhe këto shenja janë plotësisht të pavarura nga vullneti i njeriut.

Në kuptimin kriminalistik, rol kryesor ka për përcaktimi i identitetit të personit në kuptimin biologjik, nëpërmjet të ashtuquajturit identitet biologjik. Shenja me karakter biologjik janë: përmbajtje materiale të identitetit të individit dhe qenia e identitetit të tij.

## 7. Zbulimi i autorit të vrasjes

Për zbulimin e autorit të veprës penale të vrasjes, menjëherë pas njoftimit për kryerjen e saj është e rëndësishme që nga strukturat e policisë përgjegjëse për hetimin e krimeve të rënda të kryhen veprime hetimore e gjurmuese objektive dhe të shpejta. Suksesi në zbulimin e autorëve të vrasjeve dhe arrestimin e tyre, varet shumë nga veprimet urgjente dhe të njëkohshme e masave dhe veprimeve të caktuara, gjurmuese dhe hetimore, me qëllim të zbulimit të autorit, në njërën anë, dhe sigurimit të gjurmëve e provave materiale, në anën tjetër. Puna për zbulimin e autorit të vrasjes, varet shumë edhe nga koha e kaluar prej kryerjes së vrasjes e deri tek marrja dijani, nga strukturat e policisë për ngjarjen.

Në rastet kur policia merr dijani për vrasjen, pasi ka kaluar një kohë të konsiderueshme, nuk është e nevojshme ndërmarrja e këtyre operacioneve masive dhe vënies në lëvizje të një numri të madh forcash dhe mjetesh. Në raste të kësaj natyre veprimet hetimore, por edhe gjurmuese fillojnë me këqyrjen e vendit të ngjarjes, këqyrjen e kufomës, pyetjen e dëshmitarëve si dhe me kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore që do hedhin dritë mbi rrethanat e ndodhjes së krimit. Mbi bazën e fakteve dhe provave të grumbulluara, krijohen versionet hetimore dhe planifikohet e gjithë veprimtaria gjurmuese, për verifikimin dhe ndjekjen e versioneve të ngritura.

Është e rëndësishme që në raste të kësaj natyre, të bëhet identifikimi i kufomës dhe të analizohet veprimtaria e viktimës dhe mënyra e jetesës, konfliktet e mundshme, arsyet se përse viktimja është gjendur në këtë vend, lidhjet shoqërore dhe kriminale të mundshme të viktimës, numrat e telefonit dhe aparatet telefonik në përdorim. Merren të dhëna për personat që e kanë parë së fundmi viktimën, për personat që kanë komunikuar së fundmi në telefon, si dhe për personat që e kanë gjetur viktimën në vendin e ngjarjes, rrethanat e gjetjes, etj. Me qëllim që të sqarohet fakti nëse kemi të bëjmë me vrasje, vetëvrasje apo ngjarje aksidentale, është e nevojshme që të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të kryhen ekspertimet kriminalistike por nëse është e nevojshme edhe eksperimente hetimore që do të bëjnë të mundur sqarimin e trilemës së mësipërme. Është shumë e rëndësishme që grupi hetimor të punojë në unison dhe të kryhen analiza të vazhdueshme për të arritur në konkluzione të drejta dhe objektive.

Puna gjurmuese operative, është shumë e rëndësishme për zbulimin e autorëve të vrasjes dhe realizohet, nga specialistët e krimeve kundër jetës në drejtoritë vendore të policisë dhe, në komisaritet e policisë të rretheve gjyqësore. Është shumë e rëndësishme që në ngjarje të tilla të përfshihen në kryerjen e detyrave gjurmuese edhe specialistët të tjerë të policisë e kryesisht, specialistët të policisë që mbulojnë territorin. Aktivizimi i sa

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

më shumë burimeve të informacionit, është i rëndësishëm për zbulimin dhe dokumentimin ligjor të këtyre krimeve të rënda. Të afërmit e viktimës janë një burim i pazëvendësueshëm informacioni dhe, vendosja e marrëdhënieve korrekte me ta, dhe ndihma e mbrojtja e tyre në çdo rast, duhet të vlerësohet nga strukturat që merren me hetimin dhe gjurmimin e krimeve të rënda.

Nëse vrasja është kryer në ndonjë objekt të njohur, ku ka qarkullim të madh të njerëzve si, park, hotel, motel, parking, garazh, etj., është e nevojshme të grumbullohen të gjitha të dhënat, të cilat mund të jenë me interes për hetimin e vrasjes dhe zbulimin e autorit. Gjithashtu, është me interes të merren masa që të sigurohen të dhëna mbi të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur në atë vend në periudhat e mëparshme, të cilat mund të kenë lidhje me ngjarje, qoftë sipas mënyrës së kryerjes, qoftë sipas kohës dhe mjeteve të përdorura.

Në rastet kur autori i vrasjes është parë nga ndonjë dëshmitar okular dhe është njohur prej tij, siç theksuam edhe me lartë, ndërmerren masa të shpejta dhe të gjithanshme, për kapjen dhe arrestimin e tij, ndërsa nëse dëshmitari okular e ka parë autorin, por nuk e ka njohur, është e rëndësishme që në pyetjen e këtij dëshmitari të merren karakteristika sa me të detajuara të autorit të vrasjes. Shumë e rëndësishme për vazhdimin me sukses të hetimit, është edhe kryerja e verifikimeve mbi të dyshuarin ose mbi të dyshuarit, nëse kemi më shumë se një të tillë. Në këto verifikime, vëmendja përqendrohet në studimin e personalitetit së të dyshuarit, rrethanat familjare, gjendja ekonomike, aktiviteti me të cilin merret, qëndrimet morale, mënyra e jetesës, sjellja, veset, etj. Po ashtu duhet të verifikohet nëse ka qenë i dënuar apo i proceduar penalisht, verifikohen nëse ka informacione në ngarkim të tij për veprimtari kriminale.

Në rastet kur nuk kemi asnjë dëshmitar që të ketë parë autorin e vrasjes, vëmendja duhet përqendruar në studimin e personalitetit të viktimës, evidentimin e konflikteve të mundshme si dhe në marrjen e verifikimit të informacioneve për autorët e mundshëm të kryerjes së vrasjes.

Versionet hetimore duhet të ngrihen dhe të ndiqen mbi bazën e fakteve dhe provave të grumbulluara dhe jo të ngritura apriori dhe pa baza reale. Ngritja e versioneve të gabuara ndikon negativisht në punën e grupit hetimor dhe harxhon kohë dhe energji të panevojshme të punës së strukturave të policisë gjyqësore. Është e rëndësishme që versionet hetimore të ndiqen paralelisht dhe për këtë është e nevojshme që të aktivizohen disa oficerë të policisë gjyqësore që merren me hetimin e krimeve të rënda.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që në versionet hetimore të sqarohet nëse viktima është njohur me autorin dhe kjo mund të sqarohet nga dinamika e ngjarjes, vendi ku ka ndodhur vrasja, koha e kryerjes, nga dëshmitarët që kanë parë ngjarjen ose që kanë parë viktimën në shoqërinë e personave të tjerë para vrasjes, etj. Sqarimi i faktit të mësipërm do ndihmojë punën hetimore dhe gjurmuese për ngushtimin e rrethit të personave të mundshëm për kryerjen e vrasjes.

Në rastin kur viktima nuk ka njohje me autorin pra vrasja ka ndodhur në takimin e tyre të parë, vështirësitë për individualizimin e një apo disa të dyshuarve janë të mëdha. Në këto raste vëmendja duhet të përqendrohet në studimin e dinamikës së krimit, njihjen e detajuar të vendit të ngjarjes, mjetet e përdorura në krim, konstruktin fizik të autorit, rruga e ardhjes dhe largimit të autorit nga vendi i ngjarjes, mjetet e transportit të përdorura prej tij, si dhe mundësitë e veprimit fizik të viktimës mbi autorin dhe të mbartjes në trupin apo mjetet e tij të gjurmëve të krimit. Në këto raste të ngushtimit të rrethit së të dyshuarve i shërben edhe studimi i personalitetit të viktimës, i lidhjeve

shoqërore, i prirjeve dhe veseve të tij, etj. Po kështu, në rastet e hetimit të vrasjeve është e rëndësishme të përcaktohet itinerari i lëvizjeve dhe takimeve që viktimat ka pasur në ditën e ngjarjes, pasi nëpërmjet këtij veprimi do evidentojmë dëshmitarë të rëndësishëm për hetimin.

Analiza e tabulateve telefonike të viktimës, për të përcaktuar vendet ku viktimat ka qenë, jo vetëm në ditën e vrasjes, por edhe më gjerë, personat me të cilët ka komunikuar, ka shkëmbyer mesazhe, etj., janë mjaft të rëndësishme për hetimin si dhe për verifikimin e ndjekjen e versioneve hetimore.

Sqarimi i motivit të vrasjes është mjaft i rëndësishëm për zbulimin dhe dokumentimin e autorësisë së vrasjes. Puna për sqarimin e motiveve, duhet të mbështetet në studimin e personalitetit të viktimës, por edhe të dyshuarit.

Vrasjet me pagesë, paraqesin vështirësi në punën për zbulimin dhe dokumentimin ligjor të veprimitarisë kriminale të autorëve të këtyre krimeve. Në këto raste kemi të bëjmë me një formë specifike të bashkëpunimit dhe është shumë e rëndësishme ngritja dhe ndjekja e versioneve për vrasjet me pagesë. Është e rëndësishme që edhe në këto vrasje t'i kushtohet vëmendje vendit të ngjarjes dhe të gjitha rrethanave që lidhen me dinamikën e krimit. Po kështu përcaktimi sa më i saktë i karakteristikave të autorit dhe puna për zvogëlimin e rrethit të personave me këto karakteristika, është një hap i rëndësishëm drejt suksesit të hetimeve. Verifikimi i informacioneve për persona konkret që përdoren si vrasës me pagesë si dhe analizimi i vendndodhjes së tyre në ditën dhe orën e ngjarjes është një veprim i rëndësishëm hetimor dhe operativ për zbulimin e autorëve.

Analiza hetimore kriminale është një proces i identifikimit të personalitetit dhe karakteristikave të sjelljes të një ose shumë autorëve të krimit, mbi bazën e krimeve që ai ka kryer. Profili që rezulton nga kjo lloj analize, jo rrallë i parashikon një identifikim të autorit dhe, furnizon oficerët e policisë gjyqësore me një portret trupor dhe psikologjik të sjelljes së autorit. Krahas analizës hetimore kriminale në hetimin e vrasjeve, me mjaft efikasitet përdoren analizat e të dhënave analizat e tabulateve telefonike etj.

Në grupin hetimor, tashmë është bërë e domosdoshme përfshirja e analistëve me njohuri të posaçme në këtë fushë, por edhe me mjetet e infrastrukturën e nevojshme në dispozicion të tyre.

## 8. Rekomandime

1. Në hetimin e krimeve kundër jetës, është e rëndësishme mënyra e reagimit të strukturave policore në momentin që marrin dijeni për krimin.

2. Ruajtja e vendit të ngjarjes, evidentimi i dëshmitarëve, ndjekja e autorëve, janë veprime hetimore dhe operative që ndihmojnë në kryerjen e hetimeve të suksesshme.

3. Këqyrja e vendit të ngjarjes, gjetja dhe sekuestrimi i gjurmëve dhe provave të tjera materiale, është një veprim i rëndësishëm hetimor, që duhet kryer duke respektuar procedurat hetimore dhe nga oficerë të policisë gjyqësore dhe ekspertë të kualifikuar.

4. Ngritja dhe ndjekja e versioneve hetimore, duhet të mbështetet në provat e sekuestruara dhe në informacionet konkrete.

5. Trajnimi i vazhdueshëm i të gjithë strukturave të Policisë së Shtetit, duke filluar me strukturat që merren me ruajtjen e vendit të ngjarjes, të këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe i hetimit të vrasjeve, mbetet një drejtim i rëndësishëm i veprimitarisë së Akademisë së Sigurisë.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

6. Trajnimet specifike për rëndësinë e provave biologjike, mënyrën e ruajtjes së tyre në vendin e ngjarjes, gjetjes, sekuestrimit dhe ekspertimit të tyre janë evidente, nisur edhe nga mangësi të konstatuara në trajtimin e këtyre provave.

## Referenca

1. Elezi, Ismet. *E drejta penale, Pjesa e posaçme*. Tiranë: Kumi, 2014.
2. *Statistikat zyrtare të Policisë së Shtetit*.
3. *Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë*.
4. Begeja, Skënder. *Kriminalistika*. Tiranë: P.S.H, 2015.
5. Mandro, Ilirjan. *Këqyrja e vendit të ngjarjes në vrasjet me armë zjarri*. Tiranë: Ilar, 2002.
6. Meksi, Sokrat dhe Bardhyl Çipi. *Mjekësia Ligjore*. Tiranë: Arbëria, 2003.
7. Memushi, Luan. *Biologjia Humane*. Tiranë: SHBLU, 2006.
8. Meksi, Sokrat. *Mjekësia Ligjore për Shkencat Juridike*. Tiranë: 2009.
9. Çipi, Bardhyl. *Mjekësia Ligjore*. Tiranë: 2003.



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Rëndësia e ekzaminimit të provave materiale balistike dhe sqarimi i mekanizmit të ngjarjes, në këndvështrimin e balistikës kriminale

**MSc. Nikolin DURAJ**  
Instituti i Policisë Shkencore  
nikolin.duraj@asp.gov.al

**MSc. Shpëtim HUDA**  
Instituti i Policisë Shkencore  
shpetim.hudaj@asp.gov.al

## Abstrakt

Qëllimi i kësaj teme është njohja nga ana e ekspertëve kriminalistë, oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, lidhur me rëndësinë që ka ekzaminimi i provave materiale balistike dhe sqarimi i mekanizmit të ngjarjes në këndvështrimin e balistikës kriminale. Ekzaminimi i provave materiale balistike dhe sqarimi i mekanizmit të ngjarjes, ka rëndësi themelore në procesin penal, në rastet e veprave penale ku si mjet krimi është përdorur arma e zjarrit. Është detyrë parësore e ekspertëve kriminalistë dhe oficerëve të policisë gjyqësore, që pas përcaktimit të saktë të kufijve së vendit të ngjarjes, është kërkimi, zbulimi, fiksimi dhe sekuestrimi i gjurmëve dhe provave materiale balistike në tërësi, provave të tjera që kanë të bëjnë me ecurinë e hetimit për dokumentimin e veprës penale të ndodhur, si dhe identifikimin e autorëve të saj. Fiksimi i saktë i provave materiale balistike nga vendi i ngjarjes, duhet bërë konform kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe metodikave kriminale në tri mënyrat klasike, si në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, fotografimin dhe skicimin, e cila është pikë kyçe në ecurinë e gjithë procesit penal, ku veçanërisht është i rëndësishëm fiksimi i saktë i pozicionit të vendndodhjes së tyre, të cilat shërbejnë për rindërtimin e vendit të ngjarjes, që do t'i trajtojmë në pjesën e dytë të kësaj teme. Në këtë punim, janë trajtuar disa nga elementët kryesorë që mbështetemi në sqarimin e saktë të mekanizmit të ngjarjes, të ilustruar me shembuj konkret, të ndeshura në praktikën ekzaminative në Institutin e Policisë Shkencore.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

armë zjarri, municion, model, kalibër, qitje, gëzhjojë, predhë, gjurmë të mekanizmave të armës në gëzhjojë, këqyrje vendit të ngjarjes, ekzaminim.



## 1. Hyrje

Në ngjarje të ndryshme kriminale ose aksidentale, ku mjeti kryesor është përdorimi i armëve të zjarrit, këqyrja e vendit të ngjarjes, përveç metodave teknike e taktike që përdoren në përgjithësi, ka disa veçori, të cilat lidhen me këqyrjen e vendit të ngjarjes në veçanti për raste konkrete (që mund të jenë vrasje, vetëvrasje, plagosje, vjedhje me armë etj), këqyrjen e kufomave kur ka viktimë, këqyrjen e teshave së të dëmtuarve, këqyrjen e mjeteve që kanë shërbyer për kryerjen e krimit, përcaktimin e saktë të kufijve të territorit ku është zhvilluar ngjarja, përcaktimin e saktë të mekanizmit të ngjarjes së ndodhur, përcaktimin e faktit nëse jemi para një vrasjeje ose vetëvrasjeje, identifikimin e viktimës (në rastet e kufomave të pa identifikuar) etj. Praktika ka treguar se në këto lloje krimesh, në vendin e ngjarjes lihen gjurmë dhe armë zjarri, municion, model, kalibër, qitje, gëzhojë, predhë, gjurmë të mekanizmave të armës në gëzhojë, këqyrje vendit të ngjarjes, ekzaminim, prova materiale, të cilat zgjidhin rrethana të rëndësishme për çështjen, si: përcaktimi i mjetit të përdorur, sasia e pjesëtarëve në ngjarje, llojin, modelin e kalibrin të armës së përdorur, përcaktimi i mekanizmit se si është realizuar ngjarja, etj. Provat materiale balistike kanë vlerë të pakontestueshme, në drejtim të provuarit shkencërisht të fajësisë së autorëve të veprave penale. Prandaj, është detyrë parësore në vendin e ngjarjes, që provat materiale balistike (armë, municion, gëzhoja, predha dhe pjesët përbërëse të tyre) të fiksohen konform kërkesave të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P) dhe metodikës përkatëse. Fiksimi i saktë i tyre do të shërbejë njëkohësisht edhe për ekzaminimin e tyre si dhe për rindërtimin e vendit të ngjarjes, me qëllim përcaktimin e saktë të mekanizmit të sajë.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

## **2. Elementë të ekzaminimit, në kuptimin e sqarimit të mekanizmit të ngjarjes**

### **2.1 Vendi i ngjarjes**

Elementi i parë që shërben për sqarimin e mekanizmit të ngjarjes është vetë vendngjarja. Vendi i ngjarjes ka rëndësi themelore, për shkak se përshkrimi i karakteristikave të provave materiale balistike gjatë fiksimit dhe marrjes së tyre, është një element bazë. Po kështu, përshkrimi i detajuar i pozicionit së vendndodhjes të provave materiale balistike, ka rëndësi të veçantë pasi mund të jetë element vendimtar në vazhdim, për të provuar apo hedhur poshtë versione, apo pretendime të ndryshme, duke i parë këto në kombinim edhe me prova të tjera materiale apo të tjera, të natyrave të ndryshme, sipas përcaktimit të K.Pr.P.

### **2.2 Ekzaminimi i provave materiale balistike**

Ekzaminimi i provave materiale balistike si: gëzhoja, predha, pjesë përbërëse të tyre, dëmtime të objekteve të shkaktuara nga qitje me armë zjarri etj.

### **2.3 Rindërtimi**

Rindërtimi i vendit të ngjarjes, duke vendosur provat materiale sipas pozicionit të gjetur dhe duke pare përputhjen e tyre me element të tjerë së vendit të ngjarjes. Rëndësia e këqyrjes: Është elementi thelbësor i çdo veprimi të mëtejshëm dhe mund të jetë shumë e rëndësishme në sqarimin e mekanizmit të ngjarjes.

Fiksimi i saktë i çdo prove materiale balistike, orientimi i saktë i pozicionit të tyre që do të thotë përshkrimi i saktë i çdo prove materiale balistike, me sa më shumë elementë identifikues të provës, dhe sa më shumë elementë (karakteristika) që mund të çojnë në klasifikimin e tyre, në armën që përdor të tillë municion, apo edhe në përjashtimin e elementëve të caktuar. Fiksimi i saktë i dëmtimeve të shkaktuara me armë zjarri, është një hallkë tjetër e rëndësishme. Fiksimi i tyre, si në objekte të palëvizshme ashtu edhe të lëvizshme, pozicioni i tyre, objektet në të cilat janë, përshkrimi i saktë i dëmtimeve në mënyrë të tillë që të lejojë mundësinë e interpretimit të tyre duke u nisur nga karakteristikat e përshkruara, apo të fiksuar me një nga metodat e fiksimit (përshkrim fotografim skicim).

## **3. Ekzaminimi i provave materiale balistike**

### **3.1 Çfarë mund të arrihet nëpërmjet ekzaminimit**

- Në rast se kemi vetëm prova materiale balistike gëzhoja ose predha.

Nëpërmjet këtij ekzaminimi mundet që të konkludohet për numrin e armëve të përdorura, rrjedhimisht, në pjesën më të madhe së rasteve të pjesëmarrësve në krim etj. Mund të konkludohet për klasifikimin e municionit, të cilit i përkasin këto gëzhoja e predha, llojet e armëve që përdorin këtë lloji municioni etj. Nga ky ekzaminim mund të konkludohet edhe për anomali që mund të konstatohen, siç mund të jenë, probleme me folenë e fishekut, mekanizmin e shkrepjes, tytën e armës, nëse tyta e armës ka vjaska ose jo. Konkretisht mundet që të konkludohet, nëse gjatë qitjes është përdorur silenciator apo jo, nëse foleja e fishekut të kësaj arme përshtatet ose jo, me municionin që i përket gëzhoja etj.; nëse arma që ka qitur këto prova materiale balistike është përdorur në ngjarje të tjera kriminale ose jo.

- Në kombinim me prova të tjera po trajtojmë rastin e mëposhtëm.

Personi "X" akuzohet për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare (akuzohet se ka vrarë bashkëshorten)<sup>1</sup>. Në këqyrjen e vendit të ngjarjes janë fiksuar një gëzhojë dhe një predhë e kalibrit 7.65 mm. Një pjesë e provave të tjera, si një sërë letrash ku rezulton se nga ekzaminimi grafik janë shkruar nga viktima, si dhe deklarime të familjarëve që tregojnë për një vetëvrasje. Një nga provat kundër, është mospasja e mbetjeve të qitjes me armë në dorën e viktimës.

Nga këqyrja e provave, rezulton se gëzhoja është e bymyer në mesin e sajë e sipër, po kështu në predhë gjurmët e vjaskave pasqyrohen vetëm pjesërisht. Ekzaminimi balistik i gëzhojës dhe i predhës tregon se ato janë qitur nga një pistoletë *Beretta* kalibër 9 mm X 17 mm. Në klasifikimin e tyre rezultojnë se u përkasin fishekëve standard luftarak, kalibër 7.65 mm X 17 mm. Foleja e fishekut, në këtë rast, nuk përshatet me gëzhojën dhe rrjedhimisht krijon bymim të saj gjatë qitjes, kjo pengon daljen e gëzhojës prapa dhe nuk bëhet jashtëqitja e saj dhe ky, është një nga faktorët që nuk ka lejuar depozitim të mbetjeve së qitjes në dorën e viktimës. Bymimi i gëzhojës dhe mosparaqitja e rregullt (në të gjithë gjatësinë e predhës) e vjaskave janë karakteristikat tipike të këtij rasti, pra, në rastet kur fisheku i përket municionit të një kalibri më të vogël se standardet që përdor arma konkrete, paraqesin këto karakteristika që u përmendën më sipër.




Fenomenet që shoqërojnë qitjen me armë zjarri.



Pistoleta *Beretta* e kalibrit 9 mm X 17 mm.

<sup>1</sup> *Praktikë gjyqësore, Gjykata e Prizrenit Republika e Kosovës. Ekzaminuar nga specialistët e Sektorit të Balistikës në IPSH, Tiranë, 2017.*



Fotografi ku pasqyrohet qitja me fishekun standard majtas dhe fishekët jostandard djathtas (1).

- Më poshtë po rendisim disa nga konkluzionet e këtij rasti ekzaminimi.

a – Arma objekt ekspertimi me numër serial të fshirë, klasifikohet në armë zjarri luftarake, pistolette e markës *Pietro Beretta*, kalibër 9 mm X 17 mm, prodhim italian. Në gjendjen që na paraqitet, ajo është e rregullt teknikisht dhe realizon qitje normalisht (funksionim normal) duke përdorur municion (fishekë) standard për të, kalibër 9 mm X 17 mm. Nga qitjet me këto lloj fishekësh (fishekët standard) që përdoren për të 9 mm X 17 mm, pistoleta realizon jashtëqitjen (nxjerrjen) normale të gëzhjojës.

b - Arma objekt ekspertimi, pistoleta e markës *Pietro Beretta*<sup>2</sup>, kalibër 9 mm X 17 mm realizon qitje edhe me fishekët e kalibrin 7.65 mm X 17 mm, por, në këtë rast, gëzhjoja bymehet në folenë e fishekut, nuk bën jashtëqitjen normale të gëzhjojës si dhe krijon një dëmtim të çrregullt së gëzhjojës.

c - Në rast se me armën (pistoletën) objekt ekspertimi me numër të fshirë, bëhet qitje me fishekë të kalibrin 9 mm X 17 mm që janë standard për të, jashtëqitja e gëzhjojës realizohet normalisht dhe mbetjet e krijuara nga qitja, dalin në anën e përparme duke shoqëruar predhën dhe në zonën e dritares së jashtëqitësit, në shoqërim të jashtëqitjes së gëzhjojës.

e - Në rastin kur u bë qitje me fishekë të kalibrin 7.65 mm X 17mm, që nuk janë standard për këtë pistoletë, jashtëqitja e gëzhjojës nuk u pasqyrua, ndodhi bymimi i gëzhjojës në folenë e fishekut dhe vizualisht nuk duket dalje e mbetjeve në anën e dritares së jashtëqitësit, por vetëm në anën e përparme në dalje të predhës.

f – Në rastet kur bëhet qitje me armë të cilat nuk bëjnë jashtëqitjen e gëzhjojës (revolverët, pushkët e vjetra dhe armët e gjahut me mbushje manuale) si dhe në rastet kur jashtëqitja (nxjerrja e gëzhjojës) nuk bëhet në mënyrë automatike për shkak të ndonjë defekti apo ngecje për shumë arsye, nuk kemi depozitim së mbetjeve të qitjes në anën e prapme nga dalja e gëzhjojës apo dritarja e jashtëqitësit, ato mund të depozitohen vetëm në rast të nxjerrjes manuale të gëzhjojës apo hapjes së armës.

g – Mbetjet që dalin nga qitja me armë zjarri, janë mbetje nga lënda djegëse (baruti) (që kryesisht janë përbërje të azotit dhe të përbërësve të tjerë të barutit), mbetje me prejardhje nga kapsolla e armës së zjarrit (GSR) që e ka bazën në praninë e mikrogrimeve unike me përmbajtje të tre elementëve kimik (Sb, Ba, Pb antimon, barium e plumb), të cilët janë pjesë e përbërësve të lëndës brenda kapsollës, e cila është e tillë që kapsolla të funksionojë siç duhet.

<sup>2</sup> Pistoletë standard *Beretta*, kalibër 9 mm X 17 mm, prodhim italian.

h – Në raportin e ekspertimit së Laboratorit të Zagrebit është evidentuar prania e një mikrogrinice unike me përmbajtje të tre elementëve kimikë SbBaPb të cilat janë mbetje me prejardhje nga lënda e kapsollës së fishekut të armëve të zjarrit.

i – Prania e grimcave të tilla, tregon se kemi të bëjmë me kontakt me armën që ka bërë qitje ose produktet e qitjes me armë zjarri; që do të thotë se ka bërë qitje, ose ka pasur kontakt me armë ose objekte që kanë të bëjnë me qitjen me armë zjarri.

j – Gëzhoja dhe predha të fiksuara si prova materiale balistike në lidhje me ngjarjen ku është vrarë shtetasja A. H., janë qitur nga pistoleta objekt ekspertimi me numra të fshirë, të markës *Pietro Beretta*, prodhim italian.

k – Nga studimi i akteve shkresore të fashikujve, si tabela fotografike dhe akti mjekoligjor rezulton se drejtimi i lëvizjes së predhës, është nga ana e përparme–në anën e prapme, nga e djathta–në të majtë dhe nga lartë poshtë, me puqitje të tytës së armës në pozicion të tillë.

l – Nga studimi i të gjithë materialeve të fashikujve, nuk rezultojnë të dhëna apo karakteristika të tjera për të përcaktuar mënyrën e vendosjes së armës, pozicionin e qitësit apo pozicionin e viktimës në momentin kur është shkaktuar dëmtimi.

Një nga konkluzionet që mundet të arrihen, është edhe fakti nëse prova materiale balistike gëzhoja apo predha, janë qitur nga e njëjta armë që ka qitur gëzhoja apo predha të fiksuara në ngjarje të tjera, pa u gjetur arma. Kjo është një e dhënë e cila mundet të ndihmojë shumë gjatë hetimeve paraprake, si për zbulimin e autorëve e për vërtetimin e fajësisë edhe për caktimin e përgjegjësisë për gjithsecilin nga pjesëmarrësit në rastet e bashkëpunimit.

### **3.2 Rast konkret ekzaminimi**

Rasti i ekzaminimit të provave materiale balistike, në kombinim me prova të tjera dhe bashkimit të ngjarjeve (një armë e përdorur në dy vendngjarje)<sup>3</sup>.

Në Rrethin “X” gjendet i vrarë me armë zjarri shtetasi “A”. Në vendin e ngjarjes janë gjetur nëntë copë gëzhoja dhe një predhë e cila është gjetur te kufoma<sup>4</sup>. Nga ekzaminimi i këtyre provave rezultuan këto konkluzione:

a- Nëntë gëzhojat dhe një këmishë predhe objekt ekspertimi, u përkasin fishekëve standard luftarak të modelit 56, kalibër 7.62 mm që përdoren nga pushkët model 56 e 63, si dhe automatikët dhe mitralozat e lehtë model 56, kalibër 7.62 mm.

b- Në nëntë gëzhojat objekt ekspertimi, u evidentuan gjurmë të mekanizmave të armës mikrorelievi i të cilave, paraqet karakteristika me vlera identifikuese.

c- Nëntë gëzhojat objekt ekspertimi, janë qitur nga tre armë zjarri që duhet të jenë automatik model 56, kalibër 7.62 mm, konkretisht shtatë copë me stampim shifrash “71 – 66” një copë, “31 – 58” tre copë, “61 – 65” dy copë dhe “661 – 67” një copë, nga një armë, një copë me stampim shifrash “31 – 64” një armë dhe një gëzhojë me stampim shifrash “11 – 3 – 85” një armë.

d – Një nga gëzhojat objekt ekspertimi me stampim shifrash “11 – 3- 85” është qitur nga e njëjta armë që ka qitur gjashtë gëzhojat e fiksuar në ngjarjen e datës \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_, qëlluar me armë zjarri ne “X” vend.

e - Gëzhojat e tjera, model 56, kalibër 7.62 mm, të fiksuara në ngjarje të ndodhura më parë në territorin e Qarkut \_\_\_\_\_ dhe të regjistruara në sistemin informatik “AR-

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>3</sup> *Praktikë gjyqësore e Gjykatës Sarandë*, ekzaminuar në vitin 2016, në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë.

<sup>4</sup> Po aty.

SENAL” deri në datën \_\_\_\_, si dhe ato të shfaqura në listën e seleksionuar nga sistemi (kandidat list), nuk janë qitur nga arma që ka qitur gëzhhojat objekt ekspertimi të fiksuara në ngjarjen e datës \_\_\_\_\_, vrasje me armë zjarri shtetasi \_\_\_\_\_.

f. Gjurma e gjilpërës në dy fishekët objekt ekspertimi, është lënë nga gjilpëra e armës që ka qitur shtatë gëzhhojat objekt ekspertimi.

Ky konkluzion, shërbeu për të ngushtuar rrethin e personave të dyshuar madje me vonë u gjetën edhe tre armët e zjarrit që kanë qitur gëzhhojat dhe, njëra prej tyre ka qitur predhën objekt ekspertimi duke krijuar mundësinë kështu edhe për ndarjen e përgjegjësive. Pra, rasti konkret është një pjesë e historisë së suksesit në procesin penal ku ekzaminimi i provave materiale balistike përbën një element thelbësor në sqarimin e mekanizmit të ngjarjes, në caktimin e fajësisë dhe përgjegjësisë për secilin.

### **3.3 Anomalitë që dallohen në tytën e armës**

Mundet që nëpërmjet ekzaminimit të provave materiale balistike, më së shumti të predhës, të konkludohet në lidhje me tytën e armës, konkretisht nga studimi i rasteve rezulton se: nëse në predhë nuk pasqyrohen gjurmë të vjaskave, në pjesën më të madhe së rasteve kemi të bëjmë me një tytë arme të manipuluar, ku rastet me të shumta të hasura janë rastet e armëve të kalibrave 6.35 mm, 7.65 mm X 17 dhe 9 mm X 17 të cilat kryesisht janë armë të formuara nga një armë me destinacion tjetër që mund të jenë ato që përdorin fishek bosh duke vendosur në to një tytë tjetër. Por, ka edhe raste të armëve të fabrikuara, në të cilat nuk pasqyrohen gjurmë të vjaskave.

Një element tjetër që mundet të evidentohet nga ekzaminimi është fakti nëse është përdorur silenciator ose jo, pasi përdorimi i silenciatorit (shuarësit të zhurmës) lë në predhë, në pjesën më të madhe të rasteve, karakteristika të veçanta që e bëjnë të dallueshme atë. Gjurmë të tilla janë gjurmë dinamike ose heqje të materialit siç mund të jetë heqja e çrregullt e ndonjë pjese të këmishës së predhës.

### **3.4. Rastet kur paraqitet arma e zjarrit dhe prova të tjera balistike**

Pas ekzaminimeve të tjera në lidhje me armën, siç janë kërkimi për gjurmë papilare, mbetje humanë të identifikueshme me anë të ADN-së, në ekzaminimet e mëtejshme mundet të përcaktohet:

- nëse gëzhjoja dhe predha e fiksuar në lidhje me ngjarjen konkrete janë qitur ose jo nga kjo armë;

- nëse gëzhjoja apo predha të fiksuara në ngjarje të tjera janë qitur ose jo nga arma konkrete.

Këto konkluzione janë një hap me tej në vërtetimin e fajësisë nëpërmjet sqarimit të mekanizmit të vendit të ngjarjes (mënyrës se si ka ndodhur).

## **4. Rindërtimi i vendit të ngjarjes sqarimi i rrethanave**

Është pjesë e rëndësishme sqarimi i mekanizmit të ngjarjes, që në raste të veçanta, ai mundet të luajë një rol shumë të rëndësishëm. Rindërtimi është pjesë e rëndësishme dhe është në funksion të veprimit hetimorë të parashikuar në nenet 176 dhe 177 K.Pr.P. që është eksperimenti. Në nenin 176 përcaktohet se eksperimenti është riprodhim, - për aq sa është e mundur, - i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur. Në pikëpamje të balistikës kriminalistike, riprodhimi ka të bëjë me rivendosjen e provave materiale sipas këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe, sipas pretendimeve se kur

duhet të vërtetohet një rrethanë e caktuar. Nëpërmjet rindërtimit mundet të krijohen, ose të merren të dhëna të tjera, që vërtetojnë prova ose që rrëzojnë pretendime. Duke qenë se rindërtimi ka të bëjë me vendosjen e provave materiale ashtu siç ato janë fiksuar (duke shfrytëzuar metodat e fiksimit e marrjes), rëndësi shumë të madhe merr edhe saktësia e këqyrjes së vendit të ngjarjes, fiksimi i provave materiale orientimi i pozicionit të tyre. Pra, ka rëndësi, përcaktimi më logjik i pikës së orientimit dhe elementëve të tjerë orientues, si dhe saktësia e përshkrimit edhe pasqyrimin të tyre gjatë fiksimit.

Moment tjetër i rëndësishëm, është vendosja e provave saktësisht në vendin ku ato janë fiksuar, duke mos neglizhuar asnjë të dhënë. Element tjetër i rëndësishëm, është dhe studimi tërësor i të gjithë të dhënave që kanë të bëjnë me armën/armët e përdorura, karakteristikat e tyre, studimi i dëmtimeve në terren dhe karakteristikave të tyre. Modeli dhe kalibri i armës, ka të bëjë me mënyrën e jashtëqitjes së gëzhojës dhe parametra të tjerë teknike, të cilët mund të ndihmojnë në përcaktimin e pozicionit të qitësit, të drejtimit të mundshëm të qitësit, drejtimit të qitjes, kahut të qitjes, këndit të qitjes dhe mundësisht pozicionin e mundshëm të viktimës etj.

Nga këto mund të arrihet<sup>5</sup>:

- numri i personave pjesëmarrës;
- Pozicioni i secilit prej tyre, nëse kanë pasur mundësi të shohin njëri-tjetrin (nëse ka fushëpamje në pikëpamje balistike);
- jepet një tablo më e plotë mbi skemën e krimit;
- vërteton prova të tjera të grumbulluara në vendin e ngjarjes apo pretendime të ngritura gjatë procesit penal;
- ndihmon në përcaktimin e pistave të hetimit gjatë hetimeve paraprake, në vërtetimin e fajësisë dhe shkallën e përgjegjësisë penale për gjithsecilin pjesëmarrës.

#### 4.1 Ilustrim me rast konkret <sup>6</sup>

Në fshatin “V”, ka pasur një konflikt, deri në përdorimin e armëve së zjarrit të dy personave “A” dhe “B”, ku secili prej tyre shoqërohet nga grup personash. Nga përdormi i armëve të zjarrit njëri nga personat mbeti i vvarë. Në vendin e ngjarjes, u fiksuan pesë gëzhoja, të cilat rezultuan të qitura nga dy armë zjarri automatik model 56, kalibër 7.62 mm. Tre prej gëzhojave janë identifikuar me njërin prej armëve të fiksuara në një vend, ndërsa dy gëzhojat e tjera janë qitur nga një armë tjetër e panjohur. Në vendngjarje janë evidentuar edhe dëmtime me armë zjarri në murin (fasadën e banesës) dhe në një objekt të lëvizshëm, që është një gome bashkë me diskut e një autoveture.

Pas vendimit të prokurorit, në fazën e hetimeve paraprake u bë rindërtimi i vendit të ngjarjes dhe u bë ballafaqimi i deklarimeve, në raport me provat materiale balistike dhe elementët e tjerë të evidentuar dhe fiksuar në vendin e ngjarjes, duke shfrytëzuar edhe materialet shkresore të fashikullit të procedimit penal.

Nga studimi që u bë, të gjitha materialevë shkresore dhe ekzaminimet e kryera, konkretisht e procesverbalit ku rezultoi se ka të përshkruar saktësisht vendin ku ka ndodhur ngjarja, ku është përshkruar me hollësi pozicioni i vendosjes së gëzhojave, të cilat janë të vendosura në dy grupe: dy prej tyre në një vend, të shënuara me tabelat “6” e “7” dhe tre të tjerat në një vend tjetër të shënuara me tabelat “3”, “4” dhe “5”. Në të, është përshkruar pozicioni i vendosjes së një pjese predhe të gjetur në vendin e

<sup>5</sup> Sh. Huda, *Eksptimi Tekniko-Balistik*, 2001.

<sup>6</sup> *Praktikë gjyqësore e Gjykatës Vlorë*. Rast i ekzaminuar nga ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore, 2017.

ngjarjes, e cila është shënuar me tabelën me shifrën “2”, një dëmtim në këndin e sipërm të dritares, që është në anën e përparme të banesës, pika e orientimit e shënuar me “0” dhe pika ku është gjetur kufoma e shënuar me “1”.



**Rindërtimi i vendit të ngjarjes dhe përcaktimi i pozicioneve të qitësve.**

U bë rindërtimi i vendit të ngjarjes duke respektuar distancat e përshkruara në procesverbal dhe orientimin nga pika e orientimit dhe nga objekte të tjera që duken në fotografitë e tabelës fotografike (shih tabelën fotografike ku pasqyrohet me detaje rindërtimi).

Në vazhdim, u bë ekzaminimi i dëmtimeve në gomën e automjetit dhe në murin e anës së përparme të banesës, duke konkluduar për natyrën e dëmtimit dhe për drejtimin e mundshëm të qitjes.



**Tabela me shifrën “8” dhe numrin “10” paraqesin pozicionet e qitjes të përcaktuara nga rindërtimi.**

Për të bërë të mundur përcaktime që kanë të bëjnë me drejtimin e qitjes, këndin e qitjes, distancën e qitjes dhe pozicionin e qitësit, duhet që të kemi disa karakteristika siç janë:



-Pozicionin e gëzhojës ose të predhës (nëse janë gjetur në vendin e ngjarjes), tipin dhe modelin e tyre. Nga tipi dhe modeli i tyre, mundet që të bëjmë një përcaktim të mundshëm së llojit të armës që i përdor dhe, duke ditur armën, mundet që të dimë nëse është me jashtëqitje automatike ose manuale të gëzhojës, si dhe mënyrën, pozicionin dhe distancën e hedhjes së gëzhojës gjatë jashtëqitjes nga arma.

-Të kemi minimumin e dy dëmtimeve të njëpasnjëshme, korresponduese, në objekte të palëvizshme ose edhe të lëvizshme, por që mundet të përcaktohet pozicioni i tyre në momentin kur janë dëmtuar.

#### **4.2 Disa konkluzione nga ekzaminimi**

a – Në diskut dhe në gomën objekt ekspertimi, ka një dëmtim tejkshkues, shkaktuar nga kalimi i një predhe të qitur me armë zjarri, me krahë të lëvizjes së predhës nga ana e jashtme e diskut, tejkshkim i trashësisë së tij, hyrje në anën e jashtme të gomës, në pjesën anësore dhe dalje në mesin e protektorit të gomës.

b – Referuar karakteristikave të nxjerra nga studimi i materialeve shkresore të fashikullit dhe rindërtimit të vendit të ngjarjes, pozicionet e mundshme të qitjes janë P1 (tabela nr. 8) që ndodhet në distancën 18 nga pika e orientimit dhe 20 m nga tabela 9 fiksuar disku i gomës, përpara banesës, në rrugën e daljes prej saj dhe P2 (tabela nr. 10) që ndodhet në rrugë, në distancë 46 m nga pika e orientimit (dera e banesës) dhe 44 m nga dëmtimi në murin e dritares.

c – Pozicioni me i mundshëm i shkaktimit të dëmtimit në gomë dhe në disk është në rrugën ku del nga shtëpia duke marrë kthesën, ku ekziston mundësia që të shkaktohet dëmtimi në gome nisur nga pozicioni i mundshëm i krijuar nga tabela “6” dhe “7” ose edhe më afër pozicionit të qitjes (më parë) duke e zhvendosur gomën në drejtimin prapa, në varësi të pozicionit të sajë gjatë rrotullimit në momentin që është shkaktuar dëmtimi.

Këto konkluzione ndihmuan në sqarimin e mekanizmit të vendit të ngjarjes, e cila bëri të mundur evidentimin e përputhjen dhe mospërputhjen e deklarimeve të secilit, me provat materiale në kombinim me pozicionet e fiksimit të tyre, duke bërë të mundur dhe lehtësimin e cilësimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale për secilin pjesëmarrës në konflikt.

#### **4.3 Rast tjetër i rindërtimit të vendngjarjes <sup>7</sup>**

- Personi “A” konfliktohet me personin “B”. Gjatë konfliktit janë përdor armë zjarri.

- Në këtë rast janë fiksuar pesë gëzhoja model 54, kalibër 7.62 mm. Nga ekzaminim rezulton se ato janë qitur nga dy armë, tre prej të cilave nga një armë që ka dorëzuar personi “A”, pasi është dorëzuar në polici dhe dy të tjera të qitura nga një armë tjetër e panjohur.

- Në automjetin e personit “A” është evidentuar dëmtim i shkaktuar me armë zjarri, ku është përcaktuar drejtimi i qitjes.

- Rindërtimi i vendit të ngjarjes edhe në këtë rast bëri të mundur evidentimin e përputhjen dhe mospërputhjen e deklarimeve të secilit, me provat materiale në kombinim me pozicionet e fiksimit të tyre duke bërë të mundur dhe lehtësimin e cilësimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale për secilin pjesëmarrës në konflikt.

<sup>7</sup> *Praktikë gjyqësore e Gjykatës Shkodër. Rast i ekzaminuar nga ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore, 2010.*

#### 4.4 Konkludimet e rastit

- Pozicioni (vendndodhja nga këqyrja) i gëzhgjës së shënuar me shifrën “7” përputhet me distancën dhe krahun e një jashtëqitje normale (në distancë rreth 5 m në krahun e djathtë përpara qitësit) nga një pistoletë model 54, kalibër 7.62 mm e vendosur në duart e një qitësi me qëndrim në këmbë (sipas deklarimeve të shtetasit \_\_\_\_\_) me drejtim qitje të përcaktuar nga dëmtimi në anën e prapme, së jashtë me të automjetit, tip “Ford Expedition” me targa “\_\_\_\_\_” kur automjeti ndodhet në pozicionin si deklorohet nga të dy shtetasit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_”.

- Dëmtimi në anën e prapme, të majte, të automjetit tip “Ford Expedition” me targë ERE 6811 është shkaktuar nga një qitje me armë zjarri me pozicion të qitësit jashtë automjetit, e përcaktuar më sipër nga pozicioni i vendosjes së gëzhgjës të shënuar me shifrën “7” dhe drejtimi i përcaktuar nga dëmtimi.

- Pozicioni (vendndodhja) e tre gëzhgjave të shënuara me shifrat “0”, “1”, “2”, në anë të rrugës kryesore \_\_\_\_\_ – \_\_\_\_\_, (në anën e djathtë të rrugës dhe trotuarit kur je duke lëvizur për në x \_\_\_\_\_) përputhet me distancën e jashtëqitjes normale nga një pistoleta model 54, kalibër 7.62 mm e vendosur në duart e një qitësi në sediljen e përparme të automjetit tip “Ford Expedition” me targa \_\_\_\_\_, e vendosur në anën tjetër të rrugës, në një pozicion prej nga ka fushë pamje me zonën ku ndodhen gëzhgjoat e shënuara me tabelat “6” e “7”, me drejtim lëvizje nga \_\_\_\_\_ për në \_\_\_\_\_, me drejtim qitje për në zonën ku ndodhen tabelat “6” e “7” (duke drejtuar armën në këtë drejtim).

- Pozicioni i gëzhgjës së shënuar me shifrën “6” është normal (përputhet me jashtëqitjen normale nga një pistoleta model 54, kalibër 7.62 mm) në rast të qitjes nga qitësi i vendosur përafërsisht në pozicionin e vendosjes së qitjes që korrespondon me gëzhgjën e shënuar me shifrën “7”, në zonën midis gëzhgjave të shënuara me shifrat “6” dhe “7” me drejtim qitje në drejtim të automjetit, tip “Ford Expedition me targë \_\_\_\_\_ në rrugën kryesore, drejtuar për në \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ (në zonë ku ka fushëpamje).


Dëmtimi tjetër në automjetin, tip “Ford Expedition” me targa \_\_\_\_\_ është shkaktuar nga qitje me pozicion të qitësit (të armës) përafërsisht në sediljen e përparme të krahut të majtë të shoferit.

Në Institutin e Policisë Shkencore janë ekzaminuar një numër i madh armësh për periudhën janar-shtator 2017, konkretisht:

- pistoleta model 54, kalibër 7.62 mm, “TT” 44 copë;
- pistoleta 9 mm të llojeve të ndryshme 34 copë;
- armë gjahu të llojeve të ndryshme 25 copë;
- pistoleta të kalibrit 6.35 mm, të ndryshme 6 copë;
- automatik kallashnikov, kal. 7.62 mm, 222 copë;
- revolver të ndryshëm, kal. 9 mm, 5 copë;
- pushkë model 56, kalibër 7.62 mm, 106 copë;
- pushkë model 63, kalibër 7.62 mm, 60 copë;
- automatik model PPS, kalibër 7.62 mm, 11 copë;
- pistoletë “Zastava” + CZ, kal. 7.65 mm, 12 copë;
- pistoletë 8 mm, 1 copë;
- pistoletë shenjdhënëse 3 copë;
- automatik 9 mm, 1 copë;
- pushkë kalibër 6.5 mm, 4 copë;

- pistoletë “Zastava”, model 57, kalibër 7.62 mm, 5 copë;
- pushkë snajper, kal. 7.62 mm, 1 copë;
- pushkë, kal. 7.92 mm, 1 copë;
- pushkë kal. 9 mm, 3 copë;
- revolver kal. 7.62 mm, 1 copë;
- pushkë sportive, kal. 5.6, 1 copë;
- pistoletë kal. 11.43, 2 copë.

Armët dhe municionet më të përdorshëm të ndeshura në ngjarje të ndryshme kriminale për periudhën 8 mujore të vitit 2017. Po kështu janë ekzaminuar provat materiale balistike të fiksuara në 177 raste ngjarjesh ku ka pasur prova materiale balistike gëzhoja e predha apo pjesë përbërëse të tyre. Janë identifikuar në 50 raste armët që i kanë qitur gëzhojat ose predhat e fiksuara në vendngjarje. Këto armë përfshihen në numrin e armëve të ekzaminuara të përmendura më sipër. Në një numër të madh rastesh kanë marrë pjesë specialistët e balistikës, në rindërtimin e vendit të ngjarjes dhe sqarimi i rrethanave të ngjarjes.



Skicë në të cilën pasqyrohet rindërtimi i vendit të ngjarjes.

## 5. Përfundime

Këta janë disa nga elementët që kanë të bëjnë me sqarimin e mekanizmit së vendit të ngjarjes nisur nga ekzaminimi dhe studimi i provave materiale balistike, armëve, i dëmtimeve të shkaktuara me armë zjarri të evidentuara dhe fiksuara në vendin e ngjarjes, si dhe nga studimi në tërësi i fashikujve të procedimit penal, për të ndihmuar organet e procedimit penal, në caktimin e fajësisë dhe përgjegjësisë penale për autorin ose autorët e veprës penale konkrete.

Në kontekstin e kësaj teme, merr rëndësi të veçantë kryerja e veprimeve procedurale

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

nga o.p.gj. dhe ekspertët në vendin e ngjarjes, duke filluar që nga këqyrja e vendit të ngjarjes, ku rekomandohet vlerësimi i çdo prove materiale balistike gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes ku si mjet krimi është përdorur arma e zjarrit.

## 6. Rekomandime

Në kontekstin e vlerësimit të kësaj teme, po rendisim disa rekomandime që të kihen parasysh në punën e oficerëve të policisë gjyqësore dhe ekspertëve kriminalistë dhe konkretisht:

- Orientimi i vendit të ngjarjes si dhe përcaktimi i saktë, në koordinata, sipas këtij orientimi, të vendndodhjes së gjurmëve dhe provave materiale balistike.

- Kujdes i veçantë i duhet kushtuar ekzaminimit të provave materiale balistike dhe përshkrimit të hollësishëm të tyre, faktor ky i cili ndihmon në vlerësim, në raport me provat e tjera të administruara që kanë të bëjnë me armë zjarri si dhe dëmtimet e shkaktuara prej tyre.

- Vlerësimi maksimal, i përshkrimit të detajuar të dëmtimeve të evidentuara në sende dhe objekte të ndryshme, në vendin e ngjarjes, përshkrimi i pozicionit të vendndodhjes së dëmtimeve të shkaktuara me armë zjarri, përshkrimi i karakteristikave të tyre bazuar në metodikën përkatëse, që do të ndihmonin më pas gjatë rindërtimit të vendit të ngjarjes dhe përcaktimit të mekanizmit të sajë.

## Literatura

1. Kodi i Procedurës Penale, nenet 176, 177.
2. Shpëtim Huda, *Ekspertimi Tekniko-Balistik*, 2001.
3. Arkivi i Institutit të Policisë Shkencore.
4. Rowe, W. F. Firearms Identification. *Forensic Science Handbook*. Vol. 2, Ed. R. Saferstein. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall, 1988
5. *Praktikë gjyqësore, Gjykata e Prizrenit Republika e Kosovës*. Ekzaminuar nga specialistët e Sektorit të Balistikës në IPSH Tiranë, 2017.
6. *Praktikë gjyqësore e Gjykatës Vlorë*. Rast i ekzaminuar nga ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore, 2017.
7. *Praktikë gjyqësore e Gjykatës Shkodër*. Rast i ekzaminuar nga ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore, 2010.



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Aspekte juridike dhe kriminalistike, të ekspertimit të dokumenteve joorigjinale

— MSc. Vladimir IKONOMI

Instituti i Policisë Shkencore  
vladimir.ikonomi@asp.gov.al

— MSc. Ing. Viktor HAJDARI

Instituti i Policisë Shkencore  
viktor.hajdari@asp.gov.al

## Abstrakt

*Ekspertimi tekniko-grafik i dokumenteve joorigjinale, është një çështje gjerësisht e debatuar, objekt dhe i vendimeve të gjykatave tona të niveleve të ndryshme apo dhe i gjykatave të vendeve të tjera Evropiane, por jo vetëm. Ka gjykata, të shkallëve të ndryshme që gjatë marrjes në shqyrtim të çështjeve të caktuara civile apo penale, nuk e pranojnë vlerën e ekspertimeve të kryera në dokumente joorigjinale, sikundër ka edhe shumë gjykata që e kanë pranuar vlerën e këtyre ekspertimeve, duke vlerësuar përfundimet e arritura nga ekspertët, të para e të lidhura me shumë faktorë që kanë të bëjnë si me aspektin kriminalistik, ashtu dhe me aspektin juridik si dhe duke i vlerësuar konkluzionet e arritura gjatë ekspertimit, në unitet apo në korrelacion edhe me provat e tjera të administruara. Si rregull për kryerjen e një ekspertimi kriminalistik mbi një dokument, provë materiale, dokumenti që do të ekzaminohet duhet të paraqitet në origjinal. Në shqyrtimin dhe ekzaminimin e këtyre dokumenteve, gjithmonë duhet të nisemi nga parimi themelor: “Një krahasim i mirë i shkrimit ose nënshkrimit nuk mund të arrihet pa u nisur nga origjinali”<sup>1</sup>.*

*Megjithatë, bazuar në jurisprudencën e vendit tonë apo edhe të shumë vendeve të tjera, në pamjen juridike në Kodin e Procedurës Penale apo dhe atë të Civile, nuk gjenden dispozita që kërkojnë domosdoshmërisht që dokumentet provë materiale, objekte të ekspertimit kriminalistik, të jenë në origjinal<sup>2</sup> apo që të pengojnë ekzaminimin e dokumenteve provë materiale, të paraqitura jo në origjinal.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**ekspertimi kriminalistik, koncepti origjinal, jo origjinal, tekniko-grafik, juridik, provë materiale.**

1 Gayet. J., *Manuel de Police Scientifique*, Paris 1961, f. 311.

2 *Vendimi nr. 42938 dt. 21. 11. 2011*, Gjykata e Kasacionit Penal, Itali.

## 1. Hyrje

Në këtë artikull do të përpiqemi të trajtojmë aspektin juridik të ekzaminimit të dokumenteve provë materiale, të cilat na paraqiten jo në origjinal, *si dhe* aspektin kriminalistik kur ato bëhen objekt i ekspertimit kriminalistik, në pamjen teknike dhe grafike. Në mënyrë të veçantë do të fokusohemi tek arsyet dhe rastet që bëjnë të domosdoshme dhe mundësojnë kryerjen e ekspertimeve kriminalistike të dokumenteve jo në origjinal, si dhe veçoritë e kufizimet që paraqet ekspertimi kriminalistik i tyre.

Në përfundim, do të trajtojmë disa problematika në këndvështrimin juridik dhe kriminalistik, të evidentuara gjatë kryerjes së ekspertimeve tekniko-grafike të dokumenteve provë materiale jo në origjinal, duke u bazuar në praktikën kriminalistike të vendit tonë dhe të vendeve të tjerë të rajonit, e më gjerë.

## 2. Çfarë kuptojmë me “dokumentet provë materiale jo në origjinal”?

Fillimisht përkufizojmë se: “Në pikëpamjen kriminalistike koncepti origjinal për një dokument provë materiale, ka të bëjë me faktin e paraqitjes së elementëve “modelues” (të përmbajtjes personalizuese të dokumentit, si rubrika, tekste, dorëshkrime..., etj); “konfirmues” (nënshkrime, vula..., etj) dhe “përcaktues” (karakteristika teknike në formë elementësh sigurie dhe elementë të veçantë sigurie me natyrë vizuale apo dhe jovizuale) të dokumentit, në formën reale të shfaqjes së marrëdhënies së tyre me letrën e dokumentit”.

Mirëpo, shpesh në praktikën e përditshme, ballafaqohemi me faktin që dokumentet

provë materiale, paraqiten edhe:

- me plotësime të përmbajtjes së tyre në fletë vetëkopjuese (*evidentohen një sërë blloqe modularësh të institucioneve të ndryshëm, që funksionojnë si të tillë*);
- me plotësime të emetuara apo të transmetuara me ndihmën e fletëve kopjuese me letër karboni (*kryesisht ndër dokumente të periudhës para viteve 2000*);
- të riprodhuara (*fotokopjuara/skanuara*) nga ndonjë dokument burimor (originë) pas një procesi riprodhimi bardhë e zi apo në kolor;
- të fotografuara (*sipas një procesi bardhë e zi apo në kolor*).

Kjo tipologji dokumentesh të këtyre natyrave, përfshi dhe trajta të tjera të mundshme formash të ngjashme të paraqitjes së tyre, në këndvështrimin kriminalistik, trajtohen dhe emërtohen si “dokumente jo originalë”.

### **3. Disa çështje në aspektin juridik dhe kriminalistik, të ekzaminimit të “dokumenteve provë materiale jo në original”**

Dokumentet, pavarësisht faktit nëse administrohen në origjinal apo jo në origjinal, marrin cilësinë e provës materiale kur plotësojnë kriteret që parashikohen në dispozitat e K. P. Penale neni 187<sup>3</sup> dhe K. P. Civile neni 19<sup>4</sup>, duke u bërë kështu edhe objekt i ekspertimit kriminalistik të dokumenteve, në lidhje me çështje të caktuara. Pra, në Kodin e Procedurës Penale dhe atë të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, nuk ka ndonjë ndarje për sa i përket fuqisë provuese të dokumenteve provë materiale të paraqitura në origjinal, krahasuar me ato të paraqitura si jo në origjinal, apo dhe ndonjë dispozitë, për pamundësinë e kryerjes së ekspertimit kriminalistik mbi dokumente të paraqitura jo në origjinal.

Në nenin 251, “*Kopja e shkresës dhe origjinali i saj*”, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, thuhet: “*Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin*”.

Në nenin 279, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, thuhet: “*Fotografitë ose fotokopjet e shkresave kanë fuqi të njëjtë me origjinalin, përderisa saktësia e tyre vërtetohet nga personi, që sipas ligjit, është kompetent të nxjerrë kopje*”.

Gjithashtu, në Kodin e Procedurës Penale dhe atë Civile të Republikës së Shqipërisë, nuk gjendet asnjë dispozitë, që kërkon domosdoshmërisht, që dokumentet provë materiale objekt i shqyrtimit kriminalistik të jenë në origjinal; që të ndalonte kështu, kryerjen e ekzaminimit kriminalistik të dokumenteve të paraqitura jo në origjinal.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Penale e Kasacionit – Itali (Cass. Pen., n. 42938 del 21.11.2011), ka mbajtur këtë qëndrim në lidhje me ekspertimin e dokumenteve që paraqiten jo në origjinal: “*Asnjë standard nuk kërkon që ekspertiza grafike në një*

<sup>3</sup> Neni 187 i K.P.Penale: “Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurije tjetër..... si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes”.

<sup>4</sup> Neni 191 i K.P.Penale:

a. Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër.

b. Kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur ose është zhdukur, mund të merret kopja.

c. Dokumentet që përbëjnë provë materiale duhet të merren cilido qoftë personi që i ka krijuar ose që i mban.



dokument të dyshuar për falsifikime të bëhet domosdoshmërisht në origjinal dhe jo në një kopje fotostatike”<sup>5</sup>.

Ekzistenca e parimit që “Një krahasim i mirë i shkrimit ose nënshkrimit nuk mund të arrihet pa u nisur nga origjinali”, sigurisht thekson faktin që dokumentet origjinale, janë gjithmonë të preferuarat për kryerjen e një ekzaminimi kriminalistik, por kjo nuk ka të bëjë me aspektin juridik të vlerësimit të dokumenteve provë materiale, ndërkohë që është i lidhur me aspekte të veçanta të ekzaminimit kriminalistik të tyre dhe ka të bëjë me disa kufizime të ekspertimit në pamjen grafike dhe teknike, të dokumenteve prove materiale të paraqitura jo në origjinal.

Kryerja e ekspertimit në aspektin kriminalistik mbi bazën e këtyre lloje dokumentesh, do të kondicionohet gjithmonë nga lloji i dokumentit, nga gjendja në të cilën paraqitet dokumenti, nga natyra e çështjeve të shtruara për zgjidhje dhe padyshim nga niveli profesional (shkalla e kualifikimit) i ekspertit kriminalist.

#### **4. Veçori të ekzaminimit të “dokumenteve objekte ekspertimi të paraqitura jo në origjinal”**

Dokumentet provë materiale, i përkasin një game të gjerë formash e modelimesh dhe natyrisht që çështjet e ekzaminimit të tyre, përballen me një shumëllojshmëri rastesh e pyetjesh të shtruara për zgjidhje. Mirëpo në praktikën e përditshme, janë të shumta rastet kur dokumenti origjinal nuk gjendet apo nuk ekziston më, ndërkohë që ka akoma çështje që presin përgjigje prej tij. Lind pyetja: “A duhen kryer ekzaminime kriminalistike mbi dokumente objekte ekspertimi që nuk paraqiten në origjinal?”<sup>6</sup>.

Për ta bërë me të thjeshtë përgjigjen e kësaj pyetje, të diskutuar dhe debatuar prej mjaft kohësh midis profesionistëve të fushës, juristëve, etj., vlerësojmë se dokumenti provë materiale objekt ekspertimi, duhet t’i vihet në dispozicion ekspertit të fushës, i cili bazuar në larminë e rasteve të ekzaminuara si dhe në kompetencën e tij profesionale, kryen ekzaminimin e dokumenteve jo origjinale konform çështjeve të shtruara për zgjidhje, mjafton kushteve cilësore të paraqitjes së tyre, duke konkluduar për çfarë dhe për aq sa është e mundur, mbi bazë argumentesh shkencore.

Në pamjen kriminalistike nuk ka rëndësi nëse dokumenti është konceptuar (shkruar, stampuar, a pasqyruar në çfarëdo forme tjetër të mundshme) në letër të zakonshme apo speciale, në materiale sintetike, në pllaka qeramike, metalike apo çfarëdo lloji tjetër materiali të përshtatshëm; paraqitet në origjinal, i fotografuar, fotokopjuar, stampuar, printuar, etj.

*Mjaft i rëndësishëm është fakti që ai (pra dokumenti provë materiale) paraqet*

<sup>5</sup> “Nessuna norma impone che la perizia grafica su di un documento sospettato di falsità debba necessariamente svolgersi sull’originale e non su di una copia fotostatica”. (conforme, Cass. Pen., n. 7175 del 03.07.1979).

<sup>6</sup> Në botimin *Ekzaminimi Shkencor i Dokumenteve*, Tiranë 2006, f. 20, citojmë:

“Në pamje kriminalistike nuk ka rëndësi nëse dokumenti është konceptuar (shkruar, stampuar, a pasqyruar në çfarëdo forme tjetër të mundshme) në letër të zakonshme ose speciale, në materiale sintetike, në pllaka majolike, metalike e çfarëdo lloji tjetër materiali të përshtatshëm; paraqitet në origjinal, i fotografuar, fotokopjuar, stampuar, printuar etj, mjafton që ai të paraqes një tekst (me shkronja, në formë shifrash a shenjash të tjera), që ka interes për zgjidhjen e çështjes”. Kur nuk është e mundur të administrohet dokumenti origjinal, pamjet e tij fotografike, ose të filmuara dhe kopja e tij (nenet 188 e 191 të KPP + Nenet 251 e 279 të KPC), në pamje procedurale janë me të njëjtat vlera, ndërsa në pamjen kriminalistike, mund të jenë edhe me të përshtatshme, sepse në shumë raste, kur vetë origjinali i dokumentit është i dëmtuar, fotografimi e mikrofotografimi, fotokopjimi e skanimi me rezolucion të lartë, përdoren si metoda restaurimi të tyre, pikërisht për t’iu vënë në dukje elemente e detaje që u janë zbehur e dëmtuar dhe që me sy të lirë ose zmadhues të tjerë optike janë pak të dukshëm”.

*interes për zgjidhjen e çështjes.*

Natyrisht është e drejta e ekspertit, që të bëjë këqyrjen paraprake të këtyre dokumenteve dhe të vlerësojë rast pas rasti vlefshmërinë apo/dhe përshtatshmërinë e tyre, konform çështjeve të shtruara për zgjidhje. Thelbësore në këto raste, është natyra (*karakteri*) e/i pyetjeve apo i çështjeve të shtruara për zgjidhje dhe, mundësia e shkallës apo nivelit të konkluzioneve të arritura prej ekspertimit, në lidhje me këto pyetje.

Për kryerjen e ekzaminimeve bazuar në dokumente jo origjinale, duhet të angazhohen ekspertë kriminalistë të mirëkualifikuar. Kjo, për shkak të kufizimeve në procesin e shqyrtimit të dokumentit, pasojë e paraqitjes së dokumenteve joorigjinale. Në kategorinë e dokumenteve objekte ekspertimi të paraqitura jo në origjinal, gjatë ekzaminimit të tyre, evidentohen apo ndeshen një sërë problematikash.

- Një ndër problematikat kryesore në këto raste, ka të bëjë me cilësinë e paraqitjes së dokumentit objekt ekspertimi, e cila ndikon drejtpërdrejt në paraqitjen *apo* në mënyrën e paraqitjes konform origjinalit, të një sërë elementesh tekniko-grafikë të modelimit dhe të përmbajtjes së dokumentit. Në dokumentet pa cilësi (*ku në rastet më të zakonshme të tyre përmendim paraqitje dokumentesh me pamje të zbehte apo tepër të zbehtë; pamje jo të plotë të dokumentit, etj.*), mjaft prej elementëve tekniko-grafikë të modelimit dhe të përmbajtjes së dokumentit të përfutur, nuk shfaqen apo ndodh që të kemi shfaqje joreale të tyre.

- Nuk mund të arrihen akoma përcaktime shkencore, për ekspertime mbi këtë kategori dokumentesh, në rast se shtrohen për zgjidhje një sërë çështjesh të karakterit teknik, p.sh. si ato në lidhje me përcaktimin e ndërhyrjeve falsifikuese, apo çështje të përcaktimit të llojit të mjetit shkruar, etj., *ndërkohë që* ka dhe mjaft detaje të tjera të modelimit dhe të përmbajtjes së një dokumenti të kësaj kategorie, të cilët *“nuk ndikohen”* nga gjendja e dokumentit, për kryerjen e disa lloje ekzaminimesh në pamjen teknike, në lidhje me disa çështje specifike të kërkuara për t'u zgjidhur gjatë kësaj faze ekzaminimesh dhe, për të cilat mund të konkludohet. Përmendim p.sh., çështje në lidhje me paraqitjen apo dispozicionin në vendosje midis elementësh të caktuar tekniko-grafik të modelimit e të përmbajtjes së dokumentit, apo çështje në lidhje me përmbajtjen e elementëve të caktuar të dokumentit, etj.

## **5. Disa probleme të kryerjes së ekspertimit mbi “dokumente provë materiale të paraqitura jo në origjinal”**

Ekspertimet mbi dokumentet joorigjinale, paraqesin një sërë problematikash dhe vështirësish, kryesisht të karakterit teknik, të cilat bëjnë që një sërë çështjesh të lidhura me këto dokumente, të mos marrin zgjidhje të plotë shkencore.

Disa nga këto problematika, po i përmendim më poshtë:

a. *Në lidhje me dokumentin.*

- Në një dokument jo origjinal, nuk mund të përcaktohet lloji i letrës së dokumentit origjinal apo ekziston gjithashtu mundësia e pasqyrimit të dokumentit origjinal jo në përmasat reale, pra riprodhimi mund të zvogëlojë ose të zmadhojë përmasat e dokumentit, gjë e cila mund të ndikojë negativisht në nxjerrjen e shenjave individualizuese të tij (*kemi parasysht, kryesisht dokumentet e vjetër ku lloji dhe formati i letrës së një dokumenti të tillë, ka rëndësi në zgjidhjen e shumë çështjeve*).

- Në një dokument joorigjinal, nuk mund të përcaktohen ngjyrat e bojërave të pjesëve përbërëse të përmbajtjes së dokumentit, si p.sh. boja e tekstit, boja e firmave apo

boja e shenjave të vulave (*ky problem, në rastin e dokumenteve joorigjinal të paraqitur në kolor, i nënshtrohet një arsyetimi tjetër*).

- Në një dokument joorigjinal, ekziston rreziku i montimit të pjesëve përbërëse të tij, nga pjesë dokumentesh të ndryshëm. Në një dokument të riprodhuar, shenjat e prodhimit të një dokumenti me anën e montimit të pjesëve të ndryshme, si një dokument i vetëm, janë të vështira apo të pamundura për t'u evidentuar (*varet nga cilësia e montimit, etj.*)

- Kur një dokument joorigjinal ka më shumë se sa një fletë (*dokumente noteriale, etj.*), nuk evidentohet fakti nëse këto fletë kanë qenë "*të lidhura*" me shenja vulash noteri apo jo? Pra, a i përkasin fletët një dokumenti unik apo jo? Etj.

- Një dokument joorigjinal, nuk shfaq elementet e sigurisë (*të dukshëm e të padukshëm*) që mund të ketë dokumenti origjinal gjatë prodhimit të tij (*p.sh. një kartë identiteti origjinale ka mjaft elementë sigurie të dukshëm e të padukshëm, që në fotokopjen e saj nuk mund të evidentohen më*).

*b. Në lidhje me elementët përbërës të përmbajtjes së një dokumenti.*

- Në një dokument joorigjinal, cilësia e dobët e riprodhimit pengon shfaqjen e plotë apo të qartë të tërësisë së elementeve përbërës të tij, si p.sh. të tekstit, të firmave apo dhe të shenjave/gjurmëve të vulave që mund të ndodhen në të. Shfaqja e zbehtë e këtyre elementeve përbërës të përmbajtjes së dokumentit (*në një rast të dhënë*), i bën ato të pavlefshme për ekzaminime në pamjen kriminalistike. Nëse një dokument joorigjinal paraqitet në cilësi të mirë, dhe nëse ka të dhëna të mjaftueshme për të lejuar një mendim, atëherë ky dokument është i vlefshëm për kryerje ekzaminimesh në pamjen kriminalistike.

- Në një dokument joorigjinal, nuk mund të përcaktohet marrëdhënia përkundrejt letrës së dokumentit, midis pjesëve përbërëse të përmbajtjes së tij, si p.sh. marrëdhënia e tekstit me firmat apo marrëdhënia e tekstit me shenjat/gjurmët e vulave, që mund të ndodhen në të (*me termin "marrëdhënia", në këtë rast kemi parasysh p.sh., faktin që është shkruar teksti e pastaj është firmosur mbi letër, apo është firmosur letra e bardhë e pastaj është shkruar teksti, etj.*)

- Në një dokument joorigjinal, vështirësohet evidentimi i anomalive të ndryshme si p.sh., i shkallës së lidhjes së shkrimit; i vijueshmërisë në vijën e shkrimit, etj., të cilat ndërkohë janë të thjeshta për t'u evidentuar mbi një shkrim origjinal.

- Ekzaminimet në një dokument joorigjinal, në varësi të natyrës së dokumentit, rrezikojnë të bëjnë të dukshme dridhje të mjetit shkruar që në realitet nuk ekzistojnë, apo të fshehë dukshmërinë e vijave të lehta të shkrimit, apo të fshehë dukshmërinë e konfiguracionit të vijës së shkrimit në letër, konform konfiguracionit të majës së mjetit shkruar, apo dhe të fsheh vijueshmërinë e konfiguracionit të vijës së shkrimit në letër, konform emetimit të bojës nga maja e mjetit shkruar (*rast në të cilin në një dokument origjinal do të shfrytëzohim gjurmën e presionit të majës së mjetit shkruar mbi letër*).

- Në një dokument joorigjinal, jo gjithmonë mund të përcaktohet fakti nëse nënshkrimi në emër të një personi të caktuar, është nënshkruar me mjet shkruar direkt mbi letrën e dokumentit origjinal (*duke nënkuptuar si hap të parë të ekzaminimit, që personi nënshkruar ka shprehur vullnetin konform dhe në miratim të përmbajtjes së dokumentit*) apo nënshkrimi në emër të këtij personi është i mbartur nga ndonjë dokument tjetër dhe i emetuar pas një procesi riprodhimi në dokumentin joorigjinal, duke tjetërsuar vullnetin e personit në fjalë. (*rastet kur në një dokument joorigjinal, konstatohet ndërthurje dhe vijueshmëri midis elementeve përbërës të përmbajtjes së tij,*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

*si p.sh. ndërthurje dhe vijueshmëri në marrëdhënien tekst-firmë- shenjë/gjurmë vule, etj., i nënshtrihen një arsytimi tjetër).*

- Në një dokument jo origjinal, nuk mund të përcaktohet nëse shenja e vulës në emër të një personi apo institucioni të caktuar, është formuar nga stampimi i klishesë së vulës origjinale direkt mbi letërën e dokumentit origjinal, apo është shenjë vule e mbartur nga ndonjë dokument tjetër origjinal dhe e emetuar pas një procesi riprodhimi në dokumentin joorigjinal.

- Në një dokument joorigjinal, vështirësohet në maksimum dhe në mjaft raste është thuajse i pamundur, përcaktimi i faktit nëse kemi të bëjmë me ndërhyrje falsifikuese (*kimike, fizike dhe mekanike*) tek dokumenti origjinal (*dokumenti origjinë*) nga i cili është përftuar dokumenti joorigjinal, bazuar apo nisur nga ekzaminimet mbi këtë të fundit, apo për më tepër që të përcaktohet se cila ka qenë përmbajtja e mëparshme në rast se evidentohen ndërhyrje falsifikuese.

- Në një dokument joorigjinal, vështirësohet në maksimum dhe në mjaft raste është thuajse i pamundur, përcaktimi i faktit të mundësisë së falsifikimit teknik të dorëshkrimeve dhe/apo nënshkrimeve objekte ekspertimi, pra, nëse kemi të bëjmë me shkrime e nënshkrime të falsifikuara apo jo!

*Në varësi të llojit të dokumentit dhe gjendjes së paraqitjes së tij, mund të kemi shtim apo pakësim të problematikave të cituara më sipër dhe jo vetëm!*

## 6. Përfundime

Në përfundim të analizës së mësipërme, ritheksojmë edhe një herë se:

1. Në aspektin juridik nuk gjenden dispozita ligjore që ndalojnë ekspertimin kriminalistik të dokumenteve provë materiale të paraqitura jo në origjinal.

2. Në aspektin kriminalistik për shqyrtimin dhe ekzaminimin e dokumenteve provë materiale, si rregull, gjithmonë duhet të nisemi nga dokumenti origjinal. Por, kjo nuk do të thotë që në rastet kur nuk gjendet origjinali i dokumentit provë materiale, ekzaminimi kriminalistik i dokumenteve të paraqitura jo në origjinal dhe kryerja e ekspertimit bazuar mbi këto dokumente, të jetë i pavlefshëm.

3. Kryerja e ekspertimit kriminalistik mbi dokumentet provë materiale jo në origjinal (*për të cilat nuk gjendet dokumenti burimor origjinal*), është i mundur dhe i vlefshëm por ai gjithmonë do të varet nga një sërë faktorësh të grupuar dhe në lidhje me:

- llojin e dokumentit;
- gjendjen e paraqitjes së tij;
- natyrën e çështjeve të shtruara për zgjidhje para ekspertimit;
- kualifikimin e ekspertit kriminalistik.

Disa prej aspekteve juridike dhe kriminalistike të kryerjes së ekspertimit kriminalistik mbi dokumente joorigjinale, të trajtuara më sipër nga ana jonë, më tepër se një dëshirë për definim të problemit, janë një kontribut modest për të ndihmuar në kuptimin e kapaciteteve ekzaminues të dokumenteve provë materiale dhe njëkohësisht, një ftesë për të nxitur shkencëtarët e fushës në thellimin e studimeve dhe analizave shkencore, duke trajtuar shkencërisht mundësi e rrugë të reja në këtë lloj ekzaminimi dhe ndoshta, të paraqitura për referencë në të ardhmen.

## Burime & Referenca

Ky artikull është bazuar në përvojën shumë vjeçare të autorëve, duke shfrytëzuar gjithashtu burimet dhe referencat e mëposhtme:

1. Gayet. J., *Manuel de Police Scientifique*, Paris 1961.
2. *Ekzaminimi Shkencor i Dokumenteve*, Tiranë 2006.
3. Kodi Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
4. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
5. Praktika kriminalistike të I. P. Shkencore Shqiptare (2000 - 2016).
6. Praktika kriminalistike të Policisë Shkencore Italiane dhe Franceze (2000 - 2016).
7. Vendimi nr. 42938 dt. 21.11.2011 - Gjykata e Kasacionit Penal në Itali.
8. Praktika gjyqësore Nr. 2313/2016, dorëzuar më 10/13/2016 - Gjykata e Perugia-s në Itali.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Përtej kopjimit apo rikuperimit automatik, nga sistemet e kamerave të sigurisë (DVR)

— MSc. Kastriot GJOKA, EnCe<sup>1</sup>, CCL0<sup>2</sup>, CCPA<sup>3</sup>

Instituti i Policisë Shkencore

[kastriot.gjoka@asp.gov.al](mailto:kastriot.gjoka@asp.gov.al)

## Abstrakt

Në ndryshim nga provat e tjera, pamjet filmike janë “dëshmitarë okularë” të një krimi, për të kuptuar çfarë ka ndodhur, kur dhe si ka ndodhur, sa veta janë përfshirë, drejtimi i ardhjes e largimit të autorëve nga vendi i ngjarjes, për të identifikuar personat e përfshirë apo mjete e objekte të përdorura në vendin e ngjarjes, veprimet e kryera nga ana e tyre, etj. Në dekadën e fundit burimet për sigurimin e pamjeve filmike të cilat mund të ndihmojnë hetimin janë shtuar së tepërmi si rezultat i kamerave të sigurisë (CCTV)<sup>4</sup> të cilat gjenden kudo si në biznese, banesa private, automjete policie etj., e po ashtu edhe nga burime të tjera si p.sh telefonat celularë. Nxjerrja e pamjeve filmike nga kamerat e sigurisë [pajisjet digjitale videoregjistruese (DVR)], në raste të veçanta është një proces mjaft kompleks dhe kërkon njohuri e teknika të avancuara. Për nxjerrjen e pamjeve filmike nga këto pajisje mund të hasim në probleme të tilla si: pajisja nuk funksionon; pajisja është e mbyllur me fjalëkalim; të dhënat janë fshirë ose korruptuar; hard disku ka sektorë të dëmtuar dhe nuk njihet nga pajisja; pamjet e ngjarjes mund të jenë ruajtur si kopje e vetme në një USB apo hard disk të jashtëm dhe më pas janë fshirë ose korruptuar, etj. Aktualisht për pajisjet videoregjistruese digjitale (kamerat e sigurisë), ndryshe nga fusha e ekzaminimit të kompjuterëve dhe telefonave celularë, ka një numër tepër të kufizuar programesh ekzaminuese, të cilët janë të kufizuar si në numrin e markave e modeleve që mund të ekzaminohen ashtu edhe në rikuperimin e avancuar së të dhënave nga këto pajisje. Bazar në një punë studimore disa vjeçare, kam studiuar në detaje strukturën e videove të ruajtura në hard disqet e këtyre pajisjeve për pothuajse shumicën e markave dhe modeleve që janë në përdorim aktualisht në Shqipëri por edhe më gjerë, si HikVision, Avtech, Fracarro, AVT, Neutron, Defender, Vivosky, Qihan, MakVision etj., si dhe modele të tjera “unbranded”. Për secilin model janë shkruar “script”-e përkatëse kryesisht në gjuhën e programimit Python, nëpërmjet të cilëve mund të kërkohet qoftë edhe për një frame të vetëm të mbetur në hard disk nga pamjet filmike me interes (të kërkuar). Me anë të këtyre teknikave dhe metodave shkencore konkluzioni është kategorik nëse ka apo nuk ka në hard disk pamje filmike për intervalin kohor të kërkuar dhe nëse po, rikuperimi i tyre dhe ruajtja në një format të lexueshëm.

## Fjalëkyçe:

**pajisjet digjitale videoregjistruese, rikuperim të dhënash, kamera, hard disk, pamje filmike.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalorth

1. *Codec* ("compressor/decompressor") - Një pajisje ose program për kodimin dhe dekodimin e të dhënave digjitale. *Codec*-ët janë të nevojshëm për luajtjen e të dhënave të koduara (videove). Përgjithësisht në DVR *codec*-ët janë të personalizuar (*proprietary*).
2. *Imazh* - Një kopje *bitstream* (identike) e të dhënave që ruhen në një pajisje ruajtje informacioni (hard disk, USB, kartë memorie etj).
3. *Raw* - Në këtë prezantim ka kuptimin e të dhënave në nivel individual bajtësh në hard disk.
4. *DVR (Digital Video Recorder)* - Pajisje elektronike për ruajtjen në format digjital, në hard disk, ose pajisje të tjera ruajtje informacioni (lokale ose në rrjet), të pamjeve filmike të filmuara nga kamerat e sigurisë.
5. Pajisje bllokuese shkrimi (*write blocker*) - Pajisje që shërbejnë për lidhjen e hard diskut original (provë materiale) me kompjuterin ekzaminues me qëllim analizimin apo kopjimin e të dhënave, duke ruajtur të pakontaminuar përmbajtjen e hard diskut original.
6. *Header* – Disa bajt në fillim të një skedarit, të njohur ndryshe edhe si numra magjik, që shërbejnë për identifikimin dhe verifikimin e skedarit.
7. *Frame* - Videot janë të përbëra nga seri fotografish të renditura në mënyrë të njëpasnjëshme, të cilat njihen me emrin *frame*. Kur themi se një video është 25 frame për sekondë nënkupton se një sekondë e videos është e përbërë nga 25 fotografi të njëpasnjëshme.
8. *File-System* - Një metodë për organizimin dhe menaxhimin e skedarëve në një medium ruajtës, si p.sh. një hard disk. *File System*-i më i përdorur në *Windows* është NTFS. Një *file system* mund të mendohet si një indeks apo databazë që përmban vendndodhjen fizike të çdo pjesë së të dhënave në *hard drive* ose në një pajisje tjetër ruajtëse.
9. *Offset* – Një mënyrë referimi për lokalizimin e një të dhëne, në cilin bajt ose sektor gjendet e dhëna konkrete (germa, karakteri, fjala) duke filluar numërimin nga fillimi i skedarit apo hard diskut.
10. *Indeks* – Indeksi në DVR ruan informacionin për çdo skedar video të regjistruar nga DVR-ja [datën dhe orën, adresën, madhësinë, numrin e kanalit(kamerës) etj.]

## 1. Kuptim i përgjithshëm mbi rikuperimin e të dhënave (Carving)

“Carving” është një term i përgjithshëm për rikuperimin e skedarëve apo dokumenteve nga të dhënat “raw”, bazuar në karakteristikat specifike që janë prezent në të dhënat e strukturuar (skedarët apo dokumentet). Disa nga teknikat më të njohura “carving” janë:

- a) *Carving* bazuar në *header*-in dhe *footer*-in e skedarit apo dokumentit.
- b) *Carving* bazuar në *header* dhe maksimumin e madhësisë së skedarit (dokumentit).
- c) *Carving* bazuar në strukturën e skedarit (dokumentit).
- d) *Carving* bazuar në *header*-in dhe madhësinë e skedarit (dokumentit), stampuar brenda përmbajtjes së tyre.
- e) *Carving* bazuar në përmbajtjen e skedarit.


<sup>1</sup> EnCase Certified Examiner (Titulli EnCase- Ekspert i certifikuar për ekzaminime kompjuterike dhe përdorimin e metodologjisë EnCase, lëshuar nga kompania Guidance Software Inc. SHBA; nr. Licence)

<sup>2</sup> Cellebrite Certified Logical Operator (Ekspert i certifikuar për ekzaminim logjik të telefonave celularë nga kompania Cellebrite LTD, Israel)

<sup>3</sup> Cellebrite Certified Physical Analyst (i certifikuar për ekzaminime fizike (rikuperim dhe analizim të dhënash të fshira) të telefonave celularë nga kompania Cellebrite LTD, Israel).

<sup>4</sup> CCTV (closed-circuit television; televizion me qark të mbyllur) është një sistem TV në të cilin sinjali nuk shpërndahet publikisht por përdoret për qëllime monitorimi dhe sigurie (kamerat e sigurisë).

Pra, me qëllim rikuperimin e një skedari të fshirë (dokument, video, foto, etj.), nga ana e ekspertit (nëse do të bëhet rikuperim manual), ose e programeve të automatizuara që përdoren për këtë qëllim (të cilët kryejnë rikuperimin në mënyrë automatike), duhet të jenë të njohura elementët e mësipërm. Çdo skedar përgjithësisht përbëhet nga një *header* dhe një *footer*, të cilët gjenden respektivisht në fillim dhe në fund të tij, me një madhësi prej disa bajtësh:



Lokalizimi i *header*-it në një skedar (fotografi) të formatit “jpg”

Programet kompjuterike që përdoren për “carving” ofrojnë mundësinë e rikuperimit të *skedarëve të formateve të njohura* direkt nga përmbajtja “raw” e pajisjeve të ruajtjes së informacionit (hard disqe, karta memorie, UB etj), bazuar në strukturën e tyre, në vend të përdorimit të *metadave* të *file system*-eve që menaxhojnë këto memorie.

Sot ekzistojnë një larmi programesh komerciale dhe pa pagesë, të cilat ofrojnë mundësi të shumta për rikuperimin automatik së të dhënave të fshira, si:

- EnCase, FTK, Cellebrite, XRY dhe programe të tjera për rikuperim të dhënash nga kompjuterët dhe telefonat celularë;
- programe të dedikuara për rikuperim të dhënash të fshira si *Recover My Files*, *PhotoRec*;
- *Bulk Extractor*, *Scalpel*, *Phone Image Carver*;
- *Forensic Explorer*, *X-Ways*, *Nuix* and *Axiom*, etj.

Përveç programeve automatike, ekzistojnë edhe metoda që mund t’i përkufizojmë si gjysmë-automatike, si script-e në *Python*, script-e në *EnCase(EnScripts)*, në *Linux*, etj.

Dhe si mundësi e fundit është rikuperimi manual. Jemi në vitin 2017, po pse akoma kemi nevojë për rikuperim manual? Për këto arsye:

- sisteme të ndryshme operimi dhe versione të tyre;
- aplikacione e programe të ndryshme;
- *file system*-e të ndryshme;
- mungesa e standardizimit;
- kodime të larmishme së të dhënave;
- qindra formate të ndryshme videosh, audiosh, grafike, e dokumentesh;
- qindra e mijëra lloje pajisjesh kompjuterike, të cilat shtohen çdo ditë etj., etj.

Shembull konkret janë videoregjistruesit digjitalë (DVR-të). Prodhuesit e tyre përdorin variante unike si për *hardware*-in ashtu edhe për softuerët si dhe nuk e bëjnë publike mënyrën kodimit të videove që regjistrojnë nga kamerat e sigurisë. Po ashtu, në

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »



këtë industri nuk ekziston ndonjë standardizim, ndryshe nga tipat e skedarëve të përditshëm si, *Word, Power Point, PDF*, fotografi (jpg, bmp, png) etj.

Në këto kushte programet standarde që përdoren në fushën e ekzaminimit kompjuterik, si *EnCase, X-Ways*, etj., apo programe të tjera të dedikuara për rikuperim të dhënash, pothuajse në shumicën dërrmuese të rasteve nuk janë në gjendje të rikuperojnë të dhëna nga këto pajisje.


## 2. Sigurimi i pamjeve filmike nga videoregjistruesit digjital (DVR)

Për nxjerrjen(kopjimin) e pamjeve nga pajisjet videoregjistruese (kamerat e sigurisë) përdoren disa metoda si:


- duke shfrytëzuar opsionet që ofron vetë pajisja, nëpërmjet menyve, butonave e komandave( kopjimi i të dhënave në gjendje të ndezur);
- duke përdorur programe ekzaminuese si *DVR Examiner, DVR dCoder* etj.;
- në mënyrë manuale, me përdorim teknikash të avancuara, direkt nga përmbajtja “raw” e hard diskut.

Rastet kur nevojiten teknika të avancuara mund të jenë të ndryshme si p.sh:

- pajisja videoregjistruese mund të jetë e dëmtuar apo nuk funksionon;
- pajisja është e mbyllur me fjalëkalim(*password*) dhe ai nuk disponohet;
- indeksi i pajisjes është i dëmtuar, korruptuar ose fshirë;
- hard disku është formatuar, ose pamjet filmike janë fshirë;
- hard disku ka sektorë të dëmtuar dhe nuk lexohet nga pajisja;
- asnjë program automatik për rikuperim të dhënash nuk është në gjendje të rikthejë të dhënat nga kjo DVR specifike;
- kur kërkohet qoftë edhe për një sekuençë filmike, sado e shkurtër, për një interval kohor të caktuar.<sup>5</sup>



DVR e mbyllur me password



DVR që nuk mund të dekodohet nga program automatik i destinuar për rikuperim të dhënash nga këto lloj pajisjesh

<sup>5</sup> Kim Thomson dhe Kastriot Gjoka. "What Lurks Beneath: Beyond Automated Carving". Konferenca "Enfuse", Las Vegas, SHBA, 2017.


## 2.1 Sistemet DVR me strukturë video në formatin H264

Shumica e DVR-ve përdorin formatin H.264 për të regjistruar pamjet filmike nga kamerat e sigurisë (vëzhgimit). H.264, e njohur ndryshe edhe me emrin AVC (Advanced Video Coding, MPEG-4 Part 10), është një standard i ri kodimi i videove, i cili mund të arrijë video me cilësi të lartë me *bitrate*<sup>6</sup> relativisht të ulët, pra me shkallë të lartë kompresimi. Nëse videot (pamjet filmike) janë të koduara në formatin “H.264”, çdo *chunk* (bllok) video zakonisht përmban një *header* (disa bajtë identifikuese, unike për atë DVR konkrete) më pas data në “H.264 bytestream” dhe mundet ose jo një *footer*. Të dhënat H.264 konsistojnë në varg bajtësh të enkasuara në një njësi NAL (Network Abstraction Layer). Përmbajtja e kompresuar e videostream gjendet brenda këtyre njësisë NAL. Çdo njësi NAL fillon me pesë bajtë “0x00000001xy”. Tre bajtët pas bajtit të parë (që është \x00), njihen me emrin “start code prefix”. Bajti i fundit ruan informacion rreth NAL-it, ndër të tjera edhe për tipin e tij<sup>7</sup>. Ky bajti i fundit merr vlera të ndryshme në varësi të tipit të njësisë NAL. Shkalla e lartë e kompresimit, bën që zonat në hard disk ku ruhen pamje të tilla të identifikohet me lehtësi për shkak se të dhënat kanë shkallë të lartë entropie<sup>8</sup>.

Për nevoja të këtij studimi, nuk do të ndalemi në trajtimin e detajuar të videove të formatit H.264. Informacioni i mësipërm do të na shërbejë vetëm për identifikimin e zonave me interes me qëllim kërkimin në nivel *frame*-sh për pamje filmike, bazuar në datë dhe orë. Pikërisht zona përreth *header*-it dhe fillimit paketave NAL, do të jetë pikërisht zona ku do të kërkojmë për informacion të dobishëm, pra për datë dhe orë të stampuar sipas një prej mënyrave të treguara më poshtë, në këtë prezantim (shih 2.2.2), me qëllim identifikimin dhe rikuperimin manual ose automatik të pamjeve filmike të kërkuara. Metodrat dhe teknikat do të shpjegohen në vazhdim gjatë këtij prezantimi.

Shumica e prodhuesve të DVR-ve, përdorin *File System*-e të personalizuar (*proprietary*). Kur lidhim një hard disk të këtyre DVR-ve në sistemin e operimit *Windows*, volumi i hard diskut nuk do të shfaqet në *Windows Explorer*, po kështu edhe në programet për ekzaminim kompjuterik struktura e të dhënave nuk shfaqet:

Pamje e hard diskut të një DVR-je të ngarkuar në programin ekzaminues *Encase*.



```
027682436C3 C8 C5 EC A6 7F 5E 0E ED 21 31 DD 69 A1 42 A8 2D 45 48 33 B7 A8 9A DD A5 C0
0276824934D F9 09 6C E4 D4 B6 8E 03 6B 52 D7 80 EE CA AD 13 96 23 39 37 11 74 B4 A7 E8
0276825309C 95 CB 2F D9 F3 E8 71 D2 E6 40 68 D6 F2 AC E8 E4 19 60 24 DF 20 AF 34 7B 42
027682577B7 37 F6 8C FC 76 31 B2 E2 32 70 D6 34 F2 4C 54 24 F3 90 28 A1 C9 39 E8 FC 66
027682624C3 16 E7 AA 17 0F BD FF 33 87 AE F5 5A 87 EF EF 24 25 C7 C4 C2 4C 62 50 ED 2E
027682671B2 9D B2 E6 0A 04 19 C5 91 9E AC 0B 25 FF 84 F3 E9 F5 B3 A3 5A DF C5 83 75 5C
02768271896 FD FF 10 90 20 79 70 77 A8 BD 7B 38 97 2F 34 8F 76 F3 79 AC B7 91 1B 19 69
027682765B0 E0 29 D8 F0 5D 57 DE 28 D3 FF 22 2C 52 78 E7 6B 1E E6 94 F8 13 17 9D 7A 71
027682812DF CF 7C 62 3D 89 2A B2 09 DB 22 4F 2E 60 6A 7C EB 1F 56 02 E3 A0 B5 40 CE 45
0276828596A A1 72 2E 79 CF 9E 18 06 D8 E6 E6 80 00 00 01 BA 6D 4D 5D 33 04 01 02 8F 63
02768290601 00 10 CB 84 14 E0 F8 00 FF FF FF 41 12 48 4B 00 00 00 00 00 00 00 00 00
02768295380 09 00 FF 00 23 28 14 0A 00 00 80 00 00 00 00 00 FF FF 91 C0 00 0C 43 0A 00
0276830000A 2B 53 57 4C C1 FF FF FF FF 0C 00 00 00 01 67 4D 00 32 9A 67 01 40 07 8F F8
0276830473E AE F2 E3 43 00 02 64 80 00 02 64 7D 5D E5 C2 80 00 00 01 E0 00 0E 8C 00 00
027683094FF FF FD 00 00 00 01 65 88 80 18 01 1D FF 01 5C 2D 24 13 F7 6B A5 A3 00 CD 86
```

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>6</sup> Bitrate i videos është numri i bitëve që procesohen në një njësi kohe zakonisht shprehet në Kb/s, ose Mb/s.

<sup>7</sup> SWGDE Best Practices for the Recovery of Data from Security Digital Video Recorders Containing H.264 Data. Version: 1.2 (June 23, 2016).

<sup>8</sup> Entropia (e shpjeguar në mënyrë të thjeshtë) në të dhënat digjitale është matja e rastësisë në një grup të caktuar vlerash (të dhënash).

Në këto kushte identifikimi dhe nxjerrja e pamjeve filmike kërkon përdorim teknikash të avancuara, kur kjo nuk është e mundur nga pajisja për shkaqet e përmendura në fillim të këtij prezantimi.

## 2.2 Rikuperimi i pamjeve filmike nga përmbajtja “raw” e hard diskut të DVR-së

Është e nevojshme të theksojmë që në fillim, se metodat e mëposhtme, mund të aplikohen vetëm nga ekspertë me njohuri të posaçme në fushën e ekzaminimit ligjor kompjuterik dhe videove, si dhe faktin që, këto metoda të avancuara, përdoren vetëm në rastet kur të gjitha opsionet e tjera për ekstraktimin e pamjeve filmike të kërkuara kanë dështuar. Në këtë prezantim, ne do të fokusohemi në mënyrën e rikuperimit të avancuar nga DVR-të me format video “H.264”. Me pak modifikime, e njëjta logjikë dhe mënyrë inxhinierie e kundërt (*reverse engineering*) mund të aplikohet edhe në raste të tjera. Për aplikimin metodave të mëposhtme, fillimisht hard disku i pajisjes ku ruhen pamjet filmike hiqet nga pajisja dhe nëpërmjet një pajisje bllokuese shkrimi (*write blocker*) i merret një imazh (kopje ekzakte bit për bit). Imazhi i përfutur i cili prezanton saktësisht hard diskun e pajisjes, ngarkohet në programe editues ne hex (*Hex Editor*).



### 2.2.1 Mënyra e thjeshtë

Me anë të një programi *hex editor* editohet përmbajtja e hard diskut. Në rastin konkret kemi përdorur programin kompjuterik ekzaminues *EnCase*. Procedura që ndiqet është si më poshtë:

- Kopjimi i pamjeve nga hard disku i pajisjes.

Siç shikohet në figurën më poshtë ky program nuk e lexon(dekodon) *File System*-in e këtij hard disku kështu që e njeh strukturën e hard diskut si “Unused Area”. Kopjohet e gjithë kjo strukturë në copa dhe ruhet në disa skedarë me madhësi të caktuar duke ju vendosur një prapashtesë si p.sh. “H.264”.

**Kopjimi në copa i përmbajtjes së hard diskut dhe eksportimi e ruajtja e tyre si skedarë video**



**AKADEMIA  
E SIGURISË**


Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

- *Luajtja (shikimi) i pamjeve të kopjuara.*

Për luajtjen e pamjeve filmike të kopjuara në këtë mënyrë duhet tentuar përdorimi e disa programeve për lexim videosh si, “ElecCard AVC HD Player”; *Media Player Lite*; *Media Player Classic*, *ffmpeg*, *VLC(?)*, “proprietary players” të vetë pajisjeve etj. Gjithashtu rekomandohet instalimi i çdo *codec*-u të mundshëm (shumica e të cilëve mund të shkarkohen pa pagesë nga interneti), dhe po ashtu gjithmonë dhe ato të vetë DVR-ve, kur është e mundur. Provohen të gjithë dhe zgjidhet ai që i luan më mirë.

- *Gjetja e pamjeve filmike për datën dhe orën me interes.*

Një pjesë e mirë e DVR-ve i regjistrojnë pamjet filmike në mënyrë lineare. Kur hard disku mbushet dhe opsioni i mbishkrimit (*overwriting*) është i aktivizuar, aplikohet parimi FIFO (“First In First Out” - hyrja e parë fshihet e para). Me mënyrën e mësipërme të kopjimit ne gjithashtu e kemi kopjuar hard diskun në mënyrë lineare:



Kështu duke luajtur disa nga skedarët e fillimit, pastaj diku nga mesi, e më pas të fundit, ne krijojmë një ide një ide se në cilët skedarë gjenden pamjet me interes. Gjithsesi kjo është një mënyrë manuale, që do të kërkojë disa përpjekje dhe në rastet kur kemi hard disqe me volum të madh, kjo është një punë e mundimshme. Po kështu, në rastet e fragmenteve mjaft të shkurtra të pamjeve të mbetura në hard disk, identifikimi i tyre do të jetë i vështirë dhe pothuajse i pamundur.

### 2.2.2 Rikuperimi i avancuar i pamjeve filmike bazuar në datë dhe orë.

Në pajisjet DVR *metadata* kyçe ku përfshihet edhe data dhe ora, ruhen në indeksin e tyre dhe po ashtu në fillim të çdo *frame*. Në disa raste data dhe ora është e stampuar në fillim të çdo *video-chunk*-e për çdo sekondë ose në perioda të caktuara sekondash<sup>9</sup>, por në raste të tjera edhe në çdo *frame*. Data dhe ora ruhet në formate të ndryshme, ku më të zakonshmet që hasen janë:

- Unix/Epoch format (32 bit, little endian, hexadecimal);
- në *hexadecimal*, në formatin vit-muaj-ditë-orë-min-sek, ose datë-muaj-vit-orë-min-sek,;
- në binar, “bit maske” katër ose pesë bajt *Hex*;
- në binar, “bit maske” katër ose pesë bajt *Hex*, “swap bytes”.<sup>10</sup>

Metodat dhe teknikat objekt i këtij prezantimi marrin në konsideratë datën dhe orën në nivel *frame*-sh dhe jo atë që është e stampuar në indeksin e DVR-së. Data dhe

<sup>9</sup> SWGDE Best Practices for the Recovery of Data from CCTV Digital Video Recorders- Version: 1.0 (February 05, 2015).

<sup>10</sup> Kim Thomson, Kastriot Gjoka, op. cit.

ora nuk janë të koduara në të njëjtën mënyrë në çdo DVR dhe nuk është e lokalizuar (nuk ndodhet) në të njëjtin vend(*offset*), kështu që ne duhet të dimë mënyrën se si ta lokalizojmë dhe dekodojmë atë për çdo markë dhe model DVR-je. Në disa raste kjo është pak më e lehtë por ka raste kur dekodimi është mjaft i komplikuar. Zona ku do të përqendrohemi është fillimi i njësive NAL, duke kërkuar për *string*-e të tilla si “0x0000001xy”. Po kështu duhet të analizohet me kujdes zona përpara fillimit të NAL, me qëllim identifikimin e *header*-it, apo të ndonjë vargu standard bajtësh që përsëritet në mënyrë periodike, para apo pas vargut që përmban datën dhe orën.

*Më poshtë paraqitet data dhe ora për disa modele DVR dhe mënyra e dekodimit të tyre:*

-HIKVISION: datë dhe orë, pesë bajt, në “binary maske”.

Videoet janë të koduara në formatin H.264, kështu që çdo *frame* është i ruajtur në NAL. NAL, siç kemi thënë më lart, paraprihet nga një kod prej 4 bajtësh 0x00 0x00 0x00 0x01 dhe një bajt tjetër i pestë që tregon tipin e njësisë NAL. Më poshtë paraqitet vendndodhja e datës dhe orës dhe mënyra e dekodimit të saj:

```

027682436C3 C8 C5 EC A6 7F 5E 0E ED 21 31 DD 69 A1 42 A8 2D 45 48 33 B7 A8 9A DD A5 CC
0276824834D F9 09 6C E4 D4 B6 8E 03 6B 52 D7 80 EB CA AD 13 96 23 39 37 11 74 B4 A7 EB
0276825309C 95 CB 2F D9 F3 E8 71 D2 E6 40 68 D6 F2 AC E8 E4 19 60 24 DF 20 AF 34 7B 42
027682577BE 37 F6 8C FC 76 31 B2 E2 32 70 D6 34 F2 4C 54 24 F3 90 28 A1 C9 39 E8 FC 66
027682624C3 16 E7 AA 17 0F BD FF 33 87 AE F5 5A 87 EF EF 24 25 C7 C4 C2 4C 6E 50 ED 26
027682671B2 9D B2 E6 0A 04 19 C5 91 9E AC 0B 25 FF 84 F3 E9 F5 B3 A3 5A DF C5 83 75 50
02768271896 FD FF 10 90 20 79 70 77 A8 BD 7B 38 97 2F 34 8F 76 F3 79 AC B7 91 1B 19 69
027682765B0 E0 29 D8 F0 5D 57 DE 28 D3 FF 22 2C 52 78 E7 6B 1E E6 94 F8 13 17 9D 7A 71
027682812DF CF 7C 62 3D 89 2A B2 09 DB 22 4F 2E 60 6A 7C EB 1F 56 02 E3 A0 B5 40 CE 49
0276828596A A1 72 2C 79 CF 9F 88 06 D8 E6 E6 B0 00 00 01 BA 6D 4D 5D 33 04 01 02 8F 63
02768290601 00 10 CB 84 14 E0 F8 00 FF FF FF 41 12 48 4B 00 00 00 00 00 00 00 00 00
02768295380 09 00 FF 00 23 28 44 0A 00 00 80 00 00 00 00 00 00 FF FF 91 C0 00 0C 43 0A 00
0276830000A 2B 53 57 4C C1 FF FF FF FF FC 00 00 00 01 67 4D 00 32 9A 67 01 40 07 8F 9F
0276830473E AE F2 E3 43 00 02 64 80 00 02 64 7D 5D E5 C2 80 00 00 01 E0 00 0E 8C 00 03
027683094FF FF FD 00 00 00 01 65 88 80 18 01 1D FF 01 5C 2D 24 13 F7 6B A5 A3 00 CD 86
    
```

Data dhe ora në Hexadecimal: 10 CB 8414E0

Konvertuar në vlera binare: 0001000011001011100001000001010011100000,

*Dekodimi:*

Viti = 8 bitët e para	Muaji = 4 bitët pasardhëse	Dita= 5 bitët e tjera	Ora= 5 bitët e tjera	Minuta=6 bitët e tjera	Sekonda= 6 bitët e tjera
00010000	1100	10111	00001	000001	010011
Viti: 16	Muaji: 12	Data: 23	Ora: 01	Minuta: 01	Sekonda: 19

(Vlerat në binarë konvertohen në decimal) <sup>11</sup>



**Pamja filmike e kopjuar nga zona ku u gjet data dhe ora e mësipërme**

**AKADEMIA E SIGURISË**


*Konferencë shkencore ndërkombëtare:*

“ Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë ”

<sup>11</sup> Analysis of Hikvision Date/Time, (2016), Jimmy Schroering /Forensic DVR Recovery, / DVR Forensics.

-H.264 DVR, model: AVT9603E:

Datë dhe orë katër bajt në “binary masked”, “reverse bytes”.



Data dhe ora

69 4E F9 42 – (katër bajt, katër bajt përpara *string*-ut 0x0000000167)

Në “swap bytes” : 42 F9 4E 69 , në vlerë binare:010000101111001010011101101001 –

Konvertimi (nga e majta në të djathtë)

Viti = 6 bajt	Muaji = Katër bajt	Data= Pesë bajt	Ora= Pesë bajt	Minutat = Gjashtë bajt	Secondat = Gjashtë bajt
010000	1011	11100	10100	111001	101001
16	11	28	20	57	41

Pamja filmike e kopjuar nga zona ku u gjet data dhe ora e mësipërme



Pasi kemi arritur të identifikojmë datën dhe orën dhe mënyrën e dekodimit të saj, për të automatizuar procesin e kërkimit mund të shkruhen skripte të ndryshme dhe të kërkohet e gjithë përmbajtja e hard diskut. Për këtë na nevojitet të identifikojmë një *string* bajtësh të cilët gjenden gjithmonë përpara ose pas *string*-ut të bajtëve që përfaqësojnë datën dhe orën. Ky *string* bajtësh duhet të jetë i qëndrueshëm pra të përsëritet gjithmonë dhe në të njëjtin *offset* në raport me datën dhe orën. Për këtë nevojitet të kryhen disa testime derisa të vlerësohet plotësisht si teori.

“Një sekret i vogël rreth programeve automatike është se, në mënyrë që të arrijmë të bëjmë rikuperim automatik, ne duhet ta bëjmë atë të paktën njëherë manualisht. Kur arrijmë ta kuptojmë se si bëhet manualisht atëherë mund ta automatizojmë, megjithëse jo gjithmonë.”<sup>12</sup>

Më poshtë paraqitet një pjesë skripti i shkruar në gjuhën e programimit “Python”, për analizimin e përmbajtjes së një hard disku të një DVR-je ( kërkim për pamje filmike me datë dhe orë), i cili mund të ekzekutohet mbi një imazh *raw* të hard diskut:

Pamje e pjesës së fillimit një skripti në Python për analizim DVR-je sipas metodës së rekomanduar<sup>13</sup>

```

1 import time
2 import re
3 import binascii
4 import struct
5
6 def find_timestamp():
7     year = time.localtime()[0]
8     basebits = struct.unpack('10', time.localtime(1))[:10]
9     month = int(basebits[0] / 2**23)
10    day = int((basebits[0] - month*2**23) / 2**22)
11    hour = int((basebits[0] - month*2**23 - day*2**22) / 2**21)
12    minute = int((basebits[0] - month*2**23 - day*2**22 - hour*2**21) / 2**20)
13    second = int((basebits[0] - month*2**23 - day*2**22 - hour*2**21 - minute*2**20) / 2**19)
14    return str(year) + "-" + str(month) + "-" + str(day) + " " + str(hour) + ":" + str(minute) + ":" + str(second)
15
16
17 #RAW_SIZE = time.time()
18 #OUTPUT = open("bin2hex.txt", "w")
19 #buf_size = 1000000
20
21 with open("bin2hex.txt", "rb") as f:

```

<sup>12</sup> Kim Thomson, Kastriot Gjoka, op. cit.  
<sup>13,14</sup> Po aty.

Rezultatet e kërkimit pas ekzekutimit të skriptit, eksportohen nga vetë ky *script* në një skedar (mund të zgjidhet formati tekst “.txt”, “.csv” etj.). Ky skript eksporton dy elementë kryesorë; *offset*-in dhe datën dhe orën. Në versionet e përmirësuara kemi përfshirë edhe numrin e kanalit (kamerës).

Për të ilustruar rezultatet konkrete që arrihen nëpërmjet kësaj metode, në shembullin më poshtë është ekzaminuar një DVR konkrete me tre mënyra:


- në gjendje të ndezur;
- me një program ekzaminues të dedikuar për ekzaminimin e DVR-ve;
- me metodën dhe teknikën e zhvilluar nga ana jonë.

Nga këqyrja që ju bë pajisjes në gjendje të ndezur, nëpërmjet menyve të saj, ajo tregon se ka pamje filmike që i përkasin periudhës 16-11-2016 deri më 23-11-2016. Pra këto janë pamjet filmike që mund të eksportohen nëpërmjet këqyrjes së kësaj pajisje në vendngjarje.

Hard disku i kësaj pajisje, po ashtu, u analizua edhe me një nga programet kryesore, që përdoren sot në laboratorët që kryejnë ekzaminime kompjuterike dhe video. Edhe ky program, tregon se intervali kohor i pamjeve që ruhen në hard diskun e DVR-së së mësipërme, i përkasin po së njëjtës periudhë:

```
Overall Date/Time Range
Earliest: 11/16/2016 11:26:58
Latest: 11/23/2016 02:29:37
```


Me përdorimin e skriptit tonë, rezultati i përfuar tregon për prezencën e pamjeve filmike që i përkasin edhe periudhave jashtë rangut të mësipërm:



**Rezultatet e nxjerra nga *script*-i që tregojnë për prezencën e pamjeve filmike të vitit 2015**

*Kopjimi(eksportimi) i pamjeve nga hard disku.* Për datën dhe orën me interes, nga tabela e rezultateve të nxjerra nëpërmjet *script*-it, duke filluar nga *offset*-i ku ndodhet, eksportohet një *chunk* (pjesë-copë) dhe ruhet në një skedar. Në rastin konkret kemi eksportuar afërsisht 10 MB dhe e kemi ruajtur me emrin “video-1. H264”:

**Pamje e video-s së rikuperuar, duke u luajtur në një video player<sup>14</sup>:**



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

Në disa hetime edhe një *frame* i vetëm mund të zgjidhë çështjen ose mund të japë informacion të dobishëm për hetimin. P.sh nëse një ambient të caktuar është mbajtur një material apo send i paligjshëm në vitin 2015 dhe më pas është hequr nga aty në vitin 2016 dhe DVR-ja që ka regjistruar pamje filmike nga ai ambient sekuestrohet në vitin 2017, një *frame* i rikuperuar nga viti 2015 që tregon pamjen e ambientit është mjaft i rëndësishëm për hetimin.

Në kushte normale pasi hard disku i DVR-së mbushet me pamje filmike, regjistrimet e reja vazhdojnë të shkruhen në zonat ku ndodhen pamjet më të hershme (Parimi FIFO i shpjeguar më lart). Ky proces mbishkruan pamjet e vjetra dhe për rrjedhojë ato fshihen në mënyrë të parikuperueshme. Pra teorikisht pamjet e vjetra që mbishkruhen nga të rejtat si rezultat i aktivitetit regjistruar të DVR-së, nuk mund të rikthehen. Pamjet e mësipërme në rastin e demonstruar nga ana jonë i përkasin vitit 2015, ndërkohë që DVR-ja ka qenë në punë dhe ka regjistruar deri në Nëntor 2016 dhe teorikisht duhet t'i kishte fshirë çdo gjurmë të pamjeve kaq të vjetra. Fragmente pamjesh filmike të "vjetra" mund të mbeten në zona të ndryshme të hard diskut për shkak të "pamundësisë" le të themi të *firmware*-it dhe *File System*-it që menaxhon DVR-në, për të mbishkruar 100% të gjithë sipërfaqen e hard diskut. Në rastin e mësipërm pamjet e "vjetra" kanë mbetur kryesisht në fund të blloqeve të dedikuara për secilën kamerë. Pak a shumë kjo është në analogji më termin "slack space" në hard disqet e kompjuterëve me sistem operimi *Windows*.


Në rastin e kompjuterëve, dokumentet, *email*-et, apo *chat*-et janë të përbërë nga fjalë, pra nga tekst. Një nga funksionet bazike të programeve ekzaminuese kompjuterike për të kërkuar për të dhëna të tilla, është kërkimi me fjalë kërkimi (*keyword search*), i implementuar pothuajse në çdo program të tillë. Megjithatë rezultati i kërkimit asnjëherë nuk mund të thuhet se është 100% i sigurt. Ekzistojnë disa limitime në rastin e kërkimit me fjalë kërkimi, si: fragmentimi i fjalës (gjysma e fjalës mund të jetë në një sektor, ndërsa gjysma tjetër në një sektor tjetër, por që ndodhet diku tjetër në hard disk), kompresimi (fjala apo përmbajtja që kërkohet, ndodhet në një kontejner të kompresuar), kriptimi etj. etj. Në rastin e DVR-ve kemi të bëjmë me video dhe ato janë të përbëra nga *frame*. Ekzaminimi do të quhej i plotë, vetëm nëse kemi kërkuar dhe rikuperuar çdo *frame* të mundshëm. Në kompjuter, shumicën e rasteve ne nuk e dimë se si mund të jetë i ruajtur apo në ç'formë kanë mbetur në hard disk gjurmët e një dokumenti, *email*-i apo *chat*-i.

Në DVR, pavarësisht shumëllojshmërisë së tyre dhe mungesës së standardizimit në mënyrën e kodimit së të dhënave, nëse në një model të caktuar arrijmë të kuptojmë strukturën e njërës nga *frame*-t, të gjitha *frame*-t e tjera të kësaj kategorie, do të kenë të njëjtin standard kodimi.

Në metodën e rekomanduar në këtë prezantim, ne mund të rikuperojmë çdo "frame" të mundshëm të mbetur në hard disk. Kufizimi i vetëm i kësaj metode ka të bëjë me numrin e markave dhe modeleve, të cilat janë arritur të dekodohen për t'u ekzaminuar me këtë mënyrë. Pra metoda ekzaminuese e zhvilluar nga ana jonë, provon në mënyrë shkencore dhe jep një konkluzion kategorik, që në sistem (DVR) ekziston ose jo, qoftë edhe një *frame* e vetme që t'i përkasë periudhës kohore me interes, dhe nëse po, rikuperimi dhe ruajtja në një format të lexueshëm. Aktualisht, teknikat e mësipërme po përmblihen në një program të vetëm, program i cili në këto momente është në versionet e para të tij dhe në përmirësim e sipër. Deri tani, metodat e mësipërme janë zhvilluar dhe po aplikohen për pothuajse për shumicën e markave dhe modeleve



që vijnë për ekzaminim, si *HikVision, Avtech, Fracarro, AVT, Neutron, Defender, Vivosky, Qihan, MakVision* etj., si dhe modele të tjera “unbranded”<sup>15</sup>:



Problemet që hasen në rastin e përdorimit të metodave të mësipërme.

*Multiplexing*. Shumica e DVR-ve i ruajnë pamjet filmike në hard disk në formën “multiplex”( kamerat në një interval kohor të caktuar janë të përziera):

<b>Block 1</b>	<b>Kamera 1</b>
<b>Block 2</b>	<b>Kamera 2</b>
<b>Block 3</b>	<b>Kamera 1</b>
<b>Block 4</b>	<b>Kamera 3</b>
<b>Block 5</b>	<b>Kamera 4</b>
<b>Block 6</b>	<b>Kamera 2</b>

Për ndarjen e pamjeve filmike të secilës kamerë, në rastin kur bëhet kopjimi direkt, nga vetë DVR-ja e bën programi i saj. Në rastin tonë, ne kopjojmë në “raw” kështu që videot e rikuperuara do të jenë në formën *multiplex*. Ndarja e kamerave në mënyrë manuale kërkon kohë dhe përpjekje të shumta. Zgjidhjet e rekomanduara janë përdorimi i programeve të posaçme kompjuterike, si *AMPED Software, dPlex Pro*, etj.. Nëse kjo është shumë e nevojshme dhe nuk ka zgjidhje tjetër, ndarja e kamerave mund të bëhet edhe manualisht duke përdorur dhe dekoduar informacionin e nevojshëm nga *header*-i i videove (metodë e cila nuk është subjekt i këtij prezantimi).

### 3. Përfundime

- Në këtë prezantim është prezantuar një metodë e re e inxhinierie e kundërt, për të identifikuar dhe rikuperuar pamjet filmike nga videoregjistruesit digjitalë (DVR), për çdo datë dhe orë të caktuar, e cila mund të përdoret në kushtet kur metodat e tjera dështojnë.

Videoregjistruesit digjitalë (DVR-të), e ruajnë informacionin në vlera binare (0 dhe 1). Roli i ekzaminuesit është të nxjerrë informacionin e përfaqësuar në këtë mënyrë, pavarësisht metodave që ai përdor - mjafton që të mos kontaminohet të dhënat origjinale. Në rast të përdorimit të metodave të mësipërme, është përgjegjësi e ekspertit që i aplikon të verifikojë rezultatet e përfuara.

- Metoda e rekomanduar në këtë prezantim, është një metodë e avancuar, e cila jep një konkluzion shkencor kategorik dhe përfundimtar, për prezencën ose jo të këtyre

<sup>15</sup> Një falënderim i veçantë shkon për Ing. Bledar Kurti, administrator rrjeti në kompaninë telefonike celulare “PLUS Communication Sh.a”, për kontributin e tij në shkrimin e *script*-eve për automatizimin e këtyre metodave ekzaminuese.

pamjeve filmike me interes, apo qoftë edhe të një fragmenti të vetëm të tyre dhe nëse konstatohen; rikuperimin dhe eksportimin e tyre nga memoria e pajisjes (hard disku) në një format të lexueshëm.

- Metodatat e mësipërme shërbejnë për identifikimin dhe rikuperimin e pamjeve filmike me interes. Pas ekzaminimit me këtë metodë, nëse pamjet filmike të caktuara paraqesin interes për hetimin, një analizë me e hollësishme e strukturës së tyre, duhet të ndërmerret me qëllim dekodimin e saktë të tyre, për të arritur maksimumin e cilësisë së këtyre pamjeve.

- E njëjta metodologji, por duke bërë modifikimet përkatëse, mund të aplikohet për marka e modele të tjera.

## 4. Rekomandime

- Metodatat dhe teknikat e mësipërme aplikohen si hapi i fundit, vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha mundësitë e tjera. Këto metoda dhe teknika, së pari kërkojnë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme dhe së dyti, ato nuk mund të jenë të aplikueshme për çdo markë e model DVR-je. Mjafton të përmendim faktin se ky lloj ekzaminimi zhvillohet në nivel bajtësh dhe binarësh dhe nëse një hard disk me kapacitet 2 *Terabyte* (i cili është normal në ditët e sotme) do të printohej, do të duheshin rreth 172 milion faqe të formatit A4.

- Në rastet kur pajisja gjendet e ndezur, rekomandojmë fuqishëm që të bëhet menjëherë kopjimi i pamjeve filmike, direkt nga pajisja. Veç vështirësive që kanë metodatat e mësipërme, kopjimi direkt siguron dekodim më të saktë (“aspect ratio”<sup>16</sup>, numri i *frameve* për sekondë, audio, etj.) si dhe të dhëna të tjera më të plota rreth skedarëve video, si *metadat* e plota etj.,

- Nëse pamjet filmike me interes nuk konstatohen me metodatat e tjera, pajisja duhet t’i nënshtrohet ekspertimit kompjuterik. Vetëm një ekspertim shkencor i avancuar do të mundësonte rikuperimin e tyre nëse është i mundur.

- Ekspertët e ekzaminimeve kompjuterike dhe audio, nuk duhet të krijojnë varësi ndaj programeve dhe pajisjeve ekzaminuese që disponojnë. Ata duhet të njohin limitimet e tyre, në mënyrë që rezultatet e ekzaminimit të mos jenë thjesht një produkt i “shtypjes së ca butonave”.

- Për shkak të natyrës së ekzaminimit kompjuterik, vetëm nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të njohurive ndërmjet ekspertëve, punës në grup dhe kontrollit të dyfishtë të rezultateve të ekspertimit, do të rritej shkalla e suksesit.

## Bibliografia

1. Kim Thomson dhe Kastriot Gjoka. “What Lurks Beneath: Beyond Automated Carving”. Konferenca “*Enfuse*”, Las Vegas, SHBA, 2017.
2. SWGDE Best Practices for the Recovery of Data from Security Digital Video Recorders Containing H.264 Data. Version: 1.2 (June 23, 2016).
3. Bas Kloet, Hoffmann Investigations, *Advanced file carving, How much evidence are you ignoring*, September 2010.
4. *Analysis of Hikvision Date/Time*, February 25, 2016 / Jimmy Schroering / Forensic DVR Recovery, / DVR Forensics
5. SWGDE *Best Practices for the Recovery of Data from CCTV Digital Video Recorders* Version: 1.0 (February 05, 2015)



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Studimi i frekuencave alelike të popullatës shqiptare dhe, rëndësia e saj, për shkencën e biologjisë ligjore, në Shqipëri

**MSc. Ela ZAİMİ<sup>1</sup>**

Instituti i Policisë Shkencore

[ela.zaimi@asp.gov.al](mailto:ela.zaimi@asp.gov.al)

## Abstrakt

*Instituti i Policisë Shkencore në Policinë e Shtetit, prej vitit 2009 e në vazhdim kryen analizën e ADN-së me qëllim identifikimin e autorëve të veprave penale të ndryshme, identifikimin e lidhjeve gjenetike atësi dhe mëmësi, identifikimin e mbetjeve humane. ADN<sup>2</sup> është e pranishme në shumicën e qelizave të trupit tonë. Ajo është unike për secilin prej nesh dhe ne lëmë një gjurmë të saj kudo që të shkojmë. Për ekspertët e shkencave mjekoligjore, përdorimi i analizës së ADN-së është një konfirmim i identitetit të çdo personi, që ka pasur kontakt me vendngjarjen. Sigurisht, analiza e ADN-së është një hallkë me rëndësi të konsiderueshme në shkencën e biologjisë ligjore; duke ndihmuar në identifikimin e vrasësve dhe autorëve të veprave penale; duke mundësuar identifikimin e mbetjeve humane në rastet e fatkeqësive natyrore dhe masakrat njerëzore si Masakra e Srebrenicës; ndez një dritë mbi gabimet e mundshme të drejtësisë, për raste kur njerëz të pafajshëm janë dënuar gabimisht. Kaq e madhe është fuqia e ADN-së për të identifikuar, dënua dhe shfajësuar, sa shumë njerëz e perceptojnë atë të pagabueshme. Megjithatë, provat e ADN-së kanë një numër kufizimesh: mund të mos zbulohen, të neglizhohen ose të gjenden në sasi të vogla gjurmësh që e bëjnë të vështirë interpretimin. Në vendin tonë, kjo fushë e ekzaminimit shkencor ka nevojë për zhvillime bashkëkohore, mbështetje dhe kërkim shkencor. Me qëllim rritjen e kapaciteteve shkencore për analizën e ADN-së sektori i ekzaminimeve biologjike dhe ADN-së ka përfunduar me sukses projektin "Studimi i frekuencave alelike të popullatës shqiptare", të cilin po e prezantojmë në këtë konferencë shkencore. Ky projekt u realizua në sajë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së OSBE-së në Shqipëri, nën kujdesin e veçantë të z. Adrian Nessel dhe z. Scabolz Tunics. Ky projekt me vlera të rëndësishme shkencore, i realizuar për herë të parë në vendin tonë, shënon fillimet e rrugës për rritjen e cilësisë dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare si ISO 17025<sup>3</sup> duke i paraprirë procesit të akreditimit, një sfidë e madhe për t'u përmbushur në vitet në vijim<sup>4</sup>.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**ADN, IPSH, frekuenca alelike, Identifikim.**

## 1. Hyrje

Nëse njeriu do të krahasohej me një mur, atëherë çdo tullë e murit do të ishte një qelizë në organizmin tonë. Në çdo qelizë<sup>5</sup> gjendet ADN-ja, e cila është njësia biologjike që përmban informacionin gjenetik specifik, të secilit prej nesh. Në analizën e ADN-së, ne jemi të interesuar të shqyrtojmë ndryshimet midis individëve të ndryshëm dhe për këtë arsye, puna jonë fokusohet në studimin e aleleve të lokuseve<sup>6</sup> të ndryshme të ADN-së. *Aleli* është një karakteristikë e veçantë e një profili gjenetik për një lokus të caktuar. Termi “frekuencat alelike”, në lidhje me popullatën shqiptare, nënkupton shpeshësinë e shfaqjes së një aleli në mostrat e ekzaminuara. Tërësia e këtyre karakteristikave të veçanta e bën një profil gjenetik<sup>7</sup> unik.

<sup>1</sup> MSc në “Biologji Qelizore dhe Molekulare”; shefe e sektorit të ekzaminimeve biologjike në Institutin e Policisë Shkencore në Policinë e Shtetit; lektore e lëndës Biologjia Humane në Fakultetin e Stomatologjisë, Albanian University, Tiranë.

<sup>2</sup> ADN-Acidi dezoksiribonukleik

<sup>3</sup> ISO 17025 - Standard ndërkombëtar që paraqet kërkesa të përgjithshme për zotësinë e laboratorëve testues dhe kalibrues

<sup>4</sup> Në kuadër të këtij projekti dëshirojmë që të përcjellim falënderime të veçanta për z. Adrian Nessel dhe z. Scabolz Tunics; për të gjithë shefat e sektorëve të Policisë Shkencore pranë drejtorive vendore të Policisë; për të gjithë personat që vullnetarisht dhanë kampionet e pështymës; specialistin e IT-së, z. Krenar Bici dhe sigurisht të gjithë punonjësit e Sektorit të Ekzaminimeve Biologjike dhe ADN-së në Institutin e Policisë Shkencore të Policisë së Shtetit.

<sup>5</sup> Qeliza - njësia thelbësore, funksionale, ndërtimore dhe strukturale e organizmave të gjallë (R. Hook).

<sup>6</sup> Lokus - zonë e ADN-së që është objekt i kësaj analize, të cilat në rastin e kësaj analize nuk kodojnë për tipare fenotipike ose gjenotipike. Lokuset e përzgjedhura për këtë analizë janë shumë polimorfike.

<sup>7</sup> Profil gjenetik - është një bashkësi karakteristikash unike të ADN-së tek çdo individ, që përfitohet nga analizimi i një mostre biologjike dhe që shërben për të bërë identifikimin e personit nëpërmjet krahasimit të këtyre karakteristikave.

Nga studimet statistikore të kryera në vende të tjera të Evropës, rëndësia e përzgjedhjes së mostrave të tilla, është konsideruar thelbësore. Në këtë studim u analizuan 200 mostra, përfaqësuese nga e gjithë Shqipëria, mbështetur në të dhënat e publikuara nga INSTAT<sup>8</sup>, censusi i vitit 2014. Me anë të këtij studimi, identifikohen tendencat alelike të popullatës shqiptare, identifikohen alelet e rralla dhe mutacionet alelike, nëse ka. Rezultatet e këtij studimi, janë kusht për të realizuar çdo lloj vlerësimi statistikor të një profili të gjetur në vendngjarje, për të hartuar në mënyrë të plotë (*përshirë vlerësimin statistikor*) një akt ekspertimi biologjik të ADN-së dhe, frekuencat alelike të këtij studimi, do përdoren si referenca për popullatën shqiptare.

## 2. Etapat e projektit

### 2.1 Faza përgatitore

Në këtë fazë morën pjesë të gjithë shefat e sektorëve të Policisë Shkencore pranë, drejtorive vendore të policisë. Qëllimi ishte informimi i pjesëmarrësve mbi projektin dhe një paraqitja e një përmbledhjeje të detajuar të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

### 2.2 Faza e mbledhjes së mostrave

Gjatë fazës së mbledhjes së mostrave u zbatuan rregullat e mëposhtme:

Qarqet	Viti 2014	Numri i kampioneve
Shqipëria	2.894.476	200
Berat	143.888	10
Dibër	137.339	9
Durrës	275.689	19
Elbasan	302.112	20
Fier	316.406	21
Gjirokastrë	72.879	5
Korçë	225.116	15
Kukës	85.967	6
Lezhë	137.514	10
Shkodër	219.879	15
Tiranë	794.658	58
Vlorë	182.963	12

**Tabela 1**

<sup>8</sup> INSTAT- Instituti i Statistikave, <http://www.instat.gov.al/home.aspx>

- Mostrat u mblodhën nga e gjithë Shqipëria sipas ndarjes në tabelën e mëposhtme që u përcaktua nga ekspertët biologë; kjo nënkupton që rrethet me popullsi më të madhe do kenë numër më të madh mostrash përfaqësuese në këtë projekt (p.sh. Tirana).

- Ekspertët që morën mostrat u siguruan që personat që dhanë mostrën në mënyrë vullnetare nuk kanë lidhje gjenetike, p.sh. të jenë kushërinj të parë.

- Në tamponët që u përdoren për marrjen e mostrave nuk u shënuan të dhëna personale (dhe as moshë), por u shënuan vetëm vendi nga ata vijnë dhe numri rendor sipas kodit p.sh. TR1, etj.

### **2.3 Faza e ekzaminimit**

Të gjitha proceset u realizuan në laboratorin e ADN-së pranë Institutit të Policisë Shkencore. Ekstraktimet u realizuan në mënyrë manuale me kitin PrepFiler™. Çdo fazë e këtij procesi u shoqërua me plotësimin e formularëve përkatës. PCR (polymerase chain reaction), është procesi në të cilin bëhet amplifikimi i fragmenteve të ADN-së së ekstraktuar. Me anë të këtij procesi kemi amplifikuar këto lokuse:

D10S1248, HumvWA31, D16S539, D2S1338, amelogenin (sex test), D8S1179, D21S11, D18S51, D22S1045, D19S433, HumTH01, HumFGA, D2S441, D3S1358, D1S1656, D12S391, SE33, duke përdorur kitin “Amp-ISTR NGM Select™ Kit”. Aparatura e përdorur është GeneAmp PCR 9700. Produktet e amplifikuara u analizuan me aparaturën ABI PRISM 3130 *Genetic Analyzer*.

### **2.4 Faza e përpunimit së të dhënave**

Gjatë kësaj faze u krye përpunimi i të dhënave tabelare nga specialistët e teknologjisë së informacionit. Për disa lokuse u realizuan edhe përpunime manuale nga ekspertët biologë.

## **3. Përfundimet e projektit studimor**

Në fund të këtij projekti studimor arrijmë në këto përfundime:

- gjetjet e këtij studimi shërbejnë për të realizuar çdo lloj vlerësimi statistikor të një profili të gjetur në vendngjarje, për të hartuar në mënyrë të plotë (*përshirë vlerësimin statistikor*) një akt ekspertimi biologjik të ADN-së;

- frekuencat alelike të këtij studimi, do përdoren si referenca për popullatën shqiptare;

- rezultatet e këtij studimi, pas përpunimit statistikor në paraqitje tabelore janë si më poshtë (Tabela 2).

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

lokusi	D151656	D1051248	D251338	D165539	vEA	TH01	D25441	D351358	D851179	D125391	D18551	D195433	D21511	D2251045	FGA	SE33
6						0.295										
7						0.1										
7.3																0.0025
8				0.0275		0.15			0.0175							
9				0.115		0.1975			0.0075							
9.3						0.2375										
10				0.055		0.02	0.1225		0.07		0.005	0.0025				
11	0.065	0.005		0.3025			0.355		0.0775		0.0075	0.015		0.125		0.0025
11.3							0.0875									
12	0.1125	0.0025		0.3325			0.0575	0.0025	0.1		0.0675	0.075		0.005		
12.3							0.005									
13	0.0675	0.1925		0.14			0.03	0.0025	0.2925		0.1625	0.2075		0.0025		0.005
13.2												0.005				0.0025
14	0.0525	0.29		0.0275	0.085		0.3025	0.075	0.2375		0.2075	0.33		0.0675		0.0175
14.2												0.0525				
14.3	0.005															
15	0.1725	0.285			0.1025		0.0325	0.265	0.1575	0.0775	0.1275	0.1375		0.3675		0.025
15.2												0.055				
15.3	0.0675															0.0025
16	0.1125	0.1675	0.0725		0.19		0.0075	0.2375	0.035	0.025	0.1575	0.085		0.33		0.0575
16.2												0.02				
16.3	0.055															
17	0.055	0.055	0.23		0.3325			0.2075	0.005	0.0925	0.085	0.005		0.0825		0.1
17.2												0.005				
17.3	0.1475									0.01						
18	0.01	0.0025	0.09		0.2175			0.1975		0.1925	0.0775			0.0175	0.0075	0.085
18.2										0.0025		0.005				
18.3	0.055									0.035						
18.8										0.0025						
19			0.0725		0.0475			0.0125		0.1075	0.035			0.0025	0.055	0.11
19.2																0.0025
19.3	0.02									0.0075						
20			0.1725		0.025					0.1075	0.02			0.0975	0.0375	
20.2																0.0075
20.3	0.0025									0.0025						
21			0.03							0.075	0.0425			0.1675	0.0325	
21.2														0.0075	0.015	
22			0.02							0.1225	0.0025			0.1725	0.005	
22.2														0.0025	0.0425	
23			0.1375							0.09				0.17		
23.2																0.045
24			0.0775							0.0275	0.0025			0.14		
24.2														0.0075	0.025	
25			0.08							0.0225			0.0025	0.105		
25.2																0.02
26			0.0175										0.0025	0.04		
26.2																0.05
27													0.0175	0.025		
27.2																0.0425
27.3																0.0025
28													0.1275	0.0025		
28.2																0.08
29													0.31			
29.2													0.0075			0.085
30													0.1825			
30.2													0.0475			0.03
31													0.04			
31.2													0.125			0.02
32													0.0075			0.0025
32.2													0.0825			0.0275
33																0.0125
33.2													0.0475			
34																0.0025
35																0.0025

**Tabela 2**

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »



## 4. Rekomandime

*Mbështetur në përfundimet e arritura, është rekomandohet:*

- 1- përdorimi i këtyre rezultateve për përlllogaritjen e LR (Likelihood Ratio);
- 2- krahasimi i frekuencave alelike të popullatës shqiptare me frekuencat alelike të popullatave të vendeve fqinje, për të vlerësuar distancat gjenetike, të cilat do japin një pasqyrë të qartë për sa i takon lidhjeve gjenetike me popullatat fqinje.

## Literatura

1. Projiæ P, Škaro V, Šamija I, et al. Allele Frequencies for 15 Short Tandem Repeat Loci in Representative Sample of Croatian Population. *Croatian medical Journal*. 2007;48(4):473-477.
2. Lee SD, Lee JB. Allele frequency and its forensic application of STR Y27 in Korean males. *Journal of Korean Medical Science*. 1996;11(5):386-389.
3. Wang H, Shen C, Liu W, et al. Allelic frequency distributions of 21 non-combined DNA index system STR loci in a Russian ethnic minority group from Inner Mongolia, China. *Journal of Zhejiang University Science B*. 2013;14(6):533-540. doi:10.1631/jzus.B1200262.
4. Allele Frequency of 15 Short Tandem Repeats (Strs) in a Buganda.
5. Population (Central Uganda): Forensic Utility and Parentage Testing.
6. Iskakova AN, Romanova Voronina AA, Voronina EN, Sikhayeva NS, Belozerceva AB, et al. (2014) Allele Frequency and Genotype Distribution of 9 SNPs in the Kazakh Population. *J Pharmacogenomics Pharmacoproteomics* 5:129. doi: 10.4172/2153-0645.1000129.
7. Visscher PM, Hill WG (2009) The Limits of Individual Identification from Sample Allele Frequencies: Theory and Statistical Analysis. *PLoS Genet* 5(10): e1000628. <https://doi.org/10.1371/journal.pgen.1000628>.
8. Da Costa Francez PA, Rodrigues EMR, Frazão GF, dos Reis Borges ND, dos Santos SEB. Allelic frequencies and statistical data obtained from 12 codis STR loci in an admixed population of the Brazilian Amazon. *Genetics and Molecular Biology*. 2011;34(1):35-39. doi:10.1590/S1415-47572011000100007.
9. Allele frequency (nature education) : <http://www.nature.com/scitable/definition/allele-frequency-298>.
10. Allele frequencies : <http://www.allelefrequencies.net/>

# Sistemi AFIS/APIS dhe zbatimi i kësaj teknologjie, në luftën kundër kriminalitetit

**Orest Afezulli FFS<sup>1</sup>, AM<sup>2</sup>**

Drejtoria e Policisë së Shtetit, Sistemi AFIS

orest.afezulli@asp.gov.al

## Abstrakt

Në këtë punim është synuar të jepet një informacion mbi procesin e informatizimit të gjurmëve papilare, duke u fokusuar në sistemin aktual të identifikimit automatik të gjurmëve të gishtave dhe pëllëmbëve, AFIS/APIS Papillon-7, i instaluar në sektorin e daktiloskopisë, në Institutin e Policisë Shkencore, në muajin tetor 2002. Duke qenë se për herë të parë në historinë e Policisë Shqiptare është aplikuar ky sistem automatik, rrjedhimisht dhe informacioni i përdorur në këtë punim, ka dalë nga përpunimi statistikor 15 vjeçar i akumuluar në këtë sistem. Metodologjia e identifikimit të gjurmëve papilare është përpunuar ndërvite dhe një ndihmesë të jashtëzakonshme në këtë drejtim ka dhënë dhe përdorimi i teknologjisë informatike<sup>3</sup> e cila ka rritur në shkallë shumë të lartë shpejtësinë e marrjes së rezultatit dhe njëkohësisht një saktësi të admirueshme dhe mbresëlënëse të këtyre rezultateve. Përdorimi i teknologjisë së lartë, i ka dhënë përparësi zbulimit të shpejtë të veprave të ndryshme penale si dhe arrestimin dhe nxjerrjen përpara drejtësisë të autorëve, të cilët janë dekonspiruar me gjurmët papilare që kanë lënë në vendngjarje. Përdorimi i pajisjeve Live Scanner, ka bërë të mundur kontrollin e identitetit të këtyre personave brenda 30 sekondave në databazën e sistemit AFIS<sup>4</sup> si dhe, dërgimin e gjurmëve papilare të kësaj kategorie personash online në sistem, duke i dhënë akses Policisë së Shtetit që të disponojë brenda 24 orëve prova shkencore të pakundërshtueshme duke vërtetuar përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme kriminale, apo persona të ndryshëm të cilët kërkojnë t'i shmangen policisë nëpërmjet paraqitjes së tyre me identitete të rreme. Aplikimi i sistemit AFIS ka bërë të mundur edhe rritjen e prestigjit të Policisë Shqiptare, në marrëdhëniet me partnerët e saj ndërkombëtarë, si në aspektin bilateral ashtu dhe në atë multilateral, duke demonstruar shpejtësi dhe profesionalizëm në shkëmbimin elektronik të gjurmëve papilare sipas standardeve ndërkombëtare ANSI/NIS<sup>5</sup> të transmetimit të imazheve digjitale të gjurmëve të gishtave, kryesisht përmes Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol Tirana.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

AFIS, NIST, standardi ANSI, gjurmë të gishtave pa bojë, identifikimi biometrik.

## 1. Hyrja

Në këtë punim, fusha e prezantimit, lidhet me aplikimin e sistemit automatik të identifikimit të gjurmëve të gishtave dhe pëllëmbëve AFIS/APIS, që është një sistem e komplikuar në ndihmë të ekspertëve të gjurmëve të gishtave në identifikimin biometrik të personit<sup>6</sup>. Në këtë punim, janë marrë në studim aplikimet e kësaj teknologjie të re, avantazhet e saj, duke pasqyruar hapat e kryera si dhe, rezultatet e arritura të aplikimit të këtij sistemi. Duke studiuar dhe pasqyruar aplikimin e sistemit AFIS, është hedhur dritë mbi zgjidhjen e disa çështjeve gjatë fazave të zhvillimit të kësaj teknologjie. Punimi ka shumë informacion të nxjerrë nga përpunimi i të dhënave 15 vjeçare të punës me këtë sistem, që përfshin periudhën nga viti tetor 2002 deri në gusht të vitit 2017, duke i pasqyruar këto gjetje me anën e grafikëve, të cilët pasqyrojnë hap pas hapi dinamikën e punës me sistemin AFIS. Struktura e këtij punimi është ndërtuar duke dhënë informacion mbi ecurinë e këtij sistemi, paraqitjen e tij në dinamikën e zhvillimit dhe përmirësimit të aplikimit të tij, si dhe, integrimin e pajisjeve të tjera kompjuterike si Live Scanner, që ndihmojnë në një transmetim *on-line* të informacionit biometrik të gjurmëve të gishtave, me qëllim arritjen e identifikimit sa më të shpejtë dhe të saktë të personit.

<sup>1</sup> FFS – Fellow Fingerprint Society, Angli numri I anetaresimit 3100.

<sup>2</sup> AM – Active Member of International Association for Identification, USA numri anetaresimit 20506.

<sup>3</sup> J. Raerty and J.Wegstein, The LX39 latent Fingerprint Matcher. U.S.A. Government Publication. National Bureau of Standards, Institute for Computer Sciences and Technology, 1978, faqe 176.

<sup>4</sup> Komarinski Peter, 2005 Automated Fingerprint Identification Systems (AFIS) Elsevier Academic Press USA faqe 231.

<sup>5</sup> Formati ANSI/NIST-CSL 1-1993 “Për shkëmbimin e informacionit të gjurmëve të gishtave”, sponsorizuar nga Instituti Kombëtar Amerikan i Standardeve dhe Teknologjisë, publikuar nga ky Institut, nëntor 1993.

<sup>6</sup> Henry Lee & R. E. Gaensslen, *Advanced in Fingerprint Technology*, Elsevier, New York 1991, f. 23.

## 1. Një vështrim i shpejtë historik për sistemet AFIS

Zanafilla e parë për të informatizuar gjurmët e gishtave në Shqipëri, daton në vitin 1991 kur u përpunua dhe u eksperimentua sistemi SIG, i cili në bazë të tij kishte nxjerrjen e një formule daktiloskopike si dhe, hedhjen e saj në një kompjuter, me një softuer të thjeshtë, të përpunuar në programin MSDOS. Ky sistem kishte si qëllim nxjerrjen e një formule daktiloskopike, që përbëhej nga dy shkronja (që tregonin llojin e figurës papilare); pasohej nga një numër me dy shifra, që tregonte numrin e vijave papilare nga qendra e gjurmës në deltën e majtë dhe, më pas nga tre çifte karakteresh, të përbërë nga një numër dhe një shkronjë, që tregonin llojin e karakteristikës së veçantë që ndodhej në vijën imagjinare, që bashkonte qendrën e gjurmës me deltën e majtë. Ky sistem nuk pati ndonjë rezultat sepse përpunimi bëhej në mënyrë manuale, gjë që kërkonte kohë dhe njerëz në dispozicion.

Për herë të parë në historinë e Policisë Shqiptare, një sistem i mirëfilltë automatik për identifikimin e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve (Automated Fingerprint Identification System/Automated Palmprint Identification System, AFIS/APIS) u ble me fondet buxhetore në mesin e vitit 2002 dhe, u instalua në sektorin e daktiloskopisë të Institutit të Policisë Shkencore. Në funksion të plotë, ky sistem, filloi në muajin tetor 2002 dhe deri në ditët e sotme, ka punuar pa asnjë problem, duke prodhuar rezultate të jashtëzakonshme në identifikimin e gjurmëve papilare që janë futur në databazën e tij. Sistemi AFIS/APIS Papillon-7<sup>7</sup>, në strukturën e tij të parë, ka pasur një konfigurim: kapaciteti i bazës së të dhënave 150 000 copë kartelash daktiloskopike (gjurmë gishtash dhe pëllëmbësh); kapacitet për 10 000 imazhe për gjurmët papilare të vendit të ngjarjes (prej të cilave 3 000 imazhe gjurmë pëllëmbësh); me 3 poste pune; e 1 server qendror dhe 3 server *match*-era për përpunimin e informacionit; skedarët e punës të përkthyer në gjuhën shqipe.

Më pas, ky sistem është modernizuar dhe zgjeruar ndër vite, edhe falë ndihmës së misionit PAMECA e financave të buxhetit të shtetit dhe, në këtë moment, sistemi AFIS/APIS i policisë shqiptare, ka një kapacitet prej 500 000 kartelash daktiloskopike, që përmbajnë 10 gjurmë gishtash, dy gjurmë pëllëmbësh, dy fotografi dhe të dhënat alfanumerike. Konfigurimi i sistemit është një server qendror, 7 serverë shpejtues, një server backup-i si dhe 5 poste pune. Kapacitetit i bazës së të dhënave, është i tillë, që ruan imazhet e 50 mijë gjurmë gishtash të vendit të ngjarjes dhe 15 mijë gjurmë pëllëmbësh të vendit të ngjarjes. Në botë, fillimi i aplikimit të sistemit AFIS daton në vitin 1977, kur në Policinë Mbretërore të Kanadasë u instalua sistemi i parë AFIS. Më pas, në vitin 1984, është instaluar në Policinë e San Franciskos në Amerikë<sup>8</sup>. Në Angli, për herë të parë, sistemi AFIS është instaluar në vitin 1984. Sistemet AFIS përdorin për identifikimin e gjurmëve papilare imazhet e tyre, duke u përqendruar në karakteristikat e veçanta. Kompjuterët bëjnë miliona kërkime në regjistrimet e bazës së të dhënave dhe, nëse imazhi ka përputhje me ndonjë që ndodhet në bazën e të dhënave, e vendosin atë në listën e kandidatëve që konfirmohet nga ana e ekspertimit të gjurmëve të gishtave<sup>9</sup>.

<sup>7</sup> Manuali përdorimit të sistemit Afis Papillon Miass 2002, f. 3

<sup>8</sup> Sefestein Richard, "Fingerprints" *Criminalistics: An introduction to forensics science*, 10<sup>th</sup> ed., Chapter 14 (Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, 2010): H. C. Lee & R. E. Gaensslen (Eds), *Advances in Fingerprint Technology*, 2<sup>nd</sup> ed. (Boca Raton, FL: CRC Press, 2001) USA.

<sup>9</sup> Federal Bureau of Investigation, *The Science of Fingerprints: Classification and Uses*. U.S. Government Printing Office, Washington, D.C., 1984.

Ndërsa sistemet AFIS janë përpunuar, qëllimi kryesor i tyre është që të përcaktojnë nëse një person ka qenë më parë i daktiloskopuar dhe cila ka qenë historia e tij kriminale. Identifikimi biometrik i bazuar në identifikimin e personit me anën e gjurmëve të gishtave, është më i sakti midis çdo lloji identifikimi tjetër biometrik që përdoret sot. Ky identifikim nuk bazohet në emrin, seksin, ditëlindjen etj., që janë të futura në bazën e të dhënave, por saktësia e tij varet nga qartësia e imazheve papilare që ndodhen në bazën e të dhënave.

## **2. “Sistemi automatik i identifikimit të gjurmëve të duarve” (AFIS/APIS Papillon 7)**

Ky sistem është përpunuar që në vitin 1997 dhe është në proces përpunimi të vazhdueshëm. Qëllim kryesor i këtij sistemi është që të përcaktojë ngjashmërinë në mënyrë automatike të gjurmëve të gishtave. Ai që përcakton identitetin e tyre është gjithmonë njeriu, pra eksperti i gjurmëve të gishtave. Sistemi është në gjendje të krahasojë:

- gjurmët e gishtave të kartelave daktiloskopike me njëra-tjetrën;
- kartelat daktiloskopike me gjurmët e vendit të ngjarjes;
- gjurmët e vendit të ngjarjes me kartelat daktiloskopike që janë në databazë;
- gjurmët e një vendi ngjarje me të tjerat;
- gjurmët e pëllëmbëve të kartelave daktiloskopike me njëra-tjetrën;
- gjurmët e pëllëmbëve të kartelave daktiloskopike me gjurmët e pëllëmbëve të vendit të ngjarjes;
- gjurmët e pëllëmbëve të vendit të ngjarjes me pëllëmbët e kartelave daktiloskopike;
- gjurmët e pëllëmbëve të një vendi ngjarje me të tjerat.

*Me anën e këtyre krahasimeve automatike arrihet:*

- të identifikohen kufomat e paidentifikuara,
- të identifikohen personat që kanë ndryshuar identitetin e tyre,
- për të përcaktuar faktin se një personi i janë marrë gjurmët në kohë të ndryshme,
- të identifikojë personat e ndryshëm që kanë lënë gjurmët e duarve të tyre në një vend ngjarje të caktuar.

Sistemi përcakton shkallën e ngjashmërisë së gjurmëve të duarve, që i krahason në bazë të karakteristikave të tyre të veçanta. Sistemi fillon krahasimin e gjurmëve të duarve që ka në databazë, kur ka 6 karakteristika të veçanta të qarta<sup>10</sup>.

I gjithë informacioni i kartelës daktiloskopike kthehet në një skedar që ka pjesë të veçanta, në të cilat futen:

- të dhënat e personit;
- përfytyrimi i imazhit të gjurmës së gishtave;
- përshkrimi matematik i gjurmës së gishtave;
- imazhi i pëllëmbëve;
- përshkrimi matematik i gjurmës së pëllëmbëve;
- fotografitë sinjalitike të kartelës së personit të daktiloskopuar;
- shenjat e veçanta të personit;
- portreti i përshkruar i personit.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

<sup>10</sup> Manuali përdorimit të sistemit Afis Papillon Miass 2002, f. 7.

Sistemi ka një algoritëm të veçantë krahasimi. Nëse ngjashmëria është 75% atëherë sistemi krijon listën e kandidatëve ndërsa identifikimin e realizon eksperti i gjurmëve të duarve. Poshtë kësaj shifre të ngjashmërisë, sistemi nuk e merr në konsideratë. Sistemi rendit në listën e kandidatëve sipas ngjashmërisë, sa më e lartë të jetë shkalla e ngjashmërisë aq më afër është me kreun e listës dhe e kundërta. Gjatësia e listës së kandidatëve është deri në 20<sup>11</sup>. Sistemi për përshkrimin e gjurmëve të gishtave përdor:

- shenjat e përgjithshme, tipi i figurës, qendra, delta dhe sistemi koordinativ;
- karakteristikat e veçanta. Ai përdor dy karakteristika të veçanta fillimet e vijave papilare dhe degëzimin e tyre;
- për të realizuar futjen e të dhënave të karteleve në databazë kalohet në disa procese;
- formohet kërkesa dhe hidhen të dhënat e kartelës;
- kryhet skanimi i kartelës për 10 gishtat, gjurmët e kontrollit, fotografitë dhe gjurmët e pëllëmbëve;
- kalohet në përpunimin automatik;
- kalohet në kontrollin e rezultateve të kodimit;
- përpunimi i dytë automatik;
- kryerja e skeletimit;
- futja e kopjes elektronike në databazë;
- kërkimi në databazë në bazë të karakteristikave të veçanta.

Mbas kërkimit në databazë, sistemi rendit ngjashmëritë sipas listave përkatëse. Këto lista janë të shumta, por më të rëndësishmet janë, lista e kërkimit të gjurmëve të vendit të ngjarjes me ato të kartelave, lista e gjurmëve të vendit të ngjarjes me njëra-tjetrën, lista e krahasimit të gjurmëve të kartelave daktiloskopike me njëra-tjetrën etj.<sup>12</sup>

Sistemi bën krahasime automatike, si për gjurmët e kartelave ashtu dhe për gjurmët e vendit të ngjarjes, gjë që do të thotë se çdo kartelë daktiloskopike e re që futet në databazë krahasohet në mënyrë automatike me të gjithë kartelat e tjera që janë në databazë dhe sistemi i afishon kërkimet e tij në tre lista, që janë :

- lista e kartelave që kanë gjurmët e gishtave identike, por gjeneralitetet e ndryshme;
- lista e kartelave që kanë gjurmët e gishtave dhe gjeneralitete identike;
- lista e kartelave që kanë gjeneralitetet identike, por gjurmët e gishtave të ndryshme.

Për krahasimet e gjurmëve të gishtave të gjendura në vendin e ngjarjes, sistemi bën krahasime automatike dhe përpilon dy lista:

- Listën e ngjarjeve për gjurmët e gishtave të pazbuluara që janë të ngjashme;
- Listën e ngjashmërisë së gjurmëve të gishtave të vendit të ngjarjes me ato të gishtave

të kartelave daktiloskopike që janë në databazë. Në historinë e kriminalistikës shqiptare, për herë të parë, viti 2002 dhe pikërisht muaji tetor, shënon fillimin e punës për herë të parë në historinë e Policisë së Shtetit Shqiptar, të krahasimeve automatike të gjurmëve të duarve. Rezultati pozitiv me këtë sistem, është arritur në 18 mars 2003 ku më anën e tij u krye dhe identifikimi i parë automatik i dy gjurmëve të gishtave, në një rast vrasje ndodhur në qytetit e Durrësit në muajin maj 1998<sup>13</sup>.


<sup>11</sup> Best Practice Manual for Fingerprint Examination ENFSI-BPM-FIN-01 versioni 01 – November 2015, f. 17,59.

<sup>12</sup> Manuali përdorimit të sistemit Afis Papillon Miass 2002, f. 7.

<sup>13</sup> Lista positive e sistemit Afis/Apis Papillon numri 1

## 2.1 Përshkrimi i punës me sistemin AFIS/APIS Papillon-7

Në sistemin informatik AFIS/APIS Papillon-7, disa parime të pranuar në daktiloskopi, plotësohen, saktësohen dhe në një farë shkalle ndryshohen me qëllim të një përshkrimi matematik të vijave papilare më të unifikuara, më të përgjithësuara e të thjeshtëzuara, që kryhen me ndihmën e softuerit kompjuterik.



Pamja e dritares kryesore të menysë të sistemit AFIS/APIS Papillon, në gjuhën shqipe.

## 2.2 Proceset e punës në sistemin AFIS/APIS Papillon-7<sup>14</sup>

### 2.2.1. Futja e të dhënave tekst të kartelave


Vendosja e kartelave daktiloskopike në databazë, fillon me futjen e të dhënave tekst që përmbajnë ato. Pas kësaj, të dhënat e futura ruhen në sistem në formën e kërkesës për skanim. Dritarja për futjen e të dhënave tekst: për të kryer këtë, operatori plotëson fushën apo formularin që shfaqet në ekran:

Dritarja e hedhjes të së dhënave tekst të kartelës daktiloskopike.

<sup>14</sup> Manuali përdorimit të sistemit Afis Papillon Miass 2002, f. 10.

### 2.2.2 Skanimi i kartelave daktiloskopike

Ky është procesi i skanimit të pamjeve të kartelës, së ndihmën e skanerit të sheshtë dhe të skedarëve *tiff* dhe pamjeve fotografike me ndihmën e skanerit dhe të skedarëve *tiff*. Mbas futjes së të dhënave tekst, operatori mund të skanojë pamjet daktiloskopike dhe fotografike që ndodhen në kartelë.



Dritarja e skanimit të kartelave daktiloskopike.

### 2.2.3. Kodimi i kartelave


Mbasi kartela është skanuar, ajo kalon në përpunimin automatik, të ashtuquajturin përpunimin e parë, si rezultat i të cilit, sistemi përcakton llojin e pamjes daktiloskopike dhe përcakton karakteristikat e përgjithshme që mund të ndodhen.

### 2.2.4. Futja e të dhënave tekst të gjurmëve

Futja e gishtit ose pëllëmbëve në databazën e sistemit AFIS-it fillon me futjen e të dhënave tekst që përmban kartela. Pas futjes të këtyre të dhënave tekst, ato ruhen në sistem në formën e kërkesës për skanim të gjurmëve. Kjo kërkesë pastaj përdoret për skanimin e një gjurme ose një seri gjurmësh më të njëjtat të dhëna teksti.

### 2.2.5 Numri i kartelës, zgjedhja e seksit, regjistrimi i kërkesës

Mbas regjistrimit të kërkesës për shqyrtim, të gjithë fushat në ekran pastrohen dhe operatori mund të fillojë futjen e të dhënave tekst të kartelës pasardhëse.



Dritarja e futjes së të dhënave tekst të gjurmëve të vendit të ngjarjes





### 2.2.8. Vrojtimi i bazës së të dhënave


Programi i vrojtimit të kësaj baze lejon të punohet me listat e rekomandimit, të cilat formohen si rezultat i kërkimeve si dhe me listat e gjurmëve dhe kartelave që ruhen në databazë. Çfarë mund të vrojtohet në bazën e të dhënave?

Ajo përbëhet nga disa pjesë :

- lista e përgjithshme i kartelave daktiloskopike,
- lista e gjurmëve të gishtave,
- lista e gjurmëve të pëllëmbëve,
- lista e rekomandimeve,
- lista e identifikimit.

Programi i vrojtimit lejon të nxirren në ekran listat e masive të përmendur më lartë dhe të vrojtohen elementet e këtyre listave. Në këtë mënyrë vrojtimit i nënshtrohen listat: kartelat/ gjurmët e gishtave/ gjurmët e pëllëmbëve/ listat e përgjithshme rekomanduese/ listat e identifikimit. Listat e përgjithshme të rekomandimit janë listat e përgjithshme <gjurmë-kartela>; <gjurmë-gjurmë>; <kartela-gjurmë>; < kartelë-kartelë>. Për pëllëmbët krijohen lista të veçanta <gjurmë-kartelë>; <gjurmë-gjurmë>; < kartelë-gjurmë>.

Për kartelat janë gjithashtu listat <lista e dublikatave> dhe <lista e pasaportës që përputhen>.



Dritare e vrojtimit të gjurmës të vendit të ngjarjes me listën e kandidatëve që softueri ka selektuar nga baza e të dhënave.

AKADEMIA  
E SIGURISË


### 3. Disa statistika në lidhje me sistemin AFIS/APIS të Policisë Shqiptare<sup>17</sup>

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Sot në databazën e sistemit ndodhen 323 877 copë kartela daktiloskopike të personave të ndryshëm, prej të cilave, 195 756 copë janë të marra me bojë tipografike, në kartelat standard, ndërsa pjesa tjetër, prej 128 121 copë, janë të marra në rrugë

<sup>17</sup> Të dhëna të nxjerra nga përpunimi i të dhënave të databazës të sistemi Afis Papillon7.


**Numri i pergjithshem i kartelave ne databazen e sistemit AFIS (totali: 323.877)**



elektronike me anën e *Live Scanner*-ëve. Nga këto kartela 11 654 copë, i përkasin punonjësve të policisë, që kanë një numër rendor nga 00001 deri 11 654.

Nga ky numër i përgjithshëm i kartelave daktiloskopike, sistemi AFIS ka lidhur 64 567 kartela që i përkasin personave që kanë gjurmë gishtash dhe identitete të njëjta, ndërsa ka bashkuar 41 879 kartela, që kanë gjurmët e gishtave identike, por të dhëna të ndryshme, gjë që do të thotë se personat gjatë marrjes së gjurmëve të duarve në polici, kanë dhënë identitete të ndryshme.

Gjatë periudhës 15 vjeçare baza e të dhënave të sistemit AFIS është zmadhuar, duke futur në të, të gjitha kartelat daktiloskopike që ndodheshin në kartotekën daktiloskopike të sektorit të daktiloskopisë si dhe të gjitha kartela daktiloskopike që kanë ardhur në rrugë zyrtare ose elektronike nga pajisjet *Live Scanner*<sup>18</sup>. Më poshtë, jepet tabela përmbledhëse e numrit të kartelave daktiloskopike që janë futur vit pas vitit në bazën e të dhënave të sistemit AFIS.



Po të vihet re, gjatë vitit 2003 është numri më i lartë i kartelave daktiloskopike të futura në sistem, sepse në këtë kohë në sektorin e daktiloskopisë, punonin 6 operatorë me nga dy turne, 5 ditë në javë dhe numri i tyre këtë vit, kapi shifrën 71 538 copë. Pas këtij viti numri i kartelave të futura në bazën e të dhënave, ka pasur një trend të lehtë në rritje, duke qenë se në sistemin AFIS, në këtë periudhë punonin vetëm 2 operatorë dhe, deri në vitin 2007, ka pasur një fluks futjeje me mbi 30 mijë kartela në vit, sepse deri në këtë vit, në sistemin AFIS, futeshin edhe gjurmët e gishtave të personave që shoqëroheshin nga Policia e Shtetit.

Pas këtij viti, hyri në fuqi ligji i ri i Policisë Shtetit, i cili nuk lejonte më marrjen e gjurmëve të gishtave të personave të shoqëruar dhe, si rrjedhim, gjatë vitit 2008 dhe më shumë gjatë vitit 2009, numri i kartelave daktiloskopike të futura në sistem, ka pasur një

**AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë shkencore ndërkombëtare:*


« Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë »

<sup>18</sup> Të dhëna të nxjerra nga databaza e sistemit Afis Papillon 7.


trend në rritje, por tani shumë të ulët, sepse kartelat daktiloskopike, tani i merren vetëm personave të ndaluar/arrestuar.

Gjatë kësaj periudhe, në sistemin AFIS, nga 6 ekspertët e gjurmëve të gishtave, janë futur për krahasim dhe gjurmët e gishtave dhe pëllëmbëve të zbuluara në vendngjarje të ndryshme kriminale, që nuk janë zbuluar. Këto gjurmë papilare, pasi janë proceduar, janë krahasuar me të gjithë gjurmët papilare të kartelave daktiloskopike, ashtu si dhe me gjurmët e gishtave dhe të pëllëmbëve të ngjarjeve, me njëra-tjetrën. Në dy grafikët<sup>19</sup> e mëposhtëm, tregohet ecuria e futjes së këtyre gjurmëve papilare, të ngjarjeve të pazbuluara, në sistemin AFIS.

### Gjurmë gishtash nga vendngjarjet futur në sistem



### Gjurmë pëllëmbësh nga vendngjarjet futur në sistem



Siç shikohet, numri i gjurmëve papilare të ngjarjeve kriminale, vit pas viti, ka pësuar rritje, gjë që tregon si për punën e lavdërueshme të stafit të sektorit të daktiloskopisë ashtu dhe për rezultatet e larta të eksperteve kriminalistë, që kanë kryer këqyrjet e vendngjarjeve të ndryshme kriminale, në mbarë Shqipërinë, duke fiksuar shumë gjurmë papilare të vlefshme për identifikim.


Në databazën e sistemit AFIS, sot ndodhen imazhet e 23 451 gjurmëve të gishtave të gjetura në vendngjarje të ndryshme, po kështu, ndodhen imazhet e 10 820 gjurmëve të pëllëmbëve të fiksuara në vende ngjarje të ndryshme. Sistemi AFIS, ka të ndërtuar softuerin e tij, që të bëjë krahasime edhe midis gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve që janë fiksuara në vendngjarje, me njëra-tjetrën. Për këtë qëllim, në të, është edhe lista

<sup>19</sup> Të dhëna të nxjerra nga databaza e sistemit Afis Papillon 7.

<sup>20</sup> Të dhëna të nxjerra nga lista pozitive e databazës të sistemi Afis Papillon7.

e ngjarjeve ku gjurmët papilare të zbuluara në to, janë lidhur me njëra-tjetrën, gjë që do të thotë, se këto gjurmë, janë formuar nga i njëjti person, por ky person nuk ka gjurmët e duarve në databazë. Pra, sistemi ndihmon që të përcaktojmë se një person është përfshirë në dy ose më shumë ngjarje. Nga statistikat e këtij lloji, ndodhen në sistemin AFIS bashkimet e 164 rasteve, me gjurmë gishtash, që i përkasin gjurmëve brenda një ngjarje, si dhe ngjarjeve të ndryshme ku ato janë formuar nga i njëjti person. Për gjurmët e pëllëmbëve, ky numër bashkimesh është 135 raste. Me anën e sistemit, deri më sot janë identifikuar gjithsej 10 037 gjurmë gishtash si dhe 3 018 gjurmë pëllëmbësh.


Në procesin e kërkimit të gjurmëve të gishtave dhe pëllëmbëve të zbuluara në vendngjarje, rezultatet kanë qenë shumë të larta, duke pasur vit pas viti një trend rritjeje, siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm<sup>20</sup>.



Në këtë grafik janë paraqitur 3 tregues domethënës: “numri i identifikimeve”, që paraqitet me ngjyrë blu; “numri i ngjarjeve të vjetra të zbuluara”, që paraqiten me ngjyrë vishnje, si dhe numri i ngjarjeve “vjedhje me thyerje” (banesa, dyqane, lokale, makina etj). Më poshtë janë ilustruar dy identifikime, i pari, një gjurmë gishtit dhe tjetra një gjurmë e pjeshme pëllëmbë dore, të cilat janë dhe identifikimet e para për herë të parë në Shqipëri, me sistemin AFIS.




Imazhe të gjurmës të gishtit të identifikuar për herë të parë me sistemin AFIS Papillon-7 në datën 18. 3. 2003, ku gjurma në të majtë është fiksuar në një vendngjarje vrasjeje, në datën 4. 5. 1998, në Durrës; ndërsa gjurma në anën e djathtë, gjurma e gishtit të mesit të dorës së majtë të shtetasit.




**Identifikimi i parë me gjurmë pëllëmbë në Shqipëri me Sistemin AFIS/APIS një rast vjedhje banese në Fushë Krujë<sup>21</sup>.**

Aplikimi i sistemit AFIS, ka bërë të mundur edhe rritjen e prestigjit të policisë shqiptare në marrëdhëniet me partnerët e saj, si në aspektin bilateral ashtu edhe në atë multilateral, duke demonstruar shpejtësi dhe profesionalizëm në shkëmbimin elektronik të gjurmëve papilare, sipas standardeve ndërkombëtare ANSI/NIST, të transmetimit të imazheve digjitale të gjurmëve të gishtave, kryesisht përmes Zyrës Qendrore Interpol Tirana. Nga ekzaminimet e kryera në bazën e të dhënave, me kartelat daktiloskopike që ka dërguar Zyra Qendrore Interpol Tiranë, është bërë e mundur që brenda një kohe të shkurtër, të jenë bërë verifikimet e gjurmëve të gishtave të personave, që kanë pasur probleme me policinë e vendeve anëtare të Interpolit.

Kështu, rezultatet e arritura me ndihmën e sistemit AFIS, kanë bërë të mundur identifikimin e shtetasve shqiptarë për të cilët vendet anëtare të Interpolit, kanë kërkuar bashkëpunimin me policinë shqiptare. Grafiku i mëposhtëm, tregon rezultatet e identifikimit të personave vit pas viti, për llogari të Interpolit, të cilat tregohen me ngjyrë blu, si dhe numrin e rasteve, kur shtetasit shqiptarë kanë ndërruar identitetin e tyre, që paraqitet me ngjyrë vishnje.



<sup>21</sup> Imazh nga lista pozitive e identifikimeve të pëllëmbëve të sistemi AFIS papillon7 numri 1.



## 5. Disa problematika të evidentuara

Volumi i madh i punë së kryer, në hedhjen e informacionit në sistemin AFIS, ka evidentuar edhe probleme të cilat janë adresuar, por që nuk kanë gjetur zgjidhje efektive ose kanë ngelur pezull nga mosbashkëveprimi i strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit, që duhet të ndjekin këtë proces.

i - Raste e identifikimit të gjurmëve papilare të vendngjarjeve të ndryshme nga ana e sektorit të daktiloskopisë, bëhen prezent zyrtarisht me informacion pranë drejtorisë vendore të policisë ku ka ndodhur ngjarja, si dhe në drejtoritë qendrore të linjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Shtetit. Po kështu, njoftohet edhe shefi i laboratorit rajonal të Policisë Shkencore të drejtorisë vendore të policisë përkatëse, me qëllim që oficerët e policisë gjyqësore që kanë në ndjekje këto ngjarje, të marrin këtë informacion dhe të kryejnë veprimet e mëtejshme hetimore, siç është përgatitja dhe dërgimi i vendimit për ekspertimin daktiloskopik për ngjarjen e identifikuar. Në shumicën e raste, kjo gjë ndodh, por është konstatuar edhe një shqetësim nga ana jonë se, dërgimi i këtyre vendimeve bëhet me vonesë dhe, më e keqja është se mjaft prej tyre, nuk janë dërguar ende, duke lënë të pandëshkuar autorët e ngjarjeve kriminale.

ii - Mirëmbajtja e sistemit është një çështje tjetër që duhet trajtuar. Viti pas viti, pajisjet përbërëse të sistemit fillojnë të konsumohen, si moralisht ashtu dhe fizikisht, dhe për këtë qëllim, duhen zëvendësuar me pajisje më të reja dhe më të sofistikuara, me qëllim ruajtjen e arritjes së rezultateve të pritshme. Nëse një mirëmbajtje e tillë nuk ndodh, atëherë pajisjet do të pësojnë defekte dhe do të duhet më shumë kohë për tu riparuar.

Gjatë kësaj periudhe kohe 15 vjeçare pune të sistemit, ka ardhur momenti që të bëhet edhe rinovimi i pajisjeve harduerë si, serverët shpejtues, kompjuterë, ekrane, UPS, etj., të cilat, për të qenë realist, në sistemin tonë AFIS janë veterane, pra kanë një periudhe 15 vjeçare pune dhe urgjentisht duhen zëvendësuar me harduerë të rinj, bashkëkohorë, duke kaluar në ndryshimin e versionit të softit, në një më të përparuar.

**AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë shkencore ndërkombëtare:*

« Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë »

iii - Trajnimi i stafit me sistemin AFIS duhet të jetë me rigoroz, sepse disa specialistë të rinj nuk i janë nënshtruar një trajnimit të mirëfilltë për të punuar me sistemin. Përdoruesit e sistemit duhet ta njohin sa më mirë se si funksionon ai, kur trajnohen dhe certifikohen nga specialistë përkatës, të kompanive që i kanë prodhuar ato. Kjo gjë duhet të zgjidhet me rastin e përmirësimit të sistemit AFIS, që do të kryhet gjatë fillimit të vitit 2018.

iv - Një problem që lidhet me trajnimin është dhe marrja e gjurmëve të gishtave personave që janë të deportuar, “inad” apo të shtetasve të huaj që kanë probleme në territor. Kjo kategori personash, në bazë të urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, duhet të daktiloskopohen nga ana e punonjësve të policisë së kufirit dhe emigracionit, të cilët për shkak të ndryshimit të vendeve të punës, nuk janë të trajnuar posaçërisht dhe si rrjedhim, cilësia e marrjes së gjurmëve të gishtave nga ana e tyre, lë shumë për të dëshiruar dhe si rrjedhim, sjell edhe problematika në procesin e kërkimit dhe identifikimit në databazën e sistemit AFIS.

#### 4. Sistemi i pajisjeve “Live Scanner”

Qëllimi i realizimit të këtij projekti ishte:

i. Vënia në efikasitet plotë e Sistemit Automatik të Identifikimit të gjurmëve të gishtave AFIS/APIS.

ii. Krijimi i rrjetit sekondar në laboratorët rajonalë të policisë shkencore, për transmetimin *on-line* të gjurmëve të duarve, në mënyrë elektronike, direkt në bankën e të dhënave të sistemit AFIS/APIS.

iii. Rritja e shpejtësisë në kthimin e përgjigjeve në lidhje me kërkesat që do të bëjë policia kriminale, policia gjyqësore për identifikimin e personave me gjurmë papilare si dhe të Interpol Tiranës, për shtetasit shqiptarë që arrestohen, depërtohen etj.

iv. Operimi në mënyrë të pavarur nga specialistët e sektorit të daktiloskopisë të Institutit të Policisë Shkencore, që në momentin e daktiloskopimit të personave që ndalohen, arrestohen në ambientet e drejtorive e komisariateve të policisë, me qëllim identifikimin e shpejtë të tyre me anë të gjurmëve të duarve, në bazë të gjurmëve të duarve që janë administruara si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara, që mund të kenë kryer në të kaluarën.

v. Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së marrjes së gjurmëve të duarve dhe të fotografive sinjalistike, të personave që fotodaktiloskopohen duke përdorur teknikat moderne të marrjes së shenjave papilare, pa përdorimin e bojës dhe fotografimin me kamera digjitale në moment.


vi. Ulja në minimum e kostos dhe kohës, në lidhje me materialet e konsumit që përdoren për fotografimin, larjen e stampimin e filmave dhe marrjen e shenjave të duarve.

vii. Identifikimin e menjëhershëm së të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe që tentojnë të kalojnë në pikat e kalim-kontrollit, me gjeneralitete të ndryshuara në pasaportat e tyre, në rast se ata kanë qenë më parë të daktiloskopuar.

Planifikimi i këtij objekti, lidhet me mundësinë e bindjes të personave vendimmarrës për sigurimin e fondeve të nevojshme, për blerjen e këtyre pajisjeve. Nga ana e Institutit të Policisë Shkencore, gjatë viteve 2004-2006, u realizua blerja e 8 copë pajisjeve Live Scanner, të cilat u instaluan në pikën e kalimit kufitar aeroporti Rinas, porti i Durrësit,



Kakavijë, Kapshticë, laboratorët rajonalë të policisë shkencore në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Gjatë vitit 2008, me ndihmën e PAMEKA-s, u realizua blerja dhe instalimi i 7 copëve të tjerë, Live Scanner. Po kështu, gjatë vitit 2015 nga fondet IPA-2013, u instaluar 25 copë të tjera, pajisje Live Scanner. Gjatë vitit 2015, gjithashtu nëpërmjet një donacioni të ICITAP u instaluar edhe 15 copë të tjerë pajisje Live Scanner, duke arritur gjithsej 55 copë pajisje të tilla, të lidhura on-line me sistemin AFIS.



Skema e instalimit të Live Scanner-ëve në drejtoritë vendore të kufirit dhe emigracionit dhe pikat e kalimit kufitar



Skema e instalimit të Live Scanner në drejtori vendore dhe komisariatet e policisë.<sup>22</sup>

<sup>22</sup> Të dhëna të nxjerra nga vendndodhja e instalimit të pajisjeve Live Scannerë në vende.

## 5. Përfundime

i. Përdorimi me sukses i informatizimit të gjurmëve papilare në policinë shqiptare, ka ndikuar në rritjen e reputacionit të Policisë së Shtetit, në misionin e saj për të siguruar një mjedis të sigurt për qytetarët.

ii. Aplikimi i sistemit AFIS në policinë shqiptare, ka dhënë një impakt shumë të madh në drejtim të zbulimit dhe arrestimin e autorëve të veprave të ndryshme kriminale.

iii. Përdorimi i teknologjisë informatike, ka rritur në shkallë shumë të lartë shpejtësinë e marrjes së rezultatit.

iv. Bashkëpunimi i policisë shqiptare nëpërmjet Zyrës Qendrore Interpol dhe Europol Tirana, me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit, për identifikimin biometrik me anën e gjurmëve të gishtave, të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar, ka njohur nivele shumë të larta reciprociteti, falë ndihmës të sistemit AFIS.

v. Është rritur mundësia e identifikimit nga përdorimi i pajisjeve Live Scanner, së të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe që tentojnë të kalojnë në pikat e kalim kontrollit me gjeneralitete të ndryshuara në pasaportat e tyre, në rast se ata kanë qenë më parë të daktiloskopuar.

vi. Krahasimi automatik në sistemin AFIS/APIS të gjurmëve të duarve, të personave të ndaluar/arrestuar, dërguar *on-line* me *Live Scanner*, me qëllim për identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve, që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.

## 6. Rekomandime

i. Përpunimi i procedurave standarde në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore përkatëse, për të kthyer në provë çdo identifikim që kryhet nëpërmjet sistemit AFIS.

ii. Rinovimi i pajisjeve harduerë të vjetruara të sistemit AFIS dhe kalimi në versionin e ri, është çështje emergjente dhe premisë për përmirësimin e rezultateve të arritura.

iii. Trajnimi dhe certifikimi i personelit të patrajnuar rigorozisht, që punojnë në sektorin e daktiloskopisë të Institutit të Policisë Shkencore, mbetet për tu zgjidhur.

iv. Bashkëpunimi me departamentin e Kufirit dhe Emigracionit, për të realizuar një trajnim sa më të mirë të personelit të pikave të kalimit kufitar që përdorim pajisjet Live Scanner, për marrjen me cilësi sa më të lartë të gjurmëve të gishtave, të personave të deportuar, “inad” dhe shtetasve të huaj që kanë probleme në territor.

v. Adresimi për një zgjidhje procedurale dhe juridike, të mundësisë të shfrytëzimit për krahasim të gjurmëve të gishtave që fiksohen në vendngjarjet kriminale, me databazën e enkriptuar të gjurmëve të gishtave të shtetasve shqiptarë, që administrohen në sistemit AFIS MetaMorpho të kompanisë Aleat, që merret me prodhimin e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike.

## Referencat

1. Sefestein Richard, "Fingerprints" *Criminalistics: An introduction to forensics science*, 10<sup>th</sup> ed., Chapter 14 (Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, 2010); H.C.Lee & R. E. Gaensslen (Eds), *Advances in Fingerprint Technology*, 2<sup>nd</sup> ed.(Boca Raton, FL: CRC Press,2001) USA.
2. Federal Bureau of Investigation, *The Science of Fingerprints: Classification and Uses*. U.S. Government Printing Office, Washington, D.C., 1984.
3. J. Raerty and J. Wegstein, *The LX39 Latent Fingerprint Matcher*. U.S.A. Government Publication. National Bureau of Standards, Institute for Computer Sciences and Technology, 1978.
4. Henry Lee & R. E. Gaensslen, *Advanced in Fingerprint Technology*, Elsevier, New York 1991 USA.
5. Komarinski Peter, *Automated Fingerprint Identification Systems (AFIS)*, Elsevier Academic Press USA, 2005.
6. Manuali Perdorimit të Sistemit AFIS/APIS Papillon-7 2002 Miass Rusi.
7. Formati ANSI/NIST-CSL 1-1993 "Për shkëmbimin e informacionit të gjurmëve të gishtave", sponsorizuar nga Instituti Kombëtar Amerikan i Standardeve dhe Teknologjisë, publikuar nga ky Institut, nëntor 1993.
8. *Best Practice Manual for Fingerprint Examination* ENFSI-BPM-FIN-01 versioni 01 November 2015.

# Aspekte të dokumentimit ligjor, të dhunës me bazë gjinore

— MSc Eda GJOKA<sup>1</sup>

Akademia e Sigurisë

eda.gjoka@asp.gov.al

## Abstrakt

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon barazinë ndërmjet burrave dhe grave, por rezulton se gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre, si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës. Dhuna ndaj gruas është një problem kompleks, që përfshin më shumë se sa një akt në vetvete, në marrëdhëniet personale mes burrit dhe gruas. Është një problem social me përmasa të gjera, që i ka rrënjët në qëndrimet historike ndaj gruas dhe marrëdhënieve martesore. Viktimizimi i grave nga bashkëshortët e tyre përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti dhe tradita, ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm i njerëzve mbi dhunën në familje. Dhuna ndaj grave evidentohet në shumë forma, që nga mjediset shtëpiake në ambientet e punës, që nga joshjet dhe ngacmimet seksuale, deri tek përdhunimi, që nga presionet psikologjike deri tek dhuna fizike dhe vrasjet. Ky artikull do të fokusohet në identifikimin e nivelit aktual të dhunës ndaj grave në Shqipëri, si dhe në nxjerrjen në pah të legjislacionit shqiptar dhe mekanizmat mbrojtës ndaj dhunës me bazë gjinore. Bazuar në këtë analizë mund të konkludojmë se Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Me gjithë kuadrin ligjor dhe arritjet pozitive, ende ka nevojë për përmirësimin e situatës aktuale.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

## Fjalëkyçe:

**dhuna, dhuna ndaj grave, kuadri ligjor, mekanizmat mbrojtës.**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>1</sup> Përgjegjëse e Grupit mësitor kërkimor i formimit juridik, Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Juridik, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit

## 1. Hyrje

Dhuna në familje haset në shumë shoqëri njerëzore, pavarësisht nga niveli i zhvillimit ekonomik e social të tyre. Ajo është një fenomen botëror dhe prek të gjitha shtresat e popullsisë, të rinj dhe të moshuar, të arsimuar apo analfabetë, të martuar apo beqarë, prek çdo kombësi, klasë, racë apo grup etnik. Ajo përfshin dhunimin e të drejtave qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale të njeriut. Të dhënat në mbarë botën lidhur me shkallën e dhunës në familje konfirmojnë faktin se dhuna në familje është një problem ndërkombëtar shqetësues. Dhuna ndaj gruas përbën një dhunim të të drejtave njerëzore dhe përbën një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes në shoqëri. Në ditët e sotme dhuna është mes nesh, brenda në familje. Njerëzit që përjetojnë dhunën, si viktimat ose dëshmitarë, mësojnë (ndërmjet të tjerave) të kenë frikë, ta evitojnë dhunën ose të bëhen njëloj të dhunshëm si dhunuesi.

## 2. Çfarë është dhuna në familje

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë. Dhuna në familje është një nga format e krimeve më pak të raportuara dhe zakonisht konsiderohet si një çështje private, si rrjedhojë nuk dihen me saktësi përmasat dhe frekuenca e fenomenit. Megjithatë studimet e kryera tregojnë se dhuna në familje, sidomos ajo ndaj grave dhe vajzave, është rritur gjatë periudhës së tranzicionit. Vështirësia e grumbullimit të informacionit mbi dhunën në familje vjen dhe si pasojë e gjendjes ekonomike të viktimave, të cilat në shumë prej

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

rasteve janë të varfra (sidomos në vendin tonë) dhe janë individët të cilët kanë aksesin më të kufizuar ndaj informacionit për të drejtat e tyre, shërbimeve sociale, ndihmës juridike.<sup>2</sup> Në Konferencën e Katërt Botërore të Pekinit e mbajtur në shtator 1995, dhuna në familje u përkufizua si “një problem mbarëbotëror dhe që duhet trajtuar si i tillë.” Po në këtë konferencë është theksuar se ‘*dhuna ndaj gruas përbën dhunim të të drejtave njerëzore, si dhe një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes*’. Në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas është dhënë një përkufizim tjetër për dhunën në familje si “*një mekanizëm kryesor nga i cili gratë janë detyruar të qëndrojnë në një pozicion inferior, krahasuar me burrat*”.

Në Deklaratën “*Kundër Dhunës ndaj Gruas*”, bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, është dhënë përkufizimi i parë zyrtar, në të cilin thuhet se “*dhunë ndaj gruas në familje do të konsiderohet çdo akt i bazuar në përkatësinë gjinore që rezulton në, ose mund të rezultojë në: lëndime fizike, seksuale apo psikologjike, ose që shkakton vuajtje tek gratë, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private*”.

### 2.1 Format e dhunës në familje

Ekzistojnë disa forma të dhunës, ku më poshtë janë renditur ato më të përhapurat. Nuk duhet harruar që shpesh këto forma të ndryshme të dhunës në familje i gjejmë të gërshetuara me njëra-tjetrën.

a. Dhuna fizike, e cila përfshin: shtyrje, goditje, gërvishtje, mbylljen në shtëpi, goditje me objekte të forta, kërcënim me thikë ose me armë tjetër, refuzim për ta ndihmuar gruan kur është shtatzënë ose e sëmurë, tentativë për vrasje deri në formën më të rëndë, vrasjen. Forma të dhunës fizike janë edhe përpjekjet për të kontrolluar e monitoruar lëvizjet e gruas. Gratë që dyshohet se nuk janë “të rregullta” dhe “korrekte” në marrëdhëniet bashkëshortore shpesh bëhen viktima të formave ekstreme të dhunës fizike. Ato jo vetëm janë rrahur, lidhur me litar, por ju janë shuar cigare në trup, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, 48/104, 1993, Raport i OKB mbi Dhunën ndaj Grave, 1993. Janë tërhequr zvarrë, ju janë thyer eshtrat ose janë lënë natën jashtë derës së shtëpisë të vetme dhe të dhunuara. Dhuna fizike në përgjithësi ushtrohet duke filluar nga format më të lehta për të arritur deri tek ato më ekstremet. Dhunuesit janë tepër testues dhe të kujdesshëm me rritjen e nivelit të dhunës. Përgjithësisht kjo formë e dhunës takohet pas vitit të parë të martesës, gjatë shtatzënisë, për t’u përshkallëzuar pas lindjes së fëmijës së parë e për të vazhduar gjatë gjithë jetës bashkëshortore nëse gruaja nuk e kundërshton atë ose nuk gjen një mënyrë për të shpëtuar prej saj. Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm grash, viktima të dhunës në familje, e kanë përjetuar atë që në familjen e origjinës. Viktimat tregojnë se edhe nënat e tyre janë abuzuar njësoj nga bashkëshortët dhe kurrë nuk e kanë kundërshtuar atë. Çfarë është edhe më e dhimbshme, ndonëse këto nëna janë lutur për një jetë më të mirë të vajzave të tyre, prapëseprapë ju kanë dhënë atyre mesazhin se “burrat duhen duruar”.

b. Dhuna psikologjike/emocionale përfshin: talljet, kërcënimet, ndjekjen nga pas, mohimin e hapësirës për të marrë vendime, ndalimin për të dalë me shoqërinë apo dhe për të dalë vetëm, kritikën e vazhdueshme ndaj kulturës apo zakoneve, sharjet ndaj viktimës në shtëpi dhe në publik, ngarkimin me faj të viktimës për çdo gjë që shkon keq,

<sup>2</sup> Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2006. ‘Dhuna në Familje, Paraqitje e situatës aktuale në Shqipëri’.

kontrollin ndaj veshjes dhe gardërobës, etj.

c. Dhuna shpirtërore gjithashtu përfshihet në dhunën psikologjike dhe konsiston në ndalimin e shprehjes së besimit fetar ose normave kulturore, traditave dhe besimit shpirtëror.

d. Dhuna seksuale përfshin: marrëdhënie seksuale me force, trajtimin e partneres si objekt seksual, detyrimin për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e partneres, detyrimin për të realizuar marrëdhënie seksuale në forma të padëshiruara dhe të papranueshme për partneren, këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka që dëshiron partneri, detyrimin për të bërë marrëdhënie seksuale me një partner tjetër në sy ose jo të vetë bashkëshortit/partnerit, realizimi i marrëdhënieve seksuale me një partnere tjetër në sy të bashkëshortes, deklarimi për një lidhje jashtëmartesore detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike, detyrimi për të bërë prostitucion, detyrimi për të bërë striptizë, etj. Mbështetur nga të dhënat e qendrave të këshillimit kjo është forma e tretë e dhunës që deklarohet nga gratë viktimat. Në këtë rast duhet nënvizuar fakti se ndonëse një dhunë e pastër seksuale mund të jetë e treta për sa i përket frekuencës së saj, ajo është gjithnjë e implikuar dhe e gërshetuar me format e tjera të dhunës si dhuna emocionale dhe ajo fizike.

e. Dhuna ekonomike përfshin: kontrollin e parave në mënyrë që të mos i lihet viktimës mundësia për të marrë vendime për çështje ekonomike, dhënia e një vlefte të vogël parash që nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve ekonomike, refuzimi për të mbuluar shpenzimet e fëmijëve, forcimi për të vjedhur ose shitur gjërat e vlefshme, mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të partneres/bashkëshortes, etj.

## **2.2 Dhuna ndaj gruas**

Është keqtrajtimi i gruas nga partneri i saj ose pjesëtarë të tjerë të familjes. Gratë dhe vajzat rezultojnë të jenë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje. Rezulton se format e dhunshme të komunikimit në familje fatkeqësisht takohen që në moshë fare të reja dhe vajzat përjetojnë dhunë në familje jo vetëm gjatë jetës martesore, por edhe në familjen e origjinës. Në shumë raste vajzat martohen për t'i shpëtuar dhunës në familjen e tyre të origjinës, martesë që rezulton të jetë po aq ose më shumë e dhunshme për to, se sa mjedisi nga kanë ardhur. Faktorët që kontribuojnë në rëndimin e kësaj situate janë: Përkufizimi i rolit të gruas/bashkëshortes në shoqëri: mjedisi ynë social-kulturor mbart vlera e botëkuptime patriarkale të trashëguara, si i tillë rëndon shumë pozicionin e grave, historikisht të rritura nën një traditë diskriminuese gjinore.

Pritshmëritë e paarsyeshme rreth rolit të gruas, mund të çojnë në nervozizëm dhe humbje kontrolli. Gjithashtu vlerat kulturore që i tolerojnë sjelljet e dhunshme ndaj gruas e lehtësojnë ushtrimin e dhunës. Papunësia apo stresi në punë: gjendja e vështirë që shkakton papunësinë, ashtu si dhe pakënaqësia ndaj punës ose pagës, mund të ndikojë në gjendjen emocionale të burrit, e cila mund të shprehet me sjellje të dhunshme ndaj gruas. Varësia ekonomike e gruas: mentaliteti patriarkal ka pasojë të rënda edhe në varësinë ekonomike të gruas, që megjithëse detyrohet të mos punojë për të rritur fëmijët apo sepse kështu dëshiron partneri, konceptohet si barrë për t'u mbajtur.

Ndjenja paaftësie: shumë meshkuj kur e gjejnë veten në rolin e kryefamiljarit, ndjehen të paaftë për t'i përmbushur me sukses detyrimet që i veshin këtij roli, dhe shumë shpesh ndjehen fajtorë apo të turpëruar. Këto ndjenja mund të çojnë në sjellje të dhunshme ndaj bashkëshortes. Dhunimi i gruas është dhunimi i të drejtave të njeriut. Të gjithë pa

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

dallim gëzojmë të drejtën e respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe duhet të reagojmë kur këto të drejta na dhunohen.

### 3. Kuadri ligjor në Shqipëri

a. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>3</sup> (1998)*, në nenin 18 të saj, sanksionon se “të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit përbën shtyllën kurrizore të kushtetutës dhe gjithë sistemit tonë ligjor.

b. *Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)<sup>4</sup>*. Konventa njihet ndryshe edhe si Kushtetuta e Grave, për shkak të rëndësisë së madhe që ka ajo për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave në të gjitha fushat e jetës. Preambula e saj rikujton që eliminimi i diskriminimit ndaj grave dhe nxitja e barazisë midis burrave dhe grave janë të drejta themelore të cilësuar dhe të detyruara sipas Kartës së të Drejtave të Njeriut.

Në preambulë theksohet se zhvillimi i plotë i një vendi, çështjet që shqetësojnë botën mbarë, si dhe çështjet e paqes kërkojnë përpjekje maksimale nga të dy gjinitë si burrat ashtu edhe gratë. Konventa është ndërtuar në 30 nene të ndarë në 4 kapituj, me anë të së cilave ftohen shtetet palë që e ratifikojnë atë të përmbushin disa detyrime specifike për eliminimin e diskriminimit mbi bazë gjinie dhe gëzimin e ushtrimit të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave. Në mënyrë të veçantë detyrimet e shteteve palë shtrihen jo vetëm në jetën publike por edhe atë private. 16 nene të Konventës identifikojnë fushat kryesore të diskriminimit të gruas duke përcaktuar edhe rrugët e ndërhyrjes. Pjesa tjetër ka të bëjë me strukturat dhe procedurat e raportimit të Konventës. Konventa i bën thirrje të gjithë shteteve që e ratifikojnë atë të marrin të gjitha masat e përshtatshme ligjore, administrative apo masa të tjera, duke përfshirë këtu edhe masa të përkohshme pozitive për përparimin e gruas.

Sipas CEDAW Shtetet Palë duhet të marrin angazhime për të eliminuar diskriminimin në arsim, punësim, shëndetësi, dhe jetën social ekonomike dhe kulturore. Konventa parashikon një bazë të rëndësishme për realizimin e barazisë midis burrave dhe grave për të siguruar mundësi dhe akses të barabartë në jetën publike dhe atë politike. Sipas kësaj shtetet palë duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave po ashtu si burrat në qeverisje si politikëbërëse, po ashtu për përfaqësimin e tyre në arenën ndërkombëtare. Shtetet bien dakord të luftojnë të gjitha llojet e trafikut të grave si dhe shfrytëzimit të saj. Gjithashtu shtetet duhet të angazhohen që të marrin në konsideratë nevojat e gruas rurale dhe të sigurojnë pjesëmarrjen dhe përfitimin nga zhvillimi rural si të burrave dhe të grave në mënyrë të barabartë.

Dispozitat e saj parashikojnë angazhimin e shteteve palë për të marrë të gjitha masat, me qëllim eliminimin e diskriminimit e garantimin e barazisë së burrit dhe gruas në:

I. në jetën politike dhe publike të vendit, veçanërisht në të drejtën e gruas: për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike, për të marrë pjesë në përpunimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj, për të përfaqësuar qeveritë e tyre në arenën

<sup>3</sup> Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21. 10. 1998.

<sup>4</sup> Ligji nr.7767, datë 11.05.1994.



ndërkombëtare dhe për të marrë pjesë në punimet e organizatave ndërkombëtare, te drejtën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë, ashtu dhe në atë të fëmijëve të tyre etj.

II. Në të drejtat sociale e ekonomike veçanërisht në: në fushën e arsimit për të siguruar kushte të njëjta të bërjes së karrierës dhe të kualifikimit profesional, të frekuentimit të shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet arsimore të të gjitha kategorive, fushën e zënies punë, për të siguruar të drejtën për mundësi të njëjta punësimi, duke përfshirë zbatimin e kriterëve të njëjta të përzgjedhjes lidhur me zënie punë; mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit të familjes, të drejtën për pensione familjare, dhënien e mundësive të barabarta grave në zonat bujqësore etj, III. në të drejtat civile, veçanërisht në fushën civile për ti garantuar gruas zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe mundësi të njëjta për ta ushtruar këtë zotësi, në çështjet që kanë të bëjnë më me martesën dhe me marrëdhëniet familjare, të drejtën e njëjtë për të lidhur martesë, për të zgjedhur lirisht bashkëshortin, të drejtën dhe përgjegjësinë e njëjtë gjatë martesës dhe me rastin e prishjes së saj; të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, etj

c. *Konventa "Kundër torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues dhe ndëshkimit"*, hyrë në fuqi më 11 maj 1994.

d. *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut* dhe protokollet shtesë të saj (nr. 1, 2, 4, 5, 6, 7, 11, 12) është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi 2 tetor 1996.

e. *Konventa ndërkombëtare "Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore"*, aderuar në 4 tetor 1991, etj.

f. *Kodi i Familjes*<sup>5</sup>, parashikon të drejta të barabarta midis burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht për t'u martuar apo divorcuar, si dhe të drejtat dhe detyrat e ndërsjella në familje për edukimin dhe rritjen e fëmijëve. Ky Kod, solli disa dispozita të reja, të cilat mbrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e bashkëshortit të dhunuar. Duke konsideruar faktin se në një pozitë të tillë ndodhet shpesh gruaja, mbrojtja që këto dispozita sigurojnë, është e rëndësishme për të. Kështu, neni 63 parashikon për herë të parë masa urgjente kundër dhunës bashkëshortore dhe në mbrojtje të familjes, duke detyruar dhunuesin të largohet nga banesa bashkëshortore për një periudhë 3-vjeçare.

g. *Kodi Penal*<sup>6</sup>, i ndryshuar. Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënuar rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Kodi Penal, aktualisht, parashikon figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në seksionin VI të Kodit penal, "Krimet seksuale", i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, "Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës". Krimet seksuale dhe homoseksuale janë parashikuar në të njëjtin seksion.

Gjithsesi, ka disa dispozita të veçanta, siç është rasti në nenin 102 dhe 102/a, i cili përkatësisht parashikon rastet e marrëdhënieve seksuale me të mitur. Ato ndryshojnë vetëm për sa u përket dënimit. Me ndryshimet e vitit 2012 u shtua neni 130/a 'Dhuna në Familje', i cili e dënon këtë vepër penale nga 1 deri në 5 vjet heqje lirie. Gjithashtu, janë shtuar në veçanti si rrethana rënduese: a) kur vepra penale është kryer në

<sup>5</sup> I miratuar më 08.05.2003, Ligji Nr. 9062.

<sup>6</sup> Nr.7895/1995.

kundërshtim me urdhrat e mbrojtjes; b) kur vepra penale është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; c) kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, identitetin gjinor, etj. Në këtë rast të fundit, e Drejta Penale nuk ofron asnjë mundësi për të kërkuar rrethana lehtësuese.

*h. Ligji 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'*<sup>7</sup>, përbën rastin e parë të aprovimit të një ligji me iniciativën e 20 mijë zgjedhësve. Ky ligj vjen si vijues i disa hapave të mëparshëm të ndërmarrë në kuadër të konsolidimit të sistemit ligjor shqiptar në fushën e masave parandaluese dhe ndëshkuese ndaj dhunës në familje, por edhe si detyrime ndaj Kushtetutës dhe konventave të tjera të nënshkruara nga shteti shqiptar, siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e BE-së. Ligji solli disa elementë të rinj, si nga ana e procedurave legislative ashtu dhe nga ana e përmbajtjes dhe rolit që i njejn institucioneve ekzekutive dhe rehabilituese, duke e shtrirë vëmendjen jo vetëm ndaj viktimës, si parësore, por dhe ndaj dhunuesit, duke e paraparë këtë si një masë jo vetëm riparuese, por dhe parandaluese në të ardhmen. Ligji parashikon dy tipe urdhrash mbrojtjeje, urdhër i menjëhershëm mbrojtje dhe urdhër mbrojtjeje.

I pari lëshohet nga gjykata menjëherë dhe është me fuqi të përkohshme deri sa del urdhri i mbrojtjes, zbatohet në rastet kur dhuna paraqet "rezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë, mirëqenies ose shëndetit të anëtarëve të tjerë të familjes". Në rastin e dytë, urdhri i mbrojtjes lëshohet me vendim gjykate dhe parashikon masa mbrojtëse për viktimën/viktimat e dhunës në familje. Në këtë kuadër ligji sjell dhe një progres të rëndësishëm kur përcakton qartë rolin e autoriteteve përkatëse shtetërore, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në nivel të qeverisjes qendrore dhe lokale, duke filluar nga Ministria e Punës, si autoritet përgjegjës që mundëson zbatimin e ligjit, deri te autoritetet lokale, si bashkitë e komunat.

## 4. Kuadri institucional në Shqipëri

Lind pyetja cilat janë institucionet që adresojnë këtë fenomen kaq të përhapur në shoqërinë tonë. Ligji për mbrojtjen ndaj dhunës në familje parashikon dy autoritete kryesore përgjegjëse, të cilat janë: Autoritetet Administrative dhe Autoritetet Gjyqësore.

Autoriteti Përgjegjës që mundëson zbatimin e këtij ligji dhe merr përsipër hartimin e politikave dhe strategjive në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Krahas MPÇSSH, ligji ka parashikuar dhe aktorë të tjerë të cilët do të bashkëveprojnë me të janë: *Ministria e Brendshme* me komisariatet e policisë në rrethe, *Ministria e Shëndetësisë* me qendrat shëndetësore në rrethe, *Ministria e Drejtësisë*, *Ministria e Arsimit* si dhe *Autoritetet lokale (bashki, komuna)* me qendrat e shërbimeve sociale pranë tyre. Është fundamentale njohja e institucioneve të përfshira drejtpërdrejt në parandalimin e dhunës në familje, strukturat e krijuara brenda tyre qoftë në nivel qendror dhe në atë vendor si edhe efektivitetin e tyre përmes koordinimit të veprimtarisë ndërmjet tyre me qëllim mbrojtjen e anëtarëve të familjes nga dhuna. Ligji Nr. 9669 dt. 18. 12. 2006, sanksionon se autoritetet përgjegjëse në zbatim të tij janë:

- *Ministria e punës çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta (neni 6)* ka rol

<sup>7</sup> Ligji Nr. 9669, dt. 18.12.2006, 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'.

koordinues, rol mbështetës dhe mbikëqyrës. Ministria duhet të përcaktoj drejtimin e politikave shtetërore, të financoj projekte për viktimat e dhunës dhe mbrojtjen e familjes, të mbështes në ngritjen e strukturave ndihmëse e infrastrukturës dhe mbikëqyrjes së këtij procesi, të organizoj të trajnimeve, të mbaj statistika, të mbështes dhe mbikëqyrjes së qendrave të shërbimeve si dhe të licencojë të OJF-ve.

- *Ministria e Brendshme* ka për detyrë të ngrejë sektorë të veçantë kundër dhunës në familje në çdo drejtori policie. Gjithashtu Ministria e Brendshme duhet të krijojë struktura të posaçme, të caktojë personat përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe të trajnojë në vazhdimësi efektivat e policisë që do të merren me dhunën në familje. Ministria e brendshme, cakton detyra për Policinë e Shtetit në varësi të saj.

- *Ministria e Shëndetësisë dhe strukturave të saj (qendra shëndetësore në bashki dhe komuna, urgjencat mjekësore)*, duhet të krijojë kapacitetet për të trajtuar rastet e dhunës në familje në urgjenca dhe qendra shëndetësore, të ngrejë sektorë të veçantë për DhF në çdo qendër shërbimi shëndetësor dhe urgjence, të evidentojë rastin e dhunës në familje në regjistrat përkatës mjekësorë, të ofrojnë ndihmën mjekësore dhe psikologjike në çdo kohë, të kryejnë ekzaminimet mjekësore në çdo kohë, të pajisin viktimën me një raport mjekësor, të njoftojë menjëherë strukturat e tjera paralele të skemës, të referojnë/orientojnë viktimën për në shërbimet e tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, t'i ofrojnë shoqërim dhe transport viktimës deri në qendrën e shërbimit tjetër, t'i paraqesin gjykatës dokumente të certifikuara.

- *Ministria e Drejtësisë* adreson çështjet e dhunës në familje nëpërmjet shërbimit mjeko-ligjor, përmbaramit dhe mbrojtjes ligjore. Disa nga detyrat e saj janë si më poshtë: të trajnojë ekspertët mjeko-ligjore për dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve, të trajnojë përmbarusit për ekzekutimin e Urdhrit të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Mbrojtjes së Menjëhershme, të ndër marrë të gjitha veprimet e duhura që të sigurojë përmbushjen e urdhrave të mbrojtjes, të financojë për t'u siguruar viktimave të dhunës në familje mbrojtje ligjore falas, të sigurojë një numër (listë) avokatësh të trajnuar, që ofrojnë këtë shërbim.

- *Ministria e Arsimit & Shkencës* harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje si dhe përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

- *Njësia e Qeverisjes Vendore*. Roli i punonjësit social bëhet më i dukshëm në detyrat ligjore të bashkive dhe komunave. Këto njësi kanë për detyrë të krijojnë strukturat e shërbimit social për dhunën në familje, të krijojnë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit. Këto qendra duhet të respektojnë standarde të caktuara: të jenë në vendndodhje sekrete, me vëzhgim dhe ruajtje, me personel të specializuar dhe aktivitete të menduara enkas për rehabilitimin e viktimave dhe fëmijëve të tyre. Të bëjnë referim, orientim, shoqërim, transportim të viktimave për në shërbimet e tjera, t'i lëshojnë viktimës dhe gjykatës dokumente shkresore.

Dokumentet e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore janë shumë të rëndësishme, pasi mund të paraqiten si provë në gjykatë për të siguruar lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Për këtë arsye, punonjësi duhet të tregojë kujdes të veçantë në përpilimin e tyre. Të paraqesin kërkesën në gjykatë për Urdhër Mbrojtjeje për të mitur dhe për Urdhër Mbrojtjeje të Menjëhershme. Të marrin pjesë në gjykim për lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes për të miturit. Ky detyrim vjen si një ritheksim i detyrimit të përfaqësuesve të sektorëve të mbrojtjes sociale pranë bashkive dhe komunave për të marrë pjesë në

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

çdo gjykim që ka të bëjë me të miturin, i vendosur që më 2003 përmes Kodit të Familjes. Të sigurojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore. Të instalojnë një linjë telefonike 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre. Të japin informacionin e duhur statistikor për rastet e trajtuara e të evidentuara prej tyre në strukturën e MPCSSH.

- *Gjykata*. Detyra e gjykatës konsiston në shqyrtimin e kërkesave për Urdhrin e Mbrojtjes dhe Urdhrin e Mbrojtjes së Menjëhershme. Vendimet gjyqësore të lëshuara nga gjykata, synojnë që të parandalojnë episode të mëtejshme dhune mes familjarëve, duke parashikuar detyrime të tilla si, p.sh. qëndrimi në një distancë të caktuar nga viktimat, largimi i dhunuesit nga banesa e përbashkët, moskontaktimi për një kohë të caktuar, etj. (Urdhret e mbrojtjes janë një masë me karakter civil, por thyerja e tyre përbën veprë penale, në bazë të nenit 320 të Kodit Penal).

Siguron zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18. 12. 2006, “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, me ndryshimet përkatëse, vepron sipas parimeve të paanësisë, ligjshmërisë, mosdiskriminimit, mbështetjes në prova dhe respekton etikën profesionale, merr masat e organizimit të brendshëm administrativ për t’iu përgjigjur në kohë (urgjent) viktimave që i drejtohen asaj si dhe për të krijuar siguri në ambientet e gjykatës, trajnimi i gjyqtarëve për njohjen e ligjit nr. 9669, datë 18. 12. 2006, “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, me ndryshimet përkatëse, trajnimi i stafit për t’iu përgjigjur viktimave sipas ligjit dhe rregullave të etikës, puna e këtyre institucioneve administrative dhe gjyqësore është e ndërthurur, pasi nga njëra anë veprimet që autoritetet administrative kryejnë janë shërbimet që ato ofrojnë, provat që mbledhin dhe dokumentet që lëshojnë duke lehtësuar punën e gjykatës për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes për viktimat e dhunës. Nga ana tjetër, urdhrat e mbrojtjes që nxjerr gjykata janë një mjet ndihmës dhe garanci më shumë për organet administrative, në mbështetjen e vazhduar që ata japin për viktimat.

## 5. Procedura policore në faza të ndryshme të evidentimit të dhunës

Ligji “Për masat ndaj dhunës në familje”, parashikon në mënyrë të qartë dhe eksplicite institucionet përgjegjëse për adresimin e dhunës. Një prej këtyre institucioneve është Ministria e Brendshme, e cila krijon struktura të posaçme për dhunën në familje si dhe përcakton angazhimet kryesore të policisë. Policia duhet të jetë tejet efektive, efiçente dhe e mirë trajnuar, pasi viktimat e dhunës për herë të parë vendosen në kontakt me punonjësit e policisë. Efektivët e policisë duhet t’i trajtojnë këto raste me ndjeshmërinë e duhur, si dhe t’u kushtojnë viktimave vëmendjen maksimale të tyre. Përveç hetimit dhe grumbullimit të provave, roli i policisë konsiston edhe në referimin e rastit në aktorë të tjerë që ofrojnë mbrojtje. Punonjësi i Policisë së Shtetit ka detyrimin ligjor, për të orientuar dhe informuar viktimën e dhunës në familje për proceset ligjore që mund të nisin, mbi faktin që ajo/ai është dhunuar.

### 5.1 Përgjegjësitë dhe detyrat e punonjësit të policisë

Patrulla e përgjithshme e policisë dhe punonjësi i policisë, në rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë disa përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara. Duhet të reagojnë

menjëherë ndaj telefonatave për dhunë familjare, pa marrë parasysh a është raportim i menjëhershëm apo i vonuar, të vlerësojnë faktin se janë personat e parë që shkojnë në vendin e ngjarjes ku bëhet fjalë për dhunë në familje, të vlerësojnë faktin se janë personat më të rëndësishëm në situatat e dhunës familjare si dhe të luajnë një rol kryesor në sigurimin e provave dhe në bashkëpunimin me viktimën për të mundësuar më vonë një rast eventual për ndjekje penale.

Patrulla e përgjithshme e policisë dhe punonjësi i policisë së zonës, duhet të marrin informacionin para se të arrijnë në vendin e ngjarjes. Në momentin kur i afrohet vendit të ngjarjes duhet të shmangë përdorimin e borisë së mjetit dhe dritave të emergjencës, të mos parkohen makinat e policisë para shtëpisë ose në një vend ku përbën pengesë si dhe të jetë vigjilent për personat që mund të largohen nga vendi i ngjarjes si dhe për armët që mund të përdoren nga dyert, dritaret apo nga automjetet përreth. Me mbërritjen në vendngjarje do të prezantojë veten si punonjës policie, të sqarojë pse ndodhet aty si dhe të kërkojë të shohë viktimën. Punonjësi i policisë duhet të tregohet i kujdesshëm në mbledhjen e provave, të marrë të gjitha informacionet e dhëna me saktësi.

Efektivët e policisë, duhet të raportojnë me shkrim “Raportin me shkrim për incidentin”, i cili është një dokument – formular. Në përpilimin e këtij formulari punonjësi i policisë duhet të dokumentojë çdo element për secilën vepër, të dokumentojë shkeljen e urdhërit të mbrojtjes, nëse ka të tillë, të administrojë në proces-verbal dhe fiksojë me fotografi çdo dëmtim, dërmishje, skuqje në trup dhe përshkrime të shkruara të tyre, të dokumentojë incidentet e mëparshme të raportuara ose jo pranë policisë, të përshkruajë në detaje dhe jo në mënyrë të përmbledhur fjalët e viktimës, të dyshuarit dhe dëshmitarëve, të përshkruajë gjendjen emocionale të së gjitha palëve në incident, etj.

Një moment tjetër tepër i rëndësishëm është faza e intervistimit, ku punonjësi i policisë i caktuar për rastet e dhunës në familje do t’u japë përparësi rasteve të dhunës në familje, të sigurojë mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në konflikt, të përgatisë dokumentet me prova të sakta ligjore, sa më shpejt të jetë e mundur dhe t’ia dërgojë ato organit të hetimit për ndjekje penale të mëtejshme si dhe të bashkëpunojë dhe të mbrojë viktimën dhe dëshmitarin, etj.

Një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet edhe fazës së hetimit në vendngjarje, pasi aty duhet të kryhet një hetim i plotë dhe të përgatitet një raport pavarësisht nga dëshira e viktimës apo prania ose mungesa e të dyshuarit. Punonjësi i policisë gjatë hetimit në vendngjarje duhet të përdorë disa teknika policore dhe të kryejë detyrat e mëposhtme: Të afrohet me kujdes në vendngjarje (sipas rastit) dhe të shohë e dëgjojë se çfarë po ndodh përpara se të bëjë të ditur praninë e tij, të përcaktojë vendndodhjen dhe kushtet e viktimës dhe të dyshuarit, të përcaktojë nëse është përdorur armë, nëse në banesë apo në ambientin përreth saj ka armë, t’u japë ndihmë palëve të dëmtuara dhe nëse e vlerëson, të njoftojë një ambulancë.

Gjithashtu duhet të dokumentojë emrin dhe informacionin për të kontaktuar mjekun, tek i cili/e cila është vizituar viktimja, të përcaktojë nëse ka persona të tjerë në banesë apo ndërtesën ku është ushtruar dhuna, të mbajë veç të dyshuarin, viktimën dhe dëshmitarët përpara se t’i pyesë ata, të evidentojë në proces-verbal deklaratat e tyre ashtu siç thuhet dhe jo si përmbledhje të mendimeve që ka dashur të shprehë i intervistuari, të dokumentojë dhe fotografojë të gjitha dëmtimet trupore. Në proces-verbal duhet të fiksohet me fotografi apo filmim armët e mjete të tjera të ushtrimit të dhunës me cilësinë e provave material, përshkrimi i tyre duhet bërë i detajuar si dhe të

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

vlerësojë gjendjen emocionale të së gjithë personave në konflikt dhe informacionet e marra nga mjekët, punonjësit sociale të bashkive, komunave e OJF-ve, si pjesë e informacionit të siguruar për hetim.

## 6. Konkluzione

Dhuna në familje, sidomos dhuna ndaj grave është një fenomen mjaft i përhapur në shoqërinë shqiptare dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Është e domosdoshme që qeveria të ndërmarrë iniciativat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut. Duhet që të gjenden mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar ruajtjen dhe zbatimin e të drejtat të grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Fuqizimi ekonomik i grave dhe integrimi gjinor duhet të përbëjë një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore, reduktimin e dhunës me bazë gjinore si dhe të jetë pjesë e politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri. Gjithashtu, dhënia prioritet politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ritrajnimi duhet të jetë element parësor.

## Bibliografia

1. A. Mandro & A. Anastasi & E. Shkurti & A. Bozo, "Barazia Gjinore dhe Mosdiskriminimi", Shtëpia Botuese Dajti 2000, Tiranë, janar 2011.
2. Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë. Neimans, A. 2002 Gender mainstreaming in practice: a handbook, UNDP, Regional Bureau for Europe and CIS, fq. 80-82.
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
4. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW).
5. Kodi Penal.
6. Kodi i Familjes.
7. Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në 78 Marrëdhëniet Familjare".
8. OSBE (2007) "Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje - Një manual për viktimat dhe organizatat jofitimprurese".
9. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2007. 'Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje', Manual për viktimat dhe organizatat jofitimprurëse, Tiranë.
10. QNL & QSHPZH, "Institucionet shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje", Tiranë 2006.
11. 'Stop Violence against women, Guidelines for Developing a Training Program', <http://www.stopvaw.org/>
12. UNICEF (2006). Domestic Violence against Women and Girls, nr.6.
13. <http://www.magjistratura.edu.al/>
14. <http://www.gadc.org.al/v2/>
15. <http://www.al.undp.org/>
16. <http://www.sociale.gov.al/>



---

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Ndryshore mbi problematikat e sjelljes antisociale e delinkuente së të rinjve, në mjediset penitenciare në Shqipëri

Dr. Valbona MUÇA

Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan  
bonamuca@yahoo.it

Dr. Eglantina DERVISHI

Universiteti i Tiranës

Dr. Eلسabeta KAFIA

“Albanian University”, Tiranë

## Abstrakt

*Sjellja deviante mund të parashtrijë çdo sjellje jokompliante me normat dhe rregullat e shoqërisë, kulturës, organizatës a ligjësiive psikologjike e etnosociologjike. Origjina e dukurisë së deviancës, lidhet me origjinën e vetë njeriut si etnitet. Edhe pse është në thelb një problematikë e pashmangshme e shoqërisë dhe sfidave të globalizimit, kërkimet kanë treguar, se densiteti dhe intensiteti i deviancës, ka pësuar një rritje të jashtëzakonshme dhe ka ndikuar fuqishëm në disbalancat e shoqërive transitore; edhe të shoqërisë sonë. Ky artikull, ka si objektiv që të eksplorojë dhe të identifikojë faktorët, që nxisin dukurinë e sjelljes antisociale dhe delinkuente te së miturit, në institucionet penitenciare dhe të vuajtjes së dënimit në Shqipëri. Së pari, do të parashtrijmë një panoramë të gjendjes së sjelljes antisociale delinkuente në mjediset e vuajtjes së dënimit së të miturve. Së dyti, do të shtjellojmë faktorët e riskut dhe precipitues psikosocialë, që nxisin shfaqjen e sjelljeve antisociale te të miturit. Së treti, përmes analizës konkrete të rasteve, do të paraqiten edhe disa funksione dhe aftësi të profesionistëve klinikë dhe forens, me qëllim krijimin e strategjive efikase parandaluese dhe ndërhyrëse.*

*Metoda e administruar në këtë punim është e metodologjisë mikse, duke u mbështetur në përdorimin e intervistës së protokolluar dhe studimit të rasteve konkrete. Të dhënat nga analiza e thelluar e rasteve dhe intervistat, treguan një lidhje të fortë mes ndryshimeve të kushteve në mjedisin psikosocial së të miturve, me rritjen e sjelljes së shfaqur antisociale. Ndryshoret emocionale dhe marrëdhëniet ndërpersonale janë faktorët më ndikues në rritjen e incidencës së sjelljes antisociale. Në përfundim të këtij punimi janë radhitur disa gjetje dhe rekomandime, të lidhura me situatën e përgjithshme të vëzhguar, faktorët precipitues dhe mbajtës të sjelljes antisociale, si dhe ngritjen e strategjive parandaluese të sjelljeve antisociale me impakt në tërësinë e zhvillimit të individit.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**sjellje antisociale, faktorë risku, strategji parandaluese.**



## 1. Hyrje

Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në veprimtari deviante, me tendencë kriminaliteti, është kthyer në një shqetësim serioz, qoftë në pikëvështrimin global, qoftë në atë shqiptar në dekadën e fundit. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të qartësohet kufiri i moshës së individëve, që janë target-grupi objekt në parashtrimin e këtij artikulli studimor. Në tekstin e Politikës Kriminale, “për personat e moshës nën 18 vjeç, legjislacioni shqiptar përdor termin “i mitur”. Në disa dispozita të tjera përdoret edhe termi “fëmijë”.<sup>1</sup> (Elezi dhe Hysi, 2006)

Në nenin 1 të “Konventës për të Drejtat e Fëmijës”<sup>2</sup> theksohet se “fëmijë konsiderohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur ligji i brendshëm vendos një kufi më të ulët”. Legjislacioni shqiptar, si kufirin maksimal të miturisë ka vendosur moshën 18 vjeç”. Në disa vende të Europës Perëndimore, kur studiohet kriminaliteti i të miturve, studiuesit bëjnë dallim ndërmjet të miturve dhe të një kategorie të veçantë që po njej shtrirje të madhe, së të ashtuquajturve “të rriturve të rinj”. Fjala është për persona të grupmoshës 18 deri në 21 vjeç, por sipas rasteve edhe deri në 23 apo 25 vjeç, të përfshirë vullnetarisht a të induktuar për përfshirje, në veprime deviante deri në të skajshme, çka në vetvete shton nevojën e një parashtrimi më të madh të burimeve njerëzore dhe specialistëve, për identifikimin dhe parandalimin efikas.

Në kontekstin kulturor shqiptar, termat *fëmijë* dhe *i ri* përdoren me diferenca disavjeçare nga përkufizimet e cituara në paragrafët legjislativë. Kështu, përgjithësisht, trajtohen dhe konsiderohen si fëmijë individët deri më 16 vjeç ndërsa nga 16 deri më

<sup>1</sup> Elezi, E. dhe Hysi, V. (2006) *Politika Kriminale*, Tiranë: 2006.

<sup>2</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Sistemi Drejtësisë Penale për të Miturit në Shqipëri, Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij*, Tiranë: 2015.

18-20 vjeç, individët konsiderohen si të rinj. Ky dallim, në vlerësimet sipas moshave të individëve të përfshirë në sjellje penale, llojin e veprimtarisë deviante ekstreme, tipologjitë e rrishtit dhe tikitat parandaluese janë indekse të rëndësishëm për ravijëzimin e këtij artikulli.

## 2. Metodologjia

Ky artikull studimor ka për qëllim eksplorimin statistikor-empirik të faktorëve të rrishtit dhe precipitantëve psikosocialë të sjelljes deviante, delinkuente së të rinjve. Të dhënat statistikore të grumbulluara në institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe intervistat me analiza specifike të rasteve, në qendrat e rehabilitimit për të rinjtë në Shqipëri, janë përdorur në realizimin e këtij punimi. Rezultatet e parashtruara, kanë përfshirë të rinj të moshave 14-21 vjeç, të përfshirë drejtpërdrejtë a të profilizuar si subjekte me potenciale të veprimtarisë deviante kriminale, në institucionet e policimit dhe atyre të vuajtjes së lëmit, në shpërndarje të ndryshme territoriale.

## 3. Rezultatet

Përgjatë gjithë viteve të tranzicionit politiko-social, rreth 90% e moshave të reja të dënuara, janë të akuzuar për vepra penale. Është e evidente nga të dhënat që kurba e kriminalitetit fëmënor dhe rinor mbetet konstante dhe me incidencë shtuese (Dervishi, Ibrahim et al. 2017)<sup>3</sup>. Kështu për shembull, gjatë vitit 2005 janë dënuar 289 individë në moshë të re, nga të cilët, 258 për vepra penale dhe 31 për kundërvajtje. Dënimet e të miturve dhe të rinjve për kundërvajtje, kanë pësuar rritje nga krahasimi i shifrave të vitit 2005, me ato të vitit 2004 (31 në 2005 dhe 7 në 2004). Krimi *kundër pronës* ose *vjedhjet*, konsiderohen si veprat më të shpeshta penale të kryera nga të miturit dhe të rinjtë. Duke u ndalur tek disa të dhëna më specifike rreth prevalencës, vërehet se numri i të miturve të ndaluar për vepra penale, krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë së kësaj moshe, ka pësuar rënie. Kështu, gjatë vitit 2005 shënohen 25 të mitur të ndaluar për 100 000 individë të kësaj moshe, ndërsa në vitin 2004, shënohen 32 të mitur për 100 000 individë në grupmoshë. Studimet kanë treguar (Stouthamer-Loeber, 2002)<sup>4</sup> se sjellja antisociale në moshat e reja, më saktësisht në fëmijëri dhe rini, i kanë rrënjët në ndërveprimin e faktorëve të niveleve të ndryshme: individual, familjar dhe shoqërorë. Në aktualitetin tonë, kriza e përjetuar në familjen dhe shoqërinë shqiptare dhe “tronditjet” psikosociale të vazhdueshme janë prelude të tërësisë të krijimit të ciklit të deviancës antisociale. Përmbledhtas, këto të dhëna paraqiten në tabelat në vijim.

Tab. 1 Autorë të veprave penale kundër personit në 6-mujorin e parë 2016.

Tipologjia e veprës penale	Fëmijë deri 14 vjeç	Të rinj 14-21 vjeç	Gjithsej
Vrasje	—	5	5
Vrasje në tentativë	1	17	18
Plagosje e rëndë me dashje	4	10	14
Marrëdhënie seksuale/homoseksuale me dhunë	6	2	8
Vepra të turpshme	—	2	2
Vepra penale të tjera kundër personit	12	123	135
Armëmbajtje pa leje	—	11	11

Tipologjia e veprës penale	Fëmijë deri 14 vjeç	Të rinj 14-21 vjeç	Gjithsej
Vrasje	4	4	8
Vrasje në tentativë	2	15	17
Plagosje e rëndë me dashje	—	11	11
Marrëdhënie me te mitur	12	2	14
Marrëdhënie seksuale me dhunë	1	2	3
Vepra të turpshme	3	—	3
Vepra penale të tjera kundër personit	11	106	117
Rrëmbim	—	2	2
Të tjera	3	8	11

**Tab. 2 Të dënuar për veprën penale kundër personit ne 6-mujorin e parë 2016**

Sipas të dhënave të paraqitura më lart, nga qendrat e rehabilitimit së të miturve<sup>5</sup> dhe të dhënave të grumbulluara nga Ministria e Brendshme, gjatë viteve 2012-2016, veprat penale të kryera nga të miturit kanë ruajtur po ato nivele, domethënë janë rritur në raport të drejt me rritjen e veprave penale në përgjithësi. Kjo tendencë e rritjes së veprës penale tek të miturit, përkrah rritjes së krimit në përgjithësi, është e dukshme edhe në qendrat kryesore të vendit.

Kështu, veprat penale të të miturve:

- Në Tiranë: 56 raste nga 744 të evidentuara në tërësi, për vitin 2012; 36 raste nga 1505, për vitin 2013; 77 raste nga 1529, në vitin 2016 dhe 104 nga 1442, në vitin 2015. E shprehur në përqindje, situata në Tiranë është si vijon:

- për vitin 2012, veprat penale të të miturve përbëjnë 7.5%;
- për vitin 2014, veprat penale të të miturve përbëjnë afërsisht 5%;
- për vitin 2015, veprat penale të të miturve përbëjnë rreth 7% të rasteve;
- për vitin 2016, veprat penale të të miturve përbëjnë afërsisht 2.4%.

- Në Vlorë, si një nga qendrat kryesore të banuara dhe e vlerësuar si një nga qendrat me numër më të lartë të veprave penale, paraqet situata e mëposhtme:

- për vitin 2012, nga 323 vepra penale, 16 janë kryer nga të mitur, afërsisht 5%;
- për vitin 2013, nga 263 vepra penale, 3 janë kryer nga të mitur, afërsisht 1.1%;
- për vitin 2014, nga 307 vepra penale, 13 janë kryer nga të mitur, afërsisht 4.2%;
- për vitin 2015, nga 341 vepra penale, 5 janë kryer nga të mitur, afërsisht 1.5%.

- Në Elbasan, një nga qendrat më të banuara dhe me numër popullsie të konsiderueshme, situata e krimit tek të miturit paraqitet si më poshtë:

- për vitin 2012, nga 208 veprapenale, 13 janë vepra penale të kryer nga të mitur, afërsisht 6%;
- për vitin 2013, nga 310 vepra penale, 17 janë kryer nga të mitur, afërsisht 5.5%;
- për vitin 2014, nga 279 vepra penale, 29 janë kryer nga të mitur, afërsisht 10.4%;
- për vitin 2015, nga 252 vepra penale, 6 janë kryer nga të mitur, pra afërsisht 2.4%.

<sup>3</sup> Dervishi, E., Doçi, B., Beqo, A., Ibrahim, S. Muça, V. dhe Nano, L. "Risk factors for the involvement in criminal behaviors in the juveniles". Në konferencën *Individual, Family, Society - Contemporary Challenges*, Bukuresht, Rumani: 2017.

<sup>4</sup> Stouthamer-Loeber, "Risk and promotive effects in the explanation of persistent serious delinquency in boys". *Journal of Consulting and Clinical Psychology* 70, (2002).

<sup>5</sup> Ministria e Drejtësisë, bashkëpunim me Zyrën UNICEF, Tiranë dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit *Tryeza e Rrumbullakët "Drejtësia për të miturit; e tashmja dhe prespektiva"*, 18 janar 2015.

- Në Berat, i cili është një nga qytetet ku mendohet se ka pasur më shumë vepra penale të kryera nga të miturit, veçanërisht në një periudhë kohore të lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, transportimin dhe shpërndarjen e drogës si dhe krime kundër personit si: vrasje, plagosje apo veprime të mbetura në tentativë. Shifrat e mëposhtme na japin këtë situatë:

- për vitin 2012, nga 157 raste, 5 janë kryer nga të mitur, afërsisht 3%;
- për vitin 2013, nga 141 raste, 18 janë kryer nga të mitur, afërsisht 12.7%;
- për vitin 2014, nga 246 raste, 19 janë kryer nga të mitur, afërsisht 8%;
- për vitin 2015, nga 209 raste, 12 janë vepra të të miturve, ose afërsisht 5.7%.

Në një vështrim dhe krahasim të shpejtë të shifrave, na rezulton se veprat penale në moshat e reja, përbëjnë 6.25% të rasteve për vitin 2012 (nga 4.370, 274 janë raste të të miturve). Në vitin 2013 vërehet një ulje të lehtë. Veprat penale të të miturve dhe të rinjve, shënojnë 4.2% të rasteve në përgjithësi (nga 6.628, 308 janë raste të të miturve). Në vitin 2014, shifra mbetet afërsisht e barabartë me atë të një viti më parë. Nga 6.379 raste, 320 janë raste të veprave penale të kryera nga të miturit, pra rreth 5%.

## 4. Diskutime

Përfshirja e të miturve dhe të rinjve në aktivitete kriminale, është e lidhur me faktorë individualë dhe të jashtëm, të cilët krijojnë mjedisin për sjelljen penale. Në këto kushte, studimi i rolit të faktorëve individualë, si karakteristikat fizike dhe ato psikologjike, duhet analizuar në raport dhe në marrëdhënie me faktorët e jashtëm si familja, mjedisi social i përgjithshëm, mjedisi në komunitet, cilësia dhe lloji i arsimit, qeverisja dhe eksperiencat në zbatimin dhe respektimin e ligjit, etj. (Grisso, T. 1996).<sup>6</sup> Familja dhe mjedisi familjar, i japin formë jetës dhe karakterit të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, në përgjithësi. Një numër i madh të miturish dhe të rinjsh të përfshirë në vepra penale, vijnë nga familje problematike. Rritja e kriminalitetit në moshat e reja, gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit, është e lidhur drejtpërsëdrejti edhe me krizën që përjeton familja shqiptare gjatë viteve të tranzicionit.

Po kështu, nuk duhen neglizhuar të dhënat e viteve të mëparshëm si, vitet '90 dhe '97, të cilët kanë karakterizuar një periudhë të pazakontë në jetën shqiptare dhe në formësimin e kulturës së deviancës shoqërore edhe te brezat e rinj. Devianca trashëndenciale është po kështu një faktor i trashëgimisë sociale si një gen recesiv, i cili ringjallet në kushtet e favorshme. Krimet e sotme tek të miturit dhe të rinjtë, ndeshen më shpesh tek ata individë që vijnë nga familje me histori divorci, dhune, me një prind apo me prindër në emigracion.

Në mjedise të tilla, me mangësi të konsiderueshme emocionale por edhe materiale, fëmijët dhe adoleshentët nuk marrin dot modelin për të cilin kanë nevojë në këtë fazë të zhvillimit të tyre. Modelet ose mungojnë fare ose janë të deformuar dhe problematike. Fëmijët ndihen të papërkrahur, të pambështetur, të neglizhuar, dhe aspak të respektuar. Për më tepër, mjedisi ju afron situata stresuese, të vështira dhe shpesh të papërbalueshme prej tyre (Blumstein, et al. 1985)<sup>7</sup>.

Në lidhje me përhapjen territoriale të sjelljeve penale tek të miturit dhe të rinjtë, të

<sup>6</sup> Grisso, T. "Society's retributive response to juvenile violence: A development perspective". *Law and Human Behaviour* 20, (1996).

<sup>7</sup> Blumstein, A., Farrington, D. P., dhe Moitra, S., "Delinquency careers". *Crime and Justice*, vol. 6, (1985).

dhënat e grumbulluara nga intervistat e rasteve konkrete, kanë treguar se ajo takohet më shpesh tek individët që jetojnë në mjedise heterogjene. Gjatë periudhës së tranzicionit, një numër i konsiderueshëm familjesh kanë lëvizur nga zonat e thella dhe më pak të thella fshatare drejt qendrave kryesore urbane. Lëvizja e brendshme e popullsisë, është nxitur kryesisht nga mungesa e burimeve të jetesës në vendlindjet e tyre. Varfëria ekstreme, papunësia e lartë, mungesa e shërbimeve dhe pamundësia për të gjetur dhe zhvilluar aktivitete jetike, ushqyen këtë fenomen.

Të ardhurit tashmë në zonat urbane, nuk gjetën një realitet shumë më pozitiv në vendbanimet e reja. Një pjesë e mirë e këtyre vendbanimeve, ishin totalisht të papërgatitura për të përballuar fluksin e të ardhurve. Mungonin investimet dhe përgatitjet më elementare për zona të reja banimi. Të ardhurit, nga ana e tyre, nuk zotëronin aftësi dhe mundësi për të siguruar punësim dhe mbijetesë në kushtet e reja. Në disa drejtime, jeta në këto komunitete, ishte edhe më e vështirë për ata. Kostoja e jetës ishte më e lartë. Papunësia vazhonte. Diskriminimi dhe përjashtimi social ishte evident. Diferencat kulturore bëheshin pengesë për komunikime normale (Nadel, et al., 1996)<sup>8</sup>.

Popullsia autoktone nuk shprehu ndonjë qëndrim pozitiv për të mbështetur të sapoardhurit. Situata ishte edhe më e rëndë, në rastet kur të ardhurit rishtazi zaptuan edhe pronat e popullsisë autoktone. Tendenca për përjashtim u përforcau<sup>9</sup>. Të gjithë këta faktorë të psikosocialë, të ndërthurur ndërmjet tyre, inkurajojnë një mjedis që e ushqen deviancën ekstreme dhe përfshirjen e të miturve dhe të rinjve në veprimtari kriminale.

## 5. Konkluzione

Mjedisi komunitar heterogjen, ai familjar tejet i sforcuar dhe i stresuar, problemet socio ekonomike, niveli i ulët i arsimit, shërbimet e pakta në ndihmë të fëmijëve në nevojë dhe qëndrimet jomiqësore ndaj grupeve të ndryshme brenda komunitetit, ushqejnë stres, pasiguri, frustacion, agresivitet dhe sjellje të dhunshme e antisociale (Loeber, 1988)<sup>10</sup>.

Fëmijët dhe të rinjtë që rriten në mjedise të këtilla, nuk gjejnë modele pozitive për të imituar. Zgjedhja e tyre është shumë e kufizuar. Nën ndikimin e stresit dhe frustacionit, që u krijon përjashtim dhe etiketim social, si dhe vështirësitë e tjera të së miturve, modelet e të rinjve përkrijnë shumë shpesh me ato të rolit të kundërvajtësit. Nuk janë të rralla rastet kur të rinjtë e zonave suburbane, janë gjetur fajtorë për fyerje dhe kanosje ndaj personit, prishje të qetësisë publike, ngarje e makinës me shpejtësi në vendet e populluara etj. Këto akte, burojnë përgjithësisht nga ngarkesat emocionale negative dhe pamundësia për t'i shkarkuar me aktivitete të efektshme.

Pamundësia për t'u ballafaquar me modele dhe përvoja pozitive, mungesa e mbështetjes për një zhvillim dhe edukim normal të tyre, si dhe vështirësitë që ata hasin për të përballuar nevojat e ditës, i bëjnë këta fëmijë dhe të rinj të prirë për sjellje dhe veprime që ju sjellin sadopak fitim, në një kohë sa më të shkurtër.

<sup>8</sup> Nadel et al, "The Cycle of Violence and Victimization: A Study of the School Based Intervention of a Multidisciplinary Youth Violence Prevention Program". *American Journal of preventive Medicine*, (1996).

<sup>9</sup> UNICEF, *On the Rights Track: Preventive and restorative Juvenile Justice Reform in Albania*, Tirana: UNICEF Albania, (2004).

<sup>10</sup> Loeber, R. "The natural histories of juvenile conduct problems, substance use, and delinquency: Evidence for development progression: *Advances in Clinical Psychology*, vol. 11, (1988).

Është e nevojshme kësisoj rritja e fokusit të profilaksisë dhe parandalimit social nga specialistët e shëndetit mendor dhe organeve ligjzbatuese, te këto grupmosha të përfshira drejtpërdrejtë në veprimtari kriminale, por edhe të identifikimit të profileve të individëve me tendenca të deviancës ekstreme në të mirë të individit dhe shoqërisë.

## Bibliografia

1. Blumstein, A., Farrington, D. P., dhe Moitra, S. (1985) *Delinquency careers: In Crime and Justice*, vol. 6.
2. Dervishi, E., Doci, B., Beqo, A., Ibrahim, S. Muça, V. dhe Nano, L. (2017) "Risk factors for the involvement in criminal behaviors in the juveniles". Në konferencën *Individual, Family, Society - Contemporary Challenges*, Bukuresht, Rumani.
3. Elezi, E. dhe Hysi, V. (2006), *Politika Kriminale*, Tiranë: 2006.
4. Grisso, T. (1996), "Society's retributive response to juvenile violence: A development perspektive". *Law and Human Behaviour* 20.
5. Loeber, R. (1988), "The natural histories of juvenile conduct problems, substance use, and delinquency: Evedence for development progresion". In *Advances in Clinical Psychology*, vol. 11.
6. Nadel, et al., (1996), "The Cycle of Violence and Victimization: A Study of the School Based Intervention of a Multidisciplinary Youth Violence Prevention Program". *American Journal of preventive Medicine*.
7. UNICEF, (2004), *On the Rights Track: Preventive and restorative Juvenile Justice Reform in Albania*, Tirana: UNICEF Albania.
8. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, *Sistemi Drejtësisë Penale për të Miturit në Shqipëri Reflektime mbi të tashmen dhe të Ardhmen e tij*, Tiranë: 2015.
9. Stouthamer-Loeber (2002), "Risk and promotive effects in the explanation of persistent serious delinquency in boys". *Journal of Consulting and clinical Psychology* 70.
10. Ministria e Drejtësisë, bashkëpunim me Zyrën e UNICEF, Tiranë dhe Komitetit Shqiptar i Helsinkit, Tryeza e Rrumbullakët "Drejtësia për të miturit; e tashmja dhe prespektiva", 18 janar 2015.



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Teknologjia e informacionit në Policinë e Shtetit, në drejtim të dokumentimit ligjor të aktivitetit kriminal

— MSc. Dashmir ÇALI

Akademia e Sigurisë

[dashmir.cali@asp.gov.al](mailto:dashmir.cali@asp.gov.al)

## Abstrakt

*Në ditët e sotme roli i sistemeve të informacionit dhe i teknologjive të informacionit është bërë prioritar. Projektet masive teknologjike që lidhen me zhvillimin e teknologjisë dhe sistemit të internetit janë të aplikuara në polici, në të gjitha fushat, e sidomos në drejtim të dokumentimit ligjor të aktivitetit kriminal. Me anë të krijimit dhe funksionimit të sistemeve të integruara teknologjike bëhet e mundur mbledhja, grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave dhe e informacionit mbi një databazë të dhënash ekzistuese, që rifreskohet vazhdimisht. Në këtë punim paraqitet një pamje historike e zhvillimit të teknologjisë, internetit dhe komunikimeve elektronike, si dhe sisteme të veçanta informacioni, agjenda digjitale, etj. Më tej pasqyrohet roli i të dhënave dhe krijimi i databazës e i sistemeve teknologjike në Policinë e Shtetit shqiptar. Në një institucion ku prodhohen masivisht të dhëna, është e nevojshme krijimi i bazave të mirëfillta duke përdorur teknologji informatike dhe duke i integruar në rrjeta telepatike për të bërë të mundur aplikimin e programeve. Ndër sistemet teknologjike më të përdorura nga Policia Shqiptare në kuadër të analizës së informacionit kriminal dhe parandalimit të krimit është TIMS, RMIS, AFIS, Memex, Sistemi i Telefonisë Digjitale VoIP, Infrastruktura e Komunikimit WAN/LAN. Janë krijuar dhe sisteme më të avancuara si Sistemi Pajon, Sistemi Arsenal, Sistemi i "Witness Protection", Sistemi i menaxhimit të informacionit kriminal "SMIK", ADAM, etj., të cilat zhvillojnë dhe shfrytëzojnë aplikacione dhe databaza lokale me interes dhe karakter kombëtar. Përgjatë punimit trajtohen mënyra të ndërtimit të sistemeve, të përdorimit të tyre, të aplikimit dhe të funksionit. Dhe në fund trajtohen strategjitë dhe perspektivat e zhvillimit të teknologjisë së informacionit në policinë e shtetit dhe aplikacione të kërkimit në drejtim të dokumentimit të veprimtarisë kriminale, së bashku me rekomandime për politikat në vazhdim.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**teknologji informacioni, informacion kriminal, dokumentim ligjor, sistem teknologjik, databazë, integrim, aplikacion.**



## 1. Hyrje

Me anë të këtij materiali synojmë të japim njohuri teorike dhe praktike për teknologjinë e informacionit, në drejtim të dokumentimit ligjor të aktivitetit kriminal mënyrat dhe praktikat e menaxhimit të informacionit kriminal, në luftën kundër krimit dhe krimit të organizuar. Ky material do të shërbejë për punonjësit në policinë e shtetit që merren me hetimin dhe parandalimin e kriminalitetit, do shërbejë si pikë referimi për praktikat që do të kryejnë në këtë shërbim, deri në aftësimin e plotë të tyre. Materiali është trajtuar në një këndvështrim teorik dhe praktik.

## 2. Historia e shërbimit të teknologjisë së informacionit në botë, Europë dhe në Shqipëri

Vitet e fundit të shekullit të 20-të, filluan që të luajnë një rol të rëndësishëm *sistemet e menaxhimit të informacionit* dhe ato të specializuara në fushën e *internetit*, duke e afruar individin dhe institucionet shtetërore me pjesën tjetër të publikut, në një mjet të fuqishëm komunikimi mbarëbotëror. Në këtë kuptim, roli i sistemeve të informacionit dhe i teknologjive të informacionit, të aplikuara në kuadrin e rrjetave telematike, u bë prioritar. Ky prioritet shprehet në mbështetjen nga ana e të gjithë vendeve në botë, për sistemet dhe teknologjitë e informacionit, duke lënë hapur pjesëmarrjen e institucioneve, të atyre të specializuara e, pse jo, edhe të individëve, duke krijuar një hapësirë të gjerë për një pjesëmarrje masive të institucioneve dhe specialistëve në zhvillimin e aplikimeve informatike, projektet e të cilëve do të jenë masive në fushën e informatikës dhe të teknologjive të informacionit.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 2.1 Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

Teknologjia e informacionit<sup>1</sup> (SI/TI) ka luajtur një rol të veçantë, të bazuar në përpjekjet e vazhdueshme për njohuri dhe zhvillime për t'ju përgjigjur sfidave të kohës, për rendin dhe sigurinë publike. Kjo teknologji informacioni dhe, më vonë, me rritjen e kapaciteteve të komunikimit “Data” mori kuptimin “Sisteme të informacionit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit” (SI/TIK), për mbledhjen, ruajtjen, gjetjen, përpunimin, analizimin, dhe transmetimin e informacionit, kanë çuar në një konvergencë, ku kufijtë për nevoja dhe shërbime të veçanta me rritjen e volumit të informacionit, për rritjen e efektivitetit në punë të strukturave të Policisë së Shtetit.

Zhvillimi i SI/TI në vendet e BE-së<sup>2</sup>, e shikon zhvillimin të lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të këtyre vendeve. Në këto zhvillime është punuar në drejtim të shtimit dhe promovimit të shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën, në përdorimin e SI/TI në edukim për të kapërcyer hendekun digjital dhe, për të aftësuar përdoruesit drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore, në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve dhe në konsolidimin e infrastrukturës digjitale.

## 2.2 Zhvillimi i bazave të dhënave

Bazat e të dhënave në këtë kohë, përbëjnë një nga kategoritë kryesore të aplikimeve informatiko-telematike. Nga ana tjetër, ato përfaqësojnë tërësinë e informacioneve të strukturuar dhe të klasifikuara - trashëgimi e njohurive të grumbulluara gjatë veprimtarisë manuale njerëzore. Fushat e aplikimit të bazave të së dhënave me interes shtetëror dhe kombëtar janë të shumta. Përmendim të dhënat demografike, shëndetësore, ekonomike, gjeografike, gjeologjike, ekologjike, dokumentare, ligjore, historike etj. Në thelb, çdo institucion publik ose jo, nuk mund të funksionojë pa u mbështetur në baza të dhënash (që për momentin mund të mbahen thjesht në letër, të futura në dosje). Rritja e konsiderueshme e të dhënave dhe ndërveprimi midis organizatave, e bënë të pashmangshëm krijimin e bazave të mirëfillta të së dhënave, duke përdorur teknologji informatike dhe duke i integruar në rrjeta telematike, për ta bërë informacionin të disponueshëm, sipas kritereve të caktuara për shoqërinë.

## 2.3 Zhvillimi teknologjive të reja

Zhvillimi i teknologjive të reja me mundësi zbatimin e sistemeve të zhvilluara të informacionit, përbënin një domosdoshmëri, që lidhet me mundësinë e nxitjes dhe mbështetjes së investimeve për zbatimin e tyre në kohën dhe vendin e përshtatshëm, duke rekomanduar në parim zgjidhjet e mundshme teknike dhe duke pasur një bazë, për thellimin e njohjes së tyre në një kohë të shkurtër, për t'i mbështetur këto zbatime.

SI/TI është pranuar gjerësisht nga vendet e BE, si një nga forcat kryesore, duke krijuar inovacion nëpërmjet teknologjisë së informacionit në proceset e digjitalizimit si: proceset ekonomike, proceset sociale, proceset institucionale dhe administrative, përmes shërbimeve<sup>3</sup> e-*Government*, identitetit digjital, thjeshtëzimit të procedurave institucionale dhe administrative, shërbimeve ndihmëse, pjesëmarrjes në vendimmarrje të qytetarëve dhe biznesit etj.

<sup>1</sup> SI/TI - Sisteme informacioni, TI: Teknologji informacioni.

<sup>2</sup> BE : Vendet e Bashkimi Europian.

<sup>3</sup> e-Government - është përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të përmirësuar aktivitetet e organizatave të sektorit publik.

## **2.4 Zhvillime të teknologjisë së informacionit në Shqipëri**

Në nëntor të vitit 2013 vendet e Europës Juglindore miratuan “Strategjinë Rajonale për Europën Juglindore”, SEE-2020. Në këtë dokument strategjik objektivat për zhvillimin e agjendës digjitale zënë vend nën dimensionin e Shoqërisë Digjitale të shtyllës “Për një rritje të zgjuar”, “smart growth”. Ky dokument që prezanton agjendën digjitale për 2014-2020, vjen në harmoni me objektivat e zhvillimeve rajonale dhe me ato të BE-së, duke u përshtatur me kushtet dhe zhvillimet konkrete të vendit. Dokumenti, pas një analize të situatës dhe zhvillimeve aktuale, përcakton vizionin dhe objektivat e zhvillimit për periudhën 2014-2020 si dhe jep drejtimet kryesore të politikave, që do të ndiqen për realizimin e këtyre objektivave.

## **2.5 Komunikimet elektronike dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit**

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm, lidhur me përafrimin e legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike me rregullat e Bashkimit Europian. Kuadri rregullator i BE-së, në lidhje me shërbimin universal, është përfshirë në<sup>4</sup> DSHU, e cila fillimisht doli në vitin 2002 dhe u rinovua në vitin 2009. Kapitulli V i Ligjit 9918 (i ndryshuar) përfshin dispozita të shërbimit universal dhe është hartuar në përputhje të plotë me dispozitat kryesore të DSHU (versionin original të 2002 dhe ndryshimet e 2009)<sup>5</sup>.

Ligji nr. 9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 është në përputhje me acquis *communautaire* më të fundit të BE-së. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 104 të saj: “Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik” përcakton se qeveria shqiptare në fushën e shoqërisë së informacionit, në përmbushje të detyrimeve, që rrjedhin nga neni 70 mbi përfarimin e legjislacionit si dhe neni 103, “Shoqëria e Informacionit”<sup>6</sup> të MSA-së, vëmendje të veçantë i ka kushtuar plotësisht të kuadrit ligjor dhe atij institucional në përputhje me standardet evropiane.

## **3. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit**

Bazat e të dhënave përbëjnë një nga kategoritë kryesore të aplikimeve informatiko-telematike. Nga ana tjetër ato përfaqësojnë tërësinë e informacioneve të strukturuar dhe të klasifikuara, trashëgimi e njohurive të grumbulluara gjatë veprimtarisë së PSH. Roli i tyre nuk është thjesht, arkivues për hir të arkivimit. Sot informacioni është bërë element i pashmangshëm dhe vendimtar në procesin e analizës dhe marrjes së vendimeve në të gjitha fushat e sektorët e Policisë së Shtetit. Një tipar karakteristik i saj, është pikërisht varësia e saj nga informacioni, tipar që sa vjen e theksohet. Sot informacioni është një mjet i rëndësishëm për realizimin e objektivave në Policinë e Shtetit.

Rritja e konsiderueshme e të dhënave dhe ndërveprimi midis sektorëve dhe organizatave, e bën të pashmangshëm krijimin e bazave të mirëfillta së të dhënave, duke përdorur: teknologjinë informatike dhe duke e integruar në rrjeta telematike, strukturim dhe standardizim së të dhënave, zhvillim të programeve aplikative për

<sup>4</sup> DSHU – Departamenti Shërbimit Universal.

<sup>5</sup> Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

<sup>6</sup> Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për shoqërinë e informacionit. Ai mbështet kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit Europian.

përpunimin e tyre, futje intensive për një kohë të shkurtër së të dhënave masive “mbushja” e bazës, administrimi i bazës së të dhënave, për garantimin e shfrytëzimit normal të saj nga përdoruesit në Policinë e Shtetit dhe sigurimi i konfidencialitetit së të dhënave.

### 3.1 TIMS (Total Information Management System).


Nisur nga fakti që informacioni që përbën bazën e të dhënave në sektorët e lartpërmendur e ka burimin në komisariate, në drejtoritë e policive vendore e në qarqe, kuptohet se, këtu ka nisur puna për grumbullimin, përpunimin dhe transferimin e tij. Ky informacion sot menaxhohet në një sistem të vetëm të quajtur<sup>7</sup> TIMS (Total Management Information).

Nga pikëpamja operative, TIMS, na siguron me shpejtësi të dhëna të besueshme, të qëndrueshme dhe të thjeshta në përdorim, për të arritur objektivat e policisë, si: parandalimin e krimit, rritjen e zbulueshmërisë së krimeve, ruajtjes së sigurisë publike etj. Nga pikëpamja administrative “TIMS” eliminon përsëritjen e punëve, duke mundësuar shfrytëzimin e informacionit të përbashkët nga departamente të ndryshme të policisë, duke i ardhur në ndihmë drejtuesve të saj, në marrjen e vendimeve të shpejta dhe efikase.

Vlera e madhe që ka informacioni, grumbullimi dhe administrimi i tij, njihet nga kushdo. Kjo vlerë rritet po të fokusohet mbi një subjekt siç është Policia e Shtetit. Në këtë aspekt, ne duhet të vlerësojmë rolin e madh që luan TIMS, e parë kjo në dy aspekte. Së pari: aspekti operativ dhe, së dyti: në aspektin administrativ. Duke pasur parasysh punën e bërë dhe analizën e sektorëve në veçanti, janë identifikuar një sërë kategorish informacioni brenda strukturës së të dhënave në TIMS, të cilat shërbejnë si bazë në analizën e informacioneve.

**Tabela 1. Zhvillimi i kapaciteteve të SI/TI dhe rekordet që përpunohen në vitet 1990-2015.**

TABELA E ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE SI/TI NË MINISTRINË E BRENDSHME 1990-2015							
Nr	Përshkrimi i SI/TI në përdorim	SHPERNDARJA SIPAS VITEVE					
		1990	1995	2000	2005	2010	2015
1	Serverët lokale/qendrore & OS sistem & procesorë të instaluar		6	14	28	45	89
2	Personal Computer (PC)	10	110	360	750	2350	4100
3	Aplikime informatike në përdorim	4	7	10	14	18	26
4	Sasia e rekordeve që ruhen & përpunohen	65000	204500	195000	407000	630500	989000
5	Përdorues & operatorë, gjithsej	15	95	200	1000	6850	10100



<sup>1</sup> TIMS - Total Management Information System.

Numri i serverëve fizikë, dy vitet e fundit është ulur ndjeshëm, sepse është futur teknologjia e virtualizimit duke eliminuar serverët fizikë, të cilët ishin tashmë të amortizuar dhe me kapacitete procesimi të ulëta për aplikacionet dhe databazat e reja. Serverët duke u mbështetur nga sisteme operimi sikurse: *Microsoft Windows Server 2003, 2008 Standart dhe Enterprise, CentOS, Linux* kanë rritur ndjeshëm menaxhimin e databazave bashkëkohore sikurse *Oracle DB server* etj.

Tabela e Rekorderve ne Përpunim																		
Nr	Vite	Shtetas te Përpunuar ne Sektorin e Kufirit				Shtetas te Përpunuar ne Sektorin e Kufirit				DEPORTI V	IRAV	Shuma Totale e Rekorderve ne Përpunim Departament ne e Kufirit dhe Migracionit	Rekorder ne Përpunim Deri ne Vitin 2001	Drejtoria e Rendit		Shërbimet e Tjera		Shuma Totale e Rekorderve ne Përpunim
		Shtetas te Përpunuar		Mjetet e përpunuar ne Hyrje Dalje		Shtetas te Përpunuar		Mjetet e përpunuar ne Hyrje Dalje						Pasaporta	Proeca Verbbat Konstatim te Shkolles (Gjoha)	Makina & Patenta	Te lidrysh me	
		Shqiptare	Te huaj	Shqiptare	Te huaj	Shqiptare	Te huaj											
								Hyre	Dalje									
1	Viti 2002	800000	1000000	350000	300000							2500000		600000	650000	100000	100000	4000000
2	Viti 2003	1259790	1348271	558055	476305							3642421		350000	432971	100000	100000	4825392
3	Viti 2004	1651316	1702066	659195	569993							4583109		550000	650000	100000	100000	5983109
3	Viti 2005	2042841	2056940	760335	663681	585359	472665	214296	185430	10142	164	6944876		600000	700000	100000	100000	8494876
4	Viti 2006	2528002	2656995	943448	854561	585359	629192	305186	272959	42345	425	8818472		650000	750000	100000	100000	10418472
5	Viti 2007	2903306	2982547	1126515	1009945	771915	771674	310305	295587	70881	430	10243105		550000	800000	100000	100000	11793105
6	Viti 2008	3097178	3176480	1419191	1273555	803813	816209	368139	338013	73773	158	11366009		450000	850000	100000	100000	12866009
1	Viti 2009	2896602	3191439	1769996	1377264	758373	793477	500377	419995	66635	671	11978731		1070788	100000	100000	100000	13249519
2	Viti 2010	2884103	3171792	2463333	2376194	797348	838149	675673	664279	54540	1812	13899223		930000	100000	100000	100000	15029223
3	Viti 2011	3765659	4133539	2932306	2644951	967654	982081	819415	803286	15279	15380	17079550		415110	100000	100000	100000	17694660
3	Viti 2012	3620665	3959265	3513666	2918185	932853	941254	923888	841422	14898	12186	17680282		825960	100000	100000	100000	18705642
4	Viti 2013	3653972	3928245	3259868	3222566	893440	910759	902863	939510	16429	12067	177359639		636890	100000	100000	100000	18572729
5	Viti 2014	3872010	4448608	3672591	3675196	910848	915617	1014902	996653	20376	12867	19239638		1173321	100000	100000	100000	20612969
6	Viti 2015	4096526	4503907	4131532	4182918	1150234	1171556	1248547	1291496	25431	16360	21821307		1312822	100000	100000	100000	23334129
7	Viti 2016	4592293	4852483	4735509	4665961	1341606	1325610	1386537	1428576	21681	21299	24372068		112934	100000	100000	100000	26701599
SHUMA		43726473	46818117	32287622	30412573	10490202	10574443	8672936	8499286	432418	93919	192894636	12000000	39500000	123267964	15000000	15000000	211283432

### 3.2 Strategjia e zhvillimit të teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit

Gjithçka është menduar të trajtohet si një projekt strategjik afatgjatë zhvillimi, për implementimin e një infrastrukture, e cila do të mbështesë projektin TIMS në të gjithë aspektet dhe veçoritë që lidhen me shfrytëzimin e informacionit në Policinë e Shtetit. Zhvillimet që përfshinin një hark kohor prej disa vjetësh, kërkuan financime me qëllim që të instalohej dhe plotësohej infrastruktura dhe teknologjitë për hedhjen dhe përpunimin e informacionit, si dhe implementimin e shërbimeve të ndryshme, krahas përmirësimit të kushteve të punës, komunikimit me telefoni dhe radio etj. Hapat zhvilluese do ishin si më poshtë:

1. Krijimi i sistemit të informacionit eficient në të gjitha fushat dhe sektorët.
2. Instalimi i infrastrukturës dhe organizimi i punës për të thithur informacionin e bazës.
3. Krijimi i infrastrukturës së komunikimit WAN/LAN midis strukturave të centralizuara të Policisë së Shtetit.
4. Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i aplikimeve në sistemet e policisë, si TIMS<sup>8</sup>, RMIS<sup>9</sup>, AFIS<sup>10</sup>, Memex dhe në sistemin e telefonisë digjitale<sup>11</sup> VoIP etj.
5. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të Policisë të cilët do të përdorin këto sisteme.
6. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit të komunikimit<sup>12</sup> DataCom.
7. Mbështetja me burime dytësore energjie gjeneratorë.
8. Mbështetja e vazhdueshme e përdoruesve nga Qendra e Shërbimeve<sup>13</sup>

<sup>8</sup> RIMS - Shërbimet e Regjistrat të Përpunimit dhe Monitorimit të Burimeve Njerëzore.

<sup>9</sup> AFIS - Sistemi i identifikimit automatik të gjurmëve të gishtave.

<sup>10</sup> Memex -software analize dhe përpunimi informacioni.

<sup>11</sup> VoIP - teknologji për shpërndarjen e komunikimeve zanore dhe sesioneve multimediale mbi rrjetet e Internet Protocol (IP), siç është Interneti.

<sup>12</sup> DataCom - Sistemi i Transmetimit së të Dhënave të Policisë së Shtetit.

<sup>13</sup> HELPDASK është një burim që synon t'i ofrojë konsumatorit ose përdoruesit përfundimtar informacion dhe mbështetje në lidhje me produktet dhe shërbimet e DTI - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, DPP - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

### 3.3 Objektivat e përgjithshme dhe synimet e teknologjisë së informacionit, në Policinë e Shtetit

Objektivat kryesore të SI/TI, konsistojnë në zhvillimin sa më të shpejtë dhe në aplikimin sa më intensiv, në fusha nga më të ndryshmet të sistemeve dhe teknologjive të informacionit, duke filluar me edukimin dhe duke vazhduar me krijimin e rrjetave informatike dhe zhvillimin e aplikimeve mbi to, për përmirësimin e vazhdueshëm të punës së Policisë së Shtetit duke zbatuar teknologji dhe sisteme të informacionit. Këto sisteme synojnë përmirësimin e menaxhimit të informacionit, rritjen e shpejtësisë dhe sigurisë së tij. Për të realizuar këto objektiva është synuar në realizimin e studimeve analizuese-projektuese, si dhe me konkretizimin e projekteve dhe financimin e tyre për zhvillimin e proceseve edukative masive, shtrirjen e rrjetit informatik, krijimin e aplikimeve e shërbimeve telematike, krijimin e bazave së të dhënave të integruara.

### 3.4 Cilësitë themelore të sistemit TIMS

Cilësitë themelore të sistemit TIMS, të sjella në mënyrë të përmblodhur janë si më poshtë:

1. Eficienca dhe efektiviteti në përdorimin e bazës së të dhënave.
2. Përdorim i informacionit për të gjitha sektorët.
3. Ndërthurje e informacionit për sektorë të ndryshëm.

### 3.5 Shërbimet e-mail

Sistemi i postës elektronike siguron një zgjidhje të plotë dhe të lehtë, të përdorshme si për dërgim dhe për marrje informacioni midis përdoruesve, duke përfshirë këtu dhe komunikimin me sistemin e-mail të jashtëm të internetit. Ndërfaqimi i postës elektronike me internetin dhe në tërësi ndërfaqimi me "mjediset" e hapura të internetit janë të kontrolluara dhe implementuara jashtë rrjetit të brendshëm të Policisë së Shtetit, si dhe kriteret e përdorimit të tyre të jenë të përcaktuara saktë.

### 3.6 Word-procesor, spreadsheet dhe aplikimet grafike

Përdorimi i trajtuesve të tekstit (word-processor) u siguron përdoruesve mundësinë e për të aplikuar standarde të njëjta në përpunimin e dokumenteve. Spreadsheet i mundëson përdoruesit të analizojnë të dhëna tabelore, të aplikojnë përpunime financiare dhe statistike. Aplikimet grafike u japin mundësi përdoruesve të krijojnë e paraqitje grafike

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare: " Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë "

STATISTIKA E PËRGJITHSHME VEPA RA PENALE TË DËMTUAR DHE AUTORE TË NGJARJEVE		KRYETAR		EJTMËSH		NË 10 VËNJË		NË 14 DËTË 10 VËNJË		BIRORË		SHKËTËS		PËRSONA TË DËMTUAR		NË KUÇI	
NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCËVE	Epitimes	Ne epitet	Epitet	Drejtues	Epitet	Epitet	Fama	Epitet	Fama	Epitet	Epitet	Epitet	Epitet	Epitet	Epitet	Epitet
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
A.	KUMBER PERSONA	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
B.	KUMBER PROJEKTE	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
C.	VEPRA PENALE QËLLIM TË KRIMORËVE	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
D.	VEPRA PENALE E KUMBERSHMIT	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
E.	LEKENDIMËS FINANCIARE	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
F.	VEPRA PENALE E TËRËSË TË TËRËSË	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
G.	VEPRA PENALE E TËRËSË TË TËRËSË	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
1.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
2.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
3.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
4.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
5.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
6.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
7.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
8.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
9.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															
10.	Komunikim elektronik	Raport SISTEMI I ADMINISTRIMIT TOTAL TE INFORMACIONIT (TIMS)															

të rezultateve të ndryshme si për përdorim lokal dhe shpërndarje nëpërmjet internetit.

### 3.7 Kërkesat për softuerin

E rëndësishme është që sistemi plotëson kërkesat, të cilat përcaktohen në analizën e strukturës së të dhënave që qarkullojnë në TIMS dhe organizmat që lidhen me të. Analiza e strukturave e të dhënave, bëhet nga secila drejtori me vete, duke plotësuar formularët e përgatitur nga DTI. Për një mbarëvajtje të punës, duhet që këto analiza të bëhen duke ju përmbajtur prioriteteve të përcaktuara në bazë të rolit dhe rëndësisë së sektorëve.

### 3.8 Zhvillimet dhe shfrytëzimi i aplikacioneve dhe i bazave së të dhënave lokale me interes dhe karakter kombëtar

Sistemi “Papilon”<sup>14</sup>, “Arsenal”<sup>15</sup>, Sistemi i “Witness Protection”<sup>16</sup> “Case Management Software” (SMD), AND-së<sup>17</sup>, zhvillime të programit “IPA 2012”, bashkëpunimi në drejtësinë penale, “Mbrojtja e dëshmitarëve në luftën kundër krimeve të rënda dhe terrorizmit” (WINPRO II) etj.

## 4. Krijimi i një sistemi bashkëkohor të inteligjencës dhe informacionit, në luftë kundër kriminalitetit dhe veçanërisht, kimit të organizuar

### 4.1 Sistemi i menaxhimit të informacionit kriminal, “SMIK”

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Kriminal (SMIK), me anë të së cilit duhet të kuptojmë grumbullimin, transmetimin dhe administrimin e të dhënave. Ai siguron përdorimin dhe përpunimin në kohë të informacionit. Programet informatike, kompjuterike që grumbullojnë, përpunojnë, transmetojnë dhe administrojnë këto të dhëna quhen programe të *inteligjencës menaxheriale* të informacionit, të cilat janë dizajnuar dhe krijuar nga kompanitë e teknologjisë së informacionit, posaçërisht për agjencitë e zbatimit të ligjit. Këto programe ofrojnë, regjistrim dhe ruajtje së të dhënave në databazat e sistemeve të informacionit, mund të ruhen jo vetëm të dhënat e regjistruara sipas formateve standarde të këtyre informacioneve, por mund të ruhen edhe dokumente/skedarë të prodhuar në aplikacionet e Windows si Microsoft Word, Excel, audio dhe video file. Karakteristikë e këtyre aplikacioneve informatike është kërkimi i fuqishëm të dhënave, përdorin një teknologji të avancuar për kërkimin e të dhënave. Kjo teknologji bazohet në sistemin e motorëve të kërkimit, të cilët në një kohë rekord gjejnë të dhënat që kërkohen. Shkëmbim informacioni është një karakteristikë tjetër e këtyre sistemeve.

Shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit, është një veprimtari e rëndësishme për të gjitha organizatat policore dhe koncepti themelor i një policimi të udhëhequr nga intelijenca e informacionit kriminal. Kjo bëhet më e rëndësishme në shpërndarjen e informacionit ndërmjet agjencive të tjera të zbatimit të ligjit. Këto programe informatike

<sup>14</sup> Papillon - Sistem i Identifikimit automatik të gjurmëve gishtave

<sup>15</sup> Arsenal - Sistemi i gjurmëve të armëve me sfond kriminal.

<sup>16</sup> Witness Protection - Sistemi i Menaxhimit të dëshmitarëve të drejtësisë.

<sup>17</sup> ADN - Sistemi i menaxhimit të identifikimit nëpërmjet ADN -së.

krijojnë lidhje midis pjesëve, apo tërësisë së informacioneve, në një database apo databasa të ndryshme duke ofruar mundësinë për të krijuar lidhje ndërmjet pjesëve të informacionit që ndodhen në databazat dhe njëkohësisht ndihmon në gjetjen e shpejtë të këtyre lidhjeve, të cilat pa ndihmën e këtyre programeve informatike, do të duhej kohë dhe do të ishte vështirë për t'i zbatuar. Siguri dhe shpejtësi të lartë për të dhënat që administrohen, informacione të ndryshme për regjistrim, konsultim dhe shpërndarje të informacionit, krijohen premisa për akses të menjëhershëm të disa përdoruesve, në nivele dhe hierarki të ndryshme dhe, mundësohet kontrolli dhe filtrimi i informacionit duke ruajtur sigurinë dhe autenticitetin e tij.

#### 4.2 Kërkimi menaxherial

Shërben për tu pozicionuar në serverin/serverët ku keni akses dhe në *databazë/entitete* e secilit nga serverët ku do të hidhen apo kërkohen të dhënat/informacionet. Fillimisht do të japim disa shpjegime në lidhje me terminologjinë e përdorur.

*Server* - është një pajisje, ku është e instaluar databaza e integruar dhe relacionale, ku nëpërmjet programeve ose grup-programesh, përdoren për të menaxhuar sisteme të ndara burimesh. Një server fizik, i shërben kompjuterëve të tjerë (që quhen klient) të cilët lidhen me të nëpërmjet rrjetit. Një server mund të jetë gjithashtu një grupim i programeve dhe të dhënave në një kompjuter, i cili mund të përmbajë serverë të tjerë logjikë.

*Database* - është një grumbullim të dhënash, të magazinuara në të njëjtin vend.

*Entity* - përcaktohet si tipi dhe formati i informacionit të mbajtur në një databazë. Në veçanti, një entitet përbëhet nga një formular (*Forms*) që përdoret për shfaqjen dhe regjistrimin e të dhënave.

*Entities*, - liston të gjithë entitete ku keni akses dhe tregon serverët që mbajnë secilën entitet. Në qoftë se kemi akses në më tepër se një server, ky proces e bën më të lehtë, për të seleksionuar të gjithë databazat e një tipi të veçantë, pavarësisht se në cilin server është magazinuar secili databazë.

*Cases* - regjistrimet që lidhen me një hetim të caktuar, ose të cilat kanë disa elementë të përbashkët.

Konfiguracioni i kërkimit menaxherial është në varësi të drejtave të regjistrimit dhe konsultimit së të dhënave; *Kërkimi menaxherial*, në menytë e kërkim-konsultimit dhe të raporteve, një specialist, i cili ka të drejtën të regjistrojë të dhëna dhe të konsultojë të gjitha të dhënat që administrohen në "SMIK".

#### 4.3 Vështrim i përgjithshëm mbi regjistrimin e të dhënave

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave është një nga proceset më të rëndësishme, të shfrytëzimit të sistemit të informacionit, për faktin se nga cilësia e regjistrimit varen në një shkallë të gjerë procese të tjera si: kërkimi i të dhënave, zbulimi i lidhjeve ndërmjet pjesëve të informacionit, cilësia e skemave, diagrameve që do të ndërtohen etj. Përpara se të trajtojmë parimet bazë të regjistrimit, do bëjmë disa shpjegime në lidhje me terminologjinë e përdorur

*Fushë* – një pjesëz e një databazë, e dizajnuar për të mbajtur një të dhënë të vetme të informacionit, p.sh., fushat mund të jenë përcaktuar për të mbajtur një përshkrim, numrin e një karte krediti, të një pasaporte, një datë, një emër etj. Kur regjistroni informacionin në një formular (formë), çdo rubrikë teksti e tij përfaqëson një fushë të ndryshme.



*Rekord* - informacioni që përfshihet në të gjitha fushat e një databaze të vetëm, p.sh., një rekord identiteti, përfshin përmbytjen e të gjithë fushave të databazës për një person të veçantë.

*NRUI* – “numri unik i identifikimit” i prodhuar për çdo rekord në sistem.

*“Forma e hedhjes së të dhënave apo e konsultimit”* - formular, fletë pune, që përdoret për të regjistruar, shfaqur dhe kërkuar të dhënat. Çdo entitet ka formularin e vet<sup>18</sup>.

#### **4.4 Parimet bazë të regjistrimit të informacionit policor**

- Zgjidhet mjedisi (aplikacioni dhe serveri), ku do të regjistrohen dhe ruhen të dhënat. Për të regjistruar informacionet e një ngjarje kriminale, zgjidhet aplikacioni informatik, kompjuterët, aksesorë të leximit dhe ruajtjes dhe transmetimit së të dhënave, serverët etj., në të cilin grumbullohen dhe administrohen të gjitha ngjarjet dhe informacionet në shkallë vendi.

- Zgjidhet *entity*<sup>19</sup>, të cilët janë databaze që mbanë të dhëna të një tipi dhe formati të caktuar. Fillimisht zgjidhet njëra nga entitetet “*Ngjarja*” ose “*Informacione*” (në rast se do të regjistrohi një ngjarje, zgjidhet “*Ngjarja*”). Pasi regjistrohet ngjarje/informacion, të dhënat e përshkruara në to, hidhen në mënyrë më të detajuar në *entities/databazet*: “*Identitet*”, “*Automjet*”, “*Pronë*”, “*Adresa*” etj., duke krijuar rekorde të identitetit, automjet, telefon, pronë, adresë etj., të cilat quhen rekorde të mbështetura (*Substantiated /arsyetim record*), pasi ato mbështeten në të dhënat që përmbajnë rekordet informacion/ngjarje.

Për të regjistruar të dhënat në mënyrë më të shpejtë dhe për ti ruajtur ato në databaze, përdoren *Formularët*. (Format e hedhjes dhe regjistrimit, kërkimit dhe konsultimit së të dhënave).

Çdo aplikacion që ndërvepron me një databazë ka formularin e tij, i cili shërben për regjistrimin, shfaqjen dhe kërkimin e rekordeve, p.sh., databazë *Ngjarja* - ka formularin “Raportimi i ngjarjes kriminale”; databazë *Informacioni* - ka formën apo formularin “Për informacionin Policor”, e kështu me radhë formularët, format “*Identiteti*”, “*Adresa*”, “*Pasuria*”, “*Telefon*”, “*Makina*” etj.

- *Formularët* (format), janë të përbërë nga disa fusha, (rubrika), ku lehtësisht dallojmë rubrikat “*Çelës*” sikurse; (NRUI, nr. unik i identifikimit, operatori, data dhe ora e krijimit), janë fusha të cilat i gjeneron vetë aplikacioni dhe nuk kanë nevojë për plotësim. Ndërsa rubrikat, *fushat me ngjyrë*, p.sh., (të dallueshme nga përdoruesit) detyrimisht duhet të plotësohen, programi nuk lejon ruajtjen e regjistrimit nëse ju nuk keni plotësuar këto fusha. Ndërsa në fushat me ngjyrë ndryshe nga të parat, të cilat edhe nëse nuk plotësohen, programi lejon ruajtjen e regjistrimit.

-Plotësimi i fushave të *formularit të informacionit policor*, plotësimi i këtyre fushave të këtij formulari (rekordeve) do bëhet duke u mbështetur nga specialistët e strukturave të hetimit në drejtoritë e policive vendore, në qarqe dhe në komisariate.

- Në rubrikën (fusha) *Data e marrjes*, shënohet data kur është marrë informacioni,

<sup>18</sup> Form - Formular, fletë pune, që përdoret për të regjistruar, shfaqur dhe kërkuar të dhënat. Çdo entitet ka formularin e saj.

Forms limit - Maksimumi i numrit të formularëve, të një entitie/database të veçante, që mund të hapen në të njëjtën kohë.

<sup>19</sup> Entity - Përkufizim në lidhje me tipin dhe formatin e informacionit që mbahet në një databazë. database/entity, shpeshherë këmbëhen me njëri-tjetrin, pasi nënkuptojnë të njëjtën gjë në aplikacionet e inteligjencës. Entity Management - Shërben për menaxhimin, modifikimin dhe mirëmbajtjen e databazeve, entiteteve dhe formularëve të programit të inteligjencës.

protokollimit të shkresës në sekretaritë e DVPQ. Kjo datë nuk duhet ngatërruar me datën e regjistrimit të formularit, pasi datën, orën e krijimit dhe emrin e personit që plotëson formularin, aplikacioni i krijon automatikisht dhe janë të njëjta me ato të sistemit. Nr. I regjistrit që ka marrë informacioni në regjistrin që korrespondon, me numrin e regjistrit të protokollit që ka marrë informacioni në sekretaritë e DVPQ.

- *Emri, Mbiemri*, - shtypet emri i specialistit që ka plotësuar formularin dhe që është pronar i informacionit. Shtypet emri i specialistit që ka marrë për ndjekje dhe do të regjistrojë informacionin shkresor.

- *Drejtoria, sektori, seksioni, zyra etj.*, - në këtë fushë, shënohet emri i drejtorisë të DVPQ, pjesë përbërëse e së cilës është specialisti që ka marrë dhe do të regjistrojë informacionin shkresor; specialisti raportues është pjesë përbërëse e sektorit të Krimin të Organizuar në DVPQ. Rubrika *sektori* do të marrë automatikisht emërtimin “Krimi i Organizuar”, seksioni apo zyra që regjistron informacionin në varësi të strukturës funksionale organike.

- *Drejtimi* - shënohet drejtimi që mbulon specialisti raportues në DPQ, ose drejtimi që mbulon specialisti.

- *Burimi i informacionit* – plotësohet një listë me zgjedhje të burimeve të informacionit.

- *Vlerësimi* - për vlerësimin e informacionit aplikohet sistemi i vlerësimit me kodet. Janë përcaktuar fusha të ndryshme dhe të veçanta të vlerësimit; vlerësimi i burimit të informacionit të përpunuar (*vlerësimi i burimit* – “Source”); vlerësimi i vetë informacionit të përpunuar (*vlerësimi i informacionit* – “Intelligence”), trajtimi i informacionit të përpunuar (*vlerësimi për shpërndarjen* – “Handling”).

Secila nga këto rubrika ka rëndësinë e saj në vlerësimin e dokumentimit, të cilat janë të detyrueshme për tu plotësuar nga përdoruesit sikurse edhe vlerësimi i burimit, vlerësimi i informacionit, vlerësimi për shpërndarjen sikurse shpërndarja në agjenci të tjera të zbatimit të ligjit, shpërndarja agjencive të zbatimit të ligjit brenda Shqipërisë, shpërndarja vetëm brenda strukturave të Policisë së Shtetit.

## AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

- *Përshkrimi i plotë i informacionit* - përshkruhet i plotë i gjithë informacioni. Për plotësimin e kësaj fushe, duhet t'i përmbaheni rigorozisht rregullave mbi “Mënyrën e plotësimit dhe regjistrimit në SMIK”, të formularëve.

- “Risk Assessment”, *vlerësimi i rrezikut*, - nëse duhet të krijoni një rekord për “vlerësimin e rrezikut”. Ky mesazh shfaqet gjithmonë kur kërkohet të ruhet një ngjarje, një informacion si dhe në procesin e shpërndarjes. Vlerësimi i rrezikut është krijuar, për të siguruar që praktikat e punës në lidhje me grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave, janë në përputhje me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe me kodet e praktikës, për shkëmbimin e informacionit.

#### 4.5- Regjistrimi i ngjarjes, “Raportimi i ngjarjes kriminale”

Për të regjistruar një ngjarje, do të ndiqet e njëjta procedurë si te regjistrimi i informacionit policor; te formulari “Raportimi i ngjarjes kriminale”, plotësohen fushat përbërëse të këtij formulari, ruhet në databazë; në këtë rast, formulari i ngjarjes përbëhet nga disa fletë pune: “Raportimi i ngjarjes” dhe “Përshkrimi i ngjarjes”.

##### a. Plotësimi i fushave të formularit “Raportimi i ngjarjes kriminale”.

Plotësimi i fushave të formularit bëhet vetëm mbi bazën e formularëve, data e plotësimit, data e referimit të veprës penale në prokurori, nr. Protokollit - shënohet numri i protokollit që merr shkresa përcjellëse në komisarati apo drejtorinë e policisë së qarkut, - e cila shoqëron materialet referuese, emri i specialistit raportues; shënohet emri i punonjësit që plotëson formularin, mbiemri i specialistit raportues; drejtorja - shënohet emri i drejtorisë që disponon të dhënën dhe ndjek problemin; komisarati – kjo fushë do të plotësohet për rastet kur specialisti raportues, është pjesë përbërëse e komisarimit të policisë që disponon të dhënën. Zgjidhet sektori që disponon të dhënën dhe ndjek problemin, drejtimi, neni i Kodit Penal, zgjidhet neni i Kodit Penal që parashikon veprën penale, vlerësimi. Kjo rubrikë duhet të plotësohet me kodet e vlerësimit. Burimi i informacionit - kjo fushë do të plotësohet gjithmonë “Policia”, sepse njoftimin për ngjarjen e jep policia. Data e fillimit, ora e fillimit, data e mbarimit, ora e mbarimit, përshkrimi i ngjarjes – në këtë fushë do të përshkruhet në mënyrë të plotë referimi që shoqëron materialet, në lidhje me ngjarjen kriminale, kur ato përcillen në prokurori. Rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet përshkrimit të mekanizmit të kryerjes së kriminit. Provat e gjetura në vendngjarje - në këtë rubrikë do të shënohen me detaje të gjitha provat që gjenden në vendngjarje dhe/ose kanë lidhje me ngjarjen. Ruajtja e regjistrimit - pasi janë plotësuar të gjitha fushat e formularit, bëhet regjistrimi i të dhënave në databazë.

##### b. Regjistrimi i rekordeve mbështetëse (identitet, automjet, telefon, pronë, adresë etj.)

Rekordet “informacion” dhe “ngjarje” quhen rekorde mbështetëse (“substantiating record”) dhe janë emërtuar si burimi, origjina e të dhënave të rekordeve identitet, automjet, telefon, pronë, adresë etj., pasi mbi bazën e të dhënave që përmbajnë këto rekorde, krijohen rekordet identitet, automjet, pronë, telefon, adresë. Këto të fundit emërtohen “substantiated record” - rekorde të mbështetura dhe përmbajnë të dhëna të detajuara për persona, automjete, prona, adresa etj.

Gjeneralitetet   Te tjera   Përshkrimi Fizik   Shenja te veçanta   Punësimet   Arsini   Precedentet Penale   Lidhjet


Për të shfaqur në ekran nënformularin që do plotësoni, mjafton të pozicionoheni në rubrikën përkatës, p.sh në se do të plotësoni punësimet e personit, pozicionohemi në rubrikën “Punësimet”. Personat që regjistrohen në databazë duhet të jenë persona me identitet të saktë, d.m.th. të ketë të njohura katër të dhëna: emri, mbiemri, atësia dhe datëlindja. Nëse mungon njëra nga të dhënat e mësipërme, personi nuk mund të regjistrohet. Kjo është edhe arsyeja pse është e detyrueshme, që në formularin e ngjarjes apo informacionit, të shënohen sa më shumë të dhëna të vlefshme (p.sh. *alias*, nofka, targa automjeti, numra telefonikë e gjithçka tjetër që njihet për këtë person) pasi ato do

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

të shërbejnë për identifikimin e mëvonshëm të personit.



### c. Nënformulari “Gjeneralitetet e personit”

Disa nga nënformularët e identitetit dhe konkretisht nënformularët: “Të tjera”, “Shenja të veçanta”, “Punësimet”, “Arsimi” dhe “Precedentët penalë”, në përbërjen e tyre plotësohen disa fusha, për të cilat lind nevoja e më shumë se një regjistrimi, p.sh. një person mund të ketë më shumë se një shtetësi, diploma, precedentë penalë etj.; është person i dhunshëm, nevrrik, me kombësi shqiptare, shtetësi shqiptare dhe gjermane. Këto të dhëna do të plotësohen në nënformularin “Të tjera”.

### d. Regjistrimi automjeteve

Automjetet regjistrohen në formularin “Makinat”, i cili përbëhet vetëm nga një fletë pune dhe përmban të dhëna në lidhje me tipin e automjetit, markën e prodhimit, targën apo numrin e shasisë etj. Ky formular ka vetëm një fushë të detyrueshme për tu plotësuar, fushën “Targa”. Për regjistrimin e telefonave, vepohet si në rastin e regjistrimit të automjeteve dhe identiteteve.

### e. Regjistrimi i pronave, adresave etj.


Këto rekorde kërkojnë zgjedhjen e serverit ku do të kërkohen, konsultohen dhe në varësi se ku janë regjistruar të dhënat. Kjo, për faktin një person mund të jetojë, të ketë prona dhe zhvillojë aktivitetin kryesisht në një qytet, por njëkohësisht të ketë prona, pasuri dhe në qytete të tjera.

## 5. Realizimi i hetimeve proaktive dhe marrja e vendimeve, mbështetur te rezultatet e produkteve të inteligjencës së informacionit dhe analizës


### 5.1 Mmenaxhimi i inteligjencës kriminale dhe analizës së informacionit kriminal

Për menaxhimin e inteligjencës kriminale dhe analizën e informacionit kriminal, ka ndërfaqe grafike të përparuara, që bëjnë të mundur lidhjen midis personave, ngjarjeve kriminale dhe entiteteve të tjera të ruajtuara në databaza dhe aplikacione inteligjente të përpunimit, që mundësojnë menaxhimin e situatës, zbulimin ose parandalimin e ngjarjeve

kriminale ose identifikimin e personave të implikuar në to sipas skemës sintetike:



Kërkime në portalin TIMS; Regjistri i Gjendjes Civile NCR, hyrje-dalje në vendkalimet kufitare, raporte statistika, E-gjoba, ADAM, ZSHQ (Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve), komunikata ditore, menaxhimi i çështjes, informacione dhe urime të hapura, të ndryshme, etj.




### 5.2 Aplikacionet e përpunimit inteligjent të informacionit

Nëpërmjet këtyre aplikacioneve të përpunimit inteligjent të informacionit arrihet transmetim *on-line* të dhënash, sistem i certifikuar për menaxhimin e informacionit të klasifikuar, aksesimi sipas parimit “nevojë për njohje” standardizimi i mbledhjes, regjistrimit, kërkimit dhe përpunimit të informacionit, funksionimi standardizuar nga një paketë aktesh normative dhe ligjore, nga informacione të grumbulluara nga të gjitha strukturat e vendit.


### 5.3 Kërkimi në ADAM

Menaxhimi i të dhënave të regjistruara për personat e shoqëruar, ndaluar, arrestuar, raportet e kërkimit në ADAM, të dhënat e personit, vendi i shoqërimit / ndalim / arrestimit, informacion mbi ndalim / arrestimin, urdhër-arresti/ndalimi, sekuestrimet dhe provat, informacione të përgjithshme, numër telefoni, identitete të tjera (emra të ndryshuar, gjurmë gishtash, ADN-je, etj.




**5.4 Raporti i ngjarjes, informacione për, hyrje-daljet, kërkime për shtetas shqiptarë dhe të huaj të regjistruar në pikat e kalimit kufitar sipas:**

Numrit personal, emër, atësi, mbiemër, datëlindje vendlindje, qyteti i lindjes; rezultati i kërkimit; raporte statistika; rezultati i kërkimit në *raporte e statistika*, kërkim i njëkohshëm në disa “DataBase” të Policisë së Shtetit, identitete, pasaporta biometrike dhe dokumente identiteti të viteve të shkuara, letërnjoftimet elektronike, E-gjoba, leje drejtimi, aplikime në Zyrat e Shërbimit ndaj Qytetarëve, komunikata ditore. Fushat e kërkimit në E-gjoba, kërkime sipas mjetit, kërkime sipas personit, kërkime të detajuara për mjetin, kërkim i mjetit sipas pronarit, historiku i mjetit, baza të tjera të dhënash; media (burimet e hapura), eksportohen në *Excel*.



**5.5 Përpunimi i të dhënave,përftuar nga databaset përpunohen në i2 Analyst's Notebook <sup>20</sup>**



**AKADEMIA E SIGURISË**

Konferencë shkencore ndërkombëtare:  
 « Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë »

## **5.6 Qëllimi “Përpunimi inteligjent i informacionit”<sup>21</sup> (aplikacion për përpunimin e të dhënave)**

Fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve të përpunimit inteligjent të informacionit, përbën një domosdoshmëri përballë sfidave ndaj rendit dhe sigurisë publike dhe sidomos veprimtarive të organizuara kriminale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Udhëheqja nga intelijenca e veprimtarisë së strukturave të policisë gjyqësore në tërësi, dhe asaj kriminale në veçanti, përbën një model modern policimi, të karakterizuar nga një qasje proaktive hetimore dhe rezultate efikase.

Aplikimi me sukses i shërbimeve të përpunimit inteligjent të informacionit, është si një domosdoshmëri për konsultimin e informacioneve dhe dokumenteve që lidhen me të dhënat e individëve, në një aplikacion të vetëm.

Njëherësh për realizimin e detyrimeve të *Prioritetit Nr. 4, të BE*, “Përmirësimi i shkëmbimit së të dhënave mes agjencive të zbatimit të ligjit për luftën kundër krimit të organizuar, nëpërmjet hedhjes së hapave të para të ndërtimit të një platforme të sigurt për shkëmbimin e këtyre të dhënave”, të marrjes së masave për shkëmbimin e ndërsjellët të informacionit nga strukturat dhe agjencitë e interesuara, vlen të përmendet përdorimi i *web servise-ve* (mënyrë shkëmbimi informacioni), thellimi dhe zgjerimi i shkëmbimit të informacionit nëpërmjet akt-marrëveshjeve dypalëshe me organizatat shtetërore dhe joshtetërore, me qëllim shkurtimin në maksimum të procedurave burokratike, duke garantuar shkëmbimin e shpejtë të informacionit me këto institucione.

## **5.7 Modulet e sistemit “Përpunimit inteligjent të informacionit”**

### **5.7.1 Databaza e të dhënave**

Databaza “Përpunimit inteligjent i informacionit”, është unike dhe specifike. Ngjashmëri kanë tabelat dhe struktura e tyre, por formati është i ndryshëm. Informacioni tek “Përpunimi inteligjent i informacionit” është më i plotë. Informacioni në to, është unik vetëm për “Përpunimin inteligjent të informacionit”. Tabelat e tjera, janë për qëllime auditimi, tabela ndihmëse për “Përpunimin inteligjent të informacionit”

### **5.7.2. Shërbimet (“WebService”)<sup>22</sup>**

Moduli i komunikimit dhe ndërveprimit të konsultimit të informacionit në “Përpunimin inteligjent të informacionit” me sistemet e tjera, bëhet nëpërmjet *Web Service-ve*. Çdo sistem që kërkon të komunikojë për të dhëna me “Përpunimin inteligjent të informacionit”, duhet patjetër që të ndërtojë një klient të *Web Service-it*. Në këtë mënyrë, evitohet lidhja direkt e aplikacioneve të tjera me databazën e përpunimit inteligjent të informacionit, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë dhe një auditimin më të mirë. *Web Service-t* instalohen dhe komunikojnë nëpërmjet serverit në “Përpunimin inteligjent të informacionit”.

<sup>20</sup> i2 Analyst’s Notebook – Paketë programesh analizë dhe përpunimi informacioni.

<sup>21</sup> Përpunimi inteligjent i informacionit - Aplikacion informatik paketë programesh të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave.

<sup>22</sup> Web Service – Ndërfaqe komunikimi midis dy sistemeve, duke komunikuar me njëri-tjetrin nëpërmjet një pakete programesh ndërfaqës të organizuara në formën e World Wide Web.

### 5.7.3. Moduli kërkimit

Ndërfaqet e konsultimit janë unike dhe të vetme, të ndërtuara enkas për konsultimin e këtyre tabelave për “Përpunimin inteligjent të informacionit”, sipas kërkesave të policisë kriminale, Njësisë së Antiterrorit dhe Krimin të Organizuar, për të pasur të gjitha modulet e konsultimit në një aplikacion të vetëm, me qëllim shkurtimin në maksimum të procedurave burokratike. Moduli i kërkimit në “Përpunimin inteligjent të informacionit”, kompletton dhe zgjidh më së miri kërkesën e informacionit për dokumentet e individit (personit), strukturat e Policisë së Shtetit dhe në veçanti ato të krimin, krimin të organizuar, hetimit, analizës kriminale etj., të cilat e shfrytëzojnë me interes dhe sukses atë.

## 6. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale, i strukturave inteligjente të policisë, në analizimin dhe shpërndarjen e informacionit

Krijimi i një sistemi bashkëkohor të inteligjencës dhe informacionit në luftë kundër kriminalitetit dhe veçanërisht krimin të organizuar, realizimin të hetimeve proaktive dhe marrjen e vendimeve nga struktura të policisë mbështetur mbi rezultatet e produkteve të përpunimit inteligjent të informacionit dhe analizës, fuqizimin e kapaciteteve profesionale teknike dhe logjistike të strukturave inteligjente të policisë, forcimin e bashkëpunimit në analizimin dhe shpërndarjen e informacionit.

### 6.1 Kërkimi i të dhënave

Efektiviteti i një baze informacioni, qëndron në faktin se sa shpejt dhe lehtë, përdoruesit mund të gjejnë dhe rigjejnë informacione specifike, që ata kanë nevojë. Inteligenca menaxheriale ofron disa mënyra kërkimi të informacionit, lejon që të bëjmë kërkime dhe të gjejmë informacionin e dëshiruar. Mund të kërkojmë për një frazë, fjalë ose numër, në secilën prej bazave të dhënave, ose në të gjitha bazat e të dhënave, në të cilat kemi të drejta. Përpara çdo kërkimi, duhet të selektojmë (përzgjedhim) bazën e të dhënave në të cilën do të kërkojmë informacionin që duam. Mund të përzgjedhim një ose disa baza të dhënash në të njëjtën kohë. N.q.s nuk përzgjedhim një database, do të thotë se kërkimi juaj nuk ka një pikë referimi.

- Kërkimi me *free-text* (tekst të lirë)<sup>23</sup> - ky lloj kërkimi është rruga më e lehtë për të gjetur një të dhënë në një bazë të dhënash. Kur ju kërkoni me *free-text*, motori i kërkimit kërkon në të gjitha fushat e bazës së të dhënave që ju keni selektuar (përzgjedhur), për fjalën apo numrin që ju doni të gjeni. Kjo është një mënyrë e mirë kërkimi për të gjetur të dhëna kur ju nuk jeni të sigurt, se në cilën fushë të bazës së të dhënave ndodhet ky informacion.

- Nëse ju kërkoni me fjalëkyçin “drogë”, pas disa momentesh sistemi gjen një listë me të gjitha raportet që përmbajnë fjalën që kërkoni, “drogë”, dhe në ekran ju shfaqet në formën e një raporti, regjistrimi i parë në listë, fjala për të cilën ju keni kërkuar është e ngjyrosur, e dallueshme. Mbani parasysh, se kur të kërkoni me fraza, përdorni thonjëzat “ ”, p.sh. nëse kërkoni “vjedhje me armë”, kërkoni për të dhëna që përmbajnë vetëm

<sup>23</sup> Free-text search - Kërkimi me tekst të lirë, aplikacioni kërkon në të gjitha fushat e bazës së të dhënave që keni selektuar.



frazën *vjedhje me armë*, ndërsa kur nuk i përdorni thonjëzat sistemi kërkon për të gjitha të dhënat që përmbajnë fjalët *vjedhje, me dhe armë*.



## 6.2 Shenjat që mund të përdoren në kërkim

- “?” (*pikëpyetje*) - përdorimi i të cilës bëhet kur ju nuk jeni të sigurt për një emër fjalë apo numër (targë makine) që do të kërkoni. Kur përdorni këtë shenjë, aplikacioni do të kërkojë për fjalë/numra të cilave u mungon një karakter. Kjo shenjë përdoret në fillim, në mes apo në fund, në varësi të kërkimit që do të bëni ju.

- \* (ylli) - edhe kjo shenjë përdoret për kërkime (si shenja e mësipërme), kur ju nuk jeni të sigurt për një emër fjalë apo numër (targë makine) që do të kërkoni. Kur përdorni këtë shenjë, aplikacioni do të kërkojë për fjalë/numra të cilave u mungon më shumë se një karakter. Po kështu, edhe kjo shenjë mund të përdoret në fillim, në mes edhe në fund të fjalës/numrit që kërkoni.

- Kërkimi me këto shenja, bëhet i kombinuar dhe me lloje të tjera kërkimi, gjithashtu ato mund të përdoren edhe në kërkime në fusha. Në disa raste gjatë kërkimit mund të ndodhë që gjenden shumë rekorde. Në këto raste, ju mund ta specifikoni më tej pyetjen, ose të bëni një përzgjedhje më konkrete të databazave.

- Kërkimi në “Search Intelligence Database”<sup>24</sup> (duke përdorur *Query* analitike<sup>25</sup>) - në kërkimin inteligjent në databazë, do t’ju lindë nevoja për kërkime më të komplikuar, dhe ky sistem ju lejon juve, që të ndërtoni pyetje më komplekse për kërkimin e informacionit në bazën e të dhënave (“Search Intelligence Database”). Kjo mënyrë kërkimi, lejon që të kërkojmë me terma dhe të specifikojmë detajet nëpërmjet attributeve që ofron menyja dialoguese “Search Intelligence Database”.

- Atributi “Proximity”<sup>26</sup>, - ky atribut shërben për të kërkuar për fjalë, të cilat nuk janë menjëherë mbas njëra-tjetrës në një regjistrim. “Search Intelligence” vendos automatikisht vlerën e përafërsisë në kërkim, %2, por ju mund ta ndryshoni atë në varësi të interesit tuaj, p.sh., nëse ju këtë vlerë e ndryshoni nga %2 në %4, kjo do të thotë se sistemi do të gjejë regjistrime që përmbajnë fjalët “trafik” dhe “drogë” me 4 fjalë, largësi mes tyre, p.sh. “Trafik armësh dhe drogë”. Ju mund t’i kërkoni, që fjalët e gjetura në regjistrime t’i shfaqë në renditje të rregullt, p.sh nga “drogë trafik” në “trafik drogë”. Kjo realizohet duke shtuar shenjen (:) përpara %, p.sh (*drogë trafik*):%2 trafik.

- Atributi *M from N* (M nga N) - në këtë rast ju do të krijoni një pyetje që të mund të gjeni një numër sa më të vogël fjalësh nga një grup më i madh. Për të realizuar këtë do të përdorni atributin *M nga N*, fillimisht sigurohuni që të jenë të selektuara të gjitha databazet në panelin e “search intelligence”, shfaqni në ekran dritaren dialoguese “Search Intelligence Database”, shkruani disa fjalë që ju mendoni se gjenden nëpër regjistrime të databasave, p.sh. drogë armë, person, trafik, selektojini dhe zgjidhni *M From N*.

<sup>24</sup> Search Intelligence Database - Një dritare që zakonisht vendoset në anën e majtë të ekranit dhe shërben për tu pozicionuar në serverin / serverët ku keni akses dhe database/entitete e secilit nga serverët ku regjistrohen dhe kërkohen të dhënat.

<sup>25</sup> Query - Fjalë të shkruara brenda një kutie teksti të kërkimit. Një “query” mund të jetë një fjalë e vetme ose një bashkim fjalësh. Query Build - Modul i Inteligjencës së kërkimit, përdoret për të gjeneruar fjalë që mund të jenë përfshirë në një pyetësor.

<sup>26</sup> Proximity – Është një funksion i modulit të kërkimit, në të dhënat e një databaze.

- Atributi “Garbled”<sup>27</sup>, kur ju do të përdorni këtë atribut për kërkim, sistemi do të kërkojë për regjistrime që përmbajnë fjalë të veçanta ose që janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Kjo do të thotë që sistemi do të kapë fjalë të cilat kanë mënyra të ndryshme shqiptimi, ose kanë gabime drejtshkrimore, p.sh kur ju kërkoni me këtë atribut për fjalën droge, atëherë sistemi do të gjejë dhe regjistrime që mund të jene shkruar dorge, drage ose droeg.

- Atributi “And”<sup>28</sup> - e njohur si “And” (dhe). N.q.s përdorni këtë pyetësor, atëherë “Search Intelligence Database”, kërkon për çdo rekord, që përmban të dyja fjalët, që gjenden menjëherë para & dhe pas saj. Në dritaren e “Search Intelligence Databases”, shtypni një fjalë për të cilën interesoheni, zgjidhni “And” dhe vazhdoni të shtypni fjalën tjetër që kërkoni, zgjidhni *search* dhe prisni për kërkimin.

- Atributi “or” - njihet si “or” (ose). N.q.s. përdorni këtë pyetësor atëherë gjeni çdo rekord që përmban ose vetëm njërën nga fjalët para, apo pas pyetësorit, ose mund të përmbaje të dyja fjalët bashkë. Shkruani një fjalë që doni të kërkoni, zgjidhni atributin “or”, shtypni fjalën tjetër kyçe, zgjidhni *search*.

- Atributi “not” - njihet si “not” (jo). Me anë të këtij atributi do të mund të kërkoni për rekorde që përmbajnë fjalën për të cilën interesoheni, menjëherë pas shenjës “!”, kështu në rast se jeni duke kërkuar për një makinë me ngjyrë blu, atëherë ju do t’ju duhet të shmangni makinat me ngjyra të tjera, të cilat nuk ju interesojnë, p.sh. të kuqe, shtypni në dritaren e kërkimit fjalën e parë që doni të kërkoni, p.sh., blu, zgjidhni “not”, shtypni fjalën tjetër që doni të shmangni, zgjidhni *search*.

- Atributi “?” (pikëpyetje) - këtë atribut mund ta përdorni në kërkimin tuaj në rastet kur në fjalën/numrin që kërkoni, mungon ndonjë karakter, i cili nuk ju kujtohet për momentin, sidomos kjo në raste të numrave të telefonit apo targave të makinave, ose një fenomen që ndodh shpesh me mbiemrat në Shqipëri p.sh. “Hoxha – Hoxhaj”. Ky atribut përdoret në çdo pjesë të fjalës/numrit, në fillim, në mes, apo në fund, në dritaren e kërkimit shtypni fjalën/numrin që doni, në rastin e një numri telefoni, kur nuk jeni të sigurt për një numër p.sh. 06.2340643, kur kërkoni për një targë makine dhe nuk mbani mend p.sh. shkronjën e fundit të saj, në rast se doni të kërkoni për një emër e nuk jeni të sigurt për ndonjë nga karakteret (shkronjat) e tij atëherë:

- Atributi “Brackets” - kërkimi me *free text*, në *forms*-et aplikacioneve (“Search Intelligence Database” një listë me atributet e kërkimit *proximity*, *brackets*, *and*, *or*, *not* dhe “?”).

- Kërkimi i bazuar në fusha, - në ato raste kur ju e dini se në cilën fushë ndodhet e dhëna për të cilën ju kërkoni, atëherë ju mund të përdorni kërkimin e bazuar në fushë. Kur ju kërkoni me këtë metodë, specifikoni të dhënat si dhe fushën në të cilën mund të shfaqen ato.

- Kërkim me bazë fushë, duke kërkuar në më shumë se një fushë në të njëjtën kohë, Në këtë mënyrë do të kërkoni për të dhëna, por duke shtuar një tjetër fushë kërkimi.

- Kërkimi për një rekord, duke përdorur NRUI,<sup>29</sup> - kërkimi me i shpejtë për të gjetur një rekord specifik është të kërkosh nëpërmjet “Numrit unik të identifikimit” NRUI (Unique Identification Number).

<sup>27</sup> Garbled expansion - Është një funksion i modulit të Kërkimit, me ane të cilit sistemi do të kërkojë për regjistrime që përmbajnë fjalë të veçanta ose që janë të ngjashme me njëra-tjetrën.

<sup>28</sup> Boolean expression - Një kombinim i termave se pyetjes, që përdor operatorët logjike (&, |, # and !) ose operatorët (<, >, =, <=, >=) për të bërë krahasimin dhe për të gjetur përgjigje të vërteta ose false.

<sup>29</sup> NRUI -Numri unik i identifikimit i prodhuar për çdo rekord në një sistem.

### 6.3 Azhurnimi i të dhënave dhe shtimi, bashkëngjitja e rekordeve

- *Azhurnimi i rekordeve*, - të dhënat e regjistruara, të cilat ruhen dhe administrohen në databazë, mund të azhurnohen kur lind domosdoshmërisht nevoja për azhurnim. Me anë të këtij procesi, krijojmë mundësinë e regjistrimit së të dhënave shtesë, ose korrigjimin e ndonjë të dhëne nëse është shtypur gabim në rekordet e ngjarjeve dhe informacioneve.

- Për të shtuar të dhëna për rekordin, kërkoni në databazë rekordin “Hapet formulari i rekordit”, hapni informacionin ose ngjarjen mbi të bazën e të cilit është krijuar ky rekord, aktivizojmë *source* (burim) të informacionit, shfaqim në ekran formularin e rekordit dhe plotësojmë të dhënat shtesë, (nëse keni bërë gabime, mund t’i korrigjoni ato), ruani ndryshimet duke i dhënë *Update-Azhurno*. Kujdes nuk mund të ndryshohen rubrikat çelës të rekordeve të regjistrimit sikurse NRUI, “Data e regjistrimit në sistem”, përdoruesi që ka krijuar formularin etj.

- Korrigjimi i të dhënave, - kur keni regjistruar e ruajtur një rekord dhe konstatooni se keni shtypur gabim një nga të dhënat, për korrigjimin e tyre do procedoni gati njësoj si në shembullin e mësipërm.

- Bashkëngjitja dhe mbajtja në *link* e skedarëve, - në rekordet e databazave ju mund të bashkëngjitni skedarë/dokumente, vendndodhja e të cilëve është jashtë sistemit. Këto skedarë të cilët ndodhen në *Windows, Microsoft Office* etj., mund t’ia bashkëngjitni rekordeve të ndryshme të databazës, duke i ruajtur në server, ose mund t’i mbani në *link*, (lidhje). Kur ju bashkëngjitni një skedar në rekordet e databazës, programi e ruan atë në server. Nëse më vonë, ju bëni ndryshime në dokument (në dokumentin origjinë), këto ndryshime nuk do të pasqyrohen në dokumentin bashkëngjitur rekordit. Ndërsa kur mbani në lidhje, një dokument, ndryshimet në përmbajtjen e dokumentit bashkëngjitur rekordit do të azhurnohen sa herë që bëni ndryshime në dokumentin e origjinës. Nëse mbani një dokument në *link* gjithmonë shfaqet versioni aktual i dokumentit. Kur bashkëngjitni dokumentin në një rekord, nëse dëshironi këtë dokument, mund ta bëni të kërkueshëm nga databaza, ndërsa kjo nuk ndodh nëse mbani në *link* dokumentin. Në rast se fshini, i jepni emër të ri ose lëvizni dokumentin nga vendndodhja e origjinës, mbajtja në *link* e dokumentit nuk do të funksionojë më.

- Bashkëngjitja e një skedari, për rekorde të databazës, - ju mund të keni materiale të tjera, si fotografi, informacione etj., por këto materiale ju i keni të skeduar në *Word, Excel* etj. Databaza krijon mundësinë që këto materiale t’ia bashkëngjitni rekordeve të tij.

- Mbajtja në *link* e një skedari (“Add File Link”), bashkëngjitja e skedarëve duke i mbajtur në *link*, është proces i ngjashëm me shtimin, bashkëngjitjen e skedarëve. Për të mbajtur në *link* skedarët, zgjidhni “Record<sup>30</sup>-Add File Link-Add File to a Link”, dritarja dialoguese “Attachement”, duke tërhequr një skedar brenda një rekordi të databazës. “Add File to e Link” funksionon nga menyuja *Rekord* dhe nga dritarja dialoguese “Attachement”.

- Shtimi i lidhjeve *Web* tek rekordet, Për të mbajtur një rekord në *link* me një faqe të *Web*-it, - ju mund të lidhni një faqe *Web* në një rekord, në disa mënyra: nga komandat Record, “Add File Link”, “Add File Link to a Web Document”, nga dritarja dialoguese “Attachments”. Duke u pozicionuar në faqen *Web*, dhe duke e vendosur atë brenda në

<sup>30</sup> Record - Informacioni që përfshihet në gjitha fushat e një databazë të vetëm, p.sh një rekord Identiteti, përfshin përmbajtjen e të gjithë fushave të databazës “Identiteti” për një person të veçantë.

fletën e hapur të rekordit.

- Shtimi dhe mbajtja e një *linku Web* nga kutia dialoguese “Attachments”, - pasi gjejmë dhe hapim rekordin në të cilin ju doni të shtoni skedarin, zgjedhim *Edit* për ta bërë rekordin të redaktueshëm, “Attachment”, shfaqet dritarja dialoguese “Attachment”, “Add Web”, databaza shton një ikonë të re në kutinë dialoguese “Attachment”, duke shfaqur një shortkat të Web-it.



- Fshirja e skedarëve të shtuar dhe/ose mbahen në link, bashkëlidhja e fotove/pamjeve në rekordet e databazës, - lidhjet ndërmjet rekordeve, aftësia për të lidhur të dhënat/informacionet mes tyre, është një nga çelësat për t'i transformuar ato në të dhëna/informacione me cilësore. Një informacion, në vetvete përmban të dhëna të limituara, por kur këto të dhëna lidhen me të dhëna të tjerë, mund të zbulohen lidhje, apo marrëdhënie të reja mes tyre, p.sh. në një informacion përfshihet si i implikuar një person, në të njëjtën kohë në databazë ka dhe informacione të tjerë që implikojnë këtë person dhe persona të tjerë në veprimtari kriminale.

- “Link Manager”<sup>31</sup> - ofron mundësinë e krijimit të lidhjeve ndërmjet rekordeve dhe njëkohësisht ju ndihmon t'i gjeni dhe t'i shihni menjëherë këto lidhje, të cilat, pa ndihmën e programit, do të duhej kohë dhe do të ishte vështirë për t'i zbuluar.

- Tipat e lidhjeve, - lidhjet që krijohen në *Database*, mund t'i grupojmë në lidhje: “Implicit links”, lidhje të brendshme, që krijohen në mënyrë automatike nga vetë aplikacioni; “Explicit links”, lidhje të jashtme, të cilat krijohen ndërmjet rekordeve në mënyrë manuale; “Case links”, lidhje të çështjes. “Case” është grumbullim i rekordeve, të cilat janë grupuar së bashku për një arsye të veçantë, ndërsa rekordet ndërmjet tyre, mund të jenë ose mund të mos jenë të lidhur:

- të shfaqni listën e rekordeve, që janë të lidhur me rekordin që shqyrtoni;
- të krijoni lidhje mes rekordeve nga “Result Viewer”<sup>32</sup>;
- të krijoni lidhje duke përdorur “Link toolbar”-rin;
- të lidhni ndërmjet tyre, më shumë se dy rekorde.

- Paraqitja e lidhjeve ndërmjet rekordeve, - kur shqyrtoni një rekord, fillimisht ju kërkoni të dini lidhjet e tij me rekorde të tjerë; “query” ndihmon që në mënyrë të shpejtë të shihni lidhjet e rekordit, duke shfaqur të listuar të gjithë rekordet që lidhen me rekordin që po shqyrtoni. Gjithashtu, ju jep mundësinë që të zgjidhni tipin e lidhjes.

- *All* - shfaq të gjitha lidhjet e brendshme dhe të jashtme të rekordit që shqyrtoni.
- *Linked* - shfaq lidhjet ndërmjet rekordeve të krijuara në mënyrë manuale, si dhe disa nga lidhjet e krijuara në mënyrë automatike nga “query” i aplikacionit informatike etj.
- *Substantiating* - Shfaq rekordet që kanë shërbyer për të dhënat e rekordit që shqyrtoni.
- *Substantiated* - shfaq rekordet që janë të mbështetur, në rekordin që shqyrtoni .

<sup>31</sup> Link Manager - Modul i Intelligence Manager që përdoret për të shfaqur diagramet e lidhjeve.

<sup>32</sup> Results Viewer - Një dritare në të cilën shfaqen rekordet që kanë rezultuar nga një kërkim.

- Shfaqja lidhjeve ndërmjet rekordeve duke përdorur *Hyperlinku*-n, - ju mund të shikoni gjithë lidhjet e rekordit që po shqyrtoni, direkt nga formulari duke përdorur “Recorder Hyperlink”.

- Krijimi i lidhjeve mes rekordeve, aplikacionet informatike, lidhin automatikisht rekordin ngjarje/informacion me rekorde të tjerë si person, automjet, pronë, objekt etj. Këto të fundit janë të lidhur me ngjarjen/informacionin, por jo ndërmjet tyre. Kur ju vërtetoni, se dy ose më shumë rekorde kanë lidhje mes tyre, p.sh. person, automjet, person-person, ju mund të krijoni vetë këtë lidhje dhe njëkohësisht ta emërtoni atë. Kjo lidhje njihet si lidhje e jashtme – “explicit link” dhe mund të krijohet vetëm për rekordet e mbështetura:

- “*Result Viewer*”,
- *rekord i hapur*,
- *diagrami i lidhjeve*.

- Shfaqja e lidhjeve me anë të “Link Chart”<sup>33</sup> – krijimi i diagramës së lidhjeve, shërben për të shfaqur në mënyrë grafike dhe të shpejtë të gjitha lidhjet e një rekordi që kërkohet në databazën “Identitetet”. Krijon mundësinë e lidhjes së rekordeve dhe paraqitjes së tyre në mënyrë grafike, krijimin e lidhjeve të reja ndërmjet rekordeve brenda një diagrame lidhjesh duke lehtësuar analizimin e lidhjeve mes pjesëve të ndryshme të informacionit.

- Krijimi i lidhjeve ndërmjet rekordeve nga “Diagrami i lidhjeve”, lidhjet ndërmjet rekordeve që realizohen direkt nga diagrami i lidhjes është duke përdorur “Link Toolbar”.

- Lidhja e më shumë se dy rekordeve, me anë të “Link Creation Wizard” mund të lidhen me lidhje të jashtme, më shumë se dy rekorde. Përpara se të krijoni lidhjen mes rekordeve, duhet të fshihni lidhjet në diagrame.

- “Managing action”<sup>34</sup> menaxhimi i veprimeve, - menaxhimi i veprimeve, ju lejon të dërgoni, të merrni mesazhe, si dhe të ndiqni detyrat që ju janë dhënë nëpërmjet këtyre mesazheve. Këto mesazhe njihen si “action”, veprime, si të dërgoni një veprim (action), kthimi përgjigjes së një veprimi, refuzimi i një veprimi, skedimi i një veprimi. Menaxhimi i veprimit, mund të përdoret dhe për të krijuar buletine, që janë një formë e veçantë e veprimit, ato i drejtohen të gjithë përdoruesve .

- Në fushën *Subjekt* - plotësoni me pak fjalë lëndën për të cilin bën fjalë mesazhi që do të dërgoni

- Në fushën “Action”<sup>35</sup> - përshkimi kërkesës, p.sh. identifikimi personit P.Y dhe lidhjeve të tij.

- Në fushën *priority* - prioriteti që ka mesazhi që do të dërgoni: “High” (i lartë), “Low” (i ulët) dhe normal.

- Fusha “Respond by”, “Përgjigju deri më datën”, - kur përdoruesi, duhet të kthejë përgjigje.

- Nisja e “Action”, nga një formular i ngjarjes apo informacionit. Ju mund të nisni një “Veprim” direkt nga formulari i ngjarjes ose i informacionit. Mund të ndodhë që gjatë shqyrtimit apo leximit të ngjarjes apo informacionit, mund të lindë nevoja për sqarime, verifikime, kërkesa, dhënie detyre etj., të cilat mund t’i nisni me anë të “Action”.

- Kthimi i përgjigjeve për veprimet (action), - kur ju logoheni në aplikacion, nëse ju

<sup>33</sup> Link chart - Paraqitje në mënyrë grafike e rekordeve dhe lidhjeve ndërmjet tyre.

<sup>34</sup> Action Management – Moduli i Menaxhimit të Veprimeve. Shërben për nisjen, shpërndarjen dhe ndjekjen e veprimeve deri kur detyra kompletohet.

<sup>35</sup> Action - Një veprim, detyre e dhënë një përdoruesi nëpërmjet modulit të Menaxhimit të Veprimit.

kanë ardhur *veprime*, shfaqet një mesazh kujtese, i cili përmban dhe numrin e *veprimeve* që ju s'i keni lexuar "Ju është drejtuar Veprim. Dëshironi ta shikoni atë tani?"

- "Kthimi i veprimit", - ky formular përmban të dhëna të detajuara të *veprimit*, si: emrin e përdoruesit që ju ka drejtuar "Action", kërkesën që ju drejtohet, prioritetin dhe datën deri kur duhet të ktheni përgjigje, etj. Nëse ju mund të kryeni detyrën e ngarkuar.

- "Refuzimi i një veprimi", - nëse nuk keni mundësi të kryeni detyrën apo kërkesën që ju është drejtuar, ju mund të refuzoni këtë detyrë apo kërkesë.

- "Rikthimi i veprimit", - kur ju refuzohet një *veprim*, ju mund të vendosni që *veprimin* t'a nisni përsëri te përdoruesi që e refuzoi atë, ose mund t'ia nisni një përdoruesi tjetër.

- "Skedimi i veprimit, për veprimet që keni dërguar", - kur konstatooni se ato janë realizuar, ju mund t'i skedoni; logohuni në databazë duke përdorur *user name* dhe fjalëkalimin, zgjidhni në modulin "Action Management", në pjesën e sipërme të formularit "Action Histori" shfaqet data dhe ora e krijimit të veprimit, në pjesën e poshtme të formularit, në "Action Responses", shfaqen të dhëna që lidhen me Veprimet e kryera, tregon numrin e përgjigjeve, refuzuar etj.

#### 6.4 Shpërndarja e informacionit

Një funksion shumë i rëndësishëm i aplikacioneve informatike është shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të policisë si dhe në agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Procesi i shpërndarjes nis me plotësimin e formave të *shpërndarjes* dhe përfundon me printimin e informacionit. Të dhënat në lidhje me shpërndarjen, të plotësuara në formularin e shpërndarjes, regjistrohen dhe ruhen automatikisht në databazën e inteligjencës kriminale, duke bërë të mundur që administratorët e databazës, të gjejnë detaje në lidhje me shpërndarjen. Aplikacionet informatike sigurojnë shpërndarjen dhe shkëmbimin e të dhënave, por në të njëjtën kohë siguron dhe një kontroll mbi të dhënat e shpërndara: çfarë dhe kur është shpërndarë, cili nga përdoruesit ka bërë shpërndarjen, dhe te cili përdorues u shpërndanë të dhënat. Krijimi i një rekordi të shpërndarjes kalon në dy faza: Hapja dhe plotësimi i formularit të shpërndarjes, ruajtja e rekordit.

#### 6.5. Krijimi i vlerësimit të rrezikut për shpërndarje

Mund të ndodhë që informacioni që do të shpërndani, të përmbajë materiale me të dhëna personale ose të jetë sensitiv, për këtë arsye është e nevojshme të krijoni një vlerësim rreziku. Të gjitha të dhënat/informacionet që shpërndahen (dalin jashtë institucionit) ruhen në databazën "Dissemination" dhe në hiperlinkun e formularëve shfaqet numri i shpërndarjeve.

Shpërndarja nëpërmjet *Word*, - hapet *Microsoft Word*, i cili shfaq një dokument të ri me detaje të shpërndarjes. Ky dokument mund të ruhet, të printohet në të njëjtën mënyrë si veprohet me dokumente kur përdoret aplikacioni *Word*.

### 7. Legjislacioni dhe dokumentimi i aktivitetit kriminal nëpërmjet inteligjencës së informacionit

#### 7.1 Aplikacioni i kërkimit "Aplikacionet inteligjente informatike", janë vetëm për përdorim të brendshëm

"Aplikacionet informatike inteligjente" janë vetëm për përdorim të brendshëm të

strukturave ligj zbatuese. Përdoret nga punonjës të certifikuar nga DSIK<sup>36</sup>. Certifikatat janë të tipit “Për njohje”, “Konfidencial” dhe “Sekret”, informacioni qarkullon brenda rrjetit informatik të institucionit, i cili është i certifikuar nga DSIK. Është ndërtuar që informacioni për individë ose grupe interesi të përzgjidhet në interes të qëllimit dhe logjikës së punës.

### **7.2 Aplikacioni i kërkimit , në drejtim të dokumentimit të veprimtarisë kriminale, perspektiva e zhvillimit**

Aplikacioni përfshin një ndërfaqe për konsultimin e informacioneve në këto tabela. Kjo realizohet nëpërmjet një shtrese *ueb-servisesh* që është e domosdoshme për komunikimin midis sistemeve.

Gjithashtu, në diskutimet me aktmarrëveshjet që kanë dashur të arrijnë strukturat e Policisë së Shtetit, në shkëmbimin e informacionit dhe me aksesin në databazat e këtyre institucioneve dhe agjencive ligj zbatuese, ka qenë shkurtimi në maksimum i procedurave burokratike shkresore dhe arritja e qëllimit nëpërmjet aksesimit të integruar të informacionit nëpërmjet *web service*-ve.

### **7.3 Lidhja me databazat e institucioneve të treta (zgjerimi modulit te web servise-ve)**

Duke pasur parasysh përmirësimin e shkëmbimit së të dhënave mes agjencive të zbatimit të ligjit, për luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet hedhjes së hapave të para të ndërtimit të një standardi komunikimi të sigurtë për shkëmbimin e këtyre të dhënave, në databazat e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese nga strukturat e hetimit të Policisë së Shtetit, ka qenë në vetvete shkëmbimi i integruar i këtij informacioni nëpërmjet *web service*-ve Në kuadër të Prioritetit Nr. 4 dhe konkretisht të masës 2.1.2, të marrjes së masave për shkëmbimin e ndërsjellët të informacionit nga strukturat dhe agjencitë e interesuara, vlen të përmendet thellimi dhe zgjerimi i informacionit nëpërmjet Aktmarrëveshjeve dypalëshe:

- a. Aktmarrëveshja dypalëshe me Drejtorinë e Shërbimit të Transporteve Rrugore.<sup>37</sup>
- b. Aktmarrëveshja dypalëshe me ILDKPKI.<sup>38</sup>
- c. Aktmarrëveshja me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.<sup>39</sup>
- d. Aktmarrëveshja me Agjencinë e Legalizimeve (ALUIZNI-t).<sup>40</sup>
- e. Aktmarrëveshja me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.<sup>41</sup>
- f. Aktmarrëveshja për konsultimet ne Regjistrin e ZRQRPP.<sup>42</sup>

<sup>36</sup> DSIK - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), është krijuar në bazë të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar dhe “sekret”.

<sup>37</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor Nr. 664 Datë 12.05.2000.

<sup>38</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet D.P.P. Shtetit dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Nr. 3219, datë 29.07.2015.

<sup>39</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit dhe Drejtorisë Përgjithshme të Doganave Nr. 13620, datë 30.09.2010.

<sup>40</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet D.P.P. Shtetit dhe Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave, Ndërtimeve Informale Nr. 703, datë 24.06.2015.

<sup>41</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet D.P.P. Shtetit dhe Drejtoria Përgjithshme Tatimeve Nr. 5273, datë 10. 08. 2016.

<sup>42</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Dr.P.P. Shtetit dhe Dr. Përgjithshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Nr. 3187/3, datë 21.07.2015.

#### 7.4 Legjislacioni dhe dokumentimi i aktivitetit kriminal

Të shfrytëzohen më tepër produktet e inteligjencës strategjike të Policisë së Shtetit duke pasur parasysh zbatimin e ligjeve (Ligjit të ri për Policinë e Shtetit, Ligji për Konfiskimin e Aseteve Kriminale, rekomandimet e Task-Forcës kundër krimit financiar si dhe mendimet në ligjin Anti-Mafia mbi asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara<sup>43</sup>. Shërbimet e SI/TI, proaktive të bazuara në analiza të mirëfillta të riskut duhet të rriten në mënyrë thelbësore për të zhvilluar një rekord solid të hetimeve, ndjekjeve penale si dhe dënimeve finale në rastet e korrupsionit. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive duhet të zhvillohet më tej. Bashkëpunimi ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatës nëpërmjet sistemit informatik, duhet të përmirësohet, në mënyrë që hetimet paraprake, të bëra nga tre institucionet të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe, aksesit në informacion si nga databazat publike dhe ato private.

#### 7.5 Moduli i auditimit, procedurat që duhen ndjekur për auditimin

Moduli i Auditimit është moduli i cili bën të mundur kontrollin e veprimeve, auditimin e përdoruesve që kanë përdorur aplikacionet informatike. Në çdo aplikacion është i domosdoshëm kryerja e procesit të auditimit në mënyrë që të mos ketë parregullsi gjatë veprimeve të kryera nga përdoruesit. Menuja *Logimet* bën të mundur kërkimin e përdoruesve të sistemit që janë loguar e kanë përdorur aplikacionet informatike. Nëpërmjet *Auditimit* kontrollohen të gjitha veprimet, kërkimet që kryen një përdorues në mënyrë të detajuar. Kjo gjë shmang abuzimin me informacionet, që një përdorues mund të kërkojë në sistem; n.q.s në një moment të dytë do të kërkohet informacion për një përdorues, përmes *Auditimit* paraqitet gjithë lista e veprimeve që ai ka kryer në sistem me të dhëna të detajuara (data, ora e kërkimit).

## 8. Rekomandime

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të rekomandonim masat e mëposhtme:

- Të intensifikohen aplikimet informatike të drejtuara nga inteligjenca në fushën e rendit dhe sigurisë publike, policimit në komunitet, pastrimit të parave, krimeve kompjuterike, trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimeve financiare.

- Sigurimi i aksesit të plotë të policisë kriminale në databazat publike kombëtare. kompanitë celulare dhe në të dhënat e klientëve të internetit konform legjislacionit përkatës dhe, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngritja e strukturës përgjegjëse për drejtimin dhe harmonizimin e shërbimit të inteligjencës së përpunimit të informacionit, ngritja e një sistemi kombëtar të unifikuar të inteligjencës, i cili do të përmbajë çdo të dhënë, të çdo lloji, për persona të cilët në një mënyrë ose në një tjetër kanë qenë objekt i punës së agjencive të zbatimit të ligjit.

- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe garantimin e pavarësisë operationale të Policisë së Shtetit dhe strukturave të kontrollit të brendshëm, funksionimin e institucioneve dhe strukturave në varësi me profesionistë me integritet moral dhe karakter

<sup>43</sup> Vendim i Këshillit 2005/671/ÇBD, datë 20 shtator 2005, për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin për veprat me qëllime terroriste.



të fortë njerëzor. Unifikimin dhe shkurtimin në maksimum procedurat burokratike në drejtim të evidentimit të veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit gjatë evidentimit, konsultimit, kërkimit dhe administrimit së të dhënave lidhur me kriminalitetin.

- Konsolidimin e arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit, duke synuar hapjen dhe demokratizimin e mëtejshëm të institucioneve dhe strukturave në varësi përmes transparencës, informimit të publikut, llogaridhënies dhe një komunikimi me aktiv me organizatat e shoqërisë civile, medias dhe gazetarisë investigative.

- Zbatimi i një sistemi karriere me tre trajektore (“three-track system”) duke lehtësuar hyrjen e të diplomuarve nga shkencat e informatikës, matematikës së aplikuar, inxhinierisë kompjuterike, informatikës ekonomike etj. Zhvillimi i trajnimeve të posaçme për nivelin menaxherial në polici dhe shtimin e aftësive gjuhësore me kriter të pozicionit të punës.

- Strukturat për hetimin e veprave penale në Policinë e Shtetit, që shfrytëzojnë “aplikacionet informatike inteligjente” për qëllime të evidentimit, parandalimit dhe hetimit në ndihmë të plotësisht me informacione të nevojshme për të gjithë veprat penale sipas drejtimeve e juridiksionit territorial.

- Strukturat që hetojnë rastet e verifikimit, zbulimit të veprave kriminale të shfrytëzojnë “Aplikacionet informatike inteligjente” për të mbrojtur lirinë dhe të drejtat e individëve, familjarëve, subjekteve, firmave, kompanive private etj.

- Përdoruesve të sistemit duhet t’u afrohet asistencë teknike për mirëmbajtjen, administrimin, mirëfunksionimin si dhe asistencën teknike për përdoruesit për arritjen e qëllimit.

- Forcimin e bashkëpunimit institucional dhe bashkëveprimin operacional me agjencitë ndërkombëtare në fushën e luftës kundër krimit; fuqizimin e bashkëpunimit me vendet partnere; nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale për luftën kundër kriminalitetit duke ndërtuar një sistem periodik analize dhe kontrolli për zbatimin e tyre.

- Rregullat të Përgjithshme për administrimin dhe mbrojtjen e sistemit, asetet dhe administrimi *Server & DataBase & Aplikation Software* të sistemit, kontrolli në bashkëpunim me strukturat audituese të D.P.SH për përdorimin e të dhënave personale të sistemit, duke mundësuar modulën e *Auditimit* (Menaxhimi i kontrollit të logove) për përdoruesit, për qëllime pune, dhe mbrojtjen e tyre, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Përmirësimi i procedurave dhe praktikës së mbledhjes, përpunimit, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit/inteligjencës, hartimi në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë i Strategjisë Kombëtare të përpunimit inteligjent të informacionit.

- Hapat e ardhshëm duhet të përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve investiguese të agjencive ligjzbatuese, si dhe kryerjen e hetimeve proaktive dhe efektive nëpërmjet shfrytëzimit intensiv të databazave të afuara nga SI/TI, hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet e veprave penale të lidhura me krimet, terrorizmin dhe korrupsionin duhet të përmirësohen në mënyrë që hetimet paraprake të bëra nga tre institucionet, të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe aksesit në informacion si nga databazat publike dhe ato private, nëpërmjet dhënies së autonomisë së mjaftueshme dhe garantimit të qëndrueshmërisë për stafin e policisë me akseset e nevojshme në këto databaza, si dhe nëpërmjet përcaktimit të juridiksionit të qartë në lidhje me krimet, terrorizmin, korrupsionin etj.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

- Bashkëpunimi mes specialistëve dhe strukturave të specializuara të SI/TI dhe Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligj zbatuese, duhet të përmirësohet më tej, duke i paraprirë analizave funksionale sa më të hollësishme në mënyrë që të arrihen kapaciteteve të mjaftueshme dhe përmirësimin e performancës së të gjithë autoriteteve të zbatimit të ligjit për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmit.

- Të rritet më tej buxheti i sektorit të SI/TI në Policinë e Shtetit, duhet të plotësohen me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, si dhe të marrin trajnimet e nevojshme. për të mbuluar koston që nevojitet për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe shërbimet që realizon ajo.

- Bashkëpunimi ndërmjet agjencive duhet të zhvillohet më tej. Bashkëpunimi ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatave duhet të përmirësohet në mënyrë që hetimet paraprake të bëra nga tre-institucionet të kryhen si rezultat i mbledhjes inteligjente proaktive si dhe aksesit në informacion si nga databazat publike dhe ato private.

- Do të zhvillohen programet e trajnimit në bazë për implementimin e sistemit të Menaxhimit dhe përpunimit inteligjent të informacionit në strukturat e Policisë së Shtetit.

- Plotësimi i standardeve të BE-së për informatizimin dhe digjitalizimin në masën 100% të shërbimeve të Policisë së Shtetit, duke siguruar transmetimin e të dhënave dhe komunikim në çdo kohë dhe në çdo vend ku shtrihet aktiviteti i punës së punonjësve të policisë në komunitet.

## Referencat

1. *Strategjia ndërsektorale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013* (SNSHI) e miratuar me VKM Nr. 59, dt. 21.1.2009.
2. *Agjendë Digjitale për Evropën*, COM(2010)245, miratuar 19.5.2010, EC.
3. SEE-2020 (South East Europe- 2020), *Strategjia e Teknologjisë së Informacionit për Vendet e Europës Juglindore*.
4. *Strategjia e Teknologjisë së Informacionit në Shqipëri "Shqipëria Digjitale"* Strategjia e SI/TI Kombëtare, 2014-2020.
5. Arkivi Qendror i Ministrisë Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, *analiza e analiza pune vjetore, marrëveshje dhe shkëmbime informacioni* etj., viti 1999-2016.
6. Francisco José García-Peñalvo, *Journal of Information Technology, Research University of Salamanca, Spain* (31-48).
7. Charles H. Davis dhe Debora Shaw, *Introduction to Information Science and Technology*.
8. *Internet-Memex Launches new Intelligence Management tools*, Memex Intelligence software.
9. Steve Suehring, *Linux Firewalls: Enhancing Security*.
10. Mark Minasi, Christa Anderson, *Mastering Windows Server*, 2003, (50-85).
11. Joan Casteel, *Oracle 12c*, (22-75).
12. Rand Morimoto, et al., *XP windows server* (12-65).
13. Ghazi I. Alkhati, *International Journal of Information Technology and Web Engineering* (20-50).
14. John Wang, *International Journal of Information Technology Project Management*, Montclair State University, USA (9-25).
15. *Modern Information Systems*, leksion, UET.
16. Pranab Kumar Das Gupta, P. Radha Krishna. *Database Management System Oracle Sql And Pl / Sql*.
17. Mitch Tulloch, "Security and Privacy for Microsoft Office 2010 Users", *Get practical, proactive guidance for using the security and privacy management features in Office 2010 and Office 365*, Microsoft Download Center, 2010.
18. *Project Management Guide, Programme Management – and Introduction to the Techniques*, 2006.
19. Catchpoint Systems, *Web Performance Insights 2011*, posted on Catchpoint blog from 2011.
20. *Data analysis – i2 Analyst's Notebook*.

Academy of Security

Second International Scientific Conference

# Forensic sciences and contemporary security challenge

15 November, 2017  
Tirana, Albania



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

**242**

ENGLISH

---

# ABSTRACTS

---

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 9, NOVEMBER, 2017

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

**243**

---

**Criminology and its contribution to the examination of the crime scene**  
**- PhD Luan Veliqoti**

**ABSTRACT**

The criminalistics is the science of discovery and proofing the crime. That's why it has an early starting point, because the human society continuously has been interested to discover the crimes that have been continuous and concerning for it too. In its beginning, methods and means that it has applied have been not only empirical but also the violations of the human rights and freedom. On the second half of the XIX-th century, while the economical and social developments in Europe were associated even with a growth of criminality a thing that brought the need to fight and prevent it, it takes the form of a science with an object and a concrete aim. The discovery and proofing the act of a crime the science of criminology realizes through processing and applying the technical and tactic scientific methods, and even the methodological recommendations to seek, to discover, to fix and to get traces and objects material proof of the crime with the scope to discover, to investigate, to judge and to prevent the penal acts. To realize its object, the science of criminology is based on a methodology and methods or technical means that are its exclusive all this activity is based on penal ethics. For these reasons it is involved and is a part in juridical science, in the department of penal science. Because of its object, the difficulty that has the discovery and proofing the crime, the criminalistics has some peculiarities from other sciences, what it makes, "Its scientific nature", which are: the relation with many other sciences, a specific qualification of the lectures that will transmit this discipline, a specific laboratoric and didactic base, basing its activity on some principles and methods that are its exclusive, the faster spread and development of cases that includes its object. Through the means of seeking the proof is even the inspection of crime scene, to realize this investigative act the criminology has processed a variety of technical and scientific methods, it has made a variety of explanations and recommendations, that are called, "Juridical nature of crime scene", to increase the efficacy, its legal acceptance and its scientific level.

**The importance of the investigative experiment during the investigation process**

**- Proff. Ilirjan Mandro**

**ABSTRACT**

During an investigation process, we face facts and circumstances that may have a "negative" impact on a given event. There is often a need to verify the facts related to the event by proving circumstances, events, or facts that have occurred and how they may have taken place. We may be in the process of interrogating the eyewitnesses or injured persons providing details about the circumstances of the occurrence which may not comply with or be logically linked with the pieces of evidence that is found and put together at the crime scene. All these statements and counterstatements must be authenticated and the best way to do it impartially is by conducting an experiment. In any case, when the investigation process is at a "crossroad", conducting the investigation experiment in compliance with the legal requirements and the criminological methodologies is the best way out of the problem. Verifying the possibility of overseeing or listening to a conversation, the possibility of conducting a criminal act or acts at a given time, are circumstances where most investigative tests are

conducted. In order to make this paper more comprehensible to the reader, several investigative experiments from personal professional experience on establishing the likelihood of a murder, robbery or car accident have been brought up.

## **Computer forensics** **- MSc. Arjan Muqaj**

### **ABSTRACT**

Organized crime is the major threat to national security, which depends on the effectiveness of fighting crime. As IT use in every daily activity is ever increasing, it is also becoming a major crime target. Computer attacks are becoming a common feature of daily news as they are gradually replacing traditional armed attacks. A month ago, the entire world was affected by a massive cyber attack that paralyzed for few hours critical infrastructure. The attack was reported to have affected more than 70 countries, including UK, USA, China, Russia, Spain, Italy, Taiwan, etc. The major factor leading to discovery of the perpetrators of such attacks has been forensic expertise. Although a new field, the computer forensics has become a major branch of the forensics sciences. Police forces throughout the world have set up computer forensics services. Recently, computer forensics expertise is being developed and provided by specialized private organizations, including university and other academic institutions. Computer forensics helps in legal resolution of cyber attacks, but also of traditional crime cases. Well-equipped laboratories have been established within the police institutions in many countries in the world. Their investigations have served as crucial evidence in trials. The wide spread use of IT in Albania has led to incidence of crimes against computers. Government has responded by improving the relevant legal basis and establishment of specific services responsible for the fight against computer crime. Within the forensics department there is a computer and audio-video forensic unit. This unit has undertaken a wide range of forensic examinations, varying from simple to complex cases, such as the one involving the IT server of country's tax department. Almost every crime investigation, in particular organized crime cases, has involved a large volume of mobile devices forensic examinations, which have produced important evidence that in many cases has been crucial in the sentencing or acquittal of the defendants. Computer forensics and its procedures are a major challenge in the fight against crime in Albania. This work intends to analyze the current situation in the fields identify the main problems and propose potential solutions. Computer forensics requires commitment of significant human and financial resources. It also requires improved cooperation between prosecution offices and academic institutions.

## **Digital forensics in the service of the law** **- Msc. Blerim Krasniqi**

### **ABSTRACT**

This scientific paper titled, Digital Forensics in the service of law aims to scientifically address the role of electronic devices that have become an important part of our lives and are becoming essential for home and work activities and in most professions are the key tools of work. Different electronic devices except for the regular and legitimate use for what they are made for, are often used for unauthorized and illegal purposes. The illicit use of electronic devices for the commission of a criminal offense provides

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

these devices with a special forensic value and their treatment, using approved forensic methods, makes the digital evidence derived from them to be presented as valid evidence in court. The rapid development of information technology and its adoption in the service of law has revolutionized the prevention and combating criminal offenses. Digital evidence obtained from electronic devices is increasingly presented as valid evidence in the court. Digital evidence includes information that can be found on electronic devices, including information that can be found on computers, sound recordings, video and digital images. These evidence are essential in finding offenders of cybercrime, but are also useful for identifying people through digital video and images or by identifying them through voice examination. Therefore, this paper attempts to consider the importance of applying digital forensics using the approved scientific methods and its application in function of the law.

### **Improvised Explosive Devices (IED) in the experience of the crime scene examiners of the Scientific Police**

**- MSc Dritan Zoto**

#### **ABSTRACT**

Recognition by crime scene examiners, Judicial Police Officers of improvised explosive devices (IED) such as construction and their constituent parts, or ways of initiating explosive substances, helps and guides them in the crime scene of the event, as part of the investigative group. The importance of providing (preserved) the perimeter of the crime scene and its examination to determine as scientifically the mechanism of the event in the cases of the use of explosive substances of a relatively large territory for the detection of parts, conductors (wire/wire) and other constituent elements of a IED, distributed by pressure of the explosion. Laboratory examinations made to parts or other constituent elements of a IED found at the crime scene, such as detecting latent traces, biological traces (DNA) or phone calls of a SIM card, assist the proceeding authority in documenting and detecting the offender. This paper deals with some general knowledge of Improvised Explosive Equipment (IED) encountered in the experience of the crime scene examiners of the Scientific Police.

### **Accreditation - the Albanian Scientific Police Insitute future**

**- Msc. Xhevahir Çeloaliaj**

#### **ABSTRACT**

Accreditation is the procedure under which an authorized national body assesses the competence of a conformity assessment body to perform specific tasks such as testing, calibration, certification and inspection. Competence is the key to ensure the transparency, reliability and efficiency of the services provided by Accredited Conformity Assessment Bodies, based on internationally accepted standards. International standards ISO / IEC 17025 are the general requirements for the accreditation of the scientific police, which is indispensable for the legitimacy of its activity in the process of conducting the activity for different types of expertise. Accreditation is part of the legal and technical infrastructure of quality and is one of the temple's credibility columns along with standards, metrology, certification and quality management. Accreditation is the most effective market tool and a passport for accepting contracted services requiring independent and competent conformity assessment bodies. Accreditation is seen as a reliable indicator of technical



competence.

### **Optimization parameters of fragmentar voltage and collision energy for identification and separation pentaerytol tetranitrate (PETN) with LC / MS-MS**

**- Milazim Tahirukaj, Blerim Olluri, Xhemail Ademaj**

There are different methods for identifying and separating organic explosives, especially PETN, but recently, double-mass spectrometric detector chromatography has begun to accommodate numerous scientific researches by forensic scientists to find appropriate parameters for the identification and separation of organic explosives in low concentrations in pictograms or even in femtograms. Therefore, considering the needs reasonable we have begun to create optimal parameters for "collision energy" and "fragmentor voltage" for identifying and dividing PETN from other explosives by using the Liquid chromatography instrument with double-mass spectrometric detector with the APCI model, Zorbox SB - C18 column 600 bar 3 x 50 mm 3.5 µm and mobile phase: Methanol / Isopropanol / Water (1: 3: 6) as well as 0.1% chloroform. In our studies we have found optimal "collision energy" and "fragmentor voltage" values for the identification and separation of PETN from other explosives, the change of fractional energy values greatly influences the fragmentation of the molecule we are studying, the fragmentation fractions molecule at all levels and this facilitates the identification of the molecule of unknown explosive and all fractions comply with our preliminary knowledge of the PETS structure and knowledge of its potential fragmentation, in addition to the excellent division achieved with this technique and the limit of detection up to femtogram.

### **Hetimi i vrasjeve, rëndësia e gjetjes dhe administrimit të provave - MSc Tonin Vocaj**

Abstract

Murder investigations, documentation of the criminal activities of perpetrators and bringing them to justice has been and remains a constant challenge for criminal prosecution bodies around the world. Indeed it is precisely the investigation of crimes against life, the activity which clarifies and documents the indispensable elements of the offense and fully corroborates its commission as well as individualizes the criminal responsibility of the perpetrators of these serious crimes. Full and comprehensive investigations make it possible to clarify the circumstances, determine the motive of the crime, resolve the trilemma, "murder, suicide or accidental death". Moreover through the investigation it is possible to find, obtain and administer the evidence that documents the criminal activity and the responsibility of the perpetrators of these criminal acts. Among the main goals of the investigation of crimes against life, a particular priority should be given to the authentication of the commission of the offense by the author as well as the determination of the motive and purpose of the commission of this offense. The elements of the subjective side of the crime are important in order to determine the concrete provision but also the degree of fault and responsibility of the offender. Investigations of crimes against life are complex and a priority in these investigations should be addressed to the application of criminal techniques, the conduct of necessary expertise and the application of contemporary methods of analyzing each of the elements of the investigation in order to draw

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

objective conclusions and to bring to justice the perpetrators of these serious crimes. The process of trying to investigate homicides is the subject of all notices related to the elements of the criminal offense, the social relationships that are implicated, the time, place, forms of the offense, the circumstances, the consequence and the casual link, the author, the dangers, the guilt and its form, the motives and the purpose of his act and every other element that may be related or that is relevant for a fair resolution of the criminal case.

**Rëndësia e ekzaminimit të provave materiale balistike dhe sqarimi i mekanizmit të ngjarjes në këndvështrimin e balistikës kriminalistike - MSc, Nikolin Duraj, MSc Shpetim Hudaj**

**ABSTRACT**

The purpose of this topic is the recognition by criminal experts, Judicial Police Officers and Prosecutors regarding the importance of examining ballistic material evidence and clarifying the mechanism of the event in the viewpoint of criminological ballistics. Examination of ballistic evidence and clarification of the mechanism of the event is of fundamental importance in the criminal process in criminal cases where as a means of crime the firearm was used. It is the primary duty of criminal experts and Judicial Police Officers that, after precise determination of the boundaries of the scene, is the search, discovery, fixation and seizure of ballistic evidence and ballistic evidence as a whole, other evidence of progress of the investigation into the documentation of the criminal offense as well as the identification of its perpetrators. The correct fixation of ballistic material evidence from the scene of the event should be made in accordance with the requirements of the Penitentiary Penal Code and criminal methods in the three classic ways, such as in the process of site scene review, photographing and sketching, which is a key point in the performance of the entire criminal process, where it is especially important to fix the exact position of their location, which serves to rebuild the scene, which we will treat in the second part of this topic. In this topic, some of the key elements that relate to the accurate explanation of the mechanism of the event are illustrated, illustrated with concrete examples encountered in the Examination Practice at the Scientific Police Institute.

**The judicial and forensic aspects of the examination of non-original documents**

**- PhD Vladimir Ikonomi, PhD Viktor Hajdari**

The technical and graphic examination of non-original documents is a widely debated question and object not only of our courts' decisions at all levels but also of other European countries' course. There courts at different levels that when they examine different civil or criminal cases they don't accept the validity of the examination carried out on non-original documents. But there are also many courts that have accepted the validity of these documents by evaluating the conclusions reached by the experts, judged and connected with many factors that are related to the forensic and judicial aspect and by also evaluating the reached conclusion during the examination in unity or co-relation with the other administer proves. As a rule, in carrying out the examination of a document that serves as an evidence, the document to be examined should be presented as in original. During the examination of these documents we should always start from the main principal: "a good comparison of

writings and signatures can't be achieved if we don't start from the original". Nevertheless based on the jurisprudence of our country and that of other countries, in the criminal and civil code there are no dispositions that by no means request that the documents, material proves, should be in original or that abstract the examination of the documents material proves that are presented in their non-original form.

### **Beyond automated carving from video surveillance systems (DVRs) - Kastriot Gjoka**

#### **ABSTRACT**

In contrast to other evidence, CCTV footage is a "eyewitness" to a crime, to understand what happened, when and how it happened, how many suspects were involved, to determine the entry and exit points from the scene of the crime, to identify suspects, the actions carried out by them, etc. In the last decade, sources of video footage that can help investigation have been greatly increased as a result of CCTV, which are found everywhere, in businesses buildings, private houses, police vehicles, etc., and as well as from other sources such are mobile phones. Extracting video footage from security cameras [digital video recording devices (DVRs)], in some situations is a very complex process and requires advanced knowledge and techniques. To back up video footage from these devices, we may face with different problems such as: the device does not work; the device is password protected; the data is deleted or corrupted; the DVR's hard disk has bad sectors and is not recognized by the device; video footage has been stored on a USB or hard drive but has been deleted later, or the media storage become corrupted, etc. Currently, for DVRs systems (security cameras), unlike in the computer and mobile phone examination field, there are a very limited number of forensic tools, which are limited both in the number of brands and models they can examine, and capabilities for advanced data recovery from these devices.

Based on a several years of researches, I have studied the structure of the video files stored on the hard drives of these devices, for almost all brands and models seized and sent to us for forensic examination, such as HikVision, Avtech, Fracarro, AVT, Neutron, Defender, Vivosky, Qihan, MakVision, etc, and as well as for several different other unbranded models. For each model, we have written scripts, mainly in the Python programming language. These scripts are able to search and identify any part of the video files of interest, and then copying them out from the media storage. We have now created a graphical user interface program to run the scripts, and we are continuing to work to improve it. Using our proposed techniques and methods, can lead to a final conclusion, whether the certain video footage exist or not on that device, and then copying them out in a readable format.

### **Study of allele frequency for Albanian population and its importance for science of legal biology in Albania - MSc. Ela ZAIMI**

#### **ABSTRACT**

The Forensic Institute of the Albanian State Police is conducting DNA examinations since 2009 in order to identify perpetrators, who have committed different criminal offences, to identify genetic links between children and their parents and also the human remains. The DNA is present in the majority of the cells of our body. It is unique for each of us and we leave DNA traces everywhere we go. According to medical

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

and forensic science experts the use of DNA analysis is the confirmation of the identity of every person, who has been in contact with a crime scene. Without doubt, the DNA analysis is a link of significant importance in the forensic biology by helping to identify murderers and perpetrators of criminal offences and by enabling the identification of human remains in cases of natural disasters and massacres, such as the massacre of Srebrenica; it sheds light on potential miscarriages of justice when innocent persons have been wrongfully convicted.

The power of DNA to identify, convict and exonerate is so strong that many people perceive it as flawless. However, DNA evidence has a number of limitations: they might not be discovered, they could be neglected or could be found in very small quantities, which makes it difficult to interpret them.

In our country this area of scientific examination is in need of support and scientific research. In order to increase the forensic capacities for DNA analysis the Biology and DNA Examination Unit has successfully completed the project on "Research of allele frequencies of the Albanian population". This project was implemented due to the cooperation and support provided by the Organization for Security and Cooperation in Europe, Presence in Albania, especially Mr. Adrian Nessel and Mr. Szabolcs Tuncsik. It is the first time that such a project is implemented in our country and it is of scientific importance. This project marks the beginning of the road to increase the quality and fulfill international standards, such as ISO 17025, by preceding the accreditation process, which is a big challenge to deal with in the coming years. In the framework of this project we would like to pass special thanks to Mr. Adrian Nessel and Mr. Szabolcs Tuncsik, to all the heads of Forensic Units at the Local Police Directorates and all the individuals, who provided their saliva samples on a voluntary basis, the IT expert Krenar Bici and of course, all the staff of the Biology and DNA Examination Unit.

### **Automatic fingerprint identification system AFIS / APIS and implementation of this technology in fight against criminality - MSc Orest Afezoll**

#### **ABSTRACT**

The purpose of this paper is to provide information on the process of computerization of fingerprints focusing on the automatic fingerprint identification system AFIS/ APIS Papillon, installed in the Department of Dactyloscopy of the Institute of Scientific Police since October 2002. Since this automatic system has been applied for the first time in Albanian Police history, and the information used in this paper has emerged from the 15-year statistical processing accumulated in this system. The fingerprint identification methodology has been elaborated over the years and an extraordinary help in this regard has been made by the use of information technology which has increased at a very high rate the speed of receiving the result and at the same time an admirable and impressive precision of these results. The use of high technology has given priority to the solved of various criminal offenses as well as the arrest and disclosure of authors who are dehumidified with the fingerprints left on the crime scene. The implementation of IT technology has been extended to the use of Live Scanners, which have been installed so far in 12 Regional Science Laboratories, 8 Laboratories of Scientific Police at Police Commissariats, 5 Local Directorates of Border and Immigration as well as 13 Point Border Crossing in total 55 pieces. These devices are linked on-line with the AFIS / APIS system and electronically sent to the

database of this system the ten fingerprint cards of detained, arrested, deportee, foreign nationals with problems in the territory of Albania. The use of Live Scanners has made it possible to control the identity of these persons within 30 seconds in the AFIS system database and to submit the fingerprints of this category of people online to the system, giving access to the State Police to dispose within twenty-four hours irrefutable scientific evidence proving their involvement in various criminal activities, or different persons who seek to avoid police by presenting them with false identities. The 15-year experience has proven the undisputed success of applying this advanced technology to the State Police by increasing the number of criminal-case identification cases of offenders through the fingerprints several times. Thus, out of 94 Hits with manually searching on a year before 2002, the year when AFIS was installed, an average of about 110 Hits per month from 2003 to 2017. AFIS's application has enabled the Albanian Police's prestige to grow in relations with its international partners both bilaterally and multilaterally, demonstrating speed and professionalism in the electronic exchange of fingerprints according to international standards ANSI / NIST the transmission of fingerprint digital imaging, mainly through the National Interpol Office Tirana.

### **Aspects of legal documentation of gender-based violence - MSc Eda GJOKA**

#### **ABSTRACT**

The Constitution of the Republic of Albania sanctions equality between men and women, but it results that women do not enjoy the same rights as men. This inequality is tangible in many areas of life. Violence against women is a complex problem that involves more than an act in itself in the personal relationship between man and woman. It is a social problem of great proportions rooted in the historical attitudes towards women and marital relationships. Victimization of women by their husbands is reinforced by the economic situation, mentality and tradition, inadequate people's awareness of domestic violence. Violence against women is evidenced in many forms, from home environments to workplaces, from seduction and sexual harassment to rape, from psychological pressures to physical violence and murders. This article will focus on identifying the current level of violence against women in Albania, as well as highlighting Albanian legislation and protecting mechanisms against gender-based violence. Based on this analysis we can conclude that Albania has a full legal framework for violence against women and domestic violence. Despite the legal framework and the positive achievements, there is still a need to improve the current situation.

### **Variable issues on the youth antisocial and delinquent behavior issues in Penitentiary Settings in Albania - PhD Valbona Muca, PhD Eglantina Dervishi, PhD Elisabeta Kafia**

Deviant behavior might define any behavior that is inconsistent with the norms and rules of society, culture, organization and psychoanalytical and ethnosociological laws. The origin of the deviance phenomenon is related to the origin of man himself as an ethnicity. Although it is essentially an inevitable problem of society and the challenges of globalization, research has shown that the density and intensity of deviance has undergone a significant growth nowadays and has strongly influenced

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

**251**

the imbalances of the transitional societies of our society. The objective of the present article is to explore and identify the factors which enhance the phenomena of youth antisocial and delinquent behavior into Penitentiary Institutions in Albania. First, we will describe a picture of the situation of antisocial delinquent behavior in the penitentiary and sentencing settings. Second, we will outline the psychosocial precipitant and risk factors that develop the antisocial behavior of youth. Third, through a concrete case studies we will provide several functions and competencies of clinical forensic professionals aiming the development of efficient strategies of prevention and interventions. The method administered in the present article is a mixed methodology with rely in the structured Interview and the concrete Case Studies. Data from the deep case analysis and interviews revealed a strong relation between the alteration of psychosocial environment conditions of youth with an increase in the expressed antisocial behavior. Emotional and interpersonal relations variables are the most influencing factors in the incidence of antisocial behavior. In the end of the article we have outlined several findings and recommendations relating the general observed situation, precipitin and retaining factors of the antisocial behavior and the development of preventing strategies of antisocial behavior which has an impact in the whole development of the individual.

### **Information Technology in State Police towards the Legal Documentation of Criminal Activity**

- *MSc. Dashmir Çali*

Nowadays, the role of information systems and information technologies has become a priority. Massive technological projects related to the development of technology and the internet systems are applied in police institution in all areas, especially in terms of legal documentation of criminal activity. It is possible to collect process and analyze data and information on an existing database that is constantly updated through the creation and operation of integrated technology systems. In this paper is presented an historical overview of the development of technology, internet and electronic communications, as well as special information systems, digital agenda, and so on. Further, the role of data and creation of databases and technological systems is reflected in the Albanian State Police. In an institution where is produced massive data, it is necessary to create genuine databases using information technology and integrate them into telepathic networks to enable application of programs. The most used technology systems in the Albanian Police in the field of criminal intelligence analysis and crime prevention are: TIMS, RMIS, AFIS, Memex, the VoIP Digital Telephony System, WAN / LAN Communication Infrastructure. More advanced systems such as the Papiion System, the Arsenal System, the Witness Protection System, the SMIK Information System, ADAM, etc., are developed and used by local applications and databases of national interest and character. Throughout this paper, we discuss ways of building and using systems, as also ways of how to apply and make them work. And finally there are discussed strategies and perspectives on the development of state-of-the-art information technology and search applications for criminal activity documentation, along with recommendations for ongoing policies, are dealt with.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

ISBN 978-9928-210-06-7

ISSN 2413-1334

AKADEMIA E SIGURISË



9 789928 210067 >



**POLICIMI DHE SIGURIA**

**NËNTOR 2017**



**AKADEMIA E SIGURISË**

Qendra Kërkimore Shkencore  
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



**NR**

**9**